RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "PËR PËRPUTHSHMËRINË E AKTIVITETIT TË INSTITUCIONIT" PËR AUDITITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË VENDORE TË ASHK(ish ZVRPP) GJIROKASTËR

SHTATOR 2019

faqe

	***Përmbajtja*.....**	1
I	**PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE**.....	3-9
II	HYRJE(Të dhena për Raportin Përfundimtar)	9-12
a	Objektivat dhe qëllimi.....	
b	Identifikimi i çështjes.....	
c	Pergjegjësia e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	
d	Përgjegjësitë e audituesëve.....	
e	Kriteret e vlerësimit	
f	Standardet e Auditimit	
II	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....**	12
III	**GJETJET DHE REKOMANDIMET.....**	13- 200
1.	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Auditimi i mëparshëm	13-29
2.	Auditim mbi proçedurat e regjistrimit fillestar dhe pranimin e dokumentacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga ligji nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve", Ligji nr. 7699, datë 21.04.1993 "Për Kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës Bujqësore", i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin e Kompensimin e pronës i ndryshuar".	29-30
3.	Auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimit të tokës bujqësore të përfituar nga Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën" i ndryshuar; Ligji nr. 8053, datë 21.12.1995 "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore", Ligji nr. 8312 datë, 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", për periudhën e adutimit dhe transaksioneve të kryera me këto prona.	31-77
4.	Auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për vlerësimet periodike të kufizimeve të vendosura nga KLSH, ZQRPP dhe vetë regjistruesi, ose nga institucione të tjera që e kanë kompetencë.	77-77
5.	Auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga Privatizimi për periudhën e auditimit dhe transaksioneve të kryera me këtë pasuri sipas kontratave të shitblerjes të objekteve shtetërore nga (Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave dhe Pushteti Vendor).	77-91
6.	Auditim mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e objekteve me leje Legalizimi në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, Urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" të ndryshuar dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kritereve, proçedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm për kualifikimin e objekteve", i ndryshuar me VKM nr. 40, datë 11.01.2012.	91-107
6/1	- Auditim mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e objekteve me leje ndërtimi mbi troje publike dhe private, në zbatim të ligjit nr. 8405, datë 17.09.2008 "Për Urbanistikën" i ndryshuar , dhe ligjin 10119, datë 21.04,2009, i ndryshuar, për periudhën e adutimit dhe transaksioneve të kryera me këto prona.	107-125
7.	Auditim mbi procedurën e ndjekur për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga vendime gjyqësore të formës së prerë.	125-133

8.	Auditim mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme, në bazë të nenit 24/b të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e Pasurisë së paluajtshme", ndryshuar me 25/b, ligjit nr/ 33, datë 20.03.2012"Për regjistrimin e Pasurisë së paluajtshme",.	133-147 147-152
9.	Auditim mbi regjistrimin e pasurive me mbivendosje me prona të regjistruara më parë, evidentimi i tyre nga ZVRPP.	152-152
10.	Regjistrimi i pasurive Publike të transferuara dhe Administrimi i tyre.	152-157
11.	Auditimi i praktikave në proces dhe shërbimi i ZVRPP ndaj Kërkesave të qytetarëve. Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit dhe indicet e ankesat e administruara në KLSH.	157-163
12.	Të ndryshme dhe trajtimi i indiceve të ardhura nga qytetarë në KLSH	163-163
	Rekomandimet	163-190
IV	**KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT**	190-191
V	**ANEKSE**	193-197
VI	**DOKUMENTE SHOQËRUESE**	- -

I- PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.a. Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës(DVASHK)(ish ZVRPP) Gjirokastër është audituar çdo 2-3 vjet nga institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, ku në vazhdimësi janë konstatuar mangësi e shkelje. Gjatë auditimit të kryer me zgjedhje për periudhën nga data 01.01.2016 deri me 31.05.2019, janë konstatuar mangësi e shkelje, që kanë ardhur kryesisht nga ndryshimet e shpeshta të drejtuesve dhe punonjësve të institucionit, shoqëruar me një nivel të ulët profesional dhe mungesë eksperience dhe profesionalizmi, si dhe nga një kuadër legjislativë me mangësi. Ky nivel i ulët menaxhimi ka ardhur si rezultat i lëvizjeve të drejtuesve në kohë të ndryshme. Auditimi i përputhshmërisë së aktivitetit të DVASHK(ish ZVRPP) Gjirokastër paraqet një rëndësi në lidhje me informimin dhe evidentimin e shkeljeve për vendosjen e rekomandimeve në lidhje me përmirësimin e punës në të ardhmen.
I.b. Nga auditimi janë konstatuar një sërë shkeljesh e parregullsish, të cilat të ndara sipas fushave përkatëse, i përkasin kryesisht: Regjistrimit të tokës bujqësore të përfituar nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991; Regjistrimi dhe kryerja e transaksioneve për pasuritë e përfituar nga ligji nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për Kthimin e kompensimin e pronave ish pronarëve"; Regjistrimi dhe kryerja e transaksioneve për pasuritë e përfituar nga privatizimi dhe kontratat e shitblerjes së pronave shtetërore(Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave, Pushteti vendor); Regjistrimi i pasurive të përfituara me leje legalizimi, në bazë të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006; Regjistrimi i pasurive të përfituara me leje ndërtimi, në bazë të ligjeve të urbanistikës, etj, të përmbledhura si më poshtë:

-Gjetje: DVASHK**(**Ish ZVRPP) Gjirokastër në **1 rast**, me referencë nr. 15141, ZK 8541, ka kryer veprime dhe ka ofruar shërbimin e kërkuar, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi* dokumentacioni i origjinës së fitimit të pronësisë (Vendimi i KKKP Gjirokastër nr. 151, datë 22.09.2000), ***nuk është origjinal, por fotokopje i panoterizuar*** dhe i pa konfirmuar nga institucioni që e ka lëshuar aktin administrativ(ATP) sa vepruar ***në papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" dhe dhe Regulloren nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar.
Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren"**, bazuar në shkeljet e**

konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 65/1, volum 29, faqe 67, ZK 8541, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

-Gjetje: DVASHK**(**Ish ZVRPP) Gjirokastër në **1 rast**, me referencë nr. 11569 dhe 15790, ZK 8541, ka kryer veprime dhe ka ofruar shërbimin e kërkuar, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore,* ***pasi dokumentacioni i fitimit të pronësisë nuk ka përcaktuar njohje dhe kthim të truallit, ndërsa nga punonjësit e ZVRPP janë kryer veprime të lëshuar vërtetim pronësie, sa*** vepruar në ***në papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit", Regulloren nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar.

Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 13/137, volum 35, faqe 136, ZK 8541, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

-Gjetje: Ish ZVRPP Gjirokastër në 7 **raste** sipas referencave: nr. 085, nr. 089 e nr. 090, nr. 091, ZK 1640; nr. 0218, ZK 2030; nr. 0218, nr. 0155, nr. 0169, nr. 0178 dhe nr. 0161, ZK 3580, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme truall+ndërtesë në zonat urbane të fshatrave, nga të cilat ***në 2 raste,*** *janë regjistruar për të njëjtën familje 2 e më shumë pasuri truall dhe ndërtesë, duke mos zbatuar kërkesat ligjore,* pasi ***dokumenti ligjor "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", nuk plotëson kushtet për të shërbyer si Titull Pronësie, ndërsa është regjistruar në total*** trualli me sipërfaqe ***2400 m²*** dhe ndërtesa me sipërfaqe totale ***1017m²,*** sa vepruar **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25 të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", VKM nr. 432, datë 14.08.1995"Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", i shfuqizuar dhe Urdhrin e Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2013.

Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për në **7 rastet e sipërcituara dhe në të gjitha rastet e ngjashme**, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

-Gjetje: Ish ZVRPP Gjirokastër sipas referencës nr. 167, ZK 3580, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme për poseduesit e AMTP-së nr. 825, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore*, pasi është regjistruar një sipërfaqe toke në total prej ***1730 m²,*** më tepër se sipërfaqja takuese sipas AMTP-së përkatëse, sa vepruar **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25 dhe pikën 2 neni 45, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP);

Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë e regjistruara sipas AMTP-së nr. 825, referencë nr/ 0167, ZK 3580, deri në veçimin e regjistrimin në pronësi "shtet", të sipërfaqes së përfituar padrejtësisht, në zbatim të procedurave të përcaktuara në VKM nr. 994, datë 9.12.2015, e ndryshuar.

-Gjetje: Ish ZVRPP Gjirokastër në **3 raste**, sipas referencave: nr. 085, nr. 089, 09, ZK 1640 dhe nr. 0155, ZK 3580, ka regjistruar pasuri të paluajtshme dhe ka kryer transaksione, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore,* pasi për një trung familjar janë lëshuar 2 e më shumë AMTP, duke shkelur kriterin e ndarjes së tokës sipas normës për frymë të çdo fshati, dhe ndarë tokë në mënyrë të pa barabartë, për rrjedhojë nga regjistrimi i tyre ***kanë përfituar më tepër në total tokë me sipërfaqe 27700 m²,*** se sipërfaqja takuese sipas normës për frymë, bazuar në përbërjen familjare me datë 01.08.1991, sa vepruar **në papajtueshmëri** me pikën 2 neni 3, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën

bujqësore" dhe në pikën 2, të VKM-së nr. 255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës", e ndryshuar, përsa i përket regjistrimit të pasurive tokë bujqësore të ndara me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar.

Rekomandim 6: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë në **3 rastet e sipërcituara** deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015, si dhe të dërgojë AMTP-të përkatëse, për vlerësim dhe shqyrtim ligjor nga institucionet përkatëse kompetente.

-Gjetje: Ish ZVRPP Gjirokastër në **1 rast**, ka regjistruar pasuri të paluajtshme dhe ka kryer transaksione, *në favor* të poseduesit të AMTP-së me referencë nr. 11577, zk 8541, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi rezulton se* AMTP-së nr. 7482, datë 24.05.1996, me posedues [redacted], ***i mungon njëra nga vulat, që është një ndër elmentët bazë që duhet të plotësojë ky akt,*** ndërsa ZVRPP Gjirokastër, nuk duhet të procedonte me kryerjen e veprimeve duke lëshuar dokument pronësie, por duhet ti drejtohej KVVTP pranë Prefekturës së Qarkut Gjirokastër, për të konfirmuar vlefshmërinë ligjore të AMT-së, veprim **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", UKM Nr. 2, datë 13.06.2013 "Për Mënyrën e Procedimit të organeve të administratës publike për pasuritë e paluajtshme, të fituara me aktin e marrjes së tokës në pronësi (amtp)", pikën 2.2, germa ç, të UKM Nr. 994, datë 9.12.2015.

Rekomandim: Drejtori i Drejtorise Vendore ASHK Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë e përfituara me AMTP nr. 7482, datë 24.05.1996, me posedues [redacted], ZK 8541, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015.

-Gjetje: Ish/ZVRPP Gjirokastër **në 2 raste** ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: Origjina e pronës është kontrata e shitblerje Seksioni i financës Rrethi Gjirokastër datë 31.05.1995 ***organ i cili nuk ka patur tagër ligjor për kryerjen e shitjes së trojeve. Vendimi i Gjykatës nuk shprehet për ZVRPP Gjirokastër në cilësinë e të padituri në mungesë, vendim i cili nuk është ankimuar brenda afatit 15 ditor në Gjykatën e Apelit Gjirokastër. Nuk është bërë verifikimi nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër***. Veprime këto në papajtueshmëri me pikat 8.1, kreu IV të Rregullores Nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të UKM nr. 2, Datë 12.09.2012 me pikën II.i. pikën II.iii. të shkresë nr. 1969 prot, datë 23.03.2012 të ZQRPP ne dokumentin nr. 892 prot. datë 07.02.2008, shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5348 prot., date 18/10/2011, dhe shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5985 prot, date 16/11/2009. Udhëzimi nr. 79, datë 09.05.2003 i ZQRPP "Regjistrimi fillestar sporadic të pasurive të pa lujtshme në zonat urbane".

Rekomandim: Drejtori i Drejtorise ASHK Gjirokastër të marrë masa, që në bazë të pikës pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë** volum 8, faqe 41, nr. 8/132 **ZK 8542, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

-Gjetje: Ish/ZVRPP Gjirokastër **në 1 rast** ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***Mungon origjina e pronës, gjithashtu nuk është bërë verifikimi nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër***.

Veprime këto në papajtueshmëri me pikat 8.1, kreu IV të Rregullores Nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 "Për punën e zyrës se regjistrimit te pasurive te paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 me pikën II.i. pikën II.iii. të shkresë nr. 1969 prot, datë 23.03.2012 të ZQRPP. ne dokumentin nr. 892 prot. datë 07.02.2008, shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5348 prot., date 18/10/2011, dhe shkresën e Kryeregjistruesit nr.

5985 prot, date 16/11/2009. Udhëzimi nr. 79, datë 09.05.2003 i ZQRPP "Regjistrimi fillestar sporadic të pasurive të pa lujtshme në zonat urbane".

Rekomandim: Drejtori i Drejtorise ASHK Gjirokastër të marrë masa, që në bazë të pikës pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë** volum 8, faqe 125, nr. 2/261 **ZK 8542, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

-Gjetje: ZVRPP Gjirokastër në **3 raste** që ju përkasin referencat : nr. 16621, nr. 15664 dhe nr. 15021, ZK 8541, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme përfituar me leje legalizimi, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi lejet e legalizimit kanë miratuar parcela ndërtimore,* me sipërfaqe më tepër se sipërfaqja takuese sa trefishi i sipërfaqes së bazës së objektit, ndërsa *nga ZVRPP Gjirokastër, nuk janë verifikuar elementët e formës e përmbajtjes së Aktit Administrativ të Lejes së Legalizimit në lidhje me sipërfaqen e parcelës ndërtimore,* për rrjedhojë është miratuar në favor të poseduesëve të lejeve të legalizimit, më tepër ***trualli me sipërfaqe totale prej 263.6 m²,*** sa vepruar në papajtushmëri me shkronjën"a" neni 25, nenin 49, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 17 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar dhe me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".

Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi në 3 raste** për pasuritë sipas referencave të sipërcituara, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Gjithashtu në bashkëpunim me Sektorin e ALUIZNI-t, në Drejtorinë e ASHK Gjirokastër, të ndiqen procedurat e lekujdimit me çmimin e tregut, për truallin e tepërt të përfituar padrejtësisht nga poseduesit e lejeve të legalizimit.

-Gjetje: ZVRPP Gjirokastër në **1rast** me referencë nr. 0159, ZK 3580, ka regjistruar në volum 5, faqe 136, pasurinë nr. 147/362, truall me sipërfaqe 438 m² dhe ndërtesë 2 kat me sipërfaqe ndërtimi 146 m², me funksion përzier, përfituar me leje legalizimi, ***e cila është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi objekti i legalizuar bie mbi pasurinë shtet të llojit "rrugë", për*** sipërfaqen 76 m², ***ndërsa*** ZVRPP, nuk duhet të procedonte me regjistrimin e kësaj pasurie, sa vepruar në kundërshtim me germën "a", neni 25, pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit", ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar dhe VKM nr. 280, datë 01.04.2015.

Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë** nr. 147/362, volum 5, faqe 136, ZK 3580, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor apo konfirmimin zyrtar nga institucionet kompetente, që kjo pasuri "rrugë" ka ndryshuar destinacion dhe nuk shërben për interesa publike.

-Gjetje : ZVRPP Gjirokastër **në 1 rast** ka regjistruar dhe ka kryer veprime sipas referencave nr. 14903, për pasurinë nr. 20/98 në RH nr. 42, datë 27.01.2016, **truall me sipërfaqe 2182 m².** Ku konstatohen shkelje dhe parregullsi, pasi *bashkimi i pasurive në pasurinë nr. 20/83, dhe më pas ndryshimi i zërit kadastral nga pyll në truall, janë kryer sipas dokumentacionit urbanistik i paraqitur dhe i miratuar nga KRRT e Bashkisë Gjirokastër, i cili përcakton rrethim provizor dhe nuk ka të miratuar ndërtim objekti,* në kuptim të nenit 3, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për

Disiplinimin e Punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, për të cilat miratohet leja e shfrytëzimit dhe plotësohet dokumentacioni përkatës, sipas nenit 13 të këtij ligji.
Gjithashtu, konstatohet se gjatë formimit të pasurisë kryesore nr. 20/83, regjistruar në RH. nr. 114, datë 12.03.2010, truall, me sipërfaqe 2400 m^2, ***rezulton se është eleminuar kufizimi i mëparshem(në jug) me "përrua",*** i cili nuk është pasqyruar në hartën e punës si pasuri, me të cilën kufizohet dhe në vend të saj është vendosur kufizimi me pasurinë nr. 20/63.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me shkronjën "a" neni 24, të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit" dhe Regulloren nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar;
Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë** nr. 20/98, RH nr. 42, datë 27.01.2016, ZK 8541, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.
- Gjetje: Ish/ZVRPP Gjirokastër **në 1 rast** ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***Leja e sheshit planimetria e sheshit të ndërtimit dhe projekti i miratuar janë kopje, gjurma e sheshit të ndërtimit prek trotuarin pasuria me numër 16/101 e llojit trotuar, gjithashtu mungojnë marrëdhëniet me truallin***. Veprime këto në papajtueshmëri me "ç", "e", neni 20, shkronjën "a" neni 25,pikën 1 neni 48, neni 59 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe me nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998, ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 "Për Urbanistikën", i ndryshuar, nenin 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, pikën 1 të Urdhrit nr. 6 datë 21.01.2001 dhe pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012.
Rekomandim: Drejtori i Drejtorise ASHK Gjirokastër të marrë masa, që në bazë të pikës pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë në** regjistrin hipotekor nr. 54, datë 05.06.2017 pasuria nr. 16/64 **ZK** 8542**, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**
- Gjetje: Ish/ZVRPP Gjirokastër **në 1 rast** ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***Gjurma e truallit dhe e objektit prek pjesërisht rrugën me numër pasurie 16/54, Leja e sheshit Leja e ndërtimit planimetria e sheshit(studimi pjesor) të ndërtimit dhe projekti i miratuar janë kopje, projekti i miratuar nuk përputhet me kondicionet urbane të miratuar në sheshin e ndërtimit pasi në të numri maksimal i kateve është 8 ndërsa në projekt/planimetria kuota +3.06 paraqitet (nën/kat) nr.1, mungon kontrata e sipërmarrjes, në sheshin e ndërtimit sipërfaqja e ndërtimit është 496 ndërsa në regjistra 460***. Veprime këto në papajtueshmëri me "ç", "e", neni 20, shkronjën "a" neni 25,pikën 1 neni 48, neni 59 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe me nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 "Për Urbanistikën", i ndryshuar, nenin 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, pikën 1 të Urdhrit nr. 6 datë 21.01.2001 dhe pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012.
Rekomandim: Drejtori i Drejtorise ASHK Gjirokastër të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë** regjistrin hipotekor nr. 51, datë 12.03.2018 pasuria nr. 16/83 **ZK 8541, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

-Gjetje: ZVRPP Gjirokastër, nuk ka ndjekur rregullisht proceset gjyqësore, konstatuar në referncat nr. 16045 dhe 15061, duke rezultuar "në mungesë", në seancat përfundimtare të procesit gjyqësor, ***në të cilat ZVRPP Gjirokastër, ka qenë palë e paditur apo palë e trete,*** duke riskuar ankimimin brenda afateve të vendimeve të gjykatave, për të bërë të mundur ndjekjen e të gjitha shkallëve të gjykimit, sa vepruar në ***në papajtueshmëri me*** UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".

Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër, të nxjerrë urdhër dhe të autorizojë personat përkatës, që të bëjë të mundur përfaqësimin e institucionit, në të gjitha proceset gjyqësore, deri në përfundim të procesit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar, duke ndjekur brenda afateve ligjore, të gjitha shkallët e ankimimit.

-Gjetje : ZVRPP Gjirokastër **në 1 rast** ka regjistruar dhe ka kryer veprime sipas referencës nr. 15631, për pasurinë nr. 10/149, regjistruar në volum 35, faqe 158 dhe RH nr. 280, datë 17.07.2017, truallI me sipërfaqe 218 m^2, origjina e kësaj pasurie rrjedh nga Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjirokastër nr. akti 796 dhe nr. vendimi 682, datë 17.12.1999, i cili ka përcaktuar njohje të pasurisë truall me sipërfaqe 1277 m^2 dhe Vendimi i Gjykatës të Shkallës së parë Gjirokastër, nr. 00414, datë 30.06.1999, ka vendosur pjestimin e pasurisë truall me sipërfaqe 2278 m^2, rezulton se veprimet janë kryer në shkelje të dispozitave ligjore, pasi

- Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjirokastër nr. akti 796 dhe nr. vendimi 682, datë 17.12.1999, ka objekt njohje dhe është shprehur për njohjen e pronësisë në favor të paditësit, i cili nuk disponon dokumente dhe akte pronësie, duke paditur si palë Bashkinë Gjirokastër, e cila në fakt nuk është pronare e pasurisë së përfituar nga paditësi, në kuptom të nenit 195, të ligjit nr. të kodit Civil.

Gjithashtu ka një mos përputhje lidhur me sipërfaqet e përcaktuar në vendimin gjykatës për njohje dhe vendimit të gjykatës për pjestimin e pasurisë, duke ***krijuar një diferencë prej 1001 m^2(2278-1277), për të cilën mungon dokumentacioni i fitimit të pronësisë.***

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me shkronjën "a" neni 25, me pikën 2 nenin 45, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", neni 24/b i ligjit nr. 7843, datë 19.07.1994, i shfuqizuar, me pikën 5, UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" dhe Regulloren nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar.

Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë** 10/149, regjistruar në volum 35, faqe 158 dhe RH nr. 280, datë 17.07.2017, ZK 8541 dhe të gjitha pasuritë e tjera që rrjedhin nga Vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjirokastër, përkatësisht nr. akti 796 dhe nr. vendimi 682, datë 17.12.1999 dhe nr. 00414, datë 30.06.1999, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

-Gjetje : ZVRPP Gjirokastër **në 1 rast** ka regjistruar dhe ka kryer veprime sipas referencave nr. 14836 dhe nr. 8791, për pasurinë nr. 26/209, regjistruar në volum 35, faqe 13, truallI me sipërfaqe 390 m^2 dhe pasurinë nr. 26/210, regjistruar në volum 35, faqe 14, truallI me sipërfaqe 1520 m^2 dhe në RH nr. 213, datë 23.05.2016, që rrjedhin nga ndarja e pasurisë nr. 26/70, me sipërfaqe 1910 m^2, mbi të cilin ngihet banesë 1 kat e me sipërfaqe 110 m^2, regjistruar për hërë të parë në RH nr. nr. 248, datë 09.11.2009, ku si dokument origjine ka shërbyer *Vendimi Gjykatës së Rrethit Gjirokastër nr. akti 728 dhe nr. vendimi 599, datë 31.08.1992, i cili* është shprehur vetëm për njohje të pronësisë mbi ndërtesën, duke mos u shprehur në lidhje me truallin, për rrjedhojë regjistrimi ***i pasurisë truall me sipërfaqe 1910 m^2****, është kryer ne shkelje të dispoziatve ligjore,* ***pasi mungon dokumentacioni i që shërben si Titull Pronësie, sa vepruar në kundërshtim*** me germën "a" neni 24, të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" i shfuqizuar, me pikën 5, UKM nr. 2, datë 12.09.2012 dhe Regulloren nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar;

Rekomandim: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë** nr. 26/209, regjistruar në volum 35, faqe 13, truallI me sipërfaqe 390 m^2 dhe pasurinë nr. 26/210, regjistruar në volum 35, faqe 14, truallI me sipërfaqe 1520 m^2 dhe në RH nr. 213, datë 23.05.2016, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

II.c. ***Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit***

Nga auditimi i përputhshmërisë mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, (INTOSAI-t), Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualet e Auditimit të Përputhshmërisë, i kryer në Zyrën Vendore ASHK(ish ZVRPP) Gjirokastër, rezultuan devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi(kriteret), konkretisht:

- Aktiviteti i institucionit nuk ka qenë plotësisht efektiv në drejtim çështjeve që lidhen me vlerësimin e procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për regjistrim, veçanërisht në vlerësimin e përmbajtjes së dokumentacionit paraqitur për kryerje transaksionesh, regjistrime trojesh, regjistrime me leje legalizimi, regjistrime të ndërtimeve me leje ndërtimi, regjistrime me Aktet e Marrjes së Tokës Në Pronësi(AMTP) dhe transaksione ndryshimi pronësor, etj.
- Pamjaftueshmëri në përmbushje të funksioneve si një institucion që ka impakt të lartë social dhe ndikon direkt në vlerësimin dhe opinionin e qytetarëve për qeverisjen e vendit. Auditimet periodike kanë ndikuar në direkt në përmirësimin e mirëmenaxhimit të njësisë publike dhe mangësitë e evidentuara do të ishin minimizuar nga punonjësit e administratës së këtij institucioni, nëqoftëse do të kishte një nivel më të lartë të zbatimi të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.
- Janë regjistruar pasuritë e paluajtshme truall+ndërtesë në zonat urbane të fshatrave, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore,* pasi ***dokumenti ligjor "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", nuk plotëson kushtet për të shërbyer si Titull Pronësie,***
- Janë regjistruar pasuri të paluajtshme dhe janë kryer transaksione, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore,* pasi është shkelur kriteri i ndarjes së tokës sipas normës për frymë të çdo fshati, për rrjedhojë nga regjistrimi i tyre *kanë përfituar më tepër tokë* se sipërfaqja takuese sipas normës për frymë, bazuar në përbërjen familjare me 1.08.1991, sa vepruar në papajtueshmëri me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar.
- Janë regjistruar pasuri të paluajtshme përfituar me leje legalizimi, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi lejet e legalizimit kanë miratuar parcela ndërtimore,* me sipërfaqe më tepër se sipërfaqja takuese, ndërsa *nga ZVRPP Gjirokastër, nuk janë verifikuar elementët e formës e përmbajtjes së Aktit Administrativ.*
- Janë kryer regjistrime me *shkelje të dispozitave ligjore*, pasi *mungon dokumentacioni tekniko ligjor*, konkretisht: mungon akti i fitimit të pronësisë mbi truallin; *mungon konfirmimi* zyrtar nga institucionet përkatëse, lidhur me shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga përdorimi i truallit në pronësi "shtet", gjithashtu marrëdhëniet me truallin nuk janë sipas ligjit, etj.
- Nuk janë ndjekur rregullisht proceset gjyqësore, duke rezultuar "në mungesë", në seancat përfundimtare të procesit gjyqësor, ***në të cilat ZVRPP Gjirokastër, ka qenë palë e paditur apo palë e trete,*** duke rriskuar ankimimin brenda afateve të vendimeve të gjykatave, për të bërë të mundur ndjekjen e të gjitha shkallëve të gjykimit.

Mangësitë dhe shkeljet e konstatuara më sipër nën gjykimin profesional të audituesëve të pavarur të KLSH, janë materiale për devijimet e konstatuara në disa raste por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e ***një Opinioni të kualifikuar me rezervë*** *dhe për përmirësimin e gjendjes i është rekomanduar Drejtorisë Vendore ASHK(ish ZVRPP) Gjirokastër, marrja e masave përkatëse.*

II-Hyrje

Mbeshtetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Per Organizimin dhe Funksionimin ne e Kontrollit të Lartë të Shtetit, (këtu e në vazhdim KLSH) në zbatim të programit të auditimit nr. 372/1, datë 28/05/2019, ndryshuar ne nr. 372/2 dhe nr. 372/3, datë 17/07/2019, miratuar nga Kryetari i KLSH u krye auditimi në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kdastrës(ASHK) (ish ZVRPP), Gjirokastër, nga data 05.06.2019 deri më datë 09.08.2019 për periudhën nga data 01.01.2016 deri më datë 31.05.2019 (për probleme të veçanta me indicie, auditimi është shtrirë edhe në periudhat e mëparshme) "Mbi proçedurën e pranimit dhe administrimit të dokumentacionit per regjistrimin fillestar të pasurive të palujtshme, evidentimin dhe trajtimin ligjor të mbivendosjeve", nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. L K, (përgjegjës grupi)
2. A M, Auditues
3. D M, Auditues

Nga grupi i auditimit u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit mbi përputhmërinë dhe rregullshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DVASHK) Gjirokastër, *"Mbi proçedurën e pranimit dhe administrimit të dokumentacionit per regjistrimin fillestar të pasurive të palujtshme, evidentimin dhe trajtimin ligjor të mbivendosjeve"*, në tre kopje nga të cilat, dy kopje i dërgohen Drejtorisë Vendore të ASHK, Gjirokastër dhe një kopje protokollohet në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

a) Objektivat dhe qëllimi:

Objektivat: Vlerësimi i aktivitetit të institucionit lidhur me procedurën e pranimit dhe administrimit të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme dhe evidentimin dhe trajtimin ligjor të mbivendosjeve, performancën e punës në përmbushje të rritjes së transparencës së zyrës lidhur me shërbimin ndaj pubikut në lidhje zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë apo objektivave të përcaktuara me ndonjë plan strategjik zhvillimi afat shkurtër, apo afat mesëm të shkruar, në zbatim të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 *"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme"*, i ndryshuar.

Qëllimi: KLSH nëpërmjet një pune audituese sistematike dhe me zgjedhje të evidentojë deviacionet nga zbatimi i dispozitave ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 33/2012, datë 21.03.2012 dhe aktet e tjera ligjore apo nënligjore, mangësitë, shkeljet dhe parregullsitë si në drejtim të *procedurave të pranimit dhe administrimit të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme,* ashtu edhe në zbatimin e procedurave ligjore *për transaksionet e kryera,* lidhur me tarifat e aplikimit, përllogaritjes së tatimit të kalimit të pronësisë, nga strukturat e subjektit të audituar me qëllim, që auditimi ti shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës për të ardhmen, si dhe për të bërë të mundur që menaxherët e DVASHK-së Gjirokastër, të kuptojnë nevojën e domosdoshme të një strukture kompetente e cila do të bënte të mundur evidentimin në kohë të mangësive e shkeljeve me qëllim marrjen e masave në një kohë sa më të shpejtë për përmirësimin e gjendjes.

b) Identifikimi i çështjes.

1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.
2. Auditimi mbi procedurat e regjistrimit fillestar dhe pranimin e dokumentacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga ligji nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish- pronarëve", ligji nr. 7699, datë 21.4.1993 "Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore", i ndryshuar, dhe ligji nr. 9235 datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" i ndryshuar, për periudhën e auditimit dhe transaksioneve të kryera me këto prona.

3. Auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimit të tokës bujqësore të përfituar nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën" i ndryshuar; ligji nr. 8053, datë 21.12.1995 "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore", ligji nr. 8312 datë, 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", për periudhën e auditimit dhe transaksioneve të kryera me këto prona.
4. Auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për vlersimet periodike të kufizimeve të vendosura nga KLSH, ZQRPP, dhe vetë Regjistruesi, ose institucione të tjera që e kanë kopetencë.
5. Auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga privatizimi, për periudhën e auditimit dhe transaksioneve të kryera me këto prona:
a. Sipas kontratave të shitblerjes të objekteve shtetërore nga (Ministria e Ekonomisë dhe Pushteti Vendor).
b. Sipas kontratave të shitblerjes me EKB-në.
6. Auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e objekteve me leje legalizimi në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar VKM nr. 438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kritereve , të nprocedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm , për të kualifikuar objektet në ndërtim që legalizohen ose jo , i ndryshuar dhe VKM 40, datë 11.01.2012, për periudhën e auditimit dhe transaksioneve të kryera me këto prona.
- Auditim mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e objekteve me leje ndërtimi mbi troje publike dhe private, në zbatim të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën" i ndryshuar, për periudhën e auditimit dhe transaksioneve të kryera me këto prona.
7. Auditimi mbi procedurën e ndjekur për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga vendime gjyqësore të formës së prerë.
8. Auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme, në bazë të nenit 24/b, të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar me ligjin nr. 33, datë 21.03.2012 "Për Regjistrimin e pasurive të paluajtshme".
9. Auditimi mbi regjistrimin e pasurive me mbivendosje me prona të regjistruara më parë, evidentimi i tyre nga ZVRPP.
10. Regjistrimi i pasurive publike të transferuara dhe administrimi i tyre.
11. Auditim i praktikave në proces dhe shërbimi i ZVRPP ndaj kërkesave të qytetarëve. Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit dhe indicjet e ankesat e administruara në KLSH.
12. Të ndryshme dhe trajtimi i indicieve të ardhura nga qytetarë në KLSH.

c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:
Strukturat drejtuese të subjektit DVASHK Gjirokastër, mbajnë përgjegjësi për shkeljet dhe problematikat e konstatuara sipas çështjeve nën auditim, në lidhje me pranimin, regjistrimin dhe transaksionet e pasurive, kryer me mangësi dhe në shkelje të dispozitave ligjore, të përcaktuara nga ligji nr.33/2012, datë 29.04.2012 dhe të akteve ligjore e nënligjore të tjera, të evidentuara në akt-konstatimet e mbajtura dhe në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.
d) Përgjegjësitë e audituesve:
Për problematikat e trajtuara lidhur me çështjet nën auditim pikat 1,2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, etj në lidhje me pranimin dhe regjistrimin e pasurive dhe transaksionet e kryera, u konstatuan mangësi e shkelje në zbatim të ligjit nr.33/2012, datë 29.04.2012 dhe aktet nën ligjore në zbatim të tij, si dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore, duke ngarkuar me përgjegjësi kryesisht strukturat drejtuese të subjektit. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, në zbatim të këtyre standardeve janë respektuar kërkesat etike, si dhe është planifikuar dhe kryer auditimi, duke arritur nivelin e sigurisë së kërkuar.
e) Kriteret e vlerësimit:
Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit, në referencë me problematikën, është patur si kriter vlerësues në radhë të parë ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ligji nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar me ligjin nr.

33/2012 **"**Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", ligji nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve"; ligji nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", i ndryshuar; ligji nr. 7699, datë 21.4.1993 "Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore", i ndryshuar, ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën"; ligji nr. 8053, datë 21.12.1995 "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore"; ligji nr. 8312 datë, 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara"; udhëzimi i MBU nr. 106, datë 23.02.1996 "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore" dhe VKM nr. 161, datë, 08.04.1993 "Për disa shtesa e ndryshime në VKM nr. 452, datë 17.10.1992 "Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore"; ligji nr. 7980, datë 27.07.1995 "Për shitblerjen e trojeve"; ligji nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën", i ndryshuar; VKM nr. 315, datë 24.04.2003 dhe nr. 162, datë 07.03.2007 "Për dhënien me qira ose enfiteozë të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore", i ndryshuar; VKM nr. 35, datë 24.01.2007 "Për procedurat dhe format e shitjes së truallit, të pajisur me infrastrukturë për qëllime tregu"; VKM nr. 169, datë 13.03.2003 dhe nr. 703, datë 11.10.2006 "Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore apo të objekteve të veçuara, që i nënshtrohen privatizimit ose transformimit të tyre në shoqëri tregtare"; VKM nr. 704, datë 11.10.2006 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe për procedurën e shitjes"; VKM nr. 286, datë 2.6.2000 "Për kriteret e blerjes dhe shitjes së apartamenteve nga EKB në tregun e lirë të banesave"; ligji nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore"; ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat"; ligji nr. 8379, datë 29.07.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit"; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006"Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar VKM nr. 438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm , për të kualifikuar objektet në ndërtim që legalizohen ose jo , i ndryshuar dhe VKM 40, datë 11.01.2012, ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"; si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore në ndryshim dhe zbatim të tyre.

f) Standardet e auditimit

Auditmi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara, si rrjedhojë edhe Raporti Përfundimtar është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI dhe sigurohet se auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara.

III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT:

1. DVASHK Gjirokastër mbulon me aktivitet nje territor *që shtrihet në 98 zona kadastrale,* nga të cilat *4 zona urbane*(3 qyteti Gjirokastër dhe 1 qyteti Libohovë) dhe 94 *zona kadastrale fshat,* nga këto kanë kaluar në sistem regjistrimi fillestar 90 zona kadastrale, ndërsa 2 zona janë në proces regjistrimi, ndërsa 6 zona kadastrale nuk kanë kaluar në sitem regjistrimi. Kontrollit të Lartë të Shtetit e ka audituar këtë institucion çdo 2-3 vjet, ku janë konstatuar parregullsi dhe gjatë auditimit të kryer me zgjedhje për periudhën nga data 01.01.2016 deri me 31.05.2019, janë konstatuar mangësi e shkelje, që kanë ardhur kryesisht nga ndryshimet e shpeshta të drejtueseve dhe punonjësve të institucionit, si dhe nga një kuadër legjislativ me mangësi. Kjo ka sjellë si pasojë edhe një nivel të ulët të menaxhimit të veprimtarisë së subjektit. Auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së aktivitetit të DVASHK Gjirokastër, paraqet një rëndësi në lidhje me evidentimin e shkeljeve, për vendosjen e rekomandimeve, me qëllim përmirësimin e punës në të ardhmen.

2. Objekti i këtij auditimi është përputhshmëria e veprimeve të ndërmarra nga DVASHK(ish ZVRPP) Gjirokastër, për regjistrimin e pasurive, në zbatim të akteve administrative lëshuar nga organet që e kanë në kompetencë dhe vendimeve të gjykatave të formës së prerë, si dhe përmbushja e detyrave dhe sjellja me integritet e punonjësve të DVASHK(ish ZVRPP) Gjirokastër, për periudhën objekt auditimi, në raste të veçanta edhe para kësaj periudhe.

3. Qëllimi i auditimit***:*** është dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime.
4. Fushëveprimi: Auditimi është shtrirë në masën 20 % të veprimeve të kryera nga ish ZVRPP, duke audituar dokumentacionin me zgjedhje, të specifikuar në zona kadastrale dhe sipas regjistrave kadastral, pa u kufizuar gjatë auditimit.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëpërshëm

Në zbatim të kësaj pike të programit, u krye auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për përmirësimin e legjislacionit, marrjen e masave organizative, të masave disiplinore dhe të zhdëmtimit, të rekomanduara në përfundimet e auditimit nga KLSH për misionin e mëparshëm të realizuar në këtë objekt, ku rezultoi se:
Në përfundim të Auditimit me shkresën nr. 1102/11, dt. 13.05.2016, të Kryetarit të KLSH-së është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet për auditimin e ushtruar me programin nr. 1102/1, dt. 03.12.2015, ndryshuar me programin nr. 1102/3, dt. 09.02.2016 dhe nr. 1102/4, datë 29.02.2016.
Në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", brenda 6 muajve nga marrja e shkresës, *nga ana e* ZVRPP Gjirokastër *është kthyer përgjigja me shkresën përcjellëse nr. 1641/1, dt. 10.11.2016, me tonën 1102/18, datë 14.11.2016 me njoftim për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH.*
Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 81 rekomandime gjithsej, nga këto: 1 masë për përmirësim ligjor, 67 masa organizative dhe 13 masa zhdëmtimi me vlerën *20,680,521* lekë.
Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- ***a.*** *Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 1 masë për përmirësim ligjor, 67 masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht 67, nga këto janë zbatuar 33 rekomandime, janë në proces zbatimi 20 rekomandime dhe nuk janë zbatuar 14 rekomandime, nga të cvilat 4 i përkasin ZQRPP Tiranë.*
- ***b.*** *Për shpërblim dëmi janë lënë 13 rekomandime për shumën 20,680,521 lekë të arkëtueshëm, të cilat janë pranuar dhe janë në proces zbatimi 13 rekomandime në vlerën 20,680,521 lekë, pasi janë bërë njoftimet përkatëse, si dhe janë vendosur kufizimet mbi pasuritë, por në vijimësi do të ndiqen rrugët ligjore për arkëtimin e kësaj shume. Nga kjo vlerë totale e konstatuar si dëm e ekonomik, në rekomandimin nr. 2, seksioni B '"Masa Shpërblim dëmi", ZVRPP-së Gjirokatër i është rekomanduar marrja e masave kufizuese për pasuritë, si dhe njoftimi i Bashkisë Gjiroakstër për masat e marra, ndërsa ndjekja e rrugësve për shpërblim dëmi i është rekomanduar Bashkisë Gjirokastër.*

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

A. MASA PËR PËRMIRËSIM LIGJOR

Rekomandim 1: Ministri i Drejtësisë dhe ZQRPP Tiranë të kërkojnë ndryshimin e Dekretit nr. 5747,datë 29.6 1978 "Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve dhe të fshatrave", ose të hartojnë me një akt tjetër normues ku të përcaktohet : "Trualli për efekt regjistrimi për banesë para vitit 1991 Zonat Urbane Rurale të fshatrave të jetë në kufijtë fizik deri në 500 m^2, duke përfshirë këtu dhe Sipërfaqja e truallit për nevojat plotësuese të një familje bujqësore rurale" argumentuar si vijon:

Në auditimet e kryera, në regjistrimin e trojeve të shtëpive ekzistuese të banimit para v.1991 në Zonat Urbane Rurale të fshatrave i jemi referuar normës truallit deri në 300 m^2 përcaktuar në Dekretin nr. 5747,datë 29.6 1978, Dekret tashmë i tejkaluar qysh pas viteve 1990 dhe për faktin sepse ky Dekret nuk është shfuqizuar dhe nuk është hartuar ndonjë akt ligjor a nën ligjor tjetër në zëvendësim të tij .
Referimi në normën e truallit 300 m^2, ka sjellë si pasojë edhe rekomandimet e KLSH për veçim dhe regjistrim "shtet" apo kufizime të sipërfaqeve tepër e mbi këtë normë. Rekomandimi i diktuar nga zbatimi i Dekretit për sipërfaqen tepër jo vetëm është praktikisht e pamundur pë zbatim por mendohet edhe i padrejtë ndaj familjeve të zonave rurale, fshatare, sepse ky referim në kufirin 300 m^2, në Dekretin e vitit 1978 është i tejkaluar sepse vetë Dekreti i referohet kushteve të ekonomisë së centralizuar për pasojë kjo normë parashikonte vetëm nevojën për banesë duke përjashtuar dhe mos përfshirë nevojat për truall me funksion ndihmës si për ngrehina për mbulim të aktivitetit individual bujqësor mbajtjen e veglave, mjeteve të punës, kafshe pune e prodhimi, shpendë shtëpiak, depozitim prodhimesh bujqësore; nevoja të cilat në kohën e Dekretit mbuloheshin nëpërmjet veprimtarive dhe ambienteve të kolektivizuara si depo, stalla magazina, pulari, SMT etj . Ndërsa pas vitit 1991 këto nevoja (të pa përfshira në normën 300 m^2 të Dekretit) bëhen domosdoshmëri e familjeve fshatare për zhvillimin e aktivitetit bujqësor e blegtoral shmangien e pasojave sociale në stimulimin e lëvizjes nga zonat rurale në zona urbane, si dhe për mbështetje edhe të zhvillimit bujqësor rural si degë e rëndësishme zhvillimi për vendin tonë

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, por për zbatimin e tij, është në proces.

B. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandim 1: ZVRPP Gjirokastër, Regjistruesi të marrë masat për inventarizimin e dokumentacionit, evadimin sipas një programi të posaçëm të *3287 praktikave,* kërkesave në proces të pa përfunduara prej 5-10 vitesh deri ne vitet 2015, të analizohen dhe kthehen të ardhurat e përfituara pa dhënë shërbimin e faturuar në vlerën *9,909* mijë lekë, me pasojë mungesën e transparencës së ZVRPP Gjirokastër ndaj publikut, si dhe të administrohen në arkiv dokumentacioni përkatës, në zbatim të legjislacionit më sipër, sipas tabelës analitike "Përmbledhëse e Praktikave të papërfunduara në proces dhe të ardhurat e përfituara shërbim prej para Vitet 2012- 2015".
Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar, dhe vazhdon në vijimësi, pasi në zbatim të urdhrit të brendshëm, specialistët e ZVRPP Gjirokastër kanë përfunduar procesin e inventarizimit për të gjitha praktikat e aplikuara para datës 01.05.2016, si dhe numri tyre është reduktuar në mënyrë të konsiderueshme.
Rekomandim 2: ZQRPP dhe ZVRPP Gjirokastër të ndjekin hapat e duhur ligjor për instalimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të vendosin Sistemin e Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) si dhe të hartojnë, miratojnë e zbatojnë *R*regulloren e brendshme të Funksionimit të Administratës së ZVRPP Gjirokastër, si njësi e vetme në territorin vendor, bazuar ne organikat dhe organigramën dërguar nga Kryeministri me urdhrat nr. 196, datë 4.8.2014 "Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Urdhrin nr. 33, datë 2.4.2013 të Kryeministrit". Në Rregullore të përfshihen, përcaktohen, shkruhen, kushtet e pranimit, testimit fillestar të aftësive profesionale dhe trajnimit në vazhdim të punonjësve në ZVRPP, statusi i të punësuarve, përcaktimi i kryerjes së detyrave, ushtrimi i kompetencave dhe mbajtja e përgjegjësive për secilin specialist, Regjistrues, zv .Regjistrues juristëve dhe punonjës të tjerë, si dhe detyrimet lidhur me përgatitjen e evidencave informacionit në tërësi dhe administrimin e dokumentacionit; si dhe për të gjitha këto procese dhe të punësuar të përcaktohen e *vendosen SMKB (Sistemit të Mekanizmave*

të Kontrollit të Brendshëm) masa këto të detyrueshme në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe pjesërisht i zbatuar pasi ZQRPP Tiranë nuk ka informacion lidhur me ecurinë e zbatimit të këtij rekomandimi.

Rekomandim 6: ZVRPP Gjirokastër dhe ZQRPP Tiranë të marrin masat për eliminimin e bashkëpronësisë së paligjshme në ***78 Kartela*** Pasurie të Paluajtshme (KPP) në 12 zona kadastrale për ***12 fshatra,*** të përfshira në sistem në vitet 1999,2000,2001, me sipërfaqe me ***1,357,447 m²*** ndarë: ***151,335 m² arë, 253,902 m² vresht*** dhe ***952,260 m² pemëtore*** përkatësisht për ***1107 Familje bujqësore Bashkëpronare, të kryeje menaxhimin e 12 zonave Kadastrale të*** identifikojë e çelë 1107 KPP-të në përputhje me AMTP dhe listat përkatëse *si dhe* të rekomandojë e zbatojë rrugën administrative të zgjidhjes së bashkëpronësisë në bashkëpunim me DAMT e NJQV pasqyruar në tabelën "**PASURITË BUJQËSORE NË BASHKËPRONËSI PËR DISA ZONA KADASTRALE*".***

Deri datë 30.6.2016

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, por i pa zbatuar, pasi ZQRPP Tiranë nuk ka kthyer përgjigje, si dhe nuk ka informacion lidhur me ecurinë e zbatimit të këtij rekomandimi.

Rekomandim 7: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër të marrë masa, për të inventarizuar dhe çelur dosjet përkatëse për ***42 kërkesa*** për informacion, verifikim, konfirmim gjendjes juridike të Titujve të pronësisë së tokës bujqësore (ndarë 3 jashtë juridiksioni dhe 39 në juridiksion, prej të cilave ***17*** janë pa përgjigje dhe ***20 kërkesa*** me përgjigje të pa sakta e të pa plota); gjithashtu për ***8 Kërkesa*** që ZVRPP Gjirokastër ka drejtuar KVVTP për verifikim e vlerësim të titujve të pronësisë, prej të cilave 4 janë me përgjigje dhe 4 kërkesa nuk kanë përgjigje të KVVTP); të konfirmojë realisht dhe saktësisht gjendjen juridike të pasurive me AMTP sikundër trajtuar në Raport, pasqyruar në tabelën:"MARREDHENIET KVVTP-ZVRPP DHE ANASJELLTAS PER VLERËSIMIN E TITUJVE TË PRONËSISË ME AMTP VITI 2012-2015 ZVRPP GJIROKASTER viti 2012-2015".

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi, pasi nuk ka përfunduar veçimi i sipërfaqeve të tepërta.

Rekomandim 9: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër të nxjerrë urdhër kufizimi,në bazë të neneve 59, 60 dhe 74 të ligjit nr33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe të veçojë e çelë KPP –të, dhe të regjistrojë "shtet" *për 12 pasuritë me sipërfaqe tepër +1748 m² arë* për të cilat kërkuar konfirmimi për verifikim nga KVVTP, të rezultuar me *sipërfaqe e tepër norme mbi AMTP që janë dhe me mangësi në forme e në përmbajtje dhe që nuk ka veprime në KPP përkatësisht:*

1. AMTP nr. 4779/1, datë 15.7.2000, sipërfaqe tepër +274 m² Pasuria nr. 76/29, v. 7, f. 234 zk. 2392 arë R1 3000m² me Ln 3220 m² *tepër + 220 m²*, Pasuria nr. 266/3/6, v.9, f. 14 zk. 2392 arë R2 3000 m² me Ln 3054 m² *tepër + 54 m²*.

2. AMTP nr. 4802/1, datë 15.7.2000 me sipërfaqe tepër + 117 m² tepër në pasuritë
Pasuria nr. 36/37, v. 6, f. 139 zk. 2392 arë R2 3000m² me Ln 3074 m² *tepër + 74m²*,
Pasuria nr. 76/17, v.7, f. 222 zk. 2392 arë R2 1160m² me Ln 1203 m² *tepër + 43 m²*,

3. AMTP nr. 4801/1, datë 15.7.2000, me sipërfaqe tepër 128 m² që u përket 2 pasurive përkatësisht:-pasuria nr. 266/1/5, v. 8, f. 237 zk. 2392 arë R2 3000m² Ln 3085 m² *tepër + 85 m²*,
-Pasuria nr. 76/18, v. 7, f. 222 zk. 2392 arë R1 me 1160m² Ln 1203 m² *tepër + 43 m²*,

4. *AMTP nr. 4800/1, datë 15.7.2000, me 2 pasuri arë me sip,4160 m^2, me sipërfaqe tepër 118 m^2* ,-Pasuria nr. 36/38, v. 6, f. 140 zk. 2392 arë R1 3000 m^2 me Ln 3076 m^2 *tepër + 76 m^2,* -Pasuria nr. 76/22, v. 7, f. 227 zk. 2392 arë R2 1160m^2 me Ln 1202 m^2 *tepër + 42 m^2,* `
5. AMTP nr.1677, datë 8.3.1993, me total nga 10240 m^2 ka 10724 m^2, *me sipërfaqe tepër +484 m^2 KPP pasuria nr. 18/9, v.1, f.fq 31, zk.2609, vresht 520 m^2 me 835 m^2, tepër + 315 m^2 KPP nr. 252/9, v.2, f.233, zk.2609, arë 1800 m^2 me 2104 m^2, tepër + 304 m^2, dhe veçojë 169 m^2* .
6. AMTP nr. 4919, pa datë lëshimi K/F Ali Rakip Skëndi me 8 pjesëtarë (përfshirë dhe dy bijtë), gjendje familjes v.1991 me 4 pasuri me sipërfaqe 16780 m^2 dhe dy prestarë bijë sipas gjendjes v.1991 të familjes e cila disponon 3 AMTP përkatësisht:

AMTP nr. 4919, pa datë,	4 pas 16780 m^2, LN 17157, tepër +377m^2
AMTP nr. 4919/1, datë 15.7.2000	1 pas 3000 m^2, LN 3099 m^2, tepër + 99 m^2
AMTP nr. 4919/2, datë 15.7.2000	1 pas 3000 m^2, LN 3101 m^2, tepër + 101 m^2
Shuma e Familje me 8 pjesëtarë	6 pas 22780 m^2, LN 23357 m^2, tepër + 577 m^2

ku nuk është veçuar e regjistruar shtet sipërfaqja tepër +577 m^2, nga e cila janë leshur certifikata për 294 m^2 tepër, ndërsa për 283 m^2 nuk ka transaksion e nuk është veçuar shtet.
7. AMTP nr. 1123, datë 20.10.1992 në emër të *Vejsel Safet Cafaj* me 3 pasuri me sipërfaqe 12300 m^2, *me sipërfaqe tepër +484 m^2* -KPP pas nr. 26,v. 1, f. 71 zk. 3058 arë me sip 10900 m^2 sipas AMTP RII dhe 11244 m^2 sipas LN, pra sipërfaqe tepër *+344 m^2*.

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, por nuk është zbatuar plotësisht, pasi megjithëse ka urdhër për kufizimin e pasurive, rezulton i pa zbatuar për të gjitha pasuritë..

Rekomandim 11: ZVRPP Gjirokastër dhe ZQRPP Tiranë të kryejnë menaxhimin e ZK 2156 fshati Klishar sipas AMTP-ve për *414 pasuritë* e llojit pemëtore, hyrë në sistem në janar 2001 të identifikoje, çelë dhe plotësojë *164* KPP të vol.1 dhe *250* KPP të vol. 2, zk. 2156 fshati Klishar të pasurive lloji pemëtore e pasuri të tjera bujqësore sipas AMTP-ve të disponuar nga K/familjarët e fshatit Klishar.

Deri datë 31.7.2016

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, por i pa zbatuar, pasi ZQRPP Tiranë nuk ka kthyer përgjigje, si dhe nuk ka informacion lidhur me ecurinë e zbatimit të këtij rekomandimi.

Rekomandim 13: ZVRPP Gjirokastër të marrë masa të nxjerrë urdhër të posaçëm të fshijë regjistrimet për ***9 kontratat (***kontratat nr. 2994 me 2 pasuri, nr. 1211 me 2 pasuri, nr.1345 me 1 pasuri, nr. 1399 me 3 pasuri përkatësisht sipas tabelës I,II,III,IV,V,VI,VII, IX,X) me objekt dhënie përdorimi e qiraje në seksionin "D", të KPP-ve të pasurive pasqyruar tabelën "**Kontrata dhënie përdorimi dhe qiraje të PPL Shtetërore e Publike të aplikuara për regjistrim dhe të regjistruara nga ZVRPP Gjirokastër v. 2013, 2014 dhe 2015**", të kthejë zyrtarisht dokumentacionin (kontratat e Përdorimit dhe Qirasë të regjistruara dhe të pa regjistruara v. 2015) personit fizik dhe Njësisë Qeverisjes vendore që ka juridiksionin, Bashkisë Gjirokastër.

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi, pasi nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për të bërë të mundur fshirjen e regjistrimit për 9 kontratat, sipas rekomandimit të KLSH-së.

Rekomandim 14: ZQRPP Tiranë dhe ZVRPP Gjirokastër, të fillojnë procedurat ligjore,(të neglizhuar dhe pa zbatuara me parë me pasoja subjektive dhe cenimit të paanësisë së ZVRPP ndërmjet palëve), të hartojnë dokumentacionin përkatës ligjor dhe të ndjek procedurat ligjore dhe ecurinë e procesit gjyqësor, lidhur me *40 pasuri* me sipërfaqe totale *17100,9 m^2* të llojit truall

dhe ndërtesa ndarë: *12 pasuri me sipërfaqe 7360 m²* në vitin 2009, *10 pasuri me sipërfaqe 3441 m²* në vitin 2010, *7 pasuri me sipërfaqe 742,5 m²* në vitin 2011, *5 pasuri me sipërfaqe 1694,9 m² në vitin 2012* dhe *6 pasuri me sipërfaqe 3862,5 m²* në vitin 2013, pasuri këto të rezultuara me mbivendosje, në tabelën emërtuar:"Regjistrime pasurish me mbivendosje dhe transaksione pas datës 11.08.2008 mbi sipërfaqet e kthyera në VKKP nr. 134, datë 13.3.2008".

Menjëherë

Rekomandim 15: ZVRPP Gjirokastër të analizoje gjendjen e nxjerrë përgjegjësinë, të marrë masa të evidentojë,vendosë database dhe komunikojë atë brenda stafit, të krijojë hartat e pasurive të identifikuara me mbivendosje dhe të munguara si dhe të ndjekë e të raportoje ecurinë e procedurave ligjore të trajtimit pasurive të regjistruara me mbivendosje mbi prona të regjistruara me parë .

Koment;

Rekomandimet konsiderohen të pranuar dhe janë në proces zbatimi rast pas rasti, sipas rekomandimit të KLSH-së.

Gjetje 10: ZVRPP Gjirokastër me referencën *nr. 180, datë 15.11.2012 ka* regjistruar dhe lëshuar certifikata datë *15.11.2012 pronësie në emër të Komunës Picar për 2 pasuri të llojit Pyje në sipërfaqen 79 ha përkatësisht pasuria nr. 304/9, v. 11, f. 66, zk. 2956, e llojit pyll me sipërfaqe 430000 m²(43ha) lëshuar certifikata nr. 476216, dhe Pasuria nr. 304/10, v. 11, f. 67, zk. 2956, e llojit pyll me sipërfaqe 360000 m²(36 ha) lëshuar certifikata nr. 476217 (pasuri të cilat më pas Komuna i ka dhënë në përdorim me afat 99 vjet) pa dokumentacionin e marrjes në dorëzim dhe dorëzimit nga enti përfaqësuesi Shtetit, (pasi mungon dokumentacioni si procesverbal, harta, kadastra pyjore, fuqi lëndore etj) në kundërshtim ligjin nr. 33, datë 21.03.2012"Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" pra dhe* ***në kundërshtim me pikën 2, lidhja 1 si dhe me pikën 3*** **të VKM nr.** 661, datë 21.5.2008" Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave, Pyje dhe Kullota, që do të Transferohen ne Pronësi të Njësisë së Qeverisjes Vendore, Komuna Picar të Qarkut të Gjirokastrës" *(Trajtuar hollësisht në faqet 184-192 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 17: ZVRPP Gjirokastër të nxjerrë urdhër kufizimi në bazë të nenit 59,80 dhe 74 të ligjit *nr. 33, datë 21.03.2012"Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" për 2 pasuri të llojit Pyje në sipërfaqen 79 ha përkatësisht pasuria nr. 304/9, v. 11, f. 66, zk. 2956, e llojit pyll me sipërfaqe 430000 m²(43ha) lëshuar certifikata nr. 476216, dhe Pasuria nr. 304/10, v. 11, f. 67, zk. 2956, e llojit pyll me sipërfaqe 360000 m²(36 ha) lëshuar certifikata nr. 476217, deri në plotësimin e dokumentacionit të munguar, procesverbalit dorëzimit nga DSHP.*

Menjëherë

Koment;

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe por nuk është zbatuar, pasi megjithëse ka urdhër kufizimi rezulton i pa zbatuar,

Rekomandim 18: ZVRPP Gjirokastër të nxjerrë urdhër në bazë të nenit 25 germa (a) të ligjit *nr. 33, datë 21.03.2012"Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" dhe nenit 193 të Kodit Civil...",* të fshijë regjistrimin nga pronësia Komunës Picar dhe të regjistrojë"Shtet" *pasurinë* nr. 1143/3, v. 10, f. 14 zk. 2956 e llojit "Përrua", me sipërfaqe *339 057 m²(33,9 ha) me përgjegjësi administrative dhe me status juridik përdorimi MMPAU (Ministria e Mjedisit Peshkimit dhe Administrimit të Ujërave).*

Menjëherë

Koment;

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe por nuk është zbatuar, pasi megjithëse ka urdhër kufizimi rezulton i pa zbatuar,

Rekomandim 19: ZVRPP Gjirokastër të nxjerrë urdhër në bazë të nenit 25 germa (a) të ligjit *nr. 33, datë 21.03.2012"Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" dhe nenit 193 të Kodit Civil...",* për fshirjen e regjistrimit nga pronësia e Komunës Cepo dhe regjistrimin "Shtet" të sipërfaqes lumore prej 2,79 ha, përkatësisht tre pasurive nr. 477/4,v. 3, f. 179, zk. 3058, lloji kullotë në fakt (Lumë) me sipërfaqe 16740 m^2 (1,67 ha), nr. 226/2,v. 3, f. 178 zk. 3058, lloji Kullotë me sipërfaqe 9512 m^2 (0,95 ha) dhe nr. 477/5,v. 3, f. 180 zk. 3058, lloji Lumë, me sipërfaqe 1748 m^2 (0,17 ha) të ndodhura në shtratin e lumit Kardhiq *me përgjegjësi administrative dhe me status juridik përdorimi MMPAU (Ministria e Mjedisit Peshkimit dhe Administrimit të Ujërave).*

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, por nuk është zbatuar, pasi megjithëse ka urdhër kufizimi rezulton i pa zbatuar,si dhe nuk ka vazhduar procesi i ndjekjes së rrugëve ligjore(dërgimi i çështjes në gjykatë), për të bërë të mundur fshirjen e regjistrimit nga pronësia e Komunës Cepo dhe regjistrimin "Shtet" të sipërfaqes lumore prej 2,79 ha, sipas rekomandimit të KLSH-së.

Rekomandim 20: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër të vendosë masë kufizuese mbi pasurinë nr. 1375, v. 11, f. 86 zk. 2956, *regjistruar zëri kadastral "kullotë"*, që në fakt sipas VKM nr. 661, datë 21.05.2008 është *zëri kadastral "pyll"*, me sipërfaqe 33500 m^2 (3,35 ha), dhe pa shkëputur nga pasuria mëmë prej 26,5 ha, deri në plotësimin e dokumentacionit për marrjen në dorëzim, regjistrimin sipas zërit kadastral "pyll" dhe tërheqjen e certifikatës së lëshuar nr. 606360, datë 2.4.2014 në pronësi të Komunës Picar si dhe për këto veprime të njoftojë Bashkinë Gjirokastër në juridiksion të së cilës ka kaluar përgjegjësia.

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe por nuk është zbatuar, pasi megjithëse ka urdhër kufizimi rezulton i pa zbatuar,

Rekomandim 21: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 7/17 truall, volum 7, faqe 104; nr. 8/162 dyqane, volum 7, faqe 59 dhe nr. 10/34 truall, volum 7, faqe 123, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Qershor 2016

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe por nuk është zbatuar, pasi megjithëse ka urdhër kufizimi rezulton i pa zbatuar,

Rekomandim 22: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër, për ZK nr. 2392, të kërkojë saktësimin e listave të printim III dhe bërjen e bilancit të pasurive AMTP me LN, në zbatim të kërkesave të VKM nr. 994, datë 09.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi" dhe konkretisht për pasuritë nr. 83/41 arë, volum 8, faqe 122 dhe pasurinë nr. 1060 veshtë, volum 12, faqe 33.

Brenda muajit Qershor 2016

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe por nuk është zbatuar, pasi megjithëse ka urdhër kufizimi rezulton i pa zbatuar,

Rekomandim 23: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër të kërkojë saktësimin e listave të kryefamiljarëve, gjendje e vitit 1991, për ZK nr. 2392, të cilët posedojnë banesa sipas listave 001

dhe deri në saktësimin e gjendjes së pasurive të marrë masa që të mos kryhet asnjë veprim dhe konkretisht për pasuritë nr. 462, volum 9, faqe 188; nr. 617, volum 10, faqe 94; nr 705, volum 10, faqe 181; nr. 713, volum 10, faqe 189, nr. 471, volum 9, faqe 197; nr. 722, volum 10, faqe 198; nr. 737, volum 10, faqe 21; nr. 740, volum 10, faqe 216; nr. 745, volum 10, faqe 221; nr. 748, volum 10, faqe 224; nr. 976, volum 11, faqe 201; nr. 1175, volum 12, faqe 137; nr. 462, volum 9, faqe 188.

Brenda muajit Qershor 2016

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi, pasi Njësia Administrative Lazarat, Bashkia Gjirokastër,nuk ka kthyer përgjigje lidhur me konfirmimin e listave të kryefamiljarëve, për ZK nr. 2392, të cilët posedojnë banesa sipas listave 001.

Rekomandim 24: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër të kërkojë saktësimin e listave të VKM nr. 748, datë 28.05.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, ish-komuna Cepo, të Qarkut Gjirokastër" përfshirë këtu dhe pasurinë nr. 28/5, volum 4, faqe 1, në ZK nr. 2989, fshati Plasat Gjirokastër.

Brenda muajit Qershor 2016

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi sipas rekomandimit të KLSH-së.

Rekomandim 25: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër të marrë masa, që në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 8542 për pasuritë nr. 10/9 truall dhe ndërtesë, volum 7, faqe 87, nr. 2/13 $^{-N+1}$, volum 7, faqe 183, nr. 10/104, volum 7, faqe 49-50, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Ndërsa në ZK 2392, pa kufizim të kërkohet plotësimi i dokumentacionit për pasuritë nr. 83/44, volum 8, faqe 122 dhe nr. 3647ND, volum 22, faqe 185.

Brenda muajit Qershor 2016

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe por nuk është zbatuar, pasi megjithëse ka urdhër kufizimi rezulton i pa zbatuar,

Rekomandim 26: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër të marrë masa, që në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 8542 për pasuritë nr. 16/118 truall dhe ndërtesë, volum 7, faqe 141, nr. 1/147 truall dhe ndërtesë, volum 7, faqe 94, nr. 17/131 truall dhe ndërtesë, volum 7, faqe 121, nr. 24/91 truall dhe ndërtesë, volum 7, faqe 41, nr. 6/122 truall dhe ndërtesë, volum 7, faqe 186, nr. 17/33 truall dhe ndërtesë, volum 7, faqe 130 dhe ZK nr. 2781, pasuria nr. 2067 truall dhe ndërtesë, volum 9, faqe 205, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Ndërsa në ZK 2392, pa kufizim të kërkohet plotësimi i dokumentacionit për pasuritë nr. 1039 truall dhe ndërtesë, volum 12, faqe 14, nr. 1105 truall dhe ndërtesë, volum 12, faqe 48, nr. 957 truall dhe ndërtesë, volum 11, faqe 182, nr. 748 truall dhe ndërtesë, volum 10, faqe 224, nr. 1114 truall dhe ndërtesë, volum 12, faqe 76.

Brenda muajit Qershor 2016

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe por nuk është zbatuar, pasi megjithëse ka urdhër kufizimi rezulton i pa zbatuar,

Rekomandim 27: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër të marrë masa, që në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 8542 për

pasuritë nr. 21/49, volum 7, faqe 64; nr. 19/19, volum 7, faqe 137; nr. 12/96, volum 7, faqe 176; nr. 3/139, volum 7, faqe 134; nr. 18/79, volum 7, faqe 174; nr. 3/147, volum 7, faqe 48; nr. 17/37, volum 6, faqe 222; nr. 2/46, volum 7, faqe 191; nr. 7/176, volum 7, faqe 150; nr. 4/73, volum 7, faqe 62; nr. 2/25, volum 7, faqe 149; nr. 2/197, volum 7, faqe 181; nr. 2/198, volum 7, faqe 181; nr. 3/93, volum 7, faqe 99; nr. 10/53, volum 7, faqe 148; nr. 12/57, volum 7, faqe 157; nr. 9/210, volum 7, faqe 79; nr. 10/52, volum 7, faqe 30; nr. 19/60, volum 7, faqe 84; nr. 14/143, volum 7, faqe 40; nr. 14/8, volum 7, faqe 38; nr. 1/22, volum 7, faqe 101; nr. 2/213, volum 7, faqe 187; nr. 2/240, volum 6, faqe 157; nr. 3/77, volum 7, faqe 54; nr. 25/3, volum 7, faqe 70; nr. 3/61, volum 7, faqe 127; nr. 3/62, volum 3, faqe 87; nr. 13/4, volum 7, faqe 151; nr. 17/35, volum 7, faqe 68; nr. 17/36, volum 7, faqe 146, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Qershor 2016

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe por nuk është zbatuar, pasi megjithëse ka urdhër kufizimi rezulton se këto paasuri kanë pësuar tyransaksion më përpara se të dërgoheshin rekomandimet, përveç pasurisë që i oërket numërit "2", në radhitjen ne mësipërme.,

Rekomandim 28: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër të marrë masa, që në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 8542 për pasurive `, gjithashtu për rastin e mbivendosjes së krijuar me sipërfaqe prej 826 m^2 në pronë të kërkueses znj. Lumturi Ismailaj, të përgatitet dokumentacioni në zbatim të Udhëzimit të KM nr. 4, datë 21.11.2007 "Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme", deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Qershor 2016

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe por nuk është zbatuar, pasi megjithëse ka urdhër kufizimi rezulton i pa zbatuar.

Rekomandim 30: Nga ZVRPP Gjirokastër në bashkëpunim me ZQRPP të merren masa të menjëhershme për administrimin e listave printim III me kryefamiljarë për zonat kadastrale që mungojnë, të përpilohen inventarët e AMTP-ve të marra në dorëzim, si dhe administrohen fizikisht AMTP për zonat të cilat mungojnë, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", VKM nr. 556, datë 23.10.2000 "Për dorëzimin e dokumentacionit të pronësisë në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme" dhe Rregulloren nr. 2079, datë 11.6.2007 "Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme".

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi.
Rekomandim 31: Nga ana e ZVRPP Gjirokastër të merren masa që në çdo rast të lëvizjes së punonjësve të bëhet dorëzimi dhe marrja e detyrës me procesverbal, të bëhet inventarizimi i menjëhershëm i arkivës së institucionit si dhe të gjitha veprimet me pasuritë të shoqërohen me referenca përkatëse, të gjitha këto masa në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 *"Për arkivat"* dhe Rregulloren e ZQRPP nr. 184, datë 8.4.1999 *"Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme"* të ndryshuar, Rregulloren nr. 2079, datë 11.06.2007 "Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në ZVRPP".

Në vazhdimësi

Koment;

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar, pasi është bërë inventarizimi i arkivës, dhe në vijimësi është mbajtur procesverbal dorëzimi, sipas rekomandimit të KLSH-së dhe zbatohet në vijëmësi rast pas rasti.

Rekomandim 32: Nga ana e ZQRPP-së të merren masa të menjëhershme për krijimin ambienteve dhe kushteve të mjaftueshme për ushtrimin e veprimtarisë dhe ecurinë normale të procesit të regjistrimit të pasurive nga ZVRPP Gjirokastër, si dhe ruajtjen e administrimin e dokumentacionit në mënyrë të sigurt (*dokumente që kanë afat ruajtje të përjetshme*) në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 33/2012, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", Rregulloren nr. 184, datë 18.4.1999 "Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme" dhe Rregulloren nr. 2079, datë 11.6.2007 "Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme".

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, por nuk është zbatuar, pasi zbatimi i tij i përket ZQRPP Tiranë..

Rekomandim 33: Nga ZVRPP Gjirokastër në bashkëpunim me ZQRPP të merren masa për përfundimin e procesit të hedhjes së zonave në sistem, administrimin e dokumentacionit si listë printime, hartë treguese dhe volume si dhe zëvendësimin e menjëhershëm të hartave të dëmtuara të zonave kadastrale.

Deri datë 30.9.2016

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, por nuk është zbatuar, pasi zbatimi i tij i përket ZQRPP Tiranë..

Rekomandim 35: Nga ZVRPP Gjirokastër t'i kërkohet Këshillit të Qarkut Gjirokastër plotësimi i AMTP-ve me të dhëna të sakta në përputhje me Vendimin e Gjykatës Nr. 464, datë 17.09.2015 si dhe certifikatave të gjendjes civile të personave që i posedojnë ato si dhe përcjellja me shkresë e AMTP-së që mungon.
Nga ZVRPP Gjirokastër të merren masa për vendosjen e kufizimit për pasuritë të cilat janë regjistruar me AMTP dhe të cilat kanë mospërputhje me vendimin e Gjykatës deri në saktësimin e të dhënave.

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi.

Rekomandim 39: ZQRPP dhe ZVRPP Gjirokastër të kërkojnë pranë Ministrit Drejtësisë që nëpërmjet strukturave të shqyrtojë Vendimin e Gjykatës nr. 464, datë 17.09.2015, për bazueshmërinë ligjore të trajtimit me tokë të disa personave, për shkak të kufizimit ligjor të trajtimit nga KLSH të çështjes, sepse ka kaluar zgjidhja e çështjes në rrugë administrative nga KLSH dhe tashmë i është nënshtruar rrugës gjyqësore. Opinioni i KLSH në lidhje me këtë është i pamundur të jepet pasi rruga fundore është çuarja në Gjykatë.

Menjëherë

Rekomandim 41: Nga ana e ZVRPP Gjirokastër të kërkohet saktësimi i listave të kryefamiljarëve, gjendje e vitit 1991, të cilët posedojnë banesa sipas listave 0001, dhe deri në saktësimin e gjendjes së pasurive të marr masa që të mos kryhet asnjë veprim në pasuritë si vijon:
- Pasuria nr. 2580, vol 17, fq. 244, zk. 2392; Pasuria nr. 3032, vol 19, fq. 195, zk. 2392; Pasuria nr. 3026, vol. 19, fq. 189, zk. 2392; Pasuria nr. 2960, vol 19, fq. 123, zk. 2392; Pasuria nr. 2882, vol. 19, fq. 45, zk. 2392; Pasuria nr. 2885, vol 19, fq. 48, zk. 2392; Pasuria nr. 2942, vol 19, fq.

105, zk. 2392; Pasuria nr. 3213, vol 20, fq. 125, zk. 2392 ; Pasuria nr. 3296, vol 20, fq. 208, zk. 2392 ; Pasuria nr. 3339, vol 21, fq. 1, zk. 2392; Pasuria nr. 3400, vol 21, fq. 62, zk. 2392.

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi, sipas rekomandimit të KLSH-së.

Rekomandim 43: Nga ZVRPP Gjirokastër të kërkohet saktësimi i listave të kryefamiljarëve, gjendje e vitit 1991, të cilët posedojnë banesa sipas listave 0001 dhe deri në saktësimin e gjendjes së pasurive të marr masa që të mos kryhet asnjë veprim në pasuritë si vijon: - Pasuria 84/27, vol. 8, fq. 160, zk. 2392; Pasuria 84/2, vol. 8, fq. 137, zk. 2392; Pasuria 84/3, vol. 8, fq. 138, zk. 2392; Pasuria 84/29, vol. 8, fq. 162, zk. 2392; Pasuria 84/89, vol. 8, fq. 222, zk. 2392; Pasuria 84/28, vol. 8, fq. 161, zk. 2392; Pasuria 1312, vol. 13, fq. 24, zk. 2392; Pasuria 979, vol. 11, fq. 204, zk. 2392; Pasuria 2113, vol. 16, fq. 32, zk. 2392; Pasuria 2886, vol. 19, fq. 49, zk. 2392; Pasuria 2889, vol. 19, fq. 52, zk. 2392; Pasuria 3036, vol. 19, fq. 199, zk. 2392; Pasuria 3329, vol. 20, fq. 241, zk. 2392
- Të lihen të lira vetëm njëra nga pasuritë për çdo person dhe konkretisht pasuria 2484, vol. 17 , fq. 148, zk. 2392; pasuria 2470, vol. 17 , fq. 134, zk. 2392; pasuria 2684, vol. 18, fq. 98, zk. 2392; pasuria 2211, vol. 16, fq. 130, zk. 2392, për të cilat nuk është kërkuar të mos kryhen veprime si më sipër, pasi nuk janë konstatuar diferenca në sipërfaqe nga ajo e përcaktuar në listën e trojeve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi, sipas rekomandimit të KLSH-së.

Rekomandim 46: Nga ZVRPP Gjirokastër të merren masa për kufizimin e pasurive deri në dorëzimin e dokumentacionit i cili justifikon ndryshimin e zërit kadastral në përputhje me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", neni 74 dhe nenet 45, 59 neni 60, si më poshtë:
- Pasuria 646/27, vol. 4, fq. 230, zk. 2094/Karjan
- Pasuria 1110, vol. 4, fq. 130, zk. 2032/Kakoz

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe pjesërisht i zbatuar, sipas rekomandimit të KLSH-së.

Rekomandim 47: Nga ZVRPP Gjirokastër të merren masa për të vendosur kufizimin mbi pasuritë mbi të cilat janë kryer transaksione sipas tabelës nr. 2, emërtuar *"KPP me sipërfaqe tepër AMTP-LN, por që janë kryer veprime në zk. 3907"* bashkëlidhur Raportit, *(por jo mbi ato të pasuri që janë tjetërsuar tek persona të tretë, 4 raste)* deri në bërjen e bilancit të pasurive dhe veçimin në shtet të sipërfaqes që rezulton tepër sipas LN. Gjithashtu të merren masa që në pasuritë mbi të cilat nuk janë kryer veprime sipas tabelës nr. 1 emërtuar *"KPP me sipërfaqe tepër AMTP-LN, por që janë nuk janë kryer veprime në zk. 3907"* bashkëlidhur Raportit, të mos kryen transaksione në vazhdim deri në bërjen e bilancit të pasurive dhe veçimin në shtet të sipërfaqes së tepërt.

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar, sipas rekomandimit të KLSH-së.

Rekomandim 49: Nga ana e ZVRPP Gjirokastër të merren masa për të vendosur kufizimin mbi pasuritë mbi të cilat janë kryer transaksione sipas tabelës nr. 2, emërtuar *"KPP me sipërfaqe tepër*

AMTP-LN dhe LN-AMTP, por që janë kryer veprime në zk. 3701" bashkëlidhur Projekt Raportit, *(por jo mbi ato të pasuri që janë tjetërsuar tek persona të tretë pra janë shitur)* deri në bërjen e bilancit të pasurive dhe veçimin në shtet të sipërfaqes 20503 m^2 që rezulton tepër sipas LN. Gjithashtu të merren masa që në pasuritë mbi të cilat nuk janë kryer veprime sipas tabelës nr. 1 emërtuar *"KPP me sipërfaqe tepër AMTP-LN dhe LN-AMTP, por që nuk janë kryer veprime në zk. 3701"* bashkëlidhur Projekt Raportit, të mos kryen transaksione në vazhdim deri në bërjen e bilancit të pasurive dhe veçimin në shtet të sipërfaqes së tepërt prej 52849 m^2, ndërsa në rastin kur sipërfaqe e AMTP-së është më e madhe se LN, në momentin që do të aplikohet për lëshim certifikatë pronësie
apo transaksione të tjera, duhet të kërkohet deklarata noteriale për heqje dorë nga sipërfaqja e tepërt.

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar , është në proces zbatimi, sipas rekomandimit të KLSH-së.

Rekomandim 52: Nga ZVRPP Gjirokastër të merren masa për fshirjen e regjistrimit fillestar në regjistrin hipotekor nr. 4, datë 18.04.2006, zona kadastrale Topullarë, pasuria 53/1, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 *"Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme"*, Rregullores nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme".

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar, sipas rekomandimit të KLSH-së.

Rekomandim 54: Nga ZVRPP Gjirokastër të merren masa për mbylljen e kartelave të pasurisë nr. 3127, vol. 20, fq. 39, zk. 2392, nr. 3130, vol. 20, fq. 42, zk. 2392, nr. 3055, vol 19, fq. 217, zk. 2392, me sip. 1067 m^2 me firmë dhe vulë të regjistruesit si dhe hapjen e kartelës së re përkatësisht për sipërfaqen 1429 m^2 në pronësi shtet ngelur nga pasuria nr. 3130, vol. 20, fq. 42, zk. 2392 me sip 1772 m^2 dhe dy kartela të reja njëra me sipërfaqen 1018 m^2 në pronësi të Magrip Gabës dhe njëra për sipërfaqen e mbetur prej 49 m^2 nga pasuria mëmë 3055, vol 19, fq. 217, zk. 2392, me sip. 1067 m^2, e cila duhet të veçohet në shtet në përputhje me Udhëzimit metodik Nr. 76 Prot, datë 13.09.1999 "Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme".

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces, sipas rekomandimit të KLSH-së.

Rekomandim 61: ZVRPP Gjirokastër të marrë masa për kërkimin e informacionit lidhur me përcaktimin e statusit ligjor të Fabrikës Ujit Glina dhe mbi bazën e njohjes së këtij statusi të njoftojë KLSH-në, i cili nga ana e vetë pasi ta vlerësojë atë, rezervon të drejtën e dhënies se një rekomandimi lidhur me nxjerrjen e urdhrit të kufizimit për trojet e regjistruara në pronësi të shoqërisë [redacted] shpk si troje të shitura pa qenë të regjistruara në pronësi të Komunës dhe kundërshtim me ligjin 7980, datë 27.07.1995 "Për shitblerjen e trojeve" dhe me VKM nr. 364, datë 05.10.1991, pika 1, si dhe për pasaktësitë evidentuar në këtë projekt në lidhje me sipërfaqen e regjistruar me diferencë më tepër prej 3769 m^2 truall dhe diferencë sipërfaqe ndërtimi regjistruar më tepër për 5296 m^2 për objektin fabrika e Ujit Glina pa dokumentacionin e duhur ligjor nga privatizimi dhe lejet e ndërtimit, në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", për shkeljet e konstatuara.

Brenda muajt Qershor 2016

Koment;

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi, sipas rekomandimit të KLSH-së.

Rekomandimi 62: ZVRPP Gjirokastër të marrë masa për nxjerrjen e urdhrave në rastet e ndarjes së pasurive dhe verifikimin e elementëve të formës e përmbajtjes së një akti administrativ në zbatim të Udhëzimit KM nr. 2, date 12.09.2012.

Brenda muajt Qershor 2016

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, nuk ka gjetur zbatim, sipas rekomandimit të KLSH-së.

Rekomandim 65: ZVRPP Gjirokastër të marrë masa për nxjerrjen e urdhrit të kufizimit për pasurinë 16/33 në pronësi të Gentjan Nevirit regjistruar në kundërshtim me nenin 24/b të ligjit 7843, datë 13.07.1994 i ndryshuar deri në plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor, në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara.

Brenda muajit Qershor

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi, sipas rekomandimit të KLSH-së.

Rekomandimi 66: ZVRPP Gjirokastër të marrë masa për nxjerrjen e urdhrit për kufizimin e regjistrimeve të pasurive të ndodhura brenda pasurisë së përcaktuar për kthim në pronësi të Kryegjyshatës sipas vendimit të KKP nr. 134, datë 13.03.2008 në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" dhe të zbatoje urdhrin për regjistrimin në pronësi të Kryegjyshatës të pasurive të kthyera ne sipërfaqen prej *271631 m²* të llojit troje të lira evidentuar në pasqyrën 11, dhe përcaktuar në hartën e punës së ZVRPP Gjirokastër administruar për këtë qëllim si troje të lira.

Brenda muajit Qershor

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi, pasi janë vendosur kufizimet e pasurive, por vazhdon regjistrimi i siërfaqeve të lira në pronësi të Kryegjyshatës, i cili nuk ka përfunduar.

Rekomandimi 67: Për pasurinë e përfituar më tepër nga [redacted] me HTR dhe kontratë shitje pa dokumentacionin e duhur ligjor ZVRPP Gjirokastër të marrë masa për nxjerrjen e urdhrit të Kufizimit duke njoftuar palët dhe të kërkojë Komunës Dropull verifikimin e sipërfaqes përfituar më tepër duke përcaktuar pozicionin dhe sipërfaqen që duhet të përfitonte, ndërsa për sipërfaqen prej 1000 m² shitur nga Këshilli Qarkut të merret masa për nxjerrjen e urdhrit të Kufizimit dhe të njoftohen palët, në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme".

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces, sipas rekomandimit të KLSH-së.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë

kontabilizimet duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përmbarimore me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën totale ***20,680,521* lekë,** si më poshtë:

Rekomandim 1: ZVRPP Gjirokastër, Regjistruesi të njoftojë Bashkinë Gjirokastër për masat e marra (rekomanduar masa org. nr.12 më sipër), urdhrin e fshirjes së regjistrimit për ***9 kontratat (***kontratat nr. 2994 me 2 pasuri, nr. 1211 me 2 pasuri, nr. 1345 me 1 pasuri, nr. 1399 me 3 pasuri përkatësisht sipas tabelës I,II,III,IV,V,VI,VII, IX,X) dhe të ndiqen hapat ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën ***432,300*** lekë nga e cila ***300,000 lekë*** kamatë vonesa viti 2013 për ZVRPP dhe per Bashkinë Gjirokastër vlera 132,300 lekë qera dhe tatim qeraje për kontratat e v.2013-2014 ndaj personave qiramarrës pasqyruar në tabelën"**Përmbledhëse PPL Shtetërore Publike sipas llojit për regjistrim Kontrata përdorimi e qiraje dhe dëmet ekonomike të pa aplikuara nga ZVRPP Gjirokastër v. 2013, 2014 dhe 2015".**

Menjëhere

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi, pasi nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve financiare nga personat qiramarrës, sipas rekomandimit të KLSH-së.

Rekomandim 2: ZVRPP Gjirokastër, Regjistruesi të njoftojë Bashkinë Gjirokastër për masat e marra(rekomanduar masa org. nr.15 më sipër), me urdhrin e mbylljes së KPP nr. 6/95,v. 28, f. 206, zk. 8541 e llojit truall me sipërfaqen 585,9 m^2, mbi të cilën ngrihet ndërtesa 2kt në sipërfaqe ndërtimi 222 m^2, të çeljes KPP e re nr., v. fq. Zk 8541 për llojin truall me sipërfaqe 585,9 m^2, regjistrimin ne pronësi "Shtet", në juridiksion e pronësi të Bashkisë, e **cila të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e dëmit vendosur si barrë kufizuese në vlerën 16,048,170 lekë** (15,467,670 lekë qira e munguar nga përdorimi i jashtëligjshëm i truallit, vlera 572,400 lekë, për shpronësimin e marrë (pa titull pronësie), përkatësisht ndaj Bashkisë Gjirokastër vlerën **15,467,670 lekë** si Qira e munguar nga përdorimi i jashtëligjshëm e pa titull pronësie të truallit prej 585,9 m^2 dhe ndaj Buxhetit të shtetit për vlerën **572,400 lekë** e shpronësimit të përfituar pa drejtësisht e pa titull pronësie të truallit në sipërfaqen 143,[1] m^2 .

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është zbatuar nga ZVRPP Gjirokastër por është në proces lidhur me ndjekjen e rrugëve ligjore nga Bashkia Gjirokastër lidhur më arkëtimin e detyrimit financiar, sipas rekomandimit të KLSH-së.

Rekomandim 3: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër, të marrë masa, që në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej *320,854 lekë* ndarë: *14,000 lekë* për pasuritë nr. 10/42, volum 2, faqe 71, nr. 25/67, volum 4, faqe 211, nr. 26/109, volum 5, faqe 72 dhe nr. 83/40, volum 8, faqe 121, bashkëlidhur referencës 0295, në ZK nr. 2392 Lazarat; *11,000 lekë,* për pasurinë nr. 10/9, volum 7, faqe 87, në ZK nr. 8542 Gjirokastër, sipas referencë nr. 02360; *192,430 lekë,* për pasurinë nr. 17/37, volum 6, faqe 222, në ZK nr. 8542 Gjirokastër, sipas referencë nr. 02077; *21,314 lekë,* për pasurinë nr. 2/213, volum 7, faqe 187, në ZK nr. 8542 Gjirokastër, sipas referencë nr. 02677 dhe *81,200 lekë,* për pasurinë nr. 2067, volum 2, faqe 85, në ZK nr. 2781, fshati Nepravishtë Gjirokastër, sipas referencë nr. 0037, deri në pagesën e plotë të vlerave.

Brenda muajit Qershor 2016

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi lidhur me ndjekjen e rrugëve për arkëtimin e detyrimit financiar nga personat debitorë, sipas rekomandimit të KLSH-së.

Rekomandim 4: Nga ana e ZVRPP Gjirokastër të merren masa për kufizimin e pasurisë nr. 3032, vol. 19, fq. 195, zk. 2392 deri në arkëtimin e vlerave të konstatuara si dëm ekonomik më sipër në përputhje me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", neni 74 dhe nenet 45, 59 neni 60. Gjithashtu të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimin e shumës 320,999 lekë shkaktuar nga kamat vonesa dhe mos kërkimi i likuidimit të vlerës ndërtimore.

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi lidhur me ndjekjen e rrugëve për arkëtimin e detyrimit financiar nga personat debitorë, sipas rekomandimit të KLSH-së.

Rekomandim 5: Nga ana e ZVRPP Gjirokastër të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 128,744 lekë për shitjen e pronës shtetërore në sipërfaqe totale 418 m^2, nga personat përgjegjës si më poshtë:
- *z.* [redacted] me detyrë ish-Specialist Hartograf dhe *z.* [redacted] me detyrë ish-regjistrues për vlerën 52,360 lekë.
- *z.* [redacted] me detyrë ish-Specialist Hartograf dhe *z* [redacted] me detyrë ish-regjistrues për vlerën 34,188 lekë,
- *z.* [redacted] me detyrë ish-Specialist Hartograf dhe *z. Sotiraq Janora* me detyrë ish-regjistrues për vlerën 20,636 lekë,
- *z. Th C* me detyrë ish-Specialist Hartograf dhe *z.* [redacted] me detyrë ish-regjistrues për vlerën 21,560 lekë.

Menjëherë

Përgjigja e subjektit:
Ky rekomandim sipas shkresës përcjellëse nr. 62, datë 28.07.2016 dhe nr. 1641/1, datë 10.11.2016, është pranuar nga subjekti dhe për zbatimin e këtij rekomandimi Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër me shkrësën nr. 109/2, datë 02.12.2016 ka njoftuar personat debitorë, lidhur me detyrimin fianaciar që duhet të arkëtojnë.
Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi lidhur me ndjekjen e rrugëve për arkëtimin e detyrimit financiar nga personat debitorë, sipas rekomandimit të KLSH-së.
Rekomandim 6: Nga ana e ZVRPP Gjirokastër të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 15,000 lekë e ardhur nga shmangia e pagesës së taksës për kalimin e pronësisë, si dhe të mos kryej asnjë veprim mbi pasuritë përkatëse deri në dorëzimin e dokumentit që vërteton pagesën.

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi lidhur me ndjekjen e rrugëve për arkëtimin e detyrimit financiar nga personat debitorë, sipas rekomandimit të KLSH-së.

Rekomandim 7: Nga ana e ZVRPP Gjirokastër të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 100,000 lekë për shitjen e pronës shtetërore në sipërfaqe totale 10 m^2, nga personat përgjegjës si më poshtë:
- *z.* [redacted], me detyrë ish-Specialist Hartograf për vlerën 33,333 lekë
- *z.* [redacted] me detyrë ish-Specialist Jurist për vlerën 33,333 lekë
- *z.* [redacted] me detyrë ish-Regjistrues për vlerën 33,333 lekë.

Menjëherë

Koment;

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi lidhur me ndjekjen e rrugëve për arkëtimin e detyrimit financiar nga personat debitorë, sipas rekomandimit të KLSH-së.

Rekomandim 8: Nga ana e ZVRPP Gjirokastër të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 30,954 lekë e ardhur nga shmangia e pagesës së taksës për kalimin e pronësisë, si dhe të vendosë kufizimin mbi pasurinë nr. 30/3, vol 3, fq. 136, zk. 3701-Valare deri në dorëzimin e dokumentit që vërteton pagesën.

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi lidhur me ndjekjen e rrugëve për arkëtimin e detyrimit financiar nga personat debitorë, sipas rekomandimit të KLSH-së.
Gjetje: Nuk është llogaritur e ndalur kamat vonesa si dhe tarifa për regjistrimin e Vendimit të Gjykatës nr. 56, datë 21.01.1992 për pasurinë nr. 108/16, vol. 2, fq 61, zk. 3535, Suhe, në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", neni 39- Vonesa e paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik në vlerën 303,500 lekë.
Rekomandim 9: Nga Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër, të merren masat për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 303,500 lekë e ardhur nga mos llogaritja e kamat vonesës si dhe tarifës për regjistrimin e Vendimit të Gjykatës, si dhe nxjerrjen e urdhrit të kufizimit mbi pasurinë nr. 108/16, vol. 2, fq 61, zk. 3535, Suhe në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 *"Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme"*, deri në likuidimin e vlerës.

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi lidhur me ndjekjen e rrugëve për arkëtimin e detyrimit financiar nga personat debitorë, sipas rekomandimit të KLSH-së.
Rekomandim 10: Nga Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër, të merren masat për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 60,000 lekë e ardhur nga mos llogaritja e kamat vonesës për regjistrimin e Vendimit të KKKP-së, si dhe nxjerrjen e urdhrit të kufizimit mbi pasuritë:
- nr. 3684, vol. 22, fq. 96, zk. 2392,
- nr. 3055, vol 19, fq. 217, zk. 2392,
në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 *"Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme"*, deri në likuidimin e vlerës.

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe por nuk është zbatuar, pasi megjithëse ka urdhër kufizimi rezulton i pa zbatuar,

Rekomandim 11: Nga ana e ZVRPP Gjirokastër të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 52,000 lekë ardhur nga shitja e pronës shtetërore në sipërfaqe totale 321 m^2, nga personat përgjegjës si më poshtë:
- *z.* [redacted], me detyrë ish-Specialist Hartograf për vlerën 26,000 lekë
- *z.* [redacted], me detyrë ish-Regjistrues për vlerën 26,000 lekë.

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi lidhur me ndjekjen e rrugëve për arkëtimin e detyrimit financiar nga personat debitorë, sipas rekomandimit të KLSH-së.

Rekomandim 12: Nga Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër, të merren masat për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 300,000 lekë e ardhur nga mos llogaritja e kamat vonesës për regjistrimin e vonuar të lejes së përdorimit nr. 3, datë 12.11.2013, si dhe nxjerrjen e urdhrit të kufizimit në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 *"Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme"*, mbi pasurinë nr. 70/76, vol. 7, fq. 46, zk. 3701 deri në likuidimin e vlerës.

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi lidhur me ndjekjen e rrugëve për arkëtimin e detyrimit financiar nga personat debitorë, sipas rekomandimit të KLSH-së.

Rekomandim 13: ZVRPP Gjirokastër të marrë masa, që në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkojë rrugë ligjore arkëtimin e detyrimit prej **2,560,300 lekë,** sipas pasqyrës 4 bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

Menjëherë

Koment;
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe është në proces zbatimi lidhur me ndjekjen e rrugëve për arkëtimin e detyrimit financiar nga personat debitorë, sipas rekomandimit të KLSH-së.
Ky akt verifikim mbahet me personat e mëposhtëm, të cilët kanë ushtruar detyrën e Regjistruesit, për periudhën e zbatimit të rekomandimeve.
Z. Florjan Hysa, me detyrë, ish Regjistrues i ZVRPP Gjierokastër, periudha 10.11.2014 deri 14.07.2016;
Z. B B, me detyrë, ish Regjistrues i ZVRPP Gjierokastër(i komanduar), periudha 20.07.2016 deri .05.09.2016;
Z. M K, me detyrë, ish Regjistrues i ZVRPP Gjierokastër, periudha 29.09.2016 deri 15.09.2017;

Lidhur sa trajtuar në faqet 5-66 të Projekt Raportit të Auditimit dhe në Akt-verifikimin nr. 1, datë 09.08.2019, janë paraqitur observacionet në rrugë elktronike, ku sqarohet:
Lidhur me Rekomandimin 13 te pikës C- Masa per Shperblim Dëmi, me Urdher Kufizimi nr.172 date 07.11.2016 si dhe me shkresen nr. 172/1 prot., date 07.11.2016 "Njoftim", jane vendosur kufizimi i veprimeve mbi pasurite deri ne shlyerjen e detyrimit nga personat debitore.
Ne zbatim te Urdher Kufizimi nr.172 date 07.11.2016 jane arketuar 1,196,00 lekë nga 8 subjekte, pas shlyerjes së detyrimit të plotë, është proceduar me heqjen e kufizimit.
Ne perfundim te shpjegimeve dhe komenteve te sipercituara referuar konstatimeve pjese e projekt-raportit te auditit te kryer prane ish Zvrpp-Gjirokaster, kerkojme qe ato te merren ne konsiderate nga ana juaj, me shpresen se do te vlerësohen si komente të pranueshme .
Sqarimi i Grupit të auditimit:
Lidhur me observacionet e paraqitur, të sipërcituar, merren në konsideratë, gjë të cilën ne kmi shprehur edhe në akt konstatimin përkatës, ku për rekomandimet er lëna, që rezultojnë të shlyera pjesërisht detyrimet financiare, i kemi konsideruar të zbatuara "pjesërisht dhe në proces", duke i klasifikuar sipas nivelit të zbatimit të çdo rekomandimi.

2. Auditim mbi procedurat e regjistrimit fillestar dhe pranimin e dokumentacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga ligji nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve", Ligji nr. 7699, datë 21.04.1993 "Për

Kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës Bujqësore", i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin e Kompensimin e pronës i ndryshuar".

Në zbatim të kësaj pike të programit të auditimit nga verifikimi i dokumentacionit, nga përzgjedhja e referncave, të nxjerrë kryesisht nga regjistrimet në KPP, sipas volumeve përkatëse u konstatua se në **2 raste**, janë kryer regjistrime dhe ofruar shërbime, në kartelat e pasurisë së paluajtshme me të meta e mangësi, të cilat po i trajtojmë më poshtë:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet që:

- Referencë nr. 15141;

Me aplikim nr. 272, datë 01.02.2017 dhe 999, datë 28.03.2017 [redacted] ka kërkuar korrigjimin e HTR dhe lëshimin e vërtetimit të pronësisë për pasurinë 65/1, ZK 8541.

Në KPP është regjistruar këto pasuri: volum 29, faqe 67, pasuria nr , 65/1, truall me sipërfaqe 1698 m^2, lëshuar vërtetim pronësie datë 13.04.2017.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se origjina e regjistrimit të pasurisë rrjedh nga vendimit të KKKP-së Gjirokastër nr.151, datë 22.09.2000, ku përcaktohet kthimi i sipërfaqes pyjore prej 1698 m^2, regjistruar në RH nr. 674, datë 18.10.2000, në favor të 6 trashëgimtarëve të Rasim Kallfës. Nga verifikimi i dokumentacionit të origjinës të ndodhur në dosjen me referncë nr. 9167, rezulton se vendimit të KKKP-së Gjirokastër nr.151, datë 22.09.2000 dhe plan vendosja e pronës, nuk janë origjinal por fotokopje të panoterizuara dhe nuk është kërkuar konfirmimi nga Agjencia e Trajtimit të Pronës, si institucioni që ka lëshuar aktin.

Sa trajtuar arrijmë në konkluzionin se, ***regjistrimimi pasurisë dhe veprimet përkatëse, janë*** *kryer me shkelje të dispoziatve ligjore**, pasi dokumentacioni i fitimit të pronësisë nuk është origjinal por fotokopje i panoteriazuar, ndërsa nga punonjësit e ZVRPP janë kryer veprime duke lëshuar vërtetim pronësie, sa*** vepruar në ***në papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" dhe Regulloren nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuar më sipër ***ngarkohet me përgjegjësi*** M K me detyrë ish Regjistrues, Otion Ciko me detyrë ish specialisti jurist.

- Referencë nr. 11569, 15790;

Me aplikim nr. 830, datë 15.03.2017, [redacted] ka kërkuar ndarjen e pasurisë dhe lëshimin e vërtetimit të pronësisë për pasurinë 13/114, ZK 8541.

Në KPP është regjistruar këto pasuri: volum 35, faqe 136, pasuria nr , 13/137, truall dhe ndërtesë me sipërfaqe 101.6 m^2 dhe volum 35, faqe 137, pasuria nr , 13/138, truall dhe ndërtesë me sipërfaqe 38 m^2, lëshuar vërtetim pronësie datë 23.05.2017, për Margarit Llukan Koleta. Pasuria pasuria nr. 13/138, truall dhe ndërtesë me sipërfaqe 38 m^2, është tjetërsuar me kontratë dhurimi, regjistruar me referencë nr. 15790, datë 04.12.22017, lëshuar vërtetim pronësie datë 04.12.2017, për Artan Stajko.

Nga auditimi i dokumentacionit gjendje në dosjen me referencë nr. 15790, u konstatua se origjina e regjistrimit të pasurisë rrjedh nga vendimit të KKKP-së Gjirokastër nr.169, datë 27.07.1994, ku përcaktohet njohje dhe kthim për shtëpinë për trashëgimtarët e Ustref Alimi, më pas me shkresën nr. 1657, datë 09.06.2004, Bashkia Gjirokastër ka konfirmuar se trashëgimtarët e Ustref Alimit, kanë në pronësi shtëpinë me sipërfaqe prej 139.6 m^2(nuk është shoqëruar me plan rilevim). regjistruar në RH nr. 475, datë 16.07.2004, truall dhe ndërtesë me sipërfaqe 139.6 m^2, në favor të 4 trashëgimtarëve, e cila më pas me kontratë shitje nr. 2713/711, datë 26.10.2004, është tjetërsuar duke kaluar në pronësi të Margarit Koleta. Nga verifikimi i dokumentacionit të origjinës të ndodhur në dosjen me referncë nr. 5919, rezulton se vendimit të KKKP-së Gjirokastër nr.169, datë 27.07.1994 dhe plan vendosja e pronës, nuk janë shprehur për njohje dhe kthim të pasurisë truall, duke përcaktuar njohje dhe kthim të shtëpisë.

Nga ZVRPP Gjirokastër, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Sa trajtuar arrijmë në konkluzionin se, ***regjistrimi i pasurisë truall dhe veprimet e kryera,*** *janë kryer me shkelje të dispozitave ligjore****, pasi dokumentacioni i fitimit të pronësisë nuk ka përcaktuar njohje dhe kthim të truallit, ndërsa nga punonjësit e ZVRPP janë kryer veprime të lëshuar vërtetim pronësie, sa*** vepruar ***në papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit", Regulloren nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar.
Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuar më sipër ***ngarkohet me përgjegjësi***, G Kme detyrë ish specialisti jurist

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Nenin 25, të Ligjit 33, datë 21.03.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtëshme";
Nenin 4, të ligjit nr. 9235, date 29.7.2004 "Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës";
UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Nenin 4, të ligjit Nr. 7698, datë 15.4.1993 "Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave ish-Pronarëve", i ndryshuar, shfuqizuar.

Lidhur sa trajtuar në faqet 68-69 të Projekt Raportit të Auditimit dhe në Akt-Konstatimin nr. 22, datë 09.08.2019, nuk janë paraqitur observacione nga personat e atakuar

3. Auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimit të tokës bujqësore të përfituar nga Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën" i ndryshuar; Ligji nr. 8053, datë 21.12.1995 "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore", Ligji nr. 8312 datë, 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", për periudhën e adutimit dhe transaksioneve të kryera me këto prona dhe bashkëpunimi dhe korrespodenca me KVTP pranë institucionit të Prefektit Gjirokastër.

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni përkatës për regjistrimin e tokës bujqësore, si më poshtë:
Kartelat e pasurisë paluajtshme, sipas regjistrave përkatës, nga ku ZK 38541, , ZK 1640 i përkasin 7 regjistra(volume) dhe ZK 3580, i pëerka sin 7 regjistra(volume), libri i ngastrave dhe libri i pronave dhe pronarëve, si dhe LN printimi III;
Dokumentacioni sipas inventarizimit bashkëlidhur referencave përkatëse, deklarata noterale, dëshmi trashëgimnie, kontrata pjesëtimi si shkresat konfirmuese, etj.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:
Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit mbi regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituar nga ligji nr. 7501, datë 17.09.1991 "Për tokën", të ndryshuar, u përzgjodhën për auditim rreth *60 referenca*, nga të cilat u konstatua se *10 raste* u konstatuan shkelje e parregullsi, lidhur me regjstrimin dhe transaksionet e kryera me pasuri të përfituara me Aktet të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) , duke lëshuar certifikata pronësie, trajtuar si më poshtë:
1. Nga ana e ish ZVRPP Gjirokastër nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjin nr. 33/2012, datë 21.03.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme'', neni 25 germa "a" dhe neni 45 pika 2, përsa i përket regjistrimit të pasurive të paluajtëshme bazuar në akte pronësie

AMTP, pasi ***në 1 rast,*** është regjistruar në favor të posedues ëve të AMTP-së, tokë me sipërfaqe totale **prej 1730 *m²*,** më tepër se sipërfaqja takuese e përcaktuar në AMTP nr. 825.

2. Nga ana e ish ZVRPP Gjirokastër nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas nenit 25/a, nenin 45, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjit 7501, 19.07.1991, i ndryshuar, VKM nr. 432, datë 14.08.1995"Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", i shfuqizuar dhe Urdhërin e Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2013, përsa i përket regjistrimit të trojeve dhe ndërtesave në zonat urbane të fshatrave, pasi **në 7 raste** të konstatuara, ka ndodhur regjistrimi i pasurive trual+ndërtesë, duke kaluar truallin me sipërfaqe totale prej ***2400 m²***, si dhe pasuritë ndërtesë me sipërfaqe totale ***1017m²,*** nga të cilat ***në 2 raste,*** *janë regjistruar për të njëjtën familje 2 e më shumë pasuri truall dhe ndërtesë,* ***ku rezulton se dokumentit ligjor "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", nuk plotësom kushtet për të shërbyer si Titull Pronësie;***

3. Nga ana e ish ZVRPP Gjirokastër, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore e nën ligjore, të bëra në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, neni 3 pika 2 dhe në pikën 2, të VKM-së nr. 255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës", e ndryshuar, përsa i përket regjistrimit të pasurive tokë bujqësore të ndara me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar, pasi për një trung familjar janë lëshuar 2 e më shumë AMTP, duke shkelur kriterin e ndarjes së tokës sipas normës për frymë të çdo fshati dhe ndarë tokë në mënyrë të pa barabartë, për rrejdhojë në **3 raste** të konstatuara, është regjishtruar në favor të posedues ëve të AMTP-ve, një sipërfaqe toke totale prej ***27700 m²***, më tepër se sipërfaqja takuese e ndarë sipas normës për frymë.

Referuar *pikës 2 neni 3, të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008" Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisëmbi tokën bujqësore", ku përcaktohet*:

2. Titujt e pronësisë mbi tokën bujqësore janë të vlefshëm vetëm kur janë krijuar në përputhje me: *a) -----";* *b) kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 255, datë 2.8.1991 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore", të ndryshuar;*

Në pikën 2, të VKM nr. 255, përcaktohet:

2-*Ne te gjitha rastet toka ndahet Përpjestimisht Për cdo familje sipas numrit te frymeve te gjendjes civile ne datën 1 gusht 1991.*

4. Nga ana e ZVRPP Gjirokastër nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në germën "c" pika 2.2 të UKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP)", përsa i përket regjistrimit të pasurive të paluajtëshme bazuar në akte pronësie AMTP, lidhur me rastin ku mungon një nga elementet e aktit, që është njëra nga vulat, pasi në **1 rast** janë regjistruar pasuri tokë bujqësore dhe kryer veprime, ku konstatohet se se AMTP-së nr. 7482, datë 24.05.1996, i mungon njëra nga elementet bazë, që është njëra nga vulat, ndërsa ZVRPP Gjirokastër, nuk duhet të procedonte me kryerjen e veprimeve duke lëshuar dokument pronësie, por duhet ti drejtohej KVVTP pranë pranë Prefekturës së Qarkut Gjirokastër, për të konfirmuar vlefshmërinë ligjore të AMTP--së

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

- Referencë nr. 11577, ZK 8541;

Me kërkesë nr. 669, datë 15.03.218, [redacted] ka kërkuar pajisjen me dublikatë të certefikatës së pronësisë për pasurinë nr. 193/10, ZK 8541.

Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, rezulton e regjistruar pasuria **Nr. 193/10, vol. 12 faqe 130**, pemëtore me sipërfaqe 900 m², lëshuar vërtetim pronësie me datë 118.04.2018.

Origjina e kësaj pasurie rrjedh nga AMTP nr. 7482, datë 24.05.1996, me sipërfaqe totale 6000 m², lëshuar për [redacted] Pas regjistrimit në KPP, pasuria nr. 193/2, është ndarë në 2 pasuri: **Nr. 193/9, vol. 12 faqe 129**, pemëtore me sipërfaqe 4100 m² dhe pasuria e sipër trajtuar

Nr. 193/10, vol. 12 faqe 129, pemëtore me sipërfaqe 900 m^2, veprime të kryera në vitin 2012, veprimet nga specialist i pa identifikuar.
Veprimet për lësimin vërtetimit të pronësisë dublikatë janë kryer nga specialisti jurist G K.
Regjistrimi i këtyre pasurive dhe kryerja e veprimeve, është kryer më të meta dhe shkelje ligjore, pasi:
- Për pasurinë e rrjeshtit të "dytë" të AMTP-së, nuk përputhet numëri parcelës përcaktuar "nr. 99/4 Virua", ndërsa është regjistruar pasuria nr. 193/10;
- Nga punonjësit e ZVRPP-së nuk janë verifikuar elmentet e formës dhe përmbajtjes së AMT-së, pasi asaj i mungon një nga vulat(rezulton e pa vulosur), duke mos plotësuar kërkesat e pikës 1/ç, të UKM NR. 2, datë 08.04.2009, i shfuqizuar dhe pikës 1/ç, të UKM Nr. 994, datë 9.12.2015**,** ndërsa nga punonjësit e ZVRPP-së, janë kryer veprime duke lëshuar certefikatë pronësie, duke mos i dërguar pushtetit vendor relacionin përkatës, siç përcaktuar në UKM Nr. 994, datë 9.12.2015, pikën 2.2/, ç, të ku përcaktohet: .

2.2. Kur pasuria e fituar me AMTP figuron ende në pronësi të mbajtësit të parë të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore ose trashëgimtarëve të tij, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në rastet e trajtimit të kërkesave për shërbim të subjekteve të ndryshme, verifikojnë ligjshmërinë e regjistrimit të kryer dhe veprojnë, si më poshtë vijon:
a) **.....**
b) Kur, gjatë verifikimit, rezulton se regjistrimi ka mangësi apo është kryer në kundërshtim me ligjin, konstatimet e kryera, nga punonjësit që përpunojnë praktikat, i referohen regjistruesit, me shkrim, duke treguar, hollësisht, mangësitë e konstatuara.
Regjistrimi, në origjinë, i tokës bujqësore, ka mangësi, në rastet kur:
i) është kryer me mungesën e një apo më shumë elementeve të akteve të marrjes së tokës në pronësi, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi;

Sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", UKM Nr. 2, datë 13.06.2013 "Për Mënyrën e Procedimit të organeve të administratës publike për pasuritë e paluajtshme, të fituara me aktin e marrjes së tokës në pronësi (amtp)", pikën 2.2, germa ç, të UKM Nr. 994, datë 9.12.2015, ku përcaktohet
Në shkronjën "a" neni 25,

Regjistruesi, ose çdo grup i ngarkuar, kërkojnë që pronësia, si dhe kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen në bazë të kritereve të mëposhtëme:
a)pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtëshme përcaktohen nga aktet e fitimit të pronësisë, sipas nenit 193 të Kodit Civil"

Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** ish Regjistruesi, që ka kryer veprimet e regjistrimit fillestar, G K me detyrë ish specialist jurist.

- Referencë nr. 085, 097, ZK1640;
Me kërkesë nr. 1398, datë 12.04.2018 , është kërkuar regjistrimin e dëshmisë s trashëgimisë dhe kalimin e pronësisë për pasuritë e përfituara sipas Aktit të Marrjes së Tokë në Pronësi(AMTP) nr. 6256, datë , lëshuar në emër të [redacted]
Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, sipas regjistrimit fillestar, bazuar në ***AMTP nr 6256, ku poseduesit*** [redacted], si përfaqësues i familjes, i është rë dhënë ***tokë gjithsej 23600 m^2***, rezultojnë të regjistruara këto pasuri:
Nr. 24/15, vol. 4, faqe 98, arë me sipërfaqe 4608 m^2**Nr. 47/2, vol. 4, faqe 99,** arë me sipërfaqe 4427 m^2, **Nr. 52/6, vol. 4, faqe 100,** arë me sipërfaqe 9790 m^2, **Nr. 54/4, vol. 4, faqe 101,** arë me sipërfaqe 1700 m^2(sipas LN) dhe 100 m^2 sipas AMTP, nga e cila kalon volum 6, faqe 7 arë me sipërfaqe 1000 m^2, duke u ndarë sipërfaqja e tëprt dhe kaluar "shtet", **Nr. 58/42, vol. 4, faqe 102,** arë me sipërfaqe 3270 m^2 , **Nr. 308/5, vol. 4, faqe 103,** arë me sipërfaqe 360 m^2, të gjitha këto

pasuri, pas regjistrimit të dëshmisë së trashëgimisë ësjhtë bërë pjestimi ndërmjet trashëgimtarëve dhe lëshuar certefikatë pronësie me datë 04.03.2016. Veprimet janë kryer nga specialisti hartograf L B.
Gjithashtu në volumin nr. 4, fae 173, është regjistruar pasuria 314/285, truall me sipërfaqe 300 m^2 + ndërtesë me sipërfaqe 140 m^2, regjistruar gjatë kalimit të zonës në sistem regjistrimi fillestar dhe lëshuar certefikatë pronësie datë 06.07.2018. Dokumenti që ka shërbyer për regjistrimin e kësaj pasurie është lista mbi të cilin është bazuar shërben në "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", të Fshatit Frashtan, e cila rezulton e pa identifikuar me emrat e Kryeplakut të fshatit dhe Kryetarit të komunës dhe e panënshkruar prej tyre dhe e panënshkruar nga subjekti përfitues.Veprimet janë kryer nga specialisti hartograf L B.
Gjithashtu për këtë familje, është lëshuar edhe ***AMTP nr 6219, ku poseduesit Kostandin(Koç) Mihal Jushi***, si përfaqësues i familjes, i është dhënë tokë ***gjithsej 25840 m^2***, rezultojnë të regjistruara këto pasuri:
Nr. 24/6, vol. 3, faqe 13, arë me sipërfaqe 4917 m^2, **Nr. 31/9, vol. 3, faqe 14,** arë me sipërfaqe 10993 m^2, **Nr. 54/20, vol. 3, faqe 15,** arë me sipërfaqe 1746 m^2, **Nr. 46/10, vol. 3, faqe 16,** arë me sipërfaqe 300 m^2, **Nr. 47/12, vol. 3, faqe 17,** arë me sipërfaqe 5600 m^2 , **Nr. 58/32, vol. 3, faqe 18,** arë me sipërfaqe 2600 m^2, të gjitha këto pasuri, pas regjistrimit të dëshmisë së trashëgimisë ësjhtë bërë pjestimi ndërmjet trashëgimtarëve dhe lëshuar certefikatë pronësie me datë 04.03.2016. Veprimet janë kryer nga specialisti hartograf L B.
Gjithashtu në volumin nr. 3, faqe 223, është regjistruar pasuria 314/200, truall me sipërfaqe 300 m^2 + ndërtesë me sipërfaqe 190 m^2, regjistruar gjatë kalimit të zonës në sistem regjistrimi fillestar dhe lëshuar certefikatë pronësie datë 02.06.2012 dhe datë 04.03.2016. Dokumenti që ka shërbyer për regjistrimin e kësaj pasurie është lista mbi të cilin është bazuar shërben në "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", të Fshatit Frashtan, e cila rezulton e pa identifikuar me emrat e Kryeplakut të fshatit dhe Kryetarit të komunës dhe e panënshkruar prej tyre dhe e panënshkruar nga subjekti përfitues.Veprimet janë kryer nga specialistët përkatës, për vitin 2012 specialisti i pai dentifikuar.
Nga ish ZVRPP Gjirokastër, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Gjithashtu për këtë familje, është lëshuar edhe ***AMTP nr 6258, ku poseduesit Kristo Mihal Jushi***, i është dhënë tokë ***gjithsej 23180 m^2***, pasuritë rezultojnë të regjistruara në volumin nr. 2, faqe 121 dhe 170, si dhe në volumin nr. 4, faqe 62 deri 67, për të cilat nuk janë kryer veprime.
Regjistrimi i këtyre pasurive dhe kryerja e veprimeve, është kryer më të meta dhe shkelje ligjore, pasi:
- Regjistrimi i pasurive 2 pasurive nr. 314/285 dhe 314/200, përkatësisht, truall me sipërfaqe 300 m^2 + ndërtesë me sipërfaqe 140 m^2 dhe truall me sipërfaqe 300 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 190 m^2 është kryer bazuar në Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", i cili ***nuk përmbush elementet e formës dhe përmbajtjes, për të shërbyer si Titull Pronësie,*** për rrejdhojë ***ZVRPP Gjirokastër, nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive dhe lëshimin e dokumentot të pronësisë për këto pasuri.***
Sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", VKM nr. 432, datë 14.08.1995 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", i shfuqizuar dhe Urdhërin e Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2013 dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
ku përcaktohet
Në shkronjën "a" neni 25,

Regjistruesi, ose çdo grup i ngarkuar, kërkojnë që pronësia, si dhe kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen në bazë të kritereve të mëposhtëme:
a)pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtëshme përcaktohen nga aktet e fitimit të pronësisë, sipas nenit 193 të Kodit Civil"

Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** me detyrë ish regjistrues, F T me detyrë regjistrues, me detyrë specialist jurist dhe L B me detyrë ish specialist hartograf.
Duke ju referuar dokumentacionit të ndodhur në dosje, rezulton se për këtë familje, janë lëshuar 3 AMTP për 12 anëtarë të trungut familar dhe në total kjo familje ka përfituar tokë bujqësore me sipërfaqe 72540 m^2(regjistruar në KPP 72540 m^2) , ndërsa sipas normës për frymë i takonte 4.7 dyn./pers. , kësaj familje që përbëhej nga 12 persona, i takonte sipërfaqja prej 56.4 dynym, nga regjistrimi në KPP është përfituar ***më tepër tokë bujqësore me sipërfaqe 16100*** m^2[72540(sasia e tokës që ka marrë)-56400(sasia takuese)], duke mos plotësuar kërkesat përcaktuar në ligjin 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar dhe pikën 2 neni 3, të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008" Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisëmbi tokën bujqësore" dhe pikën 2, të VKM-së nr. 255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës".
ZVRPP Gjirokastër nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, por duhet ti kërkonte nga institucionet përkatëse vlefshmerinë ligjore të këtyre AMTP-ve, duke kofirmuar sasinë e tokës takuese.

- **Referencë nr. 089, 090; ZK 1640;**
Me kërkesë nr. 1885, datë 16.05.2017, nga [redacted] është kërkuar regjistrimi i kontratës së dhurimit për pasurinë nr 59/22.
Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, sipas regjistrimit fillestar, bazuar në ***AMTP nr 6192, ku poseduesit*** [redacted], si përfaqësues i familjes, i është rrë dhënë ***tokë gjithsej 38000 m^2***, rezultojnë të regjistruara këto pasuri:
Nr. 24/30 vol. 5, faqe 140, arë me sipërfaqe 10146 m^2, **Nr. 53/6 vol. 5, faqe 141,** arë me sipërfaqe 3570 m^2, **Nr. 54/30 vol. 5, faqe 142,** arë me sipërfaqe 1616 m^2, **Nr. 284/9 vol. 5, faqe 145,** arë me sipërfaqe 3570 m^2, për këto pasuri nuk janë kryer veprime dhe nuk janë lëshuar certefikata pronësie. Gjithashtu rezultojnë të regjistruara edhe pasuritë: **Nr. 59/22 vol. 5, faqe 143,** arë me sipërfaqe 15390 m^2, e cila me kontratë dhurimi sipas referencës nr, 089, datë 17.05.2017 ka kaluar në pronësi të Mihal Petros, lëshuar certifikatë pronësie datë 17.05.2017 dhe më pas me referencë nr. 090, datë 17.06.2017, me kontratë dhurimi ka kaluar në pronësi të shoqërisë "[redacted]", lëshuar certefikatë pronësie datë 17.06.2017; **Nr. 64/1 vol. 5, faqe 144,** arë me sipërfaqe 6580 m^2, e cila me kontratë dhurimi sipas referencës nr, 089, datë 17.05.2017 ka kaluar në pronësi të [redacted]. Veprimet e më sipërme janë kryer nga G K, me detyrë specialist jurist.
Duke ju referuar dokumentacionit të ndodhur në dosje, rezulton se kjo familje, me datë 01.08.1991 përbëhej nga 7 anëtarë dhe në total kjo familje ka përfituar tokë bujqësore me sipërfaqe 38000 m^2(regjistruar në KPP 38000 m^2), ndërsa sipas normës për frymë i takonte 4.7 dyn./pers. , kësaj familje që përbëhej nga 7 persona, i takonte sipërfaqja prej 32900 m^2, nga regjistrimi në KPP është përfituar ***më tepër tokë bujqësore me sipërfaqe 5100*** m^2[38000 (sasia e tokës që ka marrë)-32900(sasia takuese)], duke mos plotësuar kërkesat përcaktuar në ligjin 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar, pikën 2 neni 3,të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008" Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisëmbi tokën bujqësore" dhe pikën 2, të VKM-së nr. 255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës".
ZVRPP Gjirokastër nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, por duhet ti kërkonte pushtetit vendor kofirmimin lidhur me sasinë takuese të tokës për këtë familje.

- Referencë nr. 091, 097, ZK1640;

Me kërkesë nr. 23139, datë 21.08.2017, është kërkuar regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë dhe kalimin e pronësisë për pasuritë e trashëguara.

Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, rzulton se në volumin nr. 2, fae 116, është regjistruar pasuria 314/96, truall me sipërfaqe 300 m^2 + ndërtesë me sipërfaqe 140 m^2, regjistruar gjatë kalimit të zonës në sistem regjistrimi fillestar, e cila pas regjistrimit të aktit të trashëgimisë, sipas referencës nr. 091, datë 21.08.2017, ka kaluar në pronësi të 9 trashëgimtarëve përfitues, dhe lëshuar certefikatë pronësie datë 21.08.2017.

Dokumenti që ka shërbyer për regjistrimin e kësaj pasurie është lista mbi të cilin është bazuar shërben në "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", të Fshatit Frashtan, e cila rezulton e pa identifikuar me emrat e Kryeplakut të fshatit dhe Kryetarit të komunës dhe e panënshkruar prej tyre dhe e panënshkruar nga subjekti përfitues.Veprimet janë kryer nga specialisti jurist O C.

Nga ish ZVRPP Gjirokastër, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".

Gjithashtu për këtë familje, rezulton e regjistruar edhe pasuria 314/98, truall me sipërfaqe 300 m^2 + ndërtesë me sipërfaqe 104 m^2, volum 2, faqe 114, në emër të [redacted], i cili rezulton pjesë e trungut familjar, sipas certefikatës datë 01.08.1991, për këtë pasuri nuk janë kryer veprime dhe as lëshuar dokument pronësie.

Regjistrimi i këtyre pasurive dhe kryerja e veprimeve, është kryer më të meta dhe shkelje ligjore, pasi:

- Regjistrimi i pasurive 2 pasurive nr. 314/96 dhe 314/98, përkatësisht, truall me sipërfaqe 300 m^2 + ndërtesë me sipërfaqe 140 m^2 dhe truall me sipërfaqe 300 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 104 m^2 është kryer bazuar në Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", i cili ***nuk përmbush elementet e formës dhe përmbajtjes, për të shërbyer si Titull Pronësie,*** për rrejdhojë ***ZVRPP Gjirokastër, nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive dhe lëshimin e dokumentit të pronësisë për pasurinë nr. 314/96.***

Sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", VKM nr. 432, datë 14.08.1995 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", i shfuqizuar dhe Urdhërin e Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2013 dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".

ku përcaktohet

Në shkronjën "a" neni 25,

Regjistruesi, ose çdo grup i ngarkuar, kërkojnë që pronësia, si dhe kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen në bazë të kritereve të mëposhtëme: *a)pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtëshme përcaktohen nga aktet e fitimit të pronësisë, sipas nenit 193 të Kodit Civil"*

Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** M Kme detyrë ish regjistrues, O C me detyrë specialist jurist.

- Referencë nr. 0130, ZK 2030;

Me kërkesë nr. 1221, datë 27.03.2018, është kërkuar regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare dhe kalimin e pronësisë për pasuritë e trashëguara.

Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, rzulton se në volumin nr. 6, fae 37, është regjistruar pasuria 88/55, truall me sipërfaqe 300 m^2 + ndërtesë me sipërfaqe 130 m^2, regjistruar gjatë kalimit të zonës në sistem regjistrimi fillestar, e cila pas regjistrimit të aktit të trashëgimisë,

sipas referencës nr. 0130, datë 06.04.2018, ka kaluar në pronësi të 5 trashëgimtarëve përfitues, dhe lëshuar certefikatë pronësie datë 06.04.218.
Dokumenti që ka shërbyer për regjistrimin e kësaj pasurie është lista mbi të cilin është bazuar shërben në "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", të Fshatit Kakavie, e cila rezulton e pa identifikuar me emrat e Kryeplakut të fshatit dhe Kryetarit të komunës dhe e panënshkruar prej tyre dhe e panënshkruar nga subjekti përfitues.Veprimet janë kryer nga specialisti jurist G K.
Nga ish ZVRPP Gjirokastër, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Regjistrimi i këtyre pasurive dhe kryerja e veprimeve, është kryer më të meta dhe shkelje ligjore, pasi:
- Regjistrimi i pasurisë nr. 88/55, truall me sipërfaqe 300 m^2 + ndërtesë me sipërfaqe 130 m^2, është kryer bazuar në "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", Fshati Kakavie, i cili ***nuk përmbush elementet e formës dhe përmbajtjes, për të shërbyer si Titull Pronësie,*** për rrejdhojë ***ZVRPP Gjirokastër, nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive dhe lëshimin e dokumentit të pronësisë për pasurinë.***
Sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", VKM nr. 432, datë 14.08.1995 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", i shfuqizuar dhe Urdhërin e Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2013 dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
ku përcaktohet
Në shkronjën "a" neni 25,

Regjistruesi, ose çdo grup i ngarkuar, kërkojnë që pronësia, si dhe kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen në bazë të kritereve të mëposhtëme: *a)pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtëshme përcaktohen nga aktet e fitimit të pronësisë, sipas nenit 193 të Kodit Civil"*

Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** F T me detyrë ish regjistrues, G K me detyrë specialist jurist.

- Referencë nr. 0128, ZK 2030;
Me kërkesë nr. 24177, datë 16.10.2017, nga [redacted] është kërkuar lëshimi i certefikatës së pronësisë, kartelë dhe hartës treguese..
Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, rzulton se në volumin nr. 6, fae 101, është regjistruar pasuria 89/24/1, truall me sipërfaqe 300 m^2+ndërtesë me sipërfaqe 80 m^2, regjistruar gjatë kalimit të zonës në sistem regjistrimi fillestar dhe lëshuar certefikatë pronësie.
Dokumenti që ka shërbyer për regjistrimin e kësaj pasurie është lista mbi të cilin është bazuar shërben në "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", të Fshatit Kakavie, e cila rezulton e pa identifikuar me emrat e Kryeplakut të fshatit dhe Kryetarit të komunës dhe e panënshkruar prej tyre dhe e panënshkruar nga subjekti përfitues.Veprimet janë kryer nga specialisti jurist G K.
Nga ish ZVRPP Gjirokastër, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Regjistrimi i këtyre pasurive dhe kryerja e veprimeve, është kryer më të meta dhe shkelje ligjore, pasi:

- Regjistrimi i pasurisë nr. 89/24/1, truall me sipërfaqe 300 m^2 + ndërtesë me sipërfaqe 80 m^2, është kryer bazuar në "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", Fshati Kakavie, i cili ***nuk përmbush elementet e formës dhe përmbajtjes, për të shërbyer si Titull Pronësie,*** për rrejdhojë ***ZVRPP Gjirokastër, nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive dhe lëshimin e dokumentit të pronësisë për pasurinë.***

Sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", VKM nr. 432, datë 14.08.1995 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", i shfuqizuar dhe Urdhërin e Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2013 dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".

ku përcaktohet

Në shkronjën "a" neni 25,

Regjistruesi, ose çdo grup i ngarkuar, kërkojnë që pronësia, si dhe kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen në bazë të kritereve të mëposhtme:
a)pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme përcaktohen nga aktet e fitimit të pronësisë, sipas nenit 193 të Kodit Civil"

Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** F T me detyrë ish regjistrues, G K me detyrë specialist jurist.

- Referencë nr. 0155 , ZK 3580, Fshati Terihat;

Me kërkesë nr. 885, datë 21.04.2016, është kërkuar regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare dhe kalimin e pronësisë për pasuritë e trashëguara.

Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, rzulton se *sipas **AMTP nr 855, ku poseduesit*** [redacted] ***i*** si përfaqësues i familjes, i është rë dhënë ***tokë gjithsej 14460 m^2***, rezultojnë të regjistruara këto pasuri:

Nr. 94/10 vol. 4, faqe 46, arë me sipërfaqe 1500 m^2, **Nr. 81/3 vol. 4, faqe 47,** arë me sipërfaqe 10380 m^2, **Nr. 65/2 vol. 4, faqe 48,** arë me sipërfaqe 480 m^2, **Nr. 56/4 vol. 4, faqe 49,** arë me sipërfaqe 1982 m^2, këto pasuri janë regjistruar në vitin 1998, për poseduesin e AMTP-së dhe më pas me referncë nr. 0155, datë 25.05.2016, regjistruar akti i dëshmisë testamentare, kanë kaluar në pronësi të [redacted], lëshuar certefikata pronësie datë 25.05.2016..

Githashtu në volumin nr. 2, faqe 175, është regjistruar pasuria 174/127, zëri kadastral "pemëtore" me sipërfaqe 300 m^2, nga e cila truall me sipërfaqe 300 m^2 + ndërtesë me sipërfaqe 65 m^2, regjistruar gjatë kalimit të zonës në sistem regjistrimi fillestar, e cila sipas referencës nr. 0155 është lëshuar certefikatë pronësie datë 25.05.2016, për [redacted].

Dokumenti që ka shërbyer për regjistrimin e kësaj pasurie është lista mbi të cilin është bazuar shërben në "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", të Fshatit Terihat, e cila rezulton e pa identifikuar me emrat e Kryeplakut të fshatit dhe Kryetarit të komunës dhe e panënshkruar prej tyre dhe e panënshkruar nga subjekti përfitues.Veprimet janë kryer nga specialisti hartograf L B.

Nga ish ZVRPP Gjirokastër, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".

Regjistrimi i këtyre pasurive dhe kryerja e veprimeve, është kryer më të meta dhe shkelje ligjore, pasi:

- Në KPP volum nr 2, faqe 175, rezulton zëri kadastral "pemëtore", ndërsa regjistrimi i pasurisë përshkruhet truall+ndërtesë;

- Regjistrimi i pasurisë nr. 174/127, truall me sipërfaqe 300 m^2 + ndërtesë me sipërfaqe 65 m^2, është kryer bazuar në "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", Fshati Terihat, i cili ***nuk përmbush elementet e formës dhe përmbajtjes, për të shërbyer si Titull Pronësie,*** për rrjedhojë ***ZVRPP Gjirokastër, nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive dhe lëshimin e dokumentit të pronësisë për pasurinë.***

Sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", VKM nr. 432, datë 14.08.1995 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", i shfuqizuar dhe Urdhërin e Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2013 dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".

ku përcaktohet

Në shkronjën "a" neni 25,

Regjistruesi, ose çdo grup i ngarkuar, kërkojnë që pronësia, si dhe kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen në bazë të kritereve të mëposhtme:
a)pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtëshme përcaktohen nga aktet e fitimit të pronësisë, sipas nenit 193 të Kodit Civil"

Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** F H me detyrë ish regjistrues, L B me detyrë ish specialist hartograf.

Duke ju referuar dokumentacionit të ndodhur në dosje, rezulton se kjo familje, me datë 01.08.1991 përbëhej nga 2 anëtarë dhe në total kjo familje ka përfituar tokë bujqësore me sipërfaqe14340 m^2(regjistruar në KPP 14340 m^2), ndërsa sipas normës për frymë i takonte 3.9 dyn./pers. , kësaj familje që përbëhej nga 2 persona, i takonte sipërfaqja prej 7800 m^2, nga regjistrimi në KPP është përfituar ***më tepër tokë bujqësore me sipërfaqe 6540*** m^2[14340 (sasia e tokës që ka marrë)-7800(sasia takuese)], duke mos plotësuar kërkesat përcaktuar në ligjin 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar, pikën 2 neni 3,të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008" Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisëmbi tokën bujqësore" dhe pikën 2, të VKM-së nr. 255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës".
ZVRPP Gjirokastër nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, por duhet ti kërkonte pushtetit vendor kofirmimin lidhur me sasinë takuese të tokës për këtë familje.

- Referencë nr. 0167, ZK 3580;

Me kërkesë nr. 828, datë 26.02.2018, [redacted] ka kërkuar regjistrimin e kontratës së shitjes për pasurinë nr. 55/2 dhe lëshimin e certefikatës së pronësisë.

Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, sipas regjistrimit fillestar, bazuar në ***AMTP nr 825, ku poseduesit*** [redacted] si përfaqësues i familjes, i është rë dhënë ***tokë gjithsej 14460 m^2***, rezultojnë të regjistruara këto pasuri:

Nr. 41/7, vol. 4, faqe 70, arë me sipërfaqe 10380 m^2(sipas LN), në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore, është lëshuar certefikatë pronësie në vitin 2002

Nr. 47/21, vol. 4, faqe 71, arë me sipërfaqe 480 m^2, në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore, është lëshuar certefikatë pronësie në vitin 2002.

Nr. 88/7, vol. 4, faqe 73, arë me sipërfaqe 1500 m^2, në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore, është lëshuar certefikatë pronësie në vitin 2002.

Nr. 55/2, vol. 4, faqe 72, arë me sipërfaqe 2030 m^2(sipas LN), në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore, me referncë nr. 0167, datë 05.03.2018, është tjetërsuar me kontratë shitje, te [redacted], lëshuar certefikatë pronësie datë 05.03.2018.

Veprimet e më sipërme që lidhen me regjistrimin e kontratës së shitjes, janë kryer nga G K me detyrë specialist jurist..

Regjistrimi i këtyre pasurive dhe kryerja e veprimeve, është kryer më të meta dhe shkelje ligjore, pasi:

- familja bujqësore poseduese e AMTP nr. 825 ka përfituar më tepër se sa përcaktuar në aktin e pronësisë, sipërfaqen prej 1730 m²[16170 m² (sip. e regjistruar në KPP)-14440 m²(sip. në AMTP)], për të cilën mungon akti i fitimit të pronësisë, ndërsa nga punonjësit e ZVRPP-së, janë kryer veprime duke lëshuar certefikatë pronësie, duke mos i dërguar pushtetit vendor relacionin përkatës, siç përcaktuar në UKM Nr. 994, datë 9.12.2015, pikën 2.2/c, të ku përcaktohet: .

c) Kur janë konstatuar një apo më shumë nga mangësitë e përmendura në nënndarjet "i", të shkronjës "b", të kësaj pike, brenda dy ditëve pune, nga data e konstatimit, me anë të një relacioni, çështja i dërgohet bashkisë, në juridiksionin e së cilës ndodhet toka bujqësore e pasqyruar në AMTP. Relacioni duhet të përmbajë pjesën përshkruese të faktit, si dhe argumentimin e mangësive të konstatuara. Relacionit, detyrimisht, i bashkëlidhet edhe një kopje e AMTP-së dhe e akteve/dokumenteve që konstatojnë këto mangësi, si dhe një kopje e kartelës së pasurisë së mbajtësit të fundit të titullit të pronësisë, së bashku me gjeneralitetet e tij dhe adresën, në rast se këto të dhëna administrohen në zyrën e regjistrimit.

Sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", UKM Nr. 2, datë 13.06.2013 "Për Mënyrën e Procedimit të organeve të administratës publike për pasuritë e paluajtshme, të fituara me aktin e marrjes së tokës në pronësi (amtp)", pikën 2.2, germa b/iii UKM Nr. 994, datë 9.12.2015, ku përcaktohet
Në shkronjën "a" neni 25,

Regjistruesi, ose çdo grup i ngarkuar, kërkojnë që pronësia, si dhe kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen në bazë të kritereve të mëposhtëme:
a)pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtëshme përcaktohen nga aktet e fitimit të pronësisë, sipas nenit 193 të Kodit Civil"

Në pikën 2.2, germa b/iii UKM Nr. 994, datë 9.12.2015:

2.2. Kur pasuria e fituar me AMTP figuron ende në pronësi të mbajtësit të parë të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore ose trashëgimtarëve të tij, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në rastet e trajtimit të kërkesave për shërbim të subjekteve të ndryshme, verifikojnë ligjshmërinë e regjistrimit të kryer dhe veprojnë, si më poshtë vijon:
a) .....
b) Kur, gjatë verifikimit, rezulton se regjistrimi ka mangësi apo është kryer në kundërshtim me ligjin, konstatimet e kryera, nga punonjësit që përpunojnë praktikat, i referohen regjistruesit, me shkrim, duke treguar, hollësisht, mangësitë e konstatuara.
Regjistrimi, në origjinë, i tokës bujqësore, ka mangësi, në rastet kur:
iii) sipërfaqja e të gjitha pasurive, dhënë me AMTP, del e ndryshme nga sipërfaqja e regjistrimit fillestar të këtyre pasurive, e pasqyruar në kartelat e tyre respektive.

Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** F T me detyrë ish regjistrues, G K me detyrë specialist jurist.

- Referencë nr. 0169, ZK 3580;

Me kërkesë nr. 1505, datë 19.04.2018, [redacted] ka kërkuar regjistrimin e deklaratës noterale për heqje dorë, lëshuar nga bashkëpronarët.
Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, rzulton se në volumin nr. 4, fae 77, është regjistruar pasuria 174/284, truall me sipërfaqe 300 m² + ndërtesë me sipërfaqe 100 m², regjistruar gjatë kalimit të zonës në sistem regjistrimi fillestar, e cila pas regjistrimit të deklaratës noterale për heqje dorë, sipas referencës nr. 0169, datë 24.04.2018, ka kaluar në pronësi të Vasil [redacted] dhe lëshuar certefikatë pronësie datë 24.04.218.

Dokumenti që ka shërbyer për regjistrimin e kësaj pasurie është lista mbi të cilin është bazuar shërben në "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", të Fshatit Terihat, e cila rezulton e pa identifikuar me emrat e Kryeplakut të fshatit dhe Kryetarit të komunës dhe e panënshkruar prej tyre dhe e panënshkruar nga subjekti përfitues.Veprimet janë kryer nga specialisti jurist L K.
Nga ish ZVRPP Gjirokastër, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Regjistrimi i këtyre pasurive dhe kryerja e veprimeve, është kryer më të meta dhe shkelje ligjore, pasi:
- Regjistrimi i pasurisë nr.174/284, truall me sipërfaqe 300 m^2+ndërtesë me sipërfaqe 100 m^2, është kryer bazuar në "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", FshatiTerihat, i cili ***nuk përmbush elementet e formës dhe përmbajtjes, për të shërbyer si Titull Pronësie,*** për rrejdhojë ***ZVRPP Gjirokastër, nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive dhe lëshimin e dokumentit të pronësisë për pasurinë.***
Sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", VKM nr. 432, datë 14.08.1995 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", i shfuqizuar dhe Urdhërin e Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2013 dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
ku përcaktohet
Në shkronjën "a" neni 25,

Regjistruesi, ose çdo grup i ngarkuar, kërkojnë që pronësia, si dhe kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen në bazë të kritereve të mëposhtëme: *a)pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtëshme përcaktohen nga aktet e fitimit të pronësisë, sipas nenit 193 të Kodit Civil"*

Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** F T me detyrë ish regjistrues, L K me detyrë specialist jurist.

- Referencë nr. 0178, ZK 3580;
Me kërkesë nr. 4429, datë 05.11.2018 dhe nr. 4742, datë 27.11.2018, [redacted] ka kërkuar lëshimin e certefikatës së pronësisë, hartë treguese dhe kartelën e PP.
Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, rzulton se në volumin nr. 4, fae 115, është regjistruar pasuria 174/321, truall me sipërfaqe 300 m^2 + ndërtesë me sipërfaqe 100 m^2, regjistruar gjatë kalimit të zonës në sistem regjistrimi fillestar dhe me referencë nr. 0178, datë 04.02.2019, ka kaluar nga bshkëpronësia familjare në pronësi individuale për [redacted] Jovanio dhe lëshuar certefikatë pronësie datë 04.02.2019.
Dokumenti që ka shërbyer për regjistrimin e kësaj pasurie është lista mbi të cilin është bazuar shërben në "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", të Fshatit Terihat, e cila rezulton e pa identifikuar me emrat e Kryeplakut të fshatit dhe Kryetarit të komunës dhe e panënshkruar prej tyre dhe e panënshkruar nga subjekti përfitues.Veprimet janë kryer nga specialisti jurist R G.
Nga ish ZVRPP Gjirokastër, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Regjistrimi i këtyre pasurive dhe kryerja e veprimeve, është kryer më të meta dhe shkelje ligjore, pasi:

- Në kartelën e Pasurisë së paluajtshme, është bërë ndryshimi i prronësisë, duke kaluar nga statusi bshkëpronësi familjare"F", në prronësi individuale "I", në mungesë të ndonjë akti juridik dhe të ndonjë dokumenti për dijeninë e personave bashkëpronarë.
- Regjistrimi i pasurisë nr.174/321, truall me sipërfaqe 300 m^2+ndërtesë me sipërfaqe 100 m^2, është kryer bazuar në "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", FshatiTerihat, i cili ***nuk përmbush elementet e formës dhe përmbajtjes, për të shërbyer si Titull Pronësie,*** për rrejdhojë ***ZVRPP Gjirokastër, nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive dhe lëshimin e dokumentit të pronësisë për pasurinë.***

Sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", VKM nr. 432, datë 14.08.1995 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", i shfuqizuar dhe Urdhërin e Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2013 dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".

ku përcaktohet

Në shkronjën "a" neni 25,

Regjistruesi, ose çdo grup i ngarkuar, kërkojnë që pronësia, si dhe kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen në bazë të kritereve të mëposhtëme:
a)pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtëshme përcaktohen nga aktet e fitimit të pronësisë, sipas nenit 193 të Kodit Civil"

Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** F T me detyrë ish regjistrues, R G me detyrë specialist jurist.

- Referencë nr. 0161, ZK 3580;

Me kërkesë nr. 24911, datë 30.11.2017, [redacted] ka kërkuar lëshimin e certefikatës së pronësisë, hartë treguese dhe kartelën e PP.

Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, rzulton se në volumin nr. 4, fae 114, është regjistruar pasuria 174/323, truall me sipërfaqe 300 m^2 + ndërtesë me sipërfaqe 88 m^2, regjistruar gjatë kalimit të zonës në sistem regjistrimi fillestar dhe me referencë nr. 0161, lëshuar certefikatë pronësie datë 17.01.2018, për [redacted].

Dokumenti që ka shërbyer për regjistrimin e kësaj pasurie është lista mbi të cilin është bazuar shërben në "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", të Fshatit Terihat, e cila rezulton e pa identifikuar me emrat e Kryeplakut të fshatit dhe Kryetarit të komunës dhe e panënshkruar prej tyre dhe e panënshkruar nga subjekti përfitues.Veprimet janë kryer nga specialisti jurist O C.

Nga ish ZVRPP Gjirokastër, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".

Regjistrimi i këtyre pasurive dhe kryerja e veprimeve, është kryer më të meta dhe shkelje ligjore, pasi:

- Regjistrimi i pasurisë nr.174/323, truall me sipërfaqe 300 m^2+ndërtesë me sipërfaqe 88 m^2, është kryer bazuar në "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", FshatiTerihat, i cili ***nuk përmbush elementet e formës dhe përmbajtjes, për të shërbyer si Titull Pronësie,*** për rrejdhojë ***ZVRPP Gjirokastër, nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive dhe lëshimin e dokumentit të pronësisë për pasurinë.***

Sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", VKM nr. 432, datë 14.08.1995 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", i shfuqizuar dhe Urdhërin e Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2013 dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për

përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
ku përcaktohet:
Në shkronjën "a" neni 25,

Regjistruesi, ose çdo grup i ngarkuar, kërkojnë që pronësia, si dhe kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen në bazë të kritereve të mëposhtëme:
a)pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtëshme përcaktohen nga aktet e fitimit të pronësisë, sipas nenit 193 të Kodit Civil"

Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** F T me detyrë ish regjistrues, O C me detyrë specialist jurist.

Lidhur sa trajtuar në faqet 70-84 të Projekt Raportit të Auditimit dhe në Akt-Konstatimin nr.18, datë 09.08.2019, janë paraqitur observacionet në rrugë elktronike dhe derguar me shkresen 3202/1. Prot, datë 13.09.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 372/5, datë 16.09.2019 dhe me shkresen 3619. Prot, datë 09.09.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 372/6, datë 25.09.2019, nga z. F T, me detyrë drejtor dhe specialistët L K, O C dhe R G, ku sqarohet:
Lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr. 1577, ZK 8641, ku ju konstatoni se regjistrimi te parregullt si dhe mosrespektim te procedures - nuk qendron, pasi veprimet e kryera jane konform përcaktimeve ligjore. Sqarojmë se në dosjen me referncë nr. 10592, ndodhet e depoziatuar AMTP origjinale nr.7482 date 24.05.1996 ne emer te [redacted] dhe dolkumentacioni tjetër shoqërues, ku më pas është lëshuar dëshmia e trshëgimisë, bazuar në këtë dokumentacion është bërë regjistrimi i parceles me emertim popullor"[redacted] sipas nr.1 rendor ne AMTP e qe korrespondon me pasurine nr.193/2 me sip.5000 m2, e cila më pas është ndarë në 2 pasuri te tjera, konkretisht ne pas.nr.193/9 vol.12 faqe 129 (me sip.4100 m2) dhe pas.nr.193/10 vol.12 faqe 130 zk.8541 (me sip.900 m2) – per te cilen eshte bere leshimi i dublikates se certifikates se pronesise sipas Urdhrit te Regjstruesit nr.41 date 24.04.2018, duke u trajktuar në përppothje me procedurat ligjore të përcaktuara..... Persa i perket ***pasurise nr.314/200 vol.3 faqe 223 zk.1640****afishuar fillimisht ne emer te [redacted] sipas Listes se Trojeve (truall 300 m2, nderetse 190 m2) – sqaroj se* ***veprimet ne KPP dhe leshimi i certifikates se pronesise jane bere nga specialiste dhe Regjstrues te meparshem****, veprimet e te cileve jane te verifikueshme lehtesisht sipas shenimeve ne KPP dhe dokumentacionit te depozituar ne arkiv.*
Sa me lart, kopje te dokumentacionit perkates e gjeni bashkengjitur.
Sqarimi i Grupit të auditimit:
Lidhur me observacionet e paraqitur, të sipërcituar, nuk merren në konsideratë pasi, nuk janë paraqitur argumente dhe prova të reja, konkretisht, në observacionin tuaj ju pretendoni se në arkivë ndodhet AMTP-ja origjinale, por në fakt konstatimi ynë nuk lidhet me këtë fakt, por është konstatuar se AMTP-së i mungon njëra nga vulat, si një nga elmentët kryesor të këtij akti. Në mungesë të provave dhe fakteve të reja pretendimi juaj nuk merret në konsideratë, për rrjedhojë konstatimi ynë mbetet i pandryshuar, Lidhur me veprimet e kryera nga regjistrues të mëparshëm, jashtë periudhës që ju keni ushtruar detyrën, nuk mund të jetë përgjeghësi e juaja, ndaj pranohet nga grupi i auditimit.

Lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr. 085,097, ZK 1640,, referencës nr. 0130, ZK 2030, referencës nr. 0128, ZK 2030, referencës nr. 0169, ZK 3580, referencës nr. 0178, ZK 3580, referencës nr. 0161, ZK 3580, në të gjitha këto raste, problemi i konstatuar është i njëjtë, ku ju konstatoni se regjistrimi është i parregullt si dhe mosrespektim te procedures - nuk qendron, pasi veprimet e kryera jane konform përcaktimeve ligjore. Sqarojmë se në të gjitha rastet që ju përkasin regjistrimet e pasurive truall dhe ndërtesë në zonat urbane të fshatit, ku konstatohen që listat 001, janë të pa nënshkruara, kemi kërkuar konfirmimin me shkresat përkatëse nga Kryetari

i Bashkise Dropull, ku me shkresat përkatëse konfirmohet Kopje e Listes Emerore te Pronareve te Trojeve dhe Ndertesave siaps fhstrave rast pas rasti... .
Lidhur me pretendimet e grupit te auditit per shkelje te procedures ligjore ne regjistrimin e pasurive toke bujqesore perfituar sipas AMTP-ve perkatese "ne tejkalim te normes per fryme" – vleresoj se eshte i gabuar, ne kushtet kur po nga auditi behet me dije (sipasakt konstatimit) se keto pasuri jane disponuar sipas kontratave te pjestimit, cka nenkupton trasaksion dhe kalim pronesise ne favor te te treteve e per rrjedhoje ne interpretim te VKM nr.994/2015 pika 2.1 nuk ndalohen veprimet mbi pasurite..... . Sa me lart, kopje te dokumentacionit perkates e gjeni bashkengjitur.
Sqarimi i Grupit të auditimit:
Lidhur me observacionet e paraqitur, të sipërcituar, nuk merren në konsideratë pasi, nuk janë paraqitur argumente dhe prova të reja. Sqarojmë përsëri se konstaimi ynë lidhet me parregullsitë e akteve (listat 001) që kanë shërbyer për regjistrimin e trojeve dhe ndërtesave në zoant urbane të fshatit. Në mungesë të provave dhe fakteve të reja pretendimi juaj nuk merret në konsideratë, për rrjedhojë konstatimi ynë mbetet i pandryshuar. Lidhur me pretendimin tuaj për konstatimin *"ne tejkalim te normes per fryme", sqarojmë se ne kemi konstatuar që familjet bujqësore kanë përfituar tokë më tepar se sasia takuese dhe për këtë ne nuk kemi ngarkuar me përgjegjësi punonjësit e ZVRPP-së, nisur nga fakti se nuk është detyrim ligjor i ZVRPP-ve që të verifikojnë sasinë takuese të tokës bujqësore, për familjet bujqësore.*

***Pika 3/1.* Bashkëpunimi dhe korrespodenca me KVTP pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastër.**
Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit u grumbullua informacioni i nevojshëm, lidhur me bashkëpunimin KVVTP-ish ZVRPP.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe informacionit të paraqitur nga subjekti, konstatohet që:
Nga Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore(KVVTP) Prefekti Qarkut Gjirokastër gjatë viteve ***2016 , 2017, 2018 deri 31.05.2019,*** ka marrë gjithsej 5 vendime, ***të cilat janë administruar nga nga ish ZVRPP Gjirokastër, sipas shkresave përkatëse.***
Bashkëpunimi ndërmjet DVASHK(ish ZVRPP) Gjirokastër dhe KVVTP pranë Prefektit të Qarkut dhe anasjelltas janë të të pasqyruara në "Tabela e shkëmbimit të informacionit ZVRPP-KVVTP", bashkëlidhur.
Referuar informacionit të subjektit të audituar, sipas të dhënave pasqyruar në tabelën e shkëmbimit të informacionit ZVRPP-KVVTP, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar, rezulton se:
Në të gjitha rastet e trajtuara, rezulton se kërkues ka qenë ish ZVRPP-ja , e cila ka dërguar AMTP-të përkatëse, për shqyrtim vlefshmërie në Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë(KVVTP), nga ku rezulton se nga KVVTP-ja janë marrë gjithsej 5 vendime, nga ku rezulton se në 3 raste KVVTP-ja është shprehur për shfuqizimin e AMTP-ve përkatëse, por Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër me Vendimet përkatëse ka vendsur, rrëzimin e padisë, më pas këto vendime janë ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe janë në process shqyrtimi. Në një rast Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, ka lënë në fuqi vendimin e KVVTP-së, por është ankimuar nga poseduesi I AMTP-së, dhe çështja është në process shqyrtimi. Ndërsa në një rast Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, ka vendosur pushimin e çështjes deri në nxjerrjen e dëshmisë së trashëgimisë ligjore.
Në 2 raste KVVTP ka marrë vendim në favor të posedueseve të AMTP-ve, ndërsa në rastet e tjera, rezultojnë në process shqyrtimi.
Nga auditimi i zbatimit këtyre vendimeve si gjatë procedurës dhe pas dërgimit të tyre rezulton se:
-Masë kufizimi nuk është vendosur në asnjë rast për pasuritë e regjistruara me amtp, për të cilat vendimet shprehen për gjendjen në proces shqyrtimi deri në marrjen e formës së prere të

vendimeve gjyqësore dhe ato që marrë KVVTP Prefekti Qarkut Gjirokastër dhe dërguar në ZVRPP Gjirokastër, *pra nuk është vendosur kufizim në KPP(seksionin "E")***,** *gjatë fillimit dhe zbatimit të procedurave të shqyrtimit të verifikimit.*
veprime këto ***në kundërshtim me*** *ligjin nr.* ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", neni 74 dhe nenet 45, 59 neni 60, me vetë Vendimet e Gjykatave dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore", të ndryshuar, që ka sjellë si pasojë lënien në gjendje juridike me pronësi të mbajtësit të paligjshëm dhe për vendimet e gjykatës që kanë marrë formë të prerë, mos kalimin e titujve të pronësisë "Shtet".

Lidhur sa trajtuar në faqet 85-86 të Projekt Raportit të Auditimit dhe në Akt-Konstatimin nr. 19, datë 09.08.2019, janë paraqitur observacionet në rrugë elktronike dhe derguar me shkresen 3202/1. Prot, datë 13.09.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 372/5, datë 16.09.2019 dhe me shkresen 3619. Prot, datë 09.09.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 372/6, datë 25.09.2019, nga z. F T, me detyrë drejtor ku sqarohet:
... Referuar konstatimit tuaj se: ***Nuk eshte vendosur mase kufizimi ne asnje rast per pasurite e regjistruara me AMTP, per te cilat vendimet shprehen per gjendjen ne proces shqyrtimi deri ne marrjen e formes se prere te vendimeve gjyqesore dhe ato qe ka marre KVTP*** *pra nuk eshte vendosur kufizim ne KPP (seksionin E) gjate fillimit dhe zbatimit te procedurave te shqyrtimit te verifikimit-* ***nuk qendron, pasi ne asnje prej rasteve te konstatuara nuk permbusheshin kerkesat ligjore sipas nenit 45 te ligjit nr.33/2012 .....***
Ne 4 raste sipas tabeles te paraqitur nga ana juaj *dhe konkretisht* ***Vendimi nr 15 date 02.10.2018 i KVVTP*** *(ankimuar nga KVVTP, aktualisht ceshtja eshte ne gjykim nga Gjykata Administrative e Apelit Tirane);* ***Vendimi 12 date 27.07.2018 i KVVTP*** *(ankimuar nga z.* [redacted] *ceshtja pritet te gjykohet nga Gjykata Administrative e Apelit Tirane);* ***Vendimi 16 date 02.10.2018 i KVVTP me Vendimin nr. 657 date 21.11.2018 te Gjykates Administrative Shkalla e Pare Gjirokaster eshte vendosur pezullimi i gjykimit****; me* ***Vendimi 17 date 20.07.2018 i KVVTP*** *(ankimuar nga Avokatura e Shtetit ceshtja pritet te gjykohet nga Gjykata Administrative e Apelit Tirane) -* ***nuk kane marre forme te prere duke mos u kthyer ne titull ekzekutiv te detyrueshem per zbatim ne zbatim te nenit 451/a te Kodit te Procedures Civile.***
Ne keto kushte zyra nuk ka proceduar me vendosjen e U.K per pasurite objekt shqyrtimi dhe verifikimi nga KVVTP *deri ne marrjen forme te prere te vendimeve gjyqesore e per rrjedhoje kthimin e tyre ne tituj ekzekutive te detyrueshem per regjistrim.*
Sqarimi i Grupit të auditimit:
Lidhur me observacionet e paraqitur, të sipërcituar, nuk merren në konsideratë pasi, pretendimi juaj është i pa argumentuar, ndërsa konstatimi ynë i referohet, përcaktimeve ligjore, për të krijuar pamundësinë e tjetërsimit të pronës, gjatë procesit të shqyrtimit, gjë e cila do të sillte pasoja të pariparueshme, për rrjedhojë pretendimi juaj nuk pranohet.

Zona Kadastrale 3513 (AMTP-Stegopul).
Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit në lidhje me regjistrimin e pasurive të perfituara e perfituara nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 "Per Tokën", i ndryshuar, ligji 8053, datë 21.12.1995 "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore", ligji nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për toka buqësore të pandara" ***Zona Kadastrale 3513- fshati Stegopul*** për periudhën nga data 01.01.2016 deri me datë 31.95.2019, në zbatim të ***pikës 3*** të programit të auditimit "***nr. 372/1, datë 28/05/2019***", u shqyrtua dokumentacioni me zgjedhje sipas refencave të përcaktuara nga kartelat e pasurive të palujtshme në regjistrat 1, 2, 3 dhe 4 për ***Zonën Kadastrale 3513, Fshati Stegopul Gjirokastër,*** në lidhje me veprimet e kryera per regjistrimin e pasurive përfituar në zbatim të ligjit nr. ***nr. 7501, datë 19.07.1991, i ndryshuar dhe regjistrimi i AMTP-ve sipas VKM nr. 994, datë datë 09.12.2015 sipas kërkesave të nenit 24-25 të ligjit 33/2012.***

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:
Nga ana e Drejtorisë Vendore e ASHK(ish-ZVRPP) Gjirokastër nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjin ***nr. 7501, datë 19.07.1991, i ndryshuar dhe VKM nr.994, datë datë 09.12.2015 bazuar në kërkesat e neneve 24-25 të ligjit 33/2012*** përsa i përket Regjistrimit të pasurive pëfituar me AMTP deri me datë 15.08. 2000 dhe regjistrimi i tyre në zbatim të VKM nr. 994, datë 09.12.2015 e më pas sipas VKM nr. 253, datë 06.03.2013, referuar pikës 1, shkronjat a,b,c,ç,d,dh, pikës 2, shkronjat a,b,c,ç,d, pikës 3, 3/1, 3/2,3/3,3/4, pikës 4 dhe 5 të ***VKM nr. 994, datë 09/12/2015"Regjistrimi i Akteve të Marjes në Pronësi"***, ku përcaktohet që:

"ZVRPP Regjistron AMTP në perputhje me nenet 24,25 të ligjit 33.2012 sipas pikës 1, pas verifikimit nëse nëse AMTP përmban elementet e formës e përmbajtjes sipas shkronjave a,b,c,ç,d,dh. Kur pasuria figuron e regjistruar në ZVRPP sipas pikës 2, verifikohet ligjshmëria dhe vepron sipas shkronjat a,b,c,ç,d të kësaj pike. Kur pasuria nuk figuron e regjistruar në ZVRPP sipas pikës 3, në pronësi të përfituesit me AMTP regjistrimi do të bëhet sipas pikës 3/1, shkronjat a,b,c dhe ç, pikës 3/2, shkronjat a,b dhe c, pikës 3/3, shkronjat a,b dhe c, pika ¾, shkronjat a,b dhe c. Kur pasuria figuron e regjistruar si pasuri shteterore sipas pikës 4 dhe AMTP ndodhet në ZVRPP atëhere veprohet sipas shkronjave a dhe b të kësaj pike. Kur lloji pasurisë me AMTP nuk perputhet me llojin e pasurisë regjistruar në KPP sipas pikës 5, ZVRPP kerkon informacion nga DAMT pranë KQ për zërin kadastral datë 01.08.1991. Planvendosjet e ngastrave duhet detyrimisht të jenë të konfirmuara nga Bashkia sipas pikës 6 e VKM nr. 994.

Mangësitë e shkeljet e konstatuara nga auditimi i dokumentacionit me zgjedhje për ***zonën kadastrale 3513 fshati Stegopul, Gjirokastër*** në lidhje me zbatimin e përcaktimeve ligjore të bëra në ligjin ***nr. 7501, datë 19.07.1991, i ndryshuar dhe VKM nr. 994, datë datë 09.12.2015,*** bazuar në kërkesat e neneve 24-25 të ligjit 33/2012, më konkretisht paraqiten sipas refencave evidentuar si më poshtë:

1.Sipas Referencës nr. 0048, datë 28.06.2018, regjistruar deshmi trashëgimisë testamentare në favor të [redacted] për pasurinë ***113/7, v. 4, faqe 40, që vjen nga v.3, faqe 174 me sipërfaqe 1000 m2 tokë Arë*** dhe lëshuar certifikatë ***me datë 28.06.2018,*** me nëshkrim në KPP nga ***L K*** dhe pa nëshkruar e vulosur KPP nga ***Regjistruesi F T.***

Kjo pasuri e regjistruar me dëshmi trashëgimie vjen nga ***pasuria nr. 113/1,*** evidentuar në KPP nga projekti në emër të [redacted] ***sipas Aktit 1183 me LN 1198 m2,*** dhe nuk rezulton të jete lëshuar certifikatë sipas këtij akti.

Sipas ***refencës nr. 0044,*** pasuria me ***nr. 113/1, v. 3, faqe 174*** regjistruar me ndarje në pasurinë 137/7, v.4, faqe 40 per 1000 m2 dhe në pasurin 113/8, v.4, faqe 41 per siperfaqen shtet për 198 m2 duke veçuar pasurin shtet, ndërsa regjistruar me dëshmi trashëgimie pasuria 137/7, v.4, faqe 40 per 1000 m2 pa u rergjistruar me parë në emër të [redacted] sipas refencës 0044, datë 09.10.2017, dhe nuk ka urdhër për regjistrim.

Inventari datë 09.07.2018 nga L K dhe Akiviste A G.

*Sipas aplikimeve **23412, 23447, 23481, 23460, 23369, 1176 janë** zbatuar tarifat e pagesave per, leshim certifikatë pronësie, kopje KPP, koppje HTR dhe regjistrim deshmi trashëgimie.*

Sipas vendimit të gjykates për dëshmi trashëgimie Testamentare nr.893/350, datë 24.05.2016 është vendosur Leshim i dëshmisë trashëgimisë testamentare per trashëgimlenesin [redacted] ***Boga,*** në favor të [redacted](shtëpinë e vjeter), [redacted] (i biri Spiros dhe Antonetës trashëgon magazinën)

Prokura për [redacted] ***nr. 246/144, datë 30.01.2018 nga A*** [redacted] ***etj. në dosje gjenden:***

Vërtetim nr. 702, datë 04.09.2017 nga Bashkia Libohovë per gjendjen familjare e ***z.*** [redacted] (kryefamiljare) datë 01.08.1991, [redacted]), [redacted]) dhe [redacted]).

Vërtetim nr. 738, datë 11.09.2017 nga Bashkia Libohove që [redacted] është i njëjti me emrin [redacted]**.**

Konfirmim dokumentacioni për pronësinë [redacted] sipas Planit të Rilevimit, nga [redacted] datë 10.09.2017.
Deklaratë noteriale 2280/1144, datë 22.09.2017 [redacted] me cilesinë e kryefamiljarit, kur në fakt përfituesi me AMTP është [redacted], që është dakord me saktësimin.
Vërtetim nr. 33, datë 17.01.2017 nga Bashkia zj. [redacted] deri 17.01.2018 eshte është K/Familjre
Sipas ***AMTP nr. 1183, pa datë*** evidentohet një siperfaqe prej ***10410 m2*** ***në emër të*** [redacted] ***Boga*** *nga e cila regjistruar* ***5460 m2*** ***në KPP,*** ku evidentohet ***vreshtë 200 m2, ndersa leshuar certifikate për pasurinë 1000 m2 në emër të trashëgimtarëve të*** [redacted] u pajisur më pare përfituesi i titullit të pronësisë.
Në emër trashëgimtareve të Mite Ilo Boga janë regjistruar ***vetem 1000 m2 perfituar me AMTP nga*** [redacted]**.** Sipas regjistrimit fillestar rezulton të jenë regjistruar në KPP ***-8 pasuri me sipërfaqe gjithsej 7397 m2 nga e cila me 0001 evidentohet truall 300 m2 dhe ndërtesë 101 m2,*** ndërsa sipas AMTP dhe me listat e 0001 rezulton të jenë regjistruar 8 pasuri gjithsej 5760 m2 me ***një diferencë prej 1637 m2.*** Nuk rezultojnë në listat e printim III-të pasuritë e përfituara sipas AMTP 1183 me nr. 229/6 me sipërfaqe 3900 m2 Arë, pasuria 177/32 me siperfaqe 1050 m2 Arë në Plovisht ose gjithsej të pa evidentuara në listat e printimIII-të ***4950 m2.***
Nuk rezulton te jetë bëre saktësim pasurish në zbatim të VKM nr. 994, datë 09.12.2015 pika 2 për pasuritë e regjistruara sipas AMTP dhe sipas LN. Sipas LN evidentohen të regjistruara ***7397 m2, ose më pak se AMTP një sipërfaqe prej 3013 m2.***
Deshmia e trashëgimisë mban datën 24.05.2016, ndërsa aplikuar me nr. datë 23.04.2018, duke aplikuar me vonese dhe nuk është zbatuar kamat vonesa per regjistrim me vonesë per 10 % mbi tarifën e regjistrimit, në rastin konkret ***për 2 vjet ose 730 ditë x 70 lekë = 51100 lekë.***
Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:
Sipas AMTP nr. 1183, pa datë, në pronësi të [redacted] evidentohen gjithsej tokë arë 10410 m2 ndërsa me LN gjithsej 7397 m2 nga e cila truall 300 m2 dhe ndertim 101 m2 v.3, faqe 186, ose më pak se AMTP(dokumentacioni ligjor) një ***sipërfaqe prej 3013 m2.***
Rezulton te jetë ***regjistruar dëshmi trashëgimie testamentare*** për pasurin nr. 113/1, v.3, faqe 174 me sipërfaqe 1000 m2, pa u kryer veprimet per saktësimin e pasurive, ***në kundërshtim me pikën 2 të VKM nr. 994, datë 09.12.2015, dhe nuk ka njoftime për subjektin përfitues, dhe deklaratë per saktësimin e pasurive nga subjekti që është dakord me saktësimin.***
Deshmia e trashëgimisë mban datën 24.05.2016, ndërsa aplikuar me nr. 23.04.2018, duke aplikuar me vonese dhe nuk aplikuar kamat vonesa per regjistrim me vonesë per 10 % mbi tarifën e regjistrimit, në rastin konkret ***për 2 vjet ose 730 ditë x 70 lekë = 51100 lekë***
Për saktësimet në lidhje me pasuritë e regjistruara nuk janë bërë shënimet në KPP për mosperputhjen e sipërfaqes përcaktuar në AMTP dhe sipërfaqes sipas hartës kadastrale. Nuk ka njoftime për subjektin përfitues duke vepruar në kundershtim me pikë 2 të VKM nr. 994, datë 09.12.2012 "kur pasuria figuron e regjistruar në ZVRPP", shkronjat a,b,c,ç dhe d.
Në kundërshtim me rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999, Kreu IV-të pika 5 ":Regjistrime të ndryshimeve në KPP "Ndryshim saktësim emri" pa u saktësuar emri i subjektit përfitues, dhe ndërimi i perfaqësuesit të familjes bujqësore sipas certifikates familjare dhe deklaratën e antarëve të tjere të familjes per zgjedhjen e një perfaqësuesi të ri të familjes.
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
Ligjin_7501, dattë 19.07.1991 me ndryshime
Ligjin nr. 33/2012, datë 21.03.2012, nenet 24-25
VKM nr.994, datë datë 09.12.2015 sipas kërkesave të nenit 24-25 të ligjit 33/2012
Rregulloren 184, datë 08.04.1999.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
Z. L K me detyrë Juriste, në cilesinë e Juristit
Z.Th C me detyrë Hartograf.

(Trajtuar më hollesisht në aktkonstatimin nr. 7, datë 09.08.2019 dhe Projektraportin e auditmit të dërguar me shkresën nr. 372/4, datë 14.08.2019 dhe kthyer e protokolluar nëKLSH me nr. 372/5, datë 16.09.2019 dhe me shkresen 3619. Prot, datë 09.09.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 372/6, datë 25.09.2019. (Zona kadastrale 3513-AMTP Stegopul).

Komente dhe shpjegime nga subjekti i Audituar: *Subjekti i Audituar* ***L K(me detyrë specialiste-juriste) dhe Th C me detyrë (specialist-hartograf)kundrejt aktkonstatimin nr. 7, datë 09.08.2019 dhe Projektraportit të Auditimit dërguar nga KLSH nr. 372/4, datë 14.08.2019*** *kanë bërë komente dhe shpjegime në lidhje me problematikat e trajtuara per pasurin e regjistruar sipas* ***refencës nr. 0048, regjistrim Deshmi trashëgimie testamentare,*** *me pretendimin se pasuria* ***nr. 113/7, vol. 4, faqe 40, zk.3513 me siperfaqe 1000 m2 arë,*** *e regjistruar nga* ***Antoneta Rebi*** *është bëre sipas kërkeses së saj sipas deshmisë trashëgimisë nr.* nr . 893. rep. nr. 350 kol.. date 24.05.2016 dhe ***konstatimi i grupit te auditimit nuk qëndron, pasi veprimet e kryera jane konform ligjit nr.33/2012, Kodit Civil, ligjit nr.7698/1993 si dhe UKM nr. 2/2012.*** *Subjekti shpjegon se aplikimi i kamat voneses llogaritur nga grupi i auditimit per vleren prej* ***51100*** *është gabim mbasi* aplikimi nga qytetari me nr. 1176 mban datën 30.05.2016(KP5) ndërsa dëshmia e trashëgimisë është me ***nr. 893. rep. 350. kol. date 24.05.2016.***

Qëndrimi i grupit të auditimit *në lidhje me komentin dhe shpjegimet e subjektit të Audituar* ***L K(me detyrë specialiste-juriste) dhe Th C me detyrë (specialist-hartograf)*** *në lidhje me problematikat e trajtuara në* ***aktkonstatimin nr. 7, datë 09.08.2019 dhe Projektraportit të Auditimit dërguar nga KLSH nr. 372/4, datë 14.08.2019*** *për pasurinë e regjistruar në emër të* ***Antoneta Rebit sipas regferencës 0048****, shpjegojmë se, është konstatuar e regjistrim deshmi trashëgimie për pasurin nr. 113/1, v.3, faqe 174 me sipërfaqe 1000 m2, pa u kryer veprimet per saktësimin e pasurive,(LN-AMTP)* ***në kundërshtim me pikën 2 të VKM nr. 994, datë 09.12.2015, nuk ka njoftime për subjektin përfitues dhe nuk ka deklaratë per saktësimin e pasurive nga subjekti që është dakord me saktësimin.*** *Sipas LN evidentohen të regjistruara* ***7397 m2, ose më pak se AMTP një sipërfaqe prej 3013 m2.*** *Persa i përket që konstatimit gabim per aplikimin e kamat voneses per regjistrim sqarojmë se sipas konstatimit aplikimi evidentohet me datë 23.04.2018 ndërsa deshmi e trashëgimisë mban datën 24.05.2016 sikurse evidentuar në projektraport auditimi, ndersa nga subjekti nuk na është vënë dispozicion kopje aplikimit të qytetarit.*

Përsa pretendohet nga subjekti audituar pretendimet e paraqitura meren në konsideratë pjesërisht, kryesisht vetëm për diferencën e llogaritur të aplikimit të kamatvoneses në regjistrim në ***vlerën prej 51100 lekë,*** *ndërsa pretendimet e tjera të paraqitura nuk kanë argumentim e mbështetje ligjore për rjedhojë nuk meren në konsideratë.*

Zona Kadastrale 2392-Lazarat-AMTP.

1. Sipas AMTP 4713, date 15.05.1994(77-8) pa aplikim sipas KPP rezulton e regjistruar pasuria ***77/9, v. 8, faqe 13 tokë are sipas AMTP 4713, date 15.05.1994(77-8) me siperfaqe 4500 m2 dhe sipas LN-2500 m2 në emër të [redacted] pa datë të lëshimit të certificatës.***

Ndërsa me refencën ***nr. 00528, datë 04.10.2016*** kjo pasuri është regjistruar në emër ***të*** [redacted] dhe lëshuar certifikkatë ***me date 06.10.2016 nëshkruar M K për 2500 m2 sipas LN, ndërsa me refencën nr. 0639 kjo pasuri me KSHB i është kaluar*** [redacted]

Sipas ***AMTP 4715, datë 15.05.1994***(77-9)pa aplikim sipas KPP rezulton e regjistruar pasuria 77/10, v. 8, faqe 14 tokë are me siperfaqe 2500 m2 ndërsa sipas LN-5500 m2 në emër të [redacted] dhe nuk evidentohet data lëshimit të certifikatës.

Ndërsa me refencën ***nr. 00528, datë 05.10.2016 kjo pasuri është regjistruar në emër të*** [redacted] ***dhe lëshuar certifikkatë me date 06.10.2016 nëshkruar M K për 5500 m2 sipas LN,*** ndërsa me ***refencën nr. 0639 kjo pasuri me KSHB i është kaluar*** [redacted]

Sikurse evidentohet më lart rezulton se ***pasuritë 77/9 dhe 77/8 janë të evidentuara edhe sipas AMTP 4741 , datë 15.05.1994 në emer të*** [redacted]**.**

Sikurse evidentohet rezulton se pasuritë 77/9 dhe 77/10 rezultojnë të regjistruara në emër të [redacted] ***me 3 AMTP të ndryshme me nr. 4713(*** [redacted]

[redacted].

Në praktikën e regjistrimit të ketyre pasurive nuk gjendet urdhri i regjistruesit per veprimet në HTR dhe Kartela, nuk ka relacion nga hartografi dhe juristi per regjistrimin e titullit të pronësisë.
Sipas KPP rezultojnë të regjistruara pasuritë në emer të [redacted] AMTP 4741- me një sipërfaqe 9800 m2 dhe sipas matjeve 10478 m2 me një diferencë me LN më teper se AMTP për 678 m2 nga e cila truall me 0001 per 300 m2, ndërsa sipas AMTP 4715 regjistruar në emer të Vahit Shaban Gjinit një siperfaqe prej 9800 m2 nga e cila 300 m2 truall me 0001 dhe sipas matjeve rezulton një siperfaqe prej 12000 m2 me një diferencë më tepër me LN për 2200 m2 dhe janë kryer veprimet pa u bërë më parë saktësimi I pasurive

Në KPP sipas refencës 0528 regjistruar pasuria me emrin [redacted], ndërsa në AMTP nr. 4741 evidentohet emri [redacted], dhe nuk është bërë korigjim kartele në lidhje me emrin.
Nuk rezulton të ketë deklaratë noteriale që është dakord me saktësimet e bëra dhe nuk janë bërë shënimet në KPP për mosperputhjen e sipërfaqes përcaktuar në AMTP dhe sipërfaqes sipas hartës kadastrale. Nuk ka deklaratë noteriale për zbritjen e sipërfaqes më tepër sipas LN për gjithsej 2200 m2 dhe 678 m2 se kujt sipërfaqe do ti zbritet, duke vepruar në kundërshtim me pikën 2 të VKM nr. 994, datë 09.12.2012 "kur pasuria figuron e regjistruar në ZVRPP", shkronjat a,b,c,ç dhe d.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
Ligjin_7501, dattë 19.07.1991 me ndryshime
Ligjin nr. 33/2012, datë 21.03.2012, nenet 24-25
VKM nr. 994, datë datë 09.12.2015 sipas kërkesave të nenit 24-25 të ligjit 33/2012
VKM nr. 159, datë 21.03.2006 dhe shkresën nr. nr. 3192/2, datë 14.05.2012 të ZQRPP.
Rregulloren 184, datë 08.04.1999 dhe ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, iu ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
Z. M K me detyrë ish-regjistrues.
Z. E B me detyrë ish-hartograf.
(Trajtuar më hollësisht në Aktkonstatimin nr. 12, mbajtur me datë 31.07.2019dhe Projektraportin e auditmit të dërguar me shkresën nr. 372/4, datë 14.08.2019 dhe kthyer e protokolluar nëKLSH me nr. 372/5, datë 16.09.2019. (Zona kadastrale 2392-AMTP Lazarat).

<u>Zona Kadastrale 3513-Stegopul (0001).</u>

Nga auditimi i ushtruar në ***Drejtorinë Rajonale Vendore ASHK(ZVRPP) Gjirokastër*** në lidhje me pranimin dhe regjistrimin e dokumentacionit ***Zona Kadastrale 3513(Stegopul),*** për pasuritë e përfituara në zbatim të ***VKM 432, datë 14.08.1995, i ç'fuqizuar dhe VKM nr. 159, datë 21.03.2006,*** në bazë të ligjit 33/2012 "Per regjistrimin Pasurisë Palujtshme dhe ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", për periudhën nga data 01.01.2016 deri me datë 31.05.2018, në bazë të programit të auditimit nr. 372/1, datë 28.05.2019 në lidhje me përcaktimin e proçedurës së kalimit të pronësisë së pasurisë të perfituara sipas ligjit të Urbanistikës 7693, datë 07.04.1993 për pasuri të palujtshme të ndërtuara deri me datë 10.08.1991 dhe të truallit funksional të tyre.VKM 432, datë 14.08.1995, i ç'fuqizuar dhe VKM nr. 159, datë 21.03.2006 për periudhën 01.01.2016 deri 31.05.2018 u konstatua:
Nga ana e ZVRPP Gjirokastër nuk janë zbatuar kërkesat e ***VKM 432, datë 14.08.1995, i ç'fuqizuar dhe VKM nr. 159, datë 21.03.2006 "Për mbylljen e njësive të Menaxhimit të Projektit per SRPP dhe transferimin e funksioneve të saj ZQRPP",*** bazuar në kërkesat e neneve 24-25 të ligjit 33/2012 në lidhje me pasuritë e regjisrtuara ***"Truall dhe Ndërtesë"*** ku përcaktohet si më poshtë:

*"ZVRPP Regjistron në përputhje me nenet 24, 25 të ligjit 33.2012 mbas verifikimit të dokumentacionit pasuritë e perfituara **VKM nr. 432, datë 14.08.1995, i ç'fuqizuar dhe VKM nr. nr. 159, datë 21.03.2006** nëse plotesohen kushtet per regjistrim sipas **urdhrit të Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2012**, në lidhje me regjistrimin e pasurive **"Truall dhe ndërtesë"**, bazuar në*

aktet e lëshuara nga Organet Vendore, bazuar në VKM nr. 432, datë 14.08.1995 "Për proçedurat e regjistrimit të Pasurisë në Zonat Urbane të Fshatit",ç'fuqizuar sipas ***pikës 5, të VKM nr. 159, datë 21.03.2006 "Për mbylljen e njësive të Menaxhimit të Projektit per SRPP dhe transferimin e funksioneve të saj ZQRPP"*** *duke unifikuar proçedurat sipas urdhrit* ***nr. 411, datë 14.05.2012****, administruar në ZQRPP* ***me shkresën 3191/1, datë 14.05.2012. Sipas këtij urdhri sqarohen dhe saktësohen proçedurat që do të ndiqen në lidhje me pasuritë e regjistruara apo në proces regjistrimi sipas VKM nr. 432, datë 14.08.1995, i ç'fuqizuar duke përcaktuar 8 raste për regjistrimin e pasurive Truall dhe ndertesë, mbas daljes së VKM nr. 159, datë 21.03.2006 sipas aktit të pronësisë plotësuar (lista emërore e pronarëve të trojeve dhe të shtëpive.***

Për sa konstatuar nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit për ***zonën kadastrale 3513, fshati Stegopul,*** në lidhje me zbatimin e përcaktimeve ligjore të bëra në ***VKM 432, datë 14.08.1995, i ç'fuqizuar dhe VKM nr. 159, datë 21.03.2006 "Për mbylljen e njësive të Menaxhimit të Projektit për SRPP dhe transferimin e funksioneve të saj ZQRPP",*** bazuar në kërkesat e neneve 24-25 të ligjit 33/2012 më konkretisht regjistrimi i dokumentacionit sipas refencave paraqitet si më poshtë:

1.Me Referencë nr. 0047, aplikim ***nr. 1293, datë 03.04.2018*** është regjistruar pasuria nr. ***61/6 për truall 300 m2 dhe ndërtim 80 m2, v. 3, faqe 182, në emër të*** [redacted] sipas listave me 0001, në zbatim të VKM 432, datë 14.08.1995, i ç'fuqizuar dhe VKM nr. 159, datë 21.03.2006, lëshuar certifikate datë 10.04.2018 dhe nënshkruar KPP ***L K (juriste)*** dhe pa nëshkruar nga ***Regjistrues F T.***

Inventari datë 10.04.2018 nëshkruar nga L K(jurist) dhe Arkiviste A G.

Sipas aplikimit ***nr. 1293, datë 03.04.2018 Jorgo Kuro*** ka kërkuar regjistrimin e pasurisë ***61/6 për truall 300 m2 dhe ndërtim 80 m2*** sipas listës pronarëve të trojeve dhe shtëpive në zbatim të ***VKM 432, datë 14.08.1995, i ç'fuqizuar dhe VKM nr. 159, datë 21.03.2006.***

Shqyrtimi i kërkesës paraqitur nga [redacted] është bërë brenda afateve përcaktuar në rregulloren 184, datë 08.04.1999, në zbatim të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

Në KPP ***volum 3, faqe 182, është regjistruar pasuria nr. 61/6, ndërtesë me sipërfaqe 80 m2 dhe truall 300 m2 në pronësi të*** [redacted]**,** lëshuar çertifikatë ***datë 10.04.2018****,* me Regjistrues ***F T.*** Kartela e pasurisë së paluajtshme *është pa vulën e ZVRPP Gjirokastër dhe pa nënshkrimin e Regjistruesit,* në papajtueshmëri me pikën 8, Seksioni II, të Udhëzimit Metodik nr. 76, datë 13.09.1999 "Për plotësimin e kartelave të pasurive të paluajtshme".

Nga auditimi i dokumentacionit sipas inventarit u konstatua:

-Sipas aplikimit nr. 1293, datë 03.04.2018 "Korigjim Gabimi" në KPP rezulton të jete kryer pagesa për tarifen e shërbimit ***700 lekë*** nga ***Jorgo Kuro sipas MA datë 03.04.2018.***

-Sipas AV datë 27.03.2018 ZVRPP drejtuar z. Jorgo Kuro ZVRPP i ka kërkuar Vërtetim nga Bashkia Libohove që Jorgji Kuro është i njejti person me Jorgo Kuro***(konceptuar shkresa nga L K dhe nënshklruar nga F T).***

-Vërtetimi nr. 223, date 03.04.2018 i nëshkruar nga Bashkia Libohovë sipas kërkesës të interesuarit që [redacted] është i njëjti person me [redacted] dhe nuk ka person tjetër me këto të dhëna.

-Sipas Aplikimit nr. 1079, datë 23.03.2018(Ervina Konstandini) rezulton të llogaritur pagesa për tarifen e shërbimit për lëshim çertifikate pronësie 1500 lekë, kopje e fragmentit të hartës dhe e KPP për nga 1000 lekë, gjithsej 3500 lekë dhe bashkëlidhur MP për 3500 lekë datë 15.03.2015.

-Me shkresën nr. 447, datë 15.03.2018 Bashkia Libohove konfirmon pronësinë per pasurinë ***61/6 për truall 300 m2 dhe ndërtim 80 m2, zk 3513 Stegopul*** me kufizimet përkatëse sipas plan rilevimit përgatitur nga ***Kosta Malo datë 13.10.2017, i pa konfirmuar e nëshkruar nga Bashkia.*** Për inxhinerin me licensë nuk ka kopje license bashkëlidhur.

-Vërtetim nr. 180, datë 15.03.2018 nga Bashkia Libohovë që [redacted] ka likujduar detyrimet ndaj Bashkisë.

-HTR e pasurisë 61/6, v.3, faqe 182 nëshkruar vetëm nga ***Hartograf*** [redacted] dhe pa nëshkruar nga ***Regjistruesi F T.***
-Lista e pronarëve të trojeve dhe shtëpive ZK 3513 evidenton 47 pronarë dhe në nr. rendor 3 evidentohet pronar [redacted] ***për sipërfaqe truall 300 m2 dhe ndertim 80 m2 sipas aktit 1212 dhe nëshkruar nga Kryetari i Komunës*** [redacted] ***dhe nga K/Plaku*** [redacted]**,** ndërsa pa nëshkruar nga subjekti përfitues sikurse përcaktohet në format.
-Printimi III-të sipas LN regjistruar pasuria 61/6 v. 3, faqe 182 në emër të [redacted] truall sipas aktit 1212.
-Sipas aktit(AMTP) nr.1212, datë 15.06.1995 në emer të [redacted] evidentohet të jetë përfituar gjithsej 16650 tokë Arë dhe nuk evidentohet truall sikurse evidentohet në listat me 0001.
-sipas ***refencës nr. 0047,*** mbas korigjimit të emrit në KPP v. 3, faqe 1, në seksionin C evidentohet pronësia në emër të [redacted] ***dhe lëshuar certifikatë datë 10.04.2018,*** nënshkruar KPP nga ***L K. KPP*** ku evidentohet data e lëshimit të çertifikatës nuk rezulton të jete vulosur dhe nëshkruar nga Regjistruesi, ***në kundërshtim me udhëzimin nr. 77, datë 08.05.2003 "Per plotësimin e KPP".*** Sikurse evidentohet në KPP rezulton të jete bëre ndryshimi i KPP me lëshimin e certifikatës ***nga familjare në Individuale, pa urdhër nga regjistruesi apo pa pasur një vendim Gjykate.***
Në KPP e regjistrimit të pasurisë ***61/6, v.3, faqe 182 sipas listave të 0001*** nuk evidentohet data kur janë hedhur nga projekti dhe se listat nuk kanë datë të miratimit nga K/Komunës dhe K/Plakut dhe nuk dokumentohet se kur këto lista kanë ardhur dhe administruar në ZVRPP pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 159, datë21.03.2006 apo para hyrjes në fuqi të ketij vendimi, ***duke vepruar në kundërshtim me urdhrin e kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2012, administruar në ZQRPP me shkresën nr. 3191 dhe 3191/1, datë 14.11.2012 pikat 5,6 dhe 7.***
Për sa më sipër arrihet në konkluzionin:
Nga ZVRPP Gjirokastër nuk rezulton të jenë zbatuar proçedurat e percaktuara në ***VKM 432, datë 14.08.1995, i ç'fuqizuar dhe VKM nr. 159, datë 21.03.2006, në kundërshtinm me me urdhrin e kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2012, administruar në ZQRPP me shkresën nr. 3191 dhe 3191/1, datë 14.11.2012 pikat 5,6 dhe 7.*** Nuk është plotësuar shtojca 1, në papajtueshmeri me pikën 2-3, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Sikurse evidentohet në KPP rezulton të jetë bërë ndryshimi i KPP me lëshimin e certifikatës ***nga familjare në Individuale,*** pa urdhër nga regjistruesi apo vendim Gjykate, ***në kundërshtim me pikën 3, 3.33, "Pranimi dokumenteve për regjistrim", në zbatim të të rregullores nr. 184, datë 08.04.1999,*** ku thuhet se subjektet në varësi të formës së pronësisë (IFB) për të bërë ndryshime duhet të pasqyrojnë në dokumente, në varesi të formës pronësisë, në rastin konkret "Familjare"nëshkrimet e familjes sipas çertifikates familjare në momentin e përgatitjes së dokumentit, ose përfaqësuesit të familjes të autorizuar me prokurë.
Në KPP e regjistrimit të pasurisë ***61/6, v.3, faqe 182 sipas listave të 0001*** nuk evidentohet data kur janë hedhur nga projekti dhe se listat nuk kanë datë të miratimit nga K/Komunës dhe K/Plakut dhe nuk dokumentohet se kur këto lista kanë ardhur dhe administruar në ZVRPP pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 159, datë21.03.2006 apo para hyrjes në fuqi të ketij vendimi,
Pronësie e evidentuar sipas listave me 0001 lidhet me aktin AMTP nr. 1212, ndërsa në këtë Akt-AMTP nuk evidentohet as truall dhe as shtëpi.
Persa i perket ndryshimit të emrit, rezultoi të ketë vetëm vërtetim nga Bashkia, dhe nuk rezulton të ketë vendim të keshillit bashkiak, apo vendim gjykate, ***në kundershtim me piken 5 "Regjistrime të ndryshimeve në KPP" dhe 5/1 "Ndryshim dhe Ndrim emri të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999, "Për Regjistrimin e Pasurive të Palujtshme".***
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
Nenin 44-45 të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012
Kreun e IV-të të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999

VKM 432, datë 14.08.1995, i ç'fuqizuar dhe VKM nr. 159, datë 21.03.2006.
Udhrin e kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2012.
Udhëzimin KM nr. 2, date 12.09.2012,
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. ***L K me detyrë Juriste***
2. ***A Cme detyrë hartograf.***

2.Me Referencë nr. 0043, aplikim ***nr. 2014, datë 19.06.2016*** është regjistruar pasuria nr. ***94/8 për truall 300 m2 dhe ndërtim 105 m2, v. 3, faqe 205, në emër të*** [redacted] sipas listave me 0001, në zbatim të VKM 432, datë 14.08.1995, i ç'fuqizuar dhe VKM nr. 159, datë 21.03.2006, lëshuar certifikate datë 26.04.2017 dhe nënshkruar në KPP ***ish-regjistrues M K***, kjo KPP nëshkruar dhe vulosur nga ***ish-regjistrues M K.***
Inventari pa datë dhe nëshkruar e vulosur vetem nga ish-Regjistgruesi M K.
Sipas aplikimit ***nr. 2014, datë 19.06.2016*** [redacted] ka kërkuar regjistrimin e pasurisë ***94/8 për truall 300 m2 dhe ndërtim 105 m2,*** sipas listës pronarëve të trojeve dhe shtëpive në zbatim të ***VKM 432, datë 14.08.1995, i ç'fuqizuar dhe VKM nr. 159, datë 21.03.2006.***
Në KPP ***volum 3, faqe 205, është regjistruar pasuria nr. 94/8 për truall 300 m2 dhe ndërtim 105 m2, në pronësi të*** [redacted]**,** lëshuar çertifikatë datë ***26.04.2017*** dhe regjistrues ***M K.*** Kartela e pasurisë së paluajtshme *është e vulosur dhe nënshkruar nga ish-Regjistruesit,* në pajtueshmëri me pikën 8, Seksioni II, të Udhëzimit Metodik nr. 76, datë 13.09.1999 "Për plotësimin e kartelave të pasurive të paluajtshme".
Nga auditimi i dokumentacionit sipas inventarit u konstatua:
-Sipas aplikimit nr. 2014, datë 19.06.2016, rezulton të jete kryer pagesa për tarifën e shërbimit gjithsej ***4900 lekë*** nga [redacted] ***MA datë 19.06.2016.***
-Paraqitur çertifikatë familjare për datën 01.08.1991 me përbërje 7 persona.
-Dëshmi trashëgimie nr. 807/485/1, datë 13.09.2016 për 8 persona Trashgimlënsja [redacted] me 1/8 pjesë
-Deshmi trashëgimie nr. 808/486/1, datë 13.09.2016 per 7 persona për trashëgimlënsin [redacted] si trashgimtarë të radhës parë 7 persona me 1/7 pjesë.
-Aplikim AV- Nardi nr. 1003, datë 28.03.2017 " emri"([redacted]). AV- Nardi nr. 1937, datë 27.09.2016 që të specifikohet pasuria me plan rilevimi për pasurinë e aplikuar(nëshkruar nga M K).
-Vërtetim nr. 417, 417 datë 26.07.2016 nga Bashkia Libohovë që [redacted] ka likujduar detyrimet ndaj Bashkisë dhe rezulton i regjistruar në gjendjen civile Gjirokastër, Njesia Administrative Libohovë.
-Plan rilevimi i pasurisë 94/8, v.3, faqe 205 përgatitur dhe nëshkruar vetëm [redacted] dhe ***pa nëshkruar nga Bashkia.***
HTR- nëshkruar nga L B ish-hartograf dhe ish-Regjistgruesi M K.
-Lista e pronarëve të trojevedhe shtëpive ZK 3513 evidenton 47 pronarë dhe në nr. rendor 28 evidentohet pronar [redacted] ***për sipërfaqe truall 300 m2 dhe ndertim 105 m2 sipas aktit 1225 datë 15.06.1995 dhe nëshkruar nga Kryetari i Komunës*** [redacted]**,** ndërsa pa nëshkruar nga subjekti përfitues sikurse përcaktohet në format.
-Printimi III-të sipas LN regjistruar pasuria 94/8 v. 3, faqe 205 në emër të [redacted] ***Marko*** truall sipas aktit 1225.
-Sipas aktit(AMTP) nr.1225, datë 15.06.1995 në emer të [redacted] evidentohet të jetë përfituar gjithsej 22990 m2 tokë Arë dhe nuk evidentohet truall sikurse evidentohet në listat me 0001.
-sipas refencës nr. 0043, pasuria e regjistruar 94/8, v.3, faqe 205 evidentohet në seksionin pershkrimi i veçantë me shënimin sipas Planit të rilevimit të konfirmuar nga Bashkia dhe

deshmisë së trashëgimisë, ndërsa sipas dokumentacionit në dosje nuk rezulton që plani i rilevimit të jete i konfirmuar nga Bashkia dhe perderisa ka mare refencë duhet të ishte regjistruar në seksionin C me pronar trashëgimtaret e [redacted] sipas deshmisë së trashëgimisë dhe datës aplikimit.

Në KPP e regjistrimit të pasurisë ***94/8, v.3, faqe 205 sipas listave të 0001*** nuk evidentohet data kur janë hedhur nga projekti dhe se listat nuk kanë datë të miratimit nga K/Komunës dhe K/Plakut dhe nuk dokumentohet se kur këto lista kanë ardhur dhe administruar në ZVRPP pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 159, datë21.03.2006 apo para hyrjes në fuqi të ketij vendimi, ***duke vepruar në kundërshtim me urdhrin e kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2012, administruar në ZQRPP me shkresën nr. 3191 dhe 3191/1, datë 14.11.2012 pikat 5,6 dhe 7.***

Për sa më sipër arrihet në konkluzionin:

Nga ZVRPP Gjirokastër nuk rezulton të jenë zbatuar proçedurat e percaktuara në ***VKM 432, datë 14.08.1995, i ç'fuqizuar dhe VKM nr. 159, datë 21.03.2006, në kundërshtinm me me urdhrin e kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2012, administruar në ZQRPP me shkresën nr. 3191 dhe 3191/1, datë 14.11.2012 pikat 5,6 dhe 7.*** Nuk është plotësuar shtojca 1, në papajtueshmeri me pikën 2-3, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit". Sikurse evidentohet në KPP ***v.3, faqe 205 regjistruar pasuria 94/8 nuk*** rezulton të jetë bërë ndryshimi i KPP me lëshimin e certifikatës ***nga familjare në Individuale,*** por në dokumentacionin në dosje nuk evidentohen nëshkrimet ***e anëtarëve të familjes sipas çertifikatës familjare në momentin e pergatitjes së dokumetit, në kundërshtim me rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999, Kreu VI-të, pika 3 "Pranimi i dokumenteve per regjistrim" pikat 3.3 dhe 3,3,3 "Familje".***

Në KPP e regjistrimit të pasurisë ***94/8 sipas listave të 0001*** nuk evidentohet data kur janë hedhur nga projekti dhe se listat nuk kanë datë të miratimit nga K/Komunës dhe K/Plakut dhe nuk dokumentohet se kur këto lista kanë ardhur dhe administruar në ZVRPP pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 159, datë21.03.2006 apo para hyrjes në fuqi të ketij vendimi,

Pronësie e evidentuar sipas listave me 0001 lidhet me aktin AMTP nr. 1225, ndërsa në këtë Akt-AMTP nuk evidentohet as truall dhe as shtëpi.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Nenin 44-45 të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012
Kreun e IV-të të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999
VKM 432, datë 14.08.1995, i ç'fuqizuar dhe VKM nr. 159, datë 21.03.2006.
Udhrin e kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2012.
Udhëzimin KM nr. 2, datë 12.09.2012,

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. ***M K me detyrë ish-Regjistrues***
2. ***L B me detyrë ish-hartograf.***

<u>3.Me Referencë nr. 0050,</u> aplikim ***nr. 4193, datë 18.10.2018([redacted])*** është regjistruar pasuria nr. ***94/56 për truall 300 m2 dhe ndërtim 96 m2, v. 3, faqe 212, në emër të [redacted] Koqinit 29.10.2018*** sipas listave me 0001, në zbatim të VKM 432, datë 14.08.1995, i ç'fuqizuar dhe VKM nr. 159, datë 21.03.2006, lëshuar certifikate datë 29.10.2018 dhe nënshkruar KPP ***S Sh(juriste)*** dhe pa nëshkruar e vulosur KPP nga ***Regjistrues F T.***

Inventari datë 31.10.2018 nëshkruar nga S Sh (jurist) dhe Arkiviste A G.

Sipas aplikimit ***nr. 4193, datë 18.10.2018*** [redacted] ka kërkuar regjistrimin e pasurisë ***94/56 për truall 300 m2 dhe ndërtim 96 m2, v. 3, faqe 212,*** sipas listës pronarëve të trojeve dhe shtëpive në zbatim të ***VKM 432, datë 14.08.1995, i ç'fuqizuar dhe VKM nr. 159, datë 21.03.2006.***

Origjina pasurisë vjen nga privatizimi, sipas kontratës nr. 298/184, datë 24.09.1991, është privatizuar objekti "ish zdruktari e tapiceri", e ndërmarrjes shërbime komukale, ndërsa origjina e truallit me sipërfaqe 58 m^2, rrjedh nga kontrata e shtitblerjes nr. 1885/1595, datë 13.11.1995, palë shitëse Seksioni i Financës së Këshilli i Rrethit Gjirokastër, dhe blerës [redacted], më pas është regjistruar në regjistrat hipotekor.
Shitja e truallit nga Këshilli i Rrethit, për objektin e privatizuar, është në mospërputhje me përcaktimet ligjore, pasi të drejtën për të privatizuar truallin në funksion të objektit të privatizaur e kishte vetëm Agjencia Kombëtare e Privatizmit, apo degët e saj në rrethe,
Nga ZVRPP Gjirokastër, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Regjistrimi i pasurisë truall është kryer ***në mungesë të verifikimit të elmentev të formës dhe përmbajtjes së dokumentacionit që shërben si titull pronësie,*** sa vepruar në ***në papajtueshmëri me*** shkronjën "a", neni 25, neni 45 të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 3 të ligjit nr. 7980, datë 27.07.1995 "Për Shitblerjen e trojeve", i ndryshuar dhe UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit"
Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** F T, me detyrë Regjistrues, S Sh. me detyrë specialist jurist.

- Referencë nr. 15799; ZK 8541;
Me aplikim nr. 584, datë 224.02.2017 dhe nr. 2246, datë 04.10.2016, [redacted] ka kërkuar regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë dhe kalimin e pronësisë për pasurinë e përfituar me privatizim nga Bashkia Gjirokastër dhe pajisjen me certefikatë pronësie.
Në KPP volum 35, faqe 247, si dhe në regjistrin hipotekor nr. 424, datë 14.12.2017, është regjistruar pasuria nr. 14/48+1-1, apartament me sipërfaqe 81m^2, në pronësi të [redacted] dhe [redacted], lëshuar vërtetim pronësie datë 14,12,2017.
Regjistrimi i kësaj pasurie është kryer bazuar në dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formulari nr. 3/a, kontratë për marrjen në pronësi të apartamentit, me datë 23.12.1993, hartuar ndërmjet, përfaqësuesit të repartit ushtarak nr. 5500, z. [redacted] dhe qytearit [redacted], ku përcaktohen të dhënat për aprtamentin 2+1, kati I,, pallati , Lagja "18 Shtatori", ky dokument nuk është origjinal por fotokopje.
- Dokumentcioni hartografik(planimentri, plan vendosja);(fotokopje)
Gjithashtu pjesë e dokumentacionit, gjendje në dosjen me referncë nr. 15799, janë:
- Kërkesë për regjistrim ZVRPP Gjirokastër, datë 30.09.2016, bërë nga një specialist i pa autorizuar i Drejtorisë Rajonale EKB Gjirokastër, kërkesë e cila nuk përmban asnjë referencë ligjore dhe nuk ka konfirmimin e Titullarit të institucionit përkatës;
- Kontratë për privatizim banese, datë 30.09.2016, hartuar ndërnjet Ilia Nasto, specialist i pa autorizuar i Drejtorisë Rajonale EKB Gjirokastër dhe qytetarit qiramarrës(e pa nënshkruar nga

qytetari). Rezulton se kontrata nuk është nënshkruar nga Titullari i Institucionit dhe personai përfaqësues rezulton i pa autorizuar, gjithashtu kontrata e privatizimit duhet të hartohej tek noteri, për rrjedhojë doumenti i paraqitur nuk ka vlefshmëri juridike për të shërbyer si akt përvfitimin e pronësisë.
Sa trajtuar arrijmë në konkluzionin se, regjistrimi i pasurisë *është kryer më shkelje të dispoziateve ligjore*, ***pasi mungon dokumentacioni ligjor që shërben si Titull Pronësie***, sa vepruar në ***në papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjin nr. 9321, datë 05.11.2004 "Për privatizimin e objekteve shtetërore e banesave", UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuar më sipër ***ngarkohet me përgjegjësi*** M K me detyrë ish Regjistrues dhe O C, me detyrë specialisti jurist dhe L B specialist hartograf..

- Referencë nr. 16482; ZK 8541;
Me aplikim nr. 2800, datë 24.07.2018, [redacted] ka kërkuar regjistrimin e kalimit të pronësisë për pasurinë e përfituar me privatizim nga Bashkia Gjirokastër dhe pajisjen me certefikaatë pronësie.
Në KPP volum 36, faqe 166, është regjistruar pasuria nr. 38/58+1-4, apartament me sipërfaqe 51.6 m^2, në pronësi të Eleni Vasili dhe [redacted] lëshuar vërtetim pronësie datë 01.08.2018.
Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se kontrata e shitjes sëbashku me dokumentacionin përkatës, nuk është dërguar në ZVRPP nga Bashkia Gjirokastër ka dërguar, por është depozituar dorazi, dokumentacioni e mëposhtëm:
- Formularët nr. 2, ku përcaktohen treguesit tekniko ekonomik, të apartamentit dhe nr. 3, kontratë për privatizim banese. hartuar nga komisioni i privatizimit të Bashkisë Gjirokastër; ku përcaktohen të dhënat për aprtamentin 4, kati II,, pallati 4, Lagja "Granicë", këto formularë nuk janë origjinalë por fotokopje të panoterizuar.
- Kontrata e kalimit të pronësisë nr. 587/3 rep. , 225 kol. , datë 11.06.2018, ndërmjet Bashkisë Gjirokastër, përfaqësuar nga Kryetari dhe qytetarit që përfiton apartamentin; bazuar në vendimin nr. 39, datë 23.04.2018 të Këshillit Bashkisë;
- Dokumentcioni hartografik(planimentri, plan vendosja);
- mandat arkëtimi e pagesës në vlerën 4250 lekë;
Duke ju referuar dokumentacionit gjendje në dosjen me referenca 16482, rezulton se privatizimi i objektit apartament, është kryer me shkelje dhe parregullsi, pasi:
- Baza ligjore mbi të cilën është mbështetur privatizimi i objektit, i mohon të drejtat dhe kompetencat që ka Bashkia, të kryejë procesin e privatizimit të aprtamentit, pasi objekti në fjalë nuk është në fondin e banesave sociale, gjithashtu Bashkia Gjirokastër nuk e zotëron me dokument pronësie pronën për të bërë të mundur tjetërsimin e saj;
- Mungon kontrata e qirasë që duhet të lidhej para vitit 1992, ndërmjet ndërmarrjes komunale dhe qytetarit si qiramarrës, mbi bazën e të cilës realizohej kontrata e privatizimit, siç përcaktuar në 1, VKM nr. 97, datë 03.02.2008 "Për procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992", i ndryshuar;
Sa trajtuar arrijmë në konkluzionin se, regjistrimi i pasurisë është kryer më shkelje të dispoziateve ligjore, sa vepruar në ***në papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjin nr. 9321, datë 05.11.2004 "Për privatizimin e objekteve shtetërore e banesave", UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit", VKM nr. 97, datë 03.02.2008 "Për procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992".
Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuar më sipër ***ngarkohet me përgjegjësi*** F T me detyrë Regjistrues dhe O C, me detyrë specialisti jurist.

Lidhur sa trajtuar në faqet 129-133 të Projekt Raportit të Auditimit dhe në Akt-Konstatimin nr. 21, datë 09.08.2019, janë paraqitur observacionet në rrugë elktronike dhe derguar me shkresen 3202/1. Prot, datë 13.09.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 372/5, datë 16.09.2019 dhe me shkresen 3619. Prot, datë 09.09.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 372/6, datë 25.09.2019, nga z. F T, me detyrë drejtor dhe specialistët jurist, S Sh dhe O C, ku sqarohet:

Lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr. 16965, ZK 8541, ku konstatoni mungese te tagrave ligjore te organit qe ka bere kalimin e pronesise per shitjen e truallit si dhe per mosplotesim relacioni dhe urdhri regjistruesi ne zbatim te UKM nr.2/2012 - nuk qendron, pasi veprimet e kryera jane konform ligjit nr.33/2012, Rregullores nr.184 date 08.04.1999..... .

Konkretisht, pasuria nr.15/24 vol.36 faqe 213 zk.8541 (ndertese me truall me sip.58.0 m2), i eshte nenshtruar procesit te verifikimit te dokumentacionit tekniko-ligjor prej nga ka rezultuar regjistrimi perkates hipotekor sipas nr.regj.hip.396 date 07.06.1995.... .

Duke qene se regjistri hipotekor si dhe dokumentacioni arkivor ishte demtuar(djegur nga trazirat e vitit 1997) – ne funksion dhe te regjistrimit te deshmise se trashegimise ligjore nr.239 rep.119 kol. Date 29.05.2018 not.[redacted] per te ndjerin [redacted] (kryer ne nr.regj.hip.102 date 28.05.2019 zk.8541) eshte depozituar deklarata noteriale nr.835 rep. 405 kol. Date 29.06.2018 not.G.Kallojeri ku deklarohet mostjetersimi dhe mosbarresimi i pasurise (nga trashegimtaret Mato), shoqeruar me dokumentacionin perkates te privatizimit objektit sipas kontrate shitjes nr.298 rep. 184 kol. Date 24.09.1991(origjinale) dhe kontrates se shitjes per truallin nr.9885 rep.1595 kol. Date 13.11.1995 not.[redacted] (origjinale) me pale shitese Seksioni i Finances Rrethit Gjirokaster.

Lidhur me konstatimin se organit "Seksioni i Finances Rrethit Gjirokaster" i mungojne tagrat ligjore per kryerjen e shitjes se trojeve – sqarojme se kalimi i pronesise eshte bere me akt noterial ne zbatim te nenit 193 te Kodit Civil si dhe ne baze te tagrave qe i atribuohen organit ne fjale bazuar ne percaktimet ligjore qe vijne nga dispozitat e Ligjit nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, veprimtarive private te pavaruara dhe privatizimit",konkretisht ne nenet 3, 14, 21 e vijues, cka perforcohet edhe sipas nenit 4 te Ligjit nr.7980 date 27.07.1995 "Per shitblerjen e trojeve" ne te cilin percaktohet se:

"Kalimi i trojeve te zena prone shtetrore neprone private eshte i detyrueshem kur kerkohet nga i interesuari ne rastet kur:1.Trualli eshte i objekteve qe jane private ose qe do te privatizohen.Kalimi behet ne favor te pronareve te ketyre objekteve" .

Ne keto kushte, vleresoj se trajtimi,regjistrimi i dokumentacionit te pronesise ne nr.regj.hip.102 date 28.05.2019 zk.8541 dhe pajisja me dokument pronesie, eshte bere konform procedurave ligjore. Sa me lart, kopje te dokumentacionit perkates e gjeni bashkengjitur.

Lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr. 16482, ZK 8541, ku konstatoni pergjegjesi ligjore te regjistruesit dhe juristit lidhur me shkelje, parregullsi si dhe mungese te bazes ligjore ne privatizimin e apartamentit nga Bashkia Gjirokaster???? - nuk qendron, pasi veprimet e kryera jane konform ligjit nr.33/2012, UKM nr.2/2012 si dhe nenit 193 te Kodit Civil.

Konkretisht, pasuria apartament me sip.51.6 m2 i eshte nenshtruar procesit te verifikimit te dokumentacionit tekniko-ligjor prej nga ka rezultuar se ne favor te Eleni dhe Viktor Vasili ***nuk vertetohej "ekzistenca e nje akti noterial" per kalimin e pronesise*** *ne zbatim te ligjit nr.7652 date 23.12.1992 si dhe nenit 193 te Kodit Civil.*

Ne keto kushte eshte orientuar qytetarja qe ti drejtohet Bashkise Gjirokaster si organi kompetent ne mbeshtetje te VKM nr.97 date 03.02.2008 "Per procedurat e privatizimit te banesave objekt i ligjit nr.7652 date 23.12.1992 "Per privatizimin e banesave shteterore"... .

Si rrjedhoje e procedurave te ndjekura eshte arritur *ne vendimmarrjen sipas Vendimit te Kesh.Bashkiak nr.39 date 23.04.2018 e me pas* ***ne finalizimin e kontrates se kalimit te pronesise, kontrate e cila ne zbatim te UKM nr.2/2012 plotesonte elementet ne forme dhe permbajtje.***

Lidhur me pretendimin e ngritur nga auditi ne akt-konstatimi per mospasje dokumentacioni qiraje banese apo dokum.tjeter plotesues – sqaroj se nuk ka bazueshmeri ne kushtet kur atributet dhe kompetencat ligjore te verifikimit te te dhenave (ne funksion te procesit te privatizimit) i akordohen pushtetit vendor (Bashkise Gjirokaster) ne zbatim te VKM nr.97/2008..... .
Ne keto kushte, vleresojmë se trajtimi, regjistrimi i aktit noterial per kalimin e pronesise eshte bere konform procedurave ligjore... . Sa me lart, kopje te dokumentacionit perkates e gjeni bashkengjitur.
Lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr. 15799, ZK 8541, ku konstatoni ***se mungon dokumenti ligjor qe sherben si titull pronesie,- nuk qendron pasi regjistrimi*** *i pasurise nr.14/48+1-1, ZK,8541 vo35 fq 247 (apartament me sip.81m2) eshte regjisrtuar sipas Kontrates se Marjes ne Pronesi te Apartamentit midis rep usht5500 dhe qytetarit Azis Meni, dhe gjithe dokomentacionit tjeter te parcjelle me shkresen nr extra prot, dt 30/09/2016 nga Enti Kombetar i Banesave.*
Theksojme se Kontrata nr. 1276 Rep, date 27.04.1994 figuron te jete e regjistruar hipotekore me nr. hipotekore 1440 date 27.04.1994, ne regjistrin e apartamenteve. Evidentimi i regjistrit hipotekor te vitit 1994 eshte i pamundur ne kushtet kur hipoteka eshte djegur ne vitin 1997. Gjithashtu Kontrata e siperciter permban si element akti se eshte lidhur ndermjet paleve ne zbatim te ligjit 7652 date 23.12.1992 "per privatizimin e banesave shteterore"
Sqarimi i Grupit të auditimit:
Lidhur me observacionet e paraqitur, të sipërcituar, nuk merren në konsideratë pasi, nuk janë paraqitur argumente dhe prova të reja. Lidhur me argumentet e paraqitura nga ana juaj, për kostatimet që lidhen me referncën 16965, ku ju i referoheni *ligjit nr.7980 date 27.07.1995 "Per shitblerjen e trojeve", që përcakton të drejten e poseduesit për të privatizuar truallin nën objektin e privatizuar më parë, sqarojmë se në konstatimin tonë nuk kemi përjashtuat të drejtën për privatizmin e truallit që zë objekti i privatizuar, por konstatimi ynë lidhet me faktin se* shitja e truallit duhet të bëhej nga Agjencia Kombëtare e Privatizmit.
Lidhur me argumentet e paraqitura nga ana juaj, për kostatimet që lidhen me referncën 16482, pretendimi juaj nuk qëndron pasi, ne kemi sqaruar qartë që Bashkia nuk ka tagër për privatizimin e aprtamentit, pasi ky aprtament nuk bën pjesë në fondin e banesave sociale, ku më hollësisht kemi sqaruar në akt konstatimin përkatës.
Lidhur me argumentet e paraqitura nga ana juaj, për kostatimet që lidhen me referncën 16482, pretendimi juaj nuk qëndron pasi nuk keni paraqitur dokumente argumentuese. Sa trajtuar konstatimet tona mbeten të pandryshuara.

ZK 8542**;**
- (Për auditimin e regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituar sipas ligjit nr. 7652 date 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore Pasuritë e paluajtshme "Pallat" dhe "Apartament", i ndryshuar." etj)

Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit mbi pranimin dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituar sipas *Për auditimin e regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituar sipas ligjit nr. 7652 date 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore Pasuritë e paluajtshme "Pallat" dhe "Apartament", i ndryshuar." etj*, rezultoi se pranimi i dokumentacionit dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme është bërë me të meta dhe mangësi si më poshtë:

- Referencë nr. 0554/00475 ZK 8542**;**
Me kërkesë nr. 24948, datë 05.12.2017[redacted] ka kërkuar për tu pajisur me fragment harte, kopje kartele dhe vërtetim pronësie, regjistrim akti trashëgimie.
Në KPP volum 1, faqe 59, është regjistruar pasuria nr. 16/90+1-8, apartament me sipërfaqe 48 m^2.

ZVRPP Gjirokastër ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***Origjina e pronës kontrata e privatizimit të banesës është e pa nënshkruar nga blerësi, gjithashtu nuk është bërë verifikimi nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër***. Veprime këto në papajtueshmëri me pikat 8.1, kreu IV të Rregullores Nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 "Për punën e zyrës se regjistrimit te pasurive te paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të Udhëzim Këshillit Të Ministrave Nr. 2, Datë 12.09.2012 Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit në kundërshtim me pikën II.i. pikën II.iii. të shkresë nr. 1969 prot, datë 23.03.2012 të ZQRPP "Rregullorja mbi monitorimin e regjistrimit fillestar". ne dokumentin nr. 892 prot. datë 07.02.2008 "Procedurat e Kontrollit të Regjistrimit Fillestar", shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5348 prot., date 18/10/2011 "Skema e rishikuar për kontrollin dhe monitorimin e regjistrimit fillestar", dhe shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5985 prot, date 16/11/2009. Udhëzimi nr. 79, datë 09.05.2003 i ZQRPP "Regjistrimi fillestar sporadic të pasurive të pa lujtshme në zonat urbane".
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. F T me detyrë Regjistrues, z. G Hme detyrë ish/jurist.

- Referencë nr. 0558/0058 ZK 8542**;**
Me kërkesë nr. 2818, datë 26.07.2018, [redacted] ka kërkuar për tu pajisur me fragment harte, kopje kartele dhe vërtetim pronësie.
Në KPP volum 1, faqe 58, është regjistruar pasuria nr. 16/90+1-7, apartament me sipërfaqe 58 m^2.
ZVRPP Gjirokastër ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***Origjina e pronës kontrata e privatizimit të banesës nuk përputhet emër mbiemër pasi në të citohet [redacted] ndërsa në vendimin nr. 60, datë 28.06.2018 për përfundimi e procedurave të privatizimit citohet [redacted] gjithashtu nuk është bërë verifikimi nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër***. Veprime këto në papajtueshmëri me pikat 8.1, kreu IV të Rregullores Nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 "Për punën e zyrës se regjistrimit te pasurive te paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të Udhëzim Këshillit Të Ministrave Nr. 2, Datë 12.09.2012 Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit në kundërshtim me pikën II.i. pikën II.iii. të shkresë nr. 1969 prot, datë 23.03.2012 të ZQRPP "Rregullorja mbi monitorimin e regjistrimit fillestar". ne dokumentin nr. 892 prot. datë 07.02.2008 "Procedurat e Kontrollit të Regjistrimit Fillestar", shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5348 prot., date 18/10/2011 "Skema e rishikuar për kontrollin dhe monitorimin e regjistrimit fillestar", dhe shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5985 prot, date 16/11/2009. Udhëzimi nr. 79, datë 09.05.2003 i ZQRPP "Regjistrimi fillestar sporadic të pasurive të pa lujtshme në zonat urbane".
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. F T me detyrë Regjistrues, z. S Sh me detyrë ish/jurist.

- Referencë nr. 03423/0709, ZK 8542**;**
Me kërkesë nr. 24350, datë 25.10.2017, Mihrije Kore ka kërkuar për tu pajisur me fragment harte, kopje kartele dhe vërtetim pronësie regjistrim vendim gjykate.
Në KPP volum 8, faqe 41, është regjistruar pasuria nr. 8/132, truall me sipërfaqe 69 m^2, objekt 69 m^2, në pronësi të Mihrije Kore.
ZVRPP Gjirokastër ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: Origjina e pronës është kontrata e shitblerje Seksioni i financës Rrethi Gjirokastër datë 31.05.1995 ***organ i cili nuk ka patur tagër ligjor për kryerjen e shitjes së trojeve. Vendimi i Gjykatës nuk shprehet për ZVRPP gjirokastër në cilësinë e të padituri në mungesë, vendim i cili nuk është ankimuar brenda afatit 15 ditor në***

Gjykatën e Apelit Gjirokastër. Nuk është bërë verifikimi nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër. .
Veprime këto në papajtueshmëri me pikat 8.1, kreu IV të Rregullores Nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 "Për punën e zyrës se regjistrimit te pasurive te paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të Udhëzim Këshillit Të Ministrave Nr. 2, Datë 12.09.2012 Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit në kundërshtim me pikën II.i. pikën II.iii. të shkresë nr. 1969 prot, datë 23.03.2012 të ZQRPP "Rregullorja mbi monitorimin e regjistrimit fillestar". ne dokumentin nr. 892 prot. datë 07.02.2008 "Procedurat e Kontrollit të Regjistrimit Fillestar", shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5348 prot., date 18/10/2011 "Skema e rishikuar për kontrollin dhe monitorimin e regjistrimit fillestar", dhe shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5985 prot, date 16/11/2009. Udhëzimi nr. 79, datë 09.05.2003 i ZQRPP "Regjistrimi fillestar sporadic të pasurive të pa lujtshme në zonat urbane".
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. F T me detyrë Regjistrues, zj. G H me detyrë ish/juriste.

- Referencë nr. 03420, ZK 8542**;**
Me kërkesë nr. 2776, datë 22.09.2015, Fatmir Zylfaj ka kërkuar për tu pajisur me fragment harte, kopje kartele dhe vërtetim pronësie.
Në KPP volum 8, faqe 129, është regjistruar pasuria nr. 13/113, truall me sipërfaqe 54.3 m2, objekt 54.3 m2, në pronësi të Fatmir Zilfe.
ZVRPP Gjirokastër ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: Origjina e pronës është kontrata e shitblerje Seksioni i financës rrethi gjirokastër datë 01.11.1992 ***organ i cili nuk ka patur tagër ligjor për kryerjen e shitjes së trojeve, dy kontratat janë kopje. Nuk është bërë verifikimi nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër***.
Veprime këto në papajtueshmëri me pikat 8.1, kreu IV të Rregullores Nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 "Për punën e zyrës se regjistrimit te pasurive te paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të Udhëzim Këshillit Të Ministrave nr. 2, datë 12.09.2012 Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit në kundërshtim me pikën II.i. pikën II.iii. të shkresë nr. 1969 prot, datë 23.03.2012 të ZQRPP "Rregullorja mbi monitorimin e regjistrimit fillestar". ne dokumentin nr. 892 prot. datë 07.02.2008 "Procedurat e Kontrollit të Regjistrimit Fillestar", shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5348 prot., date 18/10/2011 "Skema e rishikuar për kontrollin dhe monitorimin e regjistrimit fillestar", dhe shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5985 prot, date 16/11/2009. Udhëzimi nr. 79, datë 09.05.2003 i ZQRPP "Regjistrimi fillestar sporadic të pasurive të pa lujtshme në zonat urbane".
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. F T me detyrë Regjistrues, z. G K me detyrë ish/juriste.

- Referencë nr. 03418, ZK 8542**;**
Me kërkesë nr. 24614, datë 07.11.2017, Thoma Qifti ka kërkuar për tu pajisur me fragment harte, kopje kartele dhe vërtetim pronësie regjistrim bashkim pasurie.
Në KPP volum 8, faqe 125, është regjistruar pasuria nr. 2/261, objekt me sipërfaqe 21 m2, në pronësi të Thoma Qifti.
ZVRPP Gjirokastër ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***Mungon origjina e pronës, gjithashtu nuk është bërë verifikimi nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër***.
Veprime këto në papajtueshmëri me pikat 8.1, kreu IV të Rregullores Nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 "Për punën e zyrës se regjistrimit te pasurive te paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të Udhëzim Këshillit Të Ministrave nr. 2, datë 12.09.2012 Për

përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit në kundërshtim me pikën II.i. pikën II.iii. të shkresë nr. 1969 prot, datë 23.03.2012 të ZQRPP "Rregullorja mbi monitorimin e regjistrimit fillestar". ne dokumentin nr. 892 prot. datë 07.02.2008 "Procedurat e Kontrollit të Regjistrimit Fillestar", shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5348 prot., date 18/10/2011 "Skema e rishikuar për kontrollin dhe monitorimin e regjistrimit fillestar", dhe shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5985 prot, date 16/11/2009. Udhëzimi nr. 79, datë 09.05.2003 i ZQRPP "Regjistrimi fillestar sporadic të pasurive të pa lujtshme në zonat urbane".
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. F T me detyrë Regjistrues, z. G K me detyrë ish/juriste.

Për problemat e trajtuar më sipër është mbajtur aktkonstatimi nr. 2, datë ***08/08/2019***
Lidhur sa trajtuar në faqet 134-136 të Projekt Raportit të Auditimit dhe në Akt-Konstatimin nr. 2, datë 08.08.2019, janë paraqitur observacionet në rrugë elktronike dhe derguar me shkresen 3202/1. Prot, datë 13.09.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 372/5, datë 16.09.2019 dhe me shkresen 3619. Prot, datë 09.09.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 372/6, datë 25.09.2019 nga; z. F T me detyrë Regjistrues, dhe G Hme detyrë ish/specialiste, S Sh
Persa i perket Konstatimit sipas(references nr.058/0558 zk.8542) :
Vleresoj se konstatimi i grupit te auditimit per mosperputhje te dhenash (emer, mbiemer) si dhe per mungese te verifikimit nese prona rrjedh nga tituj pronesie te pronarit te fundit, te regjistruar me pare ne regjister - nuk qendron, pasi veprimet e kryera jane konform ligjit nr.33/2012, UKM nr.2/2012 si dhe nenit 193 te Kodit Civil.
Konkretisht, pasuria nr.16/90+1-7 vol.1 faqe 58 zk.8542 (apartament me sip.48.0 m2) i eshte nenshtruar procesit te verifikimit te dokumentacionit tekniko-ligjor prej nga ka rezultuar se nga procesi i regjistrimit fillestar eshte afishuar ne pronesi "shtet" (me qiramarres Abedin Ahmati, etj) per shkak se sipas dokumentacionit te depozituar ne reference nr.058 – nuk vertetohet "ekzistenca e nje akti noterial" per kalimin e pronesisene zbatim te ligjit nr.7652 date 23.12.1992 si dhe nenit 193 te Kodit Civil.
Ne keto kushte eshte orientuar qytetari qe ti drejtohet Bashkise Gjirokaster si organi kompetent ne mbeshtetje te VKM nr.97 date 03.02.2008 "Per procedurat e privatizimit te banesave objekt i ligjit nr.7652 date 23.12.1992 "Per privatizimin e banesave shteterore", me qellim kryerjen e procedurave perkatese dhe realizimin e aktit noterial per kalimin e pronesise.
Si rrjedhoje e procedurave te ndjekura eshte arritur ne vendimmarrjen sipas Vendimit te Kesh.Bashkiak nr.60 date 28.06.2018e me pas ne finalizimin e kontrates se kalimit te pronesise nr.738/3 rep.298 kol. date 19.07.2018 not.G.Bineri – kontrate e cila ne zbatim te UKM nr.2/2012 plotesonte elementet ne forme dhe permbajtje, cka per pasoje konkludoi me pasqyrimin e saj ne regjistrat kadastrale.
Lidhur me pretendimin e ngritur nga auditi ne akt-konstatimi per mosperputhje te dhenash (emer, mbiemer)– sqaroj se nuk ka bazueshmeri ne kushtet kur atributet dhe kompetencat ligjore te verifikimit te te dhenave(ne funksion te procesit te privatizimit)i akordohen pushtetit vendor (Bashkise Gjirokaster) ne zbatim te VKM nr.97/2008.
Gjithashtu, theksoj faktin sekalimi i pronesise si dhe regjistrimi eshte bere ne favor te perfituesvesipas percaktimit ne aktin noterialme pale shitese Bashkine Gjirokaster, ne kushtet kur autoriteti ligjor per kalimin e pronesise eshte ushtruar dpd nga organi i caktuar sipas aktit nenligjorVKM nr.97/2008.
Ne keto kushte, vleresoj se trajtimi, regjistrimi i aktit noterial per kalimin e pronesise dhe me pas pajisja me certifikate pronesie ne favor te 5 bp. Ahmati eshte bere konform procedurave te parashikuara nga neni 25 pika "a", 32, 42 i ligjit nr.33/2012 "Per Regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme",UKM nr.2/2012 si dhe nenit 193 e vijues te Kodit Civil.
Sa me lart, kopje te dokumentacionit perkates e gjeni bashkengjitur.

- Persa i perket konstatimit sipas References nr.03420 zk.8542 - lidhur me kerkesen nr.2776 date 22.09.2015, trajtuar nga specialisti jurist G K, sipas te ciles qytetari Fatmir Zylfaj ka kerkuar per tu pajisur me vertetim pronesie, kopjekartele dhe fragment harte per pasurine nr.13/113 vol.8 faqe 129 zk.8542 (ndertese me truall me sip.54.3 m2), vleresoj se konstatimi i grupit te auditimit per dokumentacion ne cilesine e kopjes, per mungese te tagrave ligjore te organit qe ka bere kalimin e pronesise per shitjen e truallit si dhe per mungese te verifikimit nese prona rrjedh nga tituj pronesie te pronarit te fundit, te regjistruar me pare ne regjister - nuk qendron, pasi veprimet e kryera jane konform ligjit nr.33/2012, Rregullores nr.184 date 08.04.1999, UKM nr.2/2012, Kodit Civil, ligjit nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, veprimtarive private te pavaruara dhe privatizimit" si dhe akteve nenligjore perkatese.

Konkretisht, pasuria nr.13/113 vol.8 faqe 129 zk.8542 (ndertese me truall me sip.54.3 m2), i eshte nenshtruar procesit te verifikimit te dokumentacionit tekniko-ligjor prej nga ka rezultuar regjistrimi perkates hipotekor sipas nr.regj.hip.573 date 02.10.1995 per pasurine "Siperfaqe trualli prej 54.3 m2 se bashku me objektin me emertimin Dyqan i perimeve, ndodhur ne lagjen Manalat te qytetit Gjirokaster. Ndertesa eshte 1-kateshe pa ndarje te brendshme, ndertuar me mur guri".

Duke qene se regjistri hipotekor si dhe dokumentacioni arkivor ishte demtuar(djegur nga trazirat e vitit 1997) – ne funksion te riregjistrimit (kryer ne nr.regj.hip.103 date 01.12.2017 zk.8541) eshte depozituar deklarata noteriale nr.717 rep. 455 kol. Date 17.09.2015 not.E.Aliko ku deklarohet mostjetersimi dhe mosbarresimi i pasurise, shoqeruar me dokumentacionin perkates te privatizimit objektit dhe truallit sipas kontrate shitjes nr.1500 rep. 879 kol. Date 04.11.1992(origjinale),konfirmuar njekohesisht edhe sipas vertetimit te njesise me origjinalin nr.2945 rep. Date 22.11.2017 not.V.Marko (bazuar ne nenin 39 e vijues te Ligjit "Per Noterine"te kohes respektive), cka rrezon pretendimin e auditit per dokumentacion kopje. Lidhur me konstatimin se organit "Ndermarrja Tregtare e Artikujve te ndryshem Gjirokaster" i mungojne tagrat ligjore per kryerjen e shitjes se trojeve – sqarojme se referuar kontrates noterialenr.1500 rep. 879 kol. Date 04.11.1992 si dhe ne kontraten shoqeruese vertetohet qarte kalimi i pronesise per objektin dhe truallin(ne vleren 41639.7 leke ku hyn dhe vlera e truallit prej 9947.10 leke),tager qe atribuohet bazuar ne percaktimet ligjore qe vijne nga dispozitat e Ligjit nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, veprimtarive private te pavaruara dhe privatizimit",konkretisht ne nenet 3, 14, 21 e vijues.

Per rrjedhoje,kalimi i pronesise si dhe regjistrimi perkates eshte bere ne favor te perfituesit Fatmir Zylfajsipas percaktimit ne aktin noterial me pale shitese"Ndermarrja Tregtare e Artikujve te ndryshem Gjirokaster", ne kushtet kur "pushteti" ligjor per kalimin e pronesise eshte ushtruar dpd nga organi i caktuar sipasLigjit nr.7512 date 10.09.1991.

Ne keto kushte, vleresoj se trajtimi,riregjistrimi i dokumentacionit te pronesise ne nr.regj.hip.103 date 01.12.2017 zk.8541dhe pajisja me dokument pronesie ne favor te Fatmir Zylfaj eshte bere konform procedurave te parashikuara nga ligji nr.33/2012 "Per Regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme",neni 193 e vijues i Kodit Civil si dhe dispozitat ligjore qe percaktohen nga Ligji nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, veprimtarive private te pavaruara dhe privatizimit", .Sa me lart, kopje te dokumentacionit perkates e gjeni bashkengjitur.

Persa i perket konstatimit sipas References nr.03418 zk.8542 - lidhur me kerkesen nr.24614 date 07.11.2017, trajtuar nga specialisti jurist G K, sipas te ciles qytetari Thoma Qifti (njeri prej b.p) ka kerkuar regjistrimin e kontrates se pjestimit nr.895 rep. 588 kol. Date 03.11.2017 not.B.Aliko si dhe paisjen me vertetim pronesie, kopje kartele dhe fragment harte per pasurine nr.2/161 vol.8 faqe 125 zk.8542 (oborr me sip.21.0 m2), vleresoj se konstatimi i grupit te auditimit per per mungese te origjines se prones si dhe per mungese te verifikimit nese prona rrjedh nga tituj pronesie te pronarit te fundit, te regjistruar me pare ne regjister - nuk qendron, pasi veprimet e

kryera jane konform nenit 43 te ligjit nr.33/2012, Rregullores nr.184 date 08.04.1999, UKM nr.2/2012, neit 193 e vijues te Kodit Civil,.
Konkretisht, pasuria meme nr.2/27 vol.7 faqe 5 zk.8542me pershkrimin "Siperfaqe trualli prej 89 m2, mbi te cilen ngrihet shtepi banimi me siperfaqe 68 m2, ndodhur ne lagjen Varosh te qytetit Gjirokaster" - rezulton te jete regjistruar ne bashkepronesi te Lefteri, Pavli dhe Thoma Qifti ne nr.regj.hip.89 date 21.09.2012bazuar mbi dokumentacionin perkates ligjor ne zbatim te nenit 25 te Ligjit 33/2012 (depozituar ne arkive me reference nr....zk.8542), konkretisht:
Kontrate dhurimi origjinale nr.200/1 akti, nr.22 rep.kol date 19.03.1973 noter Thoma Zaro - ne favor te Leko Vasil Qifti – regjistruar ne nr.regj.transkript. 7 date 19.03.1973;
Deshmi trashegimie sipas Vendimit nr.800 date 06.10.2005 te Gjyk.Rr.Gjyq.Gjirokaster;
Plan rilevimi i konfirmuar shoqeruar me planimetrite e 2 kateve;
Konfirmim nga Arkivii Shtetit nr.186/1 prot. Date 18.08.2005, etj. Sa me lart, konfirmohet se origjina e prones rrjedh nga Kontrate dhurimi (origjinale) ne favor te Leko Vasil Qifti regjistruar ne regj.transkriptimeve 7 date 19.03.1973, prej nga konkludohet se nuk ka baze pretendimi i grupit te auditit per mungese te origjines se prones si dhe per mungese te verifikimit nese prona rrjedh nga tituj pronesie te pronarit te fundit, te regjistruar me pare ne regjister.
Ne keto kushte, vleresoj se trajtimi, regjistrimi ikontrates se pjestimit nr.895 rep. 588 kol. Date 03.11.2017 not.B.Aliko si dhe paisja me vertetim pronesiedhe fragment harte per pasurine nr.2/161 vol.8 faqe 125 zk.8542 (oborr me sip.21.0 m2) ne bashkepronesi te Lefteri, Pavli dhe Thoma Qifit -eshte bere konform procedurave te parashikuara nga dispozita 32, 43 e ligjit nr.33/2012 "Per Regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme",neni 193 e vijues i Kodit Civil si dhe UKM nr.2/2012.
Sa me lart, kopje te dokumentacionit e gjeni bashkengjitur. Përsa i përket Konstatimit sipas(referencë nr.554 dhe nr.475 ZK.8542) : Lidhur me kërkesën nr. 24948 datë 05.12.2017, trajtuar nga G H(me detyrë specialist jurist), sipas të cilit qytetari Luan Batha ka kërkuar regjistrimin e dëshmisë se trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësen Fiqirete Batha dhe regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Sidki Batha, si dhe pajisjen me çertifikatë pronesie për pasurinë nr.16/90+1-8 vol.1 fq. 59 ZK 8542 (apartament me sip.48 m2), vleresojmë se konstatimi i grupit të auditimit për mungesë te nënëshkrimit nga blerësi në kontratën e privatizimit- nuk qëndron, pasi veprimet e kryera janë konform ligjit nr.33/2012 si dhe Kodit Civil.
Konkretisht, pasuria nr. 16/90+1-8 vol.1 fq. 59 ZK 8542 (apartament me sip.48 m2), i është nënshtruar proçesit të regjistrimit fillestar të ZK.8542 dhe bazuar në dispozitat 24 dhe 25 të Ligjit nr. 33/2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" është bërë afishimi i bashkëpronarëve Fiqirete Behar Batha, Luan Vesel Batha dhe Miranda Rahmi Batha ,si bashkëpronare të pasurisë së sipërcituar në përputhje me titullin përkatës të pronësisë – Kontratë shitje nr.3834 rep. datë 5.8.1993 notere Greta Kallojeri (palë shitëse NKBanesa) – regjistruar në nr.regj.hip.2327/1994 (Ap.) depozituar origjinal në referencën nr.59 zk.8542. Bazuar në përcaktimet e nenit 27 "Ligjërimi i regjistrimit fillestar" të ligjit nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të palujtshme" , i cili përcakton se:
"Pas periudhës së afishimit publik, sipas nenit 26 të këtij ligji, të gjitha pasuritë e paluajtshme, për të cilat nuk ka asnjë pretendim të pazgjidhur, regjistrohen siç janë në kartelat dhe hartat kadastrale të përkohshme dhe që nga ky çast regjistruesi mund të lëshojë certifikatat e pronësisë, si dhe çertifikata të tjera që mund të kërkohen për përmbajtjen e kartelave dhe të hartave kadastrale."
Pas kryerjes se këtij regjistrimi, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastër në zbatim të nenit 32 pika 1 të ligjit nr.33/2012 - ka lëshuar Çertifikatën e Pronësisë kundrejt aplikimit nr. 1093 dt. 20.06.2013 të qytetarit Luan Vesel Batha. Pra regjistrimi fillestar dhe çertifikimi për herë të parë i kësaj pasurie janë bërë nga specialiste te meparshem. Me pas, ne zbatim te nenit 36 pika 1 e ligjit 33/2012, sipas te cilit percaktohet se: "Menjëherë pasi pasuria e paluajtshme të jetë regjistruar, çdo veprim juridik i mëtejshëm, që ka të bëjë e të drejtat mbi të,

duhet regjistruar në përputhje me dispozitat e këtij ligji,"...është proceduar me regjistrimine dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. 2407 rep. Nr. 950 kol. Dt. 15.11.2017 notere Bujar Xhaxho Gjirokastër për trashëgimlënësen Fiqirete Batha, si dhe rejgistrimii dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. 1266 rep. Nr. 384/1 kol. Dt. 04.12.2017 për trashëgimlënësin Sidki Batha(trashëgimtar ligjor i Fiqirete Batha).
Nisur nga fakti që çdo akt, që sjell ndryshime dhe/ose përfitim të të drejtave të pronësisë, duhet të regjistrohet, theksojmë se trajtimi dhe pajisja me çertifikatë pronësie është bërë konform ligjit nr.33/2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".
Sa me lart, dokumentacionin e gjeni bashkengjitur.
Përsa i përket Konstatimit sipas(referencs nr.3423 dhe nr.709 ZK.8542) :
Lidhur me kërkesën nr. 24350 datë 25.10.2017, trajtuar nga G H(me detyrë specialist jurist), sipas të cilit qytetarjaMihrie Kore ka kërkuar regjistrimin e vendimit gjyqësor nr. 493[21-2017-1272] dt. 14.09.2017, si dhe pajisjen me vërtetim hipotekor + HTR për pasurinë nr.3/120 ZK 8542 (truall me sipërfaqe 69 m^2 dhe objekt me sipërfaqe 69 m^2), vleresoj se konstatimi i grupit të auditimitse origjina e pronës është kontrata e shitblerjes nga Seksioni i Financës Rrethi Gjirokastër dt. 31.05.1995 dhe se Vendimi i gjykatës nuk shprehet për ZVRPP në mungesë , vendim i cili nuk është ankimar brenda afatit 15 ditor në Gjykatën e Apelit Gjirokastër- nuk qëndron, pasi veprimet e kryera janë konform ligjit nr.33/2012 si dhe Kodit Civil.
-Konkretisht me aplikimin nr. nr. 24350 datë 25.10.2017qytetarjaMihrie Kore ka kërkuar regjistrimin e vendimit gjyqësor nr. 493[21-2017-1272] dt. 14.09.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër , si dhe pajisjen me vërtetim hipotekor +HTR për pasurinë nr.3/120-N1 ZK 8542 regjistruar në nr.200 regj. Hipotekor dt. 16.11.2000 me përshkrimin objekti dhe sipërfaqja e truallit prej 69 m^2, mbi të cilin ngrihet ky objekt , të ndodhur në lagjen "Varosh" të qytetit Gjirokastër në katin e parë të një shtëpie 3 katëshe me dy ndarje të brendshme" në emër të Mira Kores.
-Origjina e kësaj pasurie është kontrata e shitblerjes nr. 1400 rep. Nr. 825 kol. Dt. 13.10.1992, notere Ariana Puto me palë shitëse Ndërmarrja Tregtare e Artikujve të Ndryshëm , palë belerëse Mira Kore me objekt "Njësi bulmeti" me sipërfaqe 69 m^2 , si dhe kontratën e shitblerjes nr. 5683 rep. Nr. 846 kol.dt. 31.05.1995 me palë shitëse Seksioni i Financës së Rrethit Gjirokastër, palë blerëse Mira Kore , me objekt truall me sipërfaqe 69 m^2.
-Kontratat e sipërcituara kanë qënë të regjistruara në regjistrin e transkriptimeve me nr. 436 dt. 8.8.1995, sipas vërtetimt të pronësisë të lëshuar nga Hipoteka Gjriokastër më dt. 8.8.1995.
-Me vendimin nr. 493[21-2017-1272] dt. 14.09.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me palë paditëse Mihrie Kore, të paditur ZVRPP Gjiroastër, me objekt "-Njohjen e pavërtetësisë së emrit "Mira' , të cilin e kam të shënuar në dokumentat e a) Kontratë e shitblerjes nr. 5683rep. Nr. 946 kol. Dt. 31.05.1995; b) Kontratë e shitblerjes nr. 1400 rep. Nr. 825 kol. Dt. 13.10.1995; c) Regjistrimin hipotekor nr. 201 dt. 16.11.2000, pasuria nr. 3/120 ZK 8542.Njohjen e vërtetësisë së emrit "Mihrie" në këto dokumenta" me të cilin është vendosur:- Njohjen e pavërtetësisë së emrit "Mira' , në dokumentat a) Kontratë e shitblerjes nr. 5683rep. Nr. 946 kol. Dt. 31.05.1995; b) Kontratë e shitblerjes nr. 1400 rep. Nr. 825 kol. Dt. 13.10.1995; c) Regjistrimin hipotekor nr. 201 dt. 16.11.2000, pasuria nr. 3/120 ZK 8542 duke njohur si të vërtetë emrin "Mihrie" në këto dokumenta.-ZVRPP Gjirokastër ka bërë vetëm regjistrimin e vendimit nr. 493[21-2017-1272] dt. 14.09.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, duke korrigjuar emrin e pronarit nga i gabuari "Mira" në të saktin "Mihrie" dhe mbi këtë pasuri aktualisht nuk është kryer asnjë transaksion tjetër.
Lidhur me faktin që pasuria truall me sipërfaqe 69 m^2 është përfituar me kontratën e shitblerjes nr. 5683 rep. Nr. 846 kol.dt. 31.05.1995 me palë shitëse Seksioni i Financës së Rrethit Gjirokastër, theksojmë se pasuria nr.3/120-N1 ZK 8542 në fakt është njësi ë ndodhur në katin e parë të godinës 3 katëshe, ndërsa trualli është në bashkëpronësi me njësitë e tjera që ndodhen në objektin 3 katësh. Gjithsesi kontratanr. 5683 rep. Nr. 846 kol.dt. 31.05.1995 me palë shitëse Seksioni i Financës së Rrethit Gjirokastër është lidhur ne zbatim te ligjit nr.7512/1991, përpara

hyrjes në fuqi të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve" i cili gjithashtu në nenin 4 të tij thotë se kalimi i trojeve të zëna pronë shtetërore në pronë private është i detyrueshëm, kur kërkohet nga i interesuari, në rastet kur:
a- Trualli është i objekteve që janë privatë ose që do të privatizohen. Kalimi bëhet në favor të pronarëve të këtyre objekteve.-ZVRPP Gjirokastër ka ofruar shërbimin ndaj qytetares duke qënën se vendimi gjyqësor ka të bëjë vetëm më korrigjimin e emrit dhe jo me tjetërsimin e të drejtave pronësore mbi pasurinë nr.nr.3/120-N1 ZK 8542.-lidhur me faktin që ndaj vendimit nr.nr. 493[21-2017-1272] dt. 14.09.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, sqarojmë se ZVRPP Gjirokastër gjatë muajit shtator 2017 ka qenë pa regjistrues duke qënë se në atë periudhë ish regjistruesi M K kishte dhënë dorëheqjen.
Neni 451/a i K.Pr.Civile i cili përcakton se : -Vendimi që ka marrë formë të prerëështë i detyrueshëm për palët, për trashëgimatrët e tyre, për personat që heqin të drejta nga plaët , për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Vendimi që ka marrë formëtë prerë ka fuqi vetëm për atë çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt qëështë zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe.Fakti që gjykata në dispozitivin e vendimit nuk është shprehur për detyrimin e ZVRPP Gjiroakstër , nuk përbën shkak për mos ekzekutimin e këtij vendimi pasi, bazuar edhe në jurisprudencen e Gj.kushtetuese , vendimi gjyqësor është një i tërë dhe pjesa e dispozitivit nuk mund të merret si një pjesë e shkëputur prej tij, pasi në pjesën arsyetuese të vendimit, Gjykata arsyeton se gabimi i emrit në regjistrin hipotekor duhet korrigjuar nga ana e ZVRPP Gjirokastër.Gjithashtu veprimet e kryera nga ana e ZVRPP Gjirokastër janë në përputhje edhe me UKM nr.2/2012, pika 3, duke qenë se vendimi gjyqësor i regjistruar nga ana jonë është vendim i formes së prerë dhe palapaditëse figuron me parë si pronare e pasurisë (te regjistruar në regjistrat hipotekorë të pasurive të paluajtshme) mbi të cilin gjykata ka disponuar me vendim. Përsa i përket Akt - Konstatimit nr. 2 (referencë nr.554 dhe nr.475 ZK.8542) :
Lidhur me kërkesën nr. 24948 datë 05.12.2017, trajtuar nga G H(me detyrë specialist jurist), sipas të cilit qytetari Luan Batha ka kërkuar regjistrimin e dëshmisë se trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësen Fiqirete Batha dhe regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Sidki Batha, si dhe pajisjen me çertifikatë pronesie për pasurinë nr.16/90+1-8 vol.1 fq. 59 ZK 8542 (apartament me sip.48 m2), vleresojmë se konstatimi i grupit të auditimit për mungesë te nënëshkrimit nga blerësi në kontratën e privatizimit- nuk qëndron, pasi veprimet e kryera janë konform ligjit nr.33/2012 si dhe Kodit Civil. Konkretisht, pasuria nr. 16/90+1-8 vol.1 fq. 59 ZK 8542 (apartament me sip.48 m2), i është nënshtruar proçesit të regjistrimit fillestar të ZK.8542 dhe bazuar në dispozitat 24 dhe 25 të Ligjit nr. 33/2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" është bërë afishimi i bashkëpronarëve Fiqirete Behar Batha, Luan Vesel Batha dhe Miranda Rahmi Batha ,si bashkëpronare të pasurisë së sipërcituar në përputhje me titullin përkatës të pronësisë – Kontratë shitje nr.3834 rep. datë 5.8.1998 notere Greta Kallojeri (palë shitëse NKBanesa) – regjistruar në nr.regj.hip.2254/1993 (Ap.) depozituar origjinal në referencën nr.59 zk.8542. Pas kryerjes se këtij regjistrimi, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastër në zbatim të nenit 32 pika 1 të ligjit nr.33/2012 - ka lëshuar Çertifikatën e Pronësisë kundrejt aplikimit nr. 1093 dt. 20.06.2013 të qytetarit Luan Vesel Batha. Pra regjistrimi fillestar dhe çertifkimi i kësaj pasurie nuk është bërë nga unë pasi në vitin 2013 nuk kam qënë e punësuar pranë ZVRPP Gjirokastër.-Referuar Kontratës së shitjes nr.3834 rep. date 5.8.1998 notere Greta Kallojeri (palë shitëse NKBanesa) – regjistruar në nr.regj.hip.2254/1993 (Ap.) rezulton se kjo kontratë është lidhur pranë noteres Greta Kallojeri Gjirokastër dhe gjithashtu kjo kontratë rezulton të ketë qënë e regjistruar pranë zyrave të Hipotekës Gjirokastër me nr. 2327 dt. 5.8.1994.
-Pra regjistrimin fillestar dhe çertifikimi për herë të parë i kësaj pasurie nuk janë bërë nga unë si specialiste. Nga ana ime është bërë vetëm regjistrimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. 2407 rep. Nr. 950 kol. Dt. 15.11.2017 notere Bujar Xhaxho Gjirokastër për trashëgimlënësen

Fiqirete Batha, si dhe rejgistrimii dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. 1266 rep. Nr. 384/1 kol. Dt. 04.12.2017 për trashëgimlënësin Sidki Batha(trashëgimtar ligjor i Fiqirete Batha).
Mungesa e nënshkrimit në kontratën e privatizimit të qytetarit Luan Batha duhet të ishtë konstatuar fillimisht nga noterja e mandej nga specilaistët që kanë bërë regjistrin fillestar në vitin 1994 e më pas nga specialisti që ka bërë çertifikimin për herë të parë gjatë kalimit të zonës në sistem në vitin 2013.
Bazuar në përcaktimet e nenit 27 "Ligjërimi i regjistrimit fillestar" të ligjit nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të palujtshme" , i cili përcakton se: Pas periudhës së afishimit publik, sipas nenit 26 të këtij ligji, të gjitha pasuritë e paluajtshme, për të cilat nuk ka asnjë pretendim të pazgjidhur, regjistrohen siç janë në kartelat dhe hartat kadastrale të përkohshme dhe që nga ky çast regjistruesi mund të lëshojë certifikatat e pronësisë, si dhe çertifikata të tjera që mund të kërkohen për përmbajtjen e kartelave dhe të hartave kadastrale. Nisur nga fakti që çdo akt, që sjell ndryshime dhe/ose përfitim të të drejtave të pronësisë, duhet të regjistrohet, theksojmë se trajtimi dhe pajisja me çertifikatë pronësie është bërë konform ligjit nr.33/2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme". Përsa i përket Akt - Konstatimit nr. 2 (referencë nr.3423 dhe nr.709 ZK.8542) : Lidhur me kërkesën nr. 24350 datë 25.10.2017, trajtuar nga G H(me detyrë specialist jurist), sipas të cilit qytetarja Mihrie Kore ka kërkuar regjistrimin e vendimit gjyqësor nr. 493[21-2017-1272] dt. 14.09.2017, si dhe pajisjen me vërtetim hipotekor + HTR për pasurinë nr.3/120 ZK 8542 (truall me sipërfaqe 69 m^2 dhe objekt me sipërfaqe 69 m^2), vleresojmë se konstatimi i grupit të auditimit se origjina e pronës është kontrata e shitblerjes nga Seksioni i Financës Rrethi Gjirokastër dt. 31.05.1995 dhe se Vendimi i gjykatës nuk shprehet për ZVRPP në mungesë , vendim i cili nuk është ankimar brenda afatit 15 ditor në Gjykatën e Apelit Gjirokastër- nuk qëndron, pasi veprimet e kryera janë konform ligjit nr.33/2012 si dhe Kodit Civil.
-Konkretisht me aplikimin nr. nr. 24350 datë 25.10.2017 qytetarja Mihrie Kore ka kërkuar regjistrimin e vendimit gjyqësor nr. 493[21-2017-1272] dt. 14.09.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër , si dhe pajisjen me vërtetim hipotekor +HTR për pasurinë nr.3/120-N1 ZK 8542 regjistruar në nr.200 regj. Hipotekor dt. 16.11.2000 me përshkrimin objekti dhe sipërfaqja e truallit prej 69 m^2, mbi të cilin ngrihet ky objekt , të ndodhur në lagjen "Varosh" të qytetit Gjirokastër në katin e parë të një shtëpie 3 katëshe me dy ndarje të brendshme" në emër të Mira Kores. -Origjina e kësaj pasurie është kontrata e shitblerjes nr. 1400 rep. Nr. 825 kol. Dt. 13.10.1992, notere Ariana Puto me palë shitëse Ndërmarrja Tregtare e Artikujve të Ndryshëm , palë belerëse Mira Kore me objekt "Njësi bulmeti" me sipërfaqe 69 m^2 , si dhe kontratën e shitblerjes nr. 5683 rep. Nr. 846 kol.dt. 31.05.1995 me palë shitëse Seksioni i Financës së Rrethit Gjirokastër, palë blerëse Mira Kore , me objekt truall me sipërfaqe 69 m^2.
-Kontratat e sipërcituara kanë qënë të regjistruara në regjistrin e transkriptimeve me nr. 436 dt. 8.8.1995, sipas vërtetimt të pronësisë të lëshuar nga Hipoteka Gjriokastër më dt. 8.8.1995.
-Me vendimin nr. 493[21-2017-1272] dt. 14.09.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me palë paditëse Mihrie Kore, të paditur ZVRPP Gjiroastër, me objekt "-Njohjen e pavërtetësisë së emrit "Mira' , të cilin e kam të shënuar në dokumentat e a) Kontratë e shitblerjes nr. 5683rep. Nr. 946 kol. Dt. 31.05.1995; b) Kontratë e shitblerjes nr. 1400 rep. Nr. 825 kol. Dt. 13.10.1995; c) Regjistrimin hipotekor nr. 201 dt. 16.11.2000, pasuria nr. 3/120 ZK 8542.Njohjen e vërtetësisë së emrit "Mihrie" në këto dokumenta" me të cilin është vendosur: - Njohjen e pavërtetësisë së emrit "Mira' , në dokumentat a) Kontratë e shitblerjes nr. 5683rep. Nr. 946 kol. Dt. 31.05.1995; b) Kontratë e shitblerjes nr. 1400 rep. Nr. 825 kol. Dt. 13.10.1995; c) Regjistrimin hipotekor nr. 201 dt. 16.11.2000, pasuria nr. 3/120 ZK 8542 duke njohur si të vërtetë emrin "Mihrie" në këto dokumenta. -ZVRPP Gjirokastër ka bërë vetëm regjistrimin e vendimit nr. 493[21-2017-1272] dt. 14.09.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, duke korrigjuar emrin e pronarit nga i gabuari "Mira" në të saktin "Mihrie" dhe mbi këtë pasuri aktualisht nuk është kryer asnjë transaksion tjetër. Lidhur me faktin që pasuria truall me sipërfaqe 69 m^2 është përfituar me kontratën e shitblerjes nr. 5683 rep. Nr. 846 kol.dt. 31.05.1995 me palë shitëse Seksioni i Financës së Rrethit Gjirokastër, theksojmë se pasuria

nr.3/120-N1 ZK 8542 në fakt është njësi ë ndodhur në katin e parë të godinës 3 katëshe, ndërsa trualli është në bashkëpronësi me njësitë e tjera që ndodhen në objektin 3 katësh. Gjithsesi kontrata nr. 5683 rep. Nr. 846 kol.dt. 31.05.1995 me palë shitëse Seksioni i Financës së Rrethit Gjirokastër është lidhur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve" i cili në nenin 4 të tij thotë se kalimi i trojeve të zëna pronë shtetërore në pronë private është i detyrueshëm, kur kërkohet nga i interesuari, në rastet kur:
a- Trualli është i objekteve që janë privatë ose që do të privatizohen. Kalimi bëhet në favor të pronarëve të këtyre objekteve. -ZVRPP Gjirokastër ka ofruar shërbimin ndaj qytetares duke qënën se vendimi gjyqësor ka të bëjë vetëm më korrigjimin e emrit dhe jo me tjetërsimin e të drejtave pronësore mbi pasurinë nr. nr.3/120-N1 ZK 8542. -lidhur me faktin që ndaj vendimit nr. nr. 493[21-2017-1272] dt. 14.09.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, sqarojmë se ZVRPP Gjirokastër gjatë muajit shtator 2017 ka qnën pa regjistrues duke qënë se në atë periudhë ish regjistruesi M K kishte dhënë dorëheqjen.
Neni 451/a i K.Pr.Civile i cili përcakton se : -Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimatrët e tyre, për personat që heqin të drejta nga plaët , për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për atë çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe. Fakti që gjykat në dispozitivin e vendimit nuk është shprehur për detyrimin e ZVRPP Gjiroakstër , nuk përbën shkak për mos ekzekutimin e këtij vendimi pasi, bazuar edhe në vendimin nr. Të gj.kushtetuese , vendimi gjyqësor është një i tërë dhe pjesa e dispozitivit nuk mund të merret si një pjesë e shkëputur prej tij, pasi në pjesën arsyetuese të vendimit, Gjykata arsyeton se gabimi i emrit në regjistrin hipotekor duhet korrigjuar nga ana e ZVRPP Gjirokastër. Gjithashtu veprimet e kryera nga ana e ZVRPP Gjirokastër janë në përputhje edhe me UKM nr.2/2012, pika 3, duke qenë se vendimi gjyqësor i regjistruar nga ana jonë është vendim i formes së prerë dhe pala paditëse figuron me parë si pronare e pasurisë (te regjistruar në regjistrat hipotekorë të pasurive të paluajtshme) mbi të cilin gjykata ka disponuar me vendim.
Sqarimi i grupit të auditimit; Observacioni juaj nuk meret në konsideratë pasi: Rast pas rasti sa parashtroni në observimet tuaja, i referoheni se cdo veprim që keni kryer është në përputhje me rregulloren 184, ligjit nr.33/2012 "Per Regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme", UKM nr.2/2012 si dhe neni 193 e vijues te Kodit Civil etj, duke bërë interpretimin e tyre, por në asnjë rast nuk paraqesni të dhëna të reja që të provojnë të kundërtën, pasi në materialin e paraqitur nga grupi i auditimit janë përcaktuar qartë veprimet apo mosveprimet e kryera nga ana juaj dhe dispozita ligjore e cila nuk është respektuar neni, paragrafi gërma, rast pas rasti sipas problematikës së dalë, ku janë kryer dhe ballafaqimet përkatëse, për rastet e mbivendosjeve, ligjshmëria dhe vlefshmëri e akteve të fitimit të pronësisë, verifikimi teknik dhe ligjor rast pas rasti kur kalojnë nga siste mi vjetër në sistemin e ri të regjistrimit të cilat duhet të trajtohen si regjistrim i mirfilltë fillestar, problematika me hartat e punës pozicjoni i objekteve hedhja e tyre me konturet e kuqe jo sipas pizicionit faktit, të meta dhe mangësi që kan erdhur edhe si rezultat i dëmtimit të hartave të punës të cilat nuk janë ribërë, dokumentacion i cili duhet të jetë i plotë orgjinal me të gjithë elementët si në formë dhe në përmbajtje. Tjetërsimi i pasurive shtet të cilat i shërbejnë një interesi publik edhe pse për të cilat nuk ka akte nënligjore nga ministritë e linjës për kalimin në administrim dhe ose përdorim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe jo vetëm. Kryerja e këtyre veorimeve kan impakt të drejtpërdrejtë tek pronarët e ligjshëm apo te grupet e interesit.

6. Auditim mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e objekteve me leje Legalizimi në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, Urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" të ndryshuar dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kritereve, proçedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm për kualifikimin e objekteve", i

ndryshuar me VKM nr. 40, datë 11.01.2012, për periudhën e auditimit dhe transaksionet e kryera me këto prona.

Në zbatim të kësaj pike të programit të auditimit, u përzgjodhën në bazë rrisku rreth 50 referenca, të nxjerra nga regjistrimet përkatëse në KPP.
Nga auditimi i dokumentacionit, mbi regjistrimin e lejeve të legalizimit në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, rezultoi se **në 4 raste,** janë regjistruar me të metë e mangësi, duke lëshuar certifikata pronësie, si më' poshtë:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

- Referencë nr. 16621; ZK 8541
Me aplikim nr. 4978, datë 12.12.2018, nga Dhurim Bajo është kërkuar regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të përfituar me Leje Legalizimi nr. 121743 datë 23.11.2018, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Gjirokastër dhe pajisja me certifikatë pronësie.
Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 41, faqe 144(regjistra sporadikë) dhe RH nr. 7, datë 11.01.2019, është regjistruar me referencë 16621, datë 11.01.2019, pasuria nr. 33/162-Nd, objekti ndërtesë 2 kat, me sipërfaqe ndërtimi të kati përdhe 94.5 m^2, me funksion të banimi lëshuar vërtetim pronësie datë 11.01.2019, duke kaluar në pronësi të Dhurim Hilmi Bajo. Në lejen e legalizimit është përcaktuar parcela ndërtimore me sipërfaqe 383 m^2, e cila do të kalojë në pronësi të poseduesit, sipas VKM-së përkatëse.
Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor, rezulton se me shkresën nr. 3616, datë 11.12.2018, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Gjirokastër ka dërguar për regjistrim në ZVRPP, Lejen e legalizimit nr. 121743 datë 23.11.2018, sëbashku me dokumentacionin shoqërues.
Sa trajtuar, rezulton se regjistrimi i pasurisë dhe përfitimi i kësaj pasurie me leje legalizimi, është kryer me shkelje dhe parregullsi, si vijon:
- Regjistrimi i pasurisë është bërë në emër të njërit nga bashkëpronarët, duke hequr të drejtën e bashkëpronësisë të 2 personave të tjerë, konkretisht Ilmi Bajo(i ati) dhe Elona Bajo(bashkëshortja), duke mos përmbushur kërkesat ligjore.
- Sipërfaqja e parcelës ndërtimore që do të miratohet me vkm përkatëse kalimi i pronësisë, rezulton se është përcaktuar më e madhe se ajo takuese, referuar 3 fishit të bazës së objektit, duke miratuar **më tepër 99.5 m2 [**383(sipërfaqja e miratuar)-283.5(3*94.5)(sipërfaqja takuese)], sa vepruar në kundërshtim pikën 1/a neni17 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar.
Nga ish ZVRPP Gjirokastër, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Sa trajtuar, rezulton se regjistrimi i pasurisë është kryer në kundërshtim me dispozitat ligjore, përcaktuar në pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" dhe pikën 1/a neni17 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar.
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ***ngarkohet me përgjegjësi*** F T me detyrë Regjistrues, S Sh, me detyrë specialist jurist.

- Referencë nr. 15664; ZK 8541

Me aplikim nr. 2610, datë 15.06.2017, nga Admirim Sinanaj është kërkuar regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të përfituar me Leje Legalizimi nr. 67928 datë 20.05.2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Gjirokastër dhe pajisja me certifikatë pronësie.
Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum , faqe regjistra sporadikë) dhe RH nr.296, datë 09.08.2017, është regjistruar me referencë 15664, pasuria nr. 20/80-Nd, objekti ndërtesë 1 kat, me sipërfaqe ndërtimi të kati përdhe 115.3 m^2, me funksion të banimi lëshuar vërtetim pronësie datë 09.08.2017, duke kaluar në pronësi të Admirim Sinanaj. Në lejen e legalizimit është përcaktuar parcela ndërtimore me sipërfaqe 500 m^2, e cila do të kalojë në pronësi të poseduesit, sipas VKM-së përkatëse.
Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor, rezulton se me shkresën nr. 2120, datë 14.06.2017, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Gjirokastër ka dërguar për regjistrim në ZVRPP, Lejen e legalizimit nr. 67928 datë 20.05.2017, sëbashku me dokumentacionin shoqërues.
Sa trajtuar, rezulton se regjistrimi i pasurisë dhe përfitimi i kësaj pasurie me leje legalizimi, është kryer me shkelje dhe parregullsi, si vijon:
- Regjistrimi i pasurisë është bërë në emër të njërit nga bashkëpronarët, duke hequr të drejtën e bashkëpronësisë bashkëshortes së tij, duke mos përmbushur kërkesat ligjore.
- Sipërfaqja e parcelës ndërtimore që do të miratohet me vkm përkatëse kalimi i pronësisë, rezulton se është përcaktuar më e madhe se ajo takuese, referuar 3 fishit të bazës së objektit, duke miratuar **më tepër 154.1 m^2 [**500(sipërfaqja e miratuar)-345(3*115.3)(sipërfaqja takuese)], sa vepruar në kundërshtim pikën 1/a neni17 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar.
- Në hartën trguese provizore lëshuar sëbashku me vërtetimin e pronësisë, rezulton e shënuar pasuria nr. 20/80, truall me sipërfaqe 500 m^2 dhe ndërtesë 1 kat me sipërfaqe kati përdhe 115.3 m^2, rezulton regjistruar edhe trualli kur në fakt akoma nuk është miratuar me VKM, veprimet të kryera nga specialisti hartograf L B.
Nga ish ZVRPP Gjirokastër, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Sa trajtuar, rezulton se regjistrimi i pasurisë është kryer në kundërshtim me dispozitat ligjore, përcaktuar në pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" dhe pikën 1/a neni17 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar.
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ***ngarkohet me përgjegjësi*** M K me detyrë ish Regjistrues, G K, me detyrë specialist jurist dhe L B me detyrë specialist hartograf.

- Referencë nr. 15021; ZK 8541
Me aplikim nr. 2115 datë 27.09.2016, nga Bardhosh Hyseni është kërkuar regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të përfituar me Leje Legalizimi nr.16657datë 28.07.2016, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Gjirokastër dhe pajisja me certifikatë pronësie.
Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 35 , faqe 48(regjistra sporadikë) dhe RH nr.425, datë 20.10.2016, është regjistruar me referencë 15021, pasuria nr. 34/13, truall me sipërfaqe 510 m^2 dhe objekti ndërtesë 2 kat, me sipërfaqe ndërtimi të kati përdhe 170 m^2, me funksion të banimi lëshuar vërtetim pronësie datë 21.12.2016, duke kaluar në pronësi të Bardhosh Hysenit.
Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor, rezulton se me shkresën nr. 1604, datë 29.08.2016, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Gjirokastër ka dërguar për regjistrim në ZVRPP, Lejen e legalizimit nr. 16657, datë 28.07.2016, sëbashku me dokumentacionin shoqërues.

Sa trajtuar, rezulton se regjistrimi i pasurisë dhe përfitimi i kësaj pasurie me leje legalizimi, është kryer me shkelje dhe parregullsi, si vijon:
- Regjistrimi i pasurisë është bërë në emër të njërit nga bashkëpronarët, duke hequr të drejtën e bashkëpronësisë bashkëshortes së tij, duke mos përmbushur kërkesat ligjore.
- Sipërfaqja e parcelës ndërtimore miratuar me vkm nr. 669, datë 29.07.2015, duke kaluar në pronësi të poseduesit, rezulton se është përcaktuar më e madhe se ajo takuese, referuar 3 fishit të bazës së objektit, duke miratuar **më tepër 10 m^2 [**510(sipërfaqja e miratuar)-500sipërfaqja takuese)], sa vepruar në kundërshtim pikën 1/a neni17 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar.
- Në hartën trguese provizore lëshuar sëbashku me vërtetimin e pronësisë, rezulton se ka patur një ndërtesë, për të cilën nuk ka ndonjë dokument apo deklaratë nga poseduesi i i lejes së legalizimit, veprimet të kryera nga specialisti hartograf L B.
Nga ish ZVRPP Gjirokastër, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Sa trajtuar, rezulton se regjistrimi i pasurisë është kryer në kundërshtim me dispozitat ligjore, përcaktuar në pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" dhe pikën 1/a neni17 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar.
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ***ngarkohet me përgjegjësi*** M K me detyrë ish Regjistrues, Nertil Nebiaj, me detyrë specialist jurist dhe E B me detyrë specialist hartograf.

- Referencë nr. 0159; ZK 3580;
Me aplikim nr. 1063, datë 11.05.2016, nga Alqi Vangjel Ruci është kërkuar regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të përfituar me Leje Legalizimi nr. 16462, datë 21.04.2016, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Gjirokastër dhe pajisja me certifikatë pronësie.
Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 5, faqe 136, është regjistruar me referencë 0159, pasuria nr. 174/362, truall me sipërfaqe 438 m^2 dhe objekti ndërtesë 2 kat, me sipërfaqe ndërtimi të kati përdhe 146 m^2, me funksion socila ekonomik, lëshuar certefikatë pronësie datë 12.12.2017, duke kaluar në pronësi të Alqi Vangjel Ruci.
Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor, rezulton se me shkresën nr.669, datë 22.04.2016, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Gjirokastër ka dërguar për regjistrim në ZVRPP, Lejen e legalizimit nr. 16462, datë 21.04.2016, sëbashku me dokumentacionin shoqërues.
Duke ju referuar dokumentacionit hartografik, gen planit dhe hartës treguese të punës së ZVRPP, rezulton se objekti i legalizuar ndërtesë, bie pjesërisht, mbi pasurinë "rrugë" me numër 174/1, për sipërfaqen 76 m^2, e cila figuron e tillë edhe në KPP, volum 1, faqe 4, duke plotësuar kërkesat e pikës 2/e, kreu II, të VKM nr. 280, datë 01.04.2015 "Për Përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje".
Nga specialisti hartograf nuk është bërë azhornimi i pasurisë në hartat përkatëse, megjithëse ka përfunduar procedura e regjistrimit dhe pajisja me dokument pronësie.
Nga ish ZVRPP Gjirokastër, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".

Sa trajtuar, rezulton se lëshimi i lejes së legalizimit dhe regjistrimi i pasurisë së përfituar, nr. 174/362, truall me sipërfaqe 438 m^2 dhe objekti ndërtesë 2 kat, me sipërfaqe ndërtimi të kati përdhe 146 m^2, *është kryer në kundërshtim me dispozitat ligjore*, ***pasi objekti i legalizuar bie mbi pasurinë shtet të llojit "rrugë", ndërsa*** ZVRPP, nuk duhet të procedonte me regjistrimin e kësaj pasurie, sa vepruar në kundërshtim me germën "a", neni 25, pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit", ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar dhe VKM nr. 280, datë 01.04.2015

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ***ngarkohet me përgjegjësi*** F T, me detyrë ish Regjistrues, O C, me detyrë specialist jurist dhe L B me detyrë specialist hartograf.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Shkronjën "a" neni 25 dhe pikën 5 neni 45, të Ligjit 33, datë 21.03.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtëshme";

Pikën 10.6, Kreu i II, të Regullorës nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar;

Me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale".

Lidhur sa trajtuar në faqet 136-140 të Projekt Raportit të Auditimit dhe në Akt-Konstatimin nr. 15, datë 09.08.2019, janë paraqitur observacionet në rrugë elktronike dhe derguar me shkresen 3202/1. Prot, datë 13.09.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 372/5, datë 16.09.2019, dhe me shkresen 3619. Prot, datë 09.09.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 372/6, datë 25.09.2019, nga z. F T, me detyrë drejtor dhe specialistët jurist, S Sh dhe O C, ku sqarohet:

Lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr. 16621, ZK 8541, ku konstatoni ***heqje te bashkepronesise dhe miratim te siperfaqes se parceles ndertimore me shume se 3-fishi i sip.ndertimore - nuk qendron, pasi veprimet e kryera jane konform*** *pikës 2 te nenit 49 te ligjit nr.33/2012 "Regjistrimi i objekteve te legalizuar" percaktohet se "****Regjistrimi kryhet në favor të subjektit, të cilit i është lëshuar leja e legalizimit.***

Lidhur me percaktimin e siperfaqes se parceles ndertimore – eshte kompetence e Drejtorise Rajonale te ALUINI-t Gjirokaster *(cka kerkon me pas miratimin me VKM) dhe jo ZVRPP-se.*

Ne keto kushte, trajtimi dhe pajisja me dokument pronesie, eshte bere konform procedurave ligjore. Sa me lart, kopje te dokumentacionit perkates e gjeni bashkengjitur.

*Lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr. 0159, ZK 3580, ku konstatoni****se pasuria e legalizuar bie pjeserisht ne rruge, mosazhornim te hartes treguese si dhe mosplotesim relacioni dhe urdhri regjistruesit- nuk qendron, pasi veprimet e kryera jane konform përcaktimeve ligjore,*** *per arsyet si me poshte****:***

*- Referuar nenit 49 te ligjit nr.33/2012 "Regjistrimi i objekteve te legalizuara" percaktohet se:"1.****Regjistruesi bën regjistrimin e objektit të legalizuar menjëherë pas përcjelljes për regjistrim nga Agjencia e Legalizimit,..... , cka nenkupton detyrimin ligjor te ZVRPP-se per regjistrim te akteve perkatese*** *(leje legalizmi dhe kontrate kalimi pronesie parcele ndertimore).*

*Persa i perket pjeses prej 76 m2 qe ka qene pjese e pasurise nr.174/1 zk.3580 (me lloj pasurie rruge (fshati) – theksoj se****eshte kompetence e Drejtorise Rajonale te ALUINI-t Gjirokasterte beje verifikimin e elementeve tekniko-ligjore e me pas te kualifikoje objektinsi dhe parcelen ndertimore perkatese ne funksion te objektit informal..Per me teper, kalimi i pronesie per sip.prej 438 m2*** *(ku ben pjese dhe sip.prej 76 m2 me lloj pasurie rruge)* ***eshte miratuar me VKM nr.235 date 30.03.2016*** *(ne zbatim te procedurave sipas VKM nr.280/2015, etj).*

- Lidhur me pretendimin per mosazhornim te hartes treguese – nuk qendron pasi nga konstatimi i planshetes (ne shkalle 1:1000) J-34-5 (8-C) fshati Terihat rezulton te jete bere shenimi perkates ne harte, prej nga eshte bere dhe leshimi i fragmetit perkates..... .
Ne keto kushte, trajtimi dhe pajisja me dokument pronesie, eshte bere konform procedurave ligjore. Sa me lart, kopje te dokumentacionit perkates e gjeni bashkengjitur.
Sqarimi i Grupit të auditimit:
Lidhur me observacionet e paraqitur, të sipërcituar, nuk merren në konsideratë pasi, nuk janë paraqitur argumente dhe prova të reja. Lidhur me argumentet e paraqitura nga ana juaj, për kostatimet që lidhen me referncat përkatëse, ku ju pretendoni se ZVRPP ka detyrim ligjor që të regjistroje të gjitha lejet e legalizimit, duke kaluar përgjegjësinë tek Drejtoria e ALUIZNI-t, lidhur me shkeljet e konstatuara, gjithsesi sqarojmë se pavarësisht se ju nuk keni pëergjegjësi për aktin e lëshuar, duhet domosdoshmërisht të verifikoni eelmenët e formës dhe përmabjtjes dhe në çdo rast që konstatohen parregullsi, duhet ti ridërgoni për korigjim pranë Drejtorisë së ALUIZNI-t.. Sa trajtuar konstatimet tona mbeten të pandryshuara.

Zona kadastrale 3513 Stegopul.
Nga audtimi i dokumentacionit në lidhje me pranimin dhe regjistrimin e objekteve me leje legalizimi në zbatim të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizmin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, VKM nr.438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo", i ndryshuar dhe VKM nr.40, datë 11.01.2012, për periudhën e auditimit dhe transaksioneve të kryera me këto prona per periudhën 01.01.2016 deri me datë 31.05.2019 sipas programit 372/1, datë 28.05.209 u konstatua:
Nga ana e Drjejtoria Vendore e ASHK(ish-ZVRPP) Gjirokastër nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra përsa i përket regjistrimit të pasurive të përfituara nga ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizmin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, VKM nr.438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo", i ndryshuar dhe VKM nr.40, datë 11.01.2012 në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit nr. 372/1, datë 28.05.2019 me zgjedhje në dokumentacionin e ***Zonës Kadastrale 3513 Stegopul Gjirokastër,*** në zbatim të neneve 44-45, pika 5 të Ligjit nr. 33, , datë 21.03.2012" dhe pikës 2 të Udhezimit nr. 2, datë 12.09.2012 në të cilin përcaktohet që:

"Regjistrimi i fitimit apo kalimit të drejtes së drejtes së pronësisë për pasuritë e palujtshme të njohura apo të fituara me anë të ligjit , vendim gjyqësor, aktit administrativ ose me parashkrim fitues, në zbatim të neneve 44-45 te ligjit 33, datë 21.03.3012 "Per regjistrimin e pasurive të Palujtshme" behet nga ZVRPP pas verifikimit të plotë të elementëve të aktit që njeh ose permban fitimin e të drejtën e pronësisë per efekt të plotësimit të kushteve të regjistrimit të percaktuara në nenin 193 të Kodit civil të RSH, dhe pasurive të përfituara nga ligji nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizmin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua si më poshtë:
1.Me refencën nr. 0051, date 02.04.2019. Aplikim nr. 1440, date 03.04.2019 në KPP rezulton e regjistruar p. 94/11, v.4, faqe 43 ndërtesë në emër të Ilia Vangjel Marko për sipërfaqen prej 52 m2 sipas lejes legalizimit nr. 121884, datë 28.02.2019 me certificate të lëshuar me datë 02.04.2019, nënshkruar kpp nga specialistja ***L K dhe certifikata nga Forian Taçi.***
Sipas refencës nr. 0053, datë 14.06.2019, aplikim nr. 1440, datë 03.04.2019(që lidhet me apl.1072, date 21.03.2012017, apl. 608, date 22.02.2019) dhe kopjen origjinale të deshmisë së trashëgimisë nr. 333/156/2) rezulton regjistruar pasuria me dëshmi trashëgimie nga ***Jorgaq Marko*** për pasurinë ***p. 94/11, v.4, faqe 43 ndërtesë*** evidentuar në emër të ***Ilia Vangjel Marko*** për sipërfaqen prej 52 m2, sipas ***lejes legalizimit nr. 121884, datë 28.02.2019 i cili ka vdekur me datë 12.01.2019.***

Për këtë pasuri 94/11, v.4, faqe 43 ndertesë e regjistruar me refencen nr. 0051, në seksionin E është vendosur shënimi ***"mungojnë marrëdhëniet me truallin", ndërsa në lejem e legalizimit ka shënimin që do të mitratohet me VKM.***

-Inventari datë 17.06.2019 nga specialistët L K, Th C dhe Arkiviste A G.

Nuk ka relacion nga hartografi dhe Juristi dhe urdhër për regjistrim nga regjistruesi të dokumentacionit dërguar nga ALUIZNI-i Gjirokastër ku të përcaktohet se ky objekt gjendet në truall shtet dhe per veprimet që do të kryhen në HTR dhe KPP në lidhje me truallin dhe objektin.

Harta treguese është e nënshkruar nga ***Th C*** dhe pa nëshkrimin e ***Regjistruesit F T*** per sipërfaqen ***52 m2 ndërtesë, në kundershtim me udhëzimine KM nr. 2, datë 12.09.2012, pika 2, 3, 4,..pika 8 për plotësimin e formularit të verifikimit sipas shtojcave 1,2,3 bashkëlidhur udhëzimit.***

Harta treguese është e nënshkruar nga ***E I*** por jo nga ***Regjistruesi F T*** per siperfaqen ***52 m2 ndërtesë.***

Dëshmia e trashëgimisë Testamentare nr. 333/156/2, datë 18.02.2019 me kërkues ***Jorgaq Marko*** me objekt: Leshimi i dëshmisë së trashëgimisë testamentare per trashëgimlënsin ***Ilia Marko.***

-Për pjesën e pasurisë Shtëpi Banimi 94/9, me sipërfaqe trualli 300 m2 dhe ndërtim 90 m2me të drejtën e përdorimit të një dhome nga Spiro Marko.

Me shkresën nr. 1157/1, date 25.03.2019 dërguar në ZVRPP Gjirokastër dokumentacioni bashkëlidhur lejes së legalizimit nr. 121884, datë 28.02.2019 per Godinë shërbimi 1 kat me ***certificate të lëshuar me datë 02.04.2019, në emër të Ilia Markos*** si Leje legalizimi, Gen Plani dhe Planimetria e Katit perdhe dhe certifikata e gjendjes familjare lëshuar me date 28.01.2015, dhe jo sipas datës në momentin e aplikimit per legalizim në zbatim të pikës 10, të VKM nr. 1095, date 28.12.2015.

Nuk ka relacionin për përpilimin e urdhrit të regjistruesit në lidhje me vendodhjen e objektit të ndërtuar dhe mënyrën e kryerjes së veprimeve në KPP dhe HTR.

Sipas lejes së legalizimit nr. 121884, parcela evidentohet për ***150 m2 dhe ndërtim 52 m2,*** ku thuhet se ***pasuria është në pronësi shtet dhe do të miratohet me VKM.*** Është vënë shënimi në seksionin E hipoteke ligjore, sipas ***refencës nr. 0051,*** në zbatim te pikës 16 të VKM nr 1095, date 28.12.2015.

Leja e Legalizimit dhe Gen-Plani nënshkruar nga ***E B dhe Nertil Nebiaj.***

Sikurse evidentohet ne dokumentacionin bashkelidhur praktikës regjistrimi rezulton te jete kryer në fillim në emer të ***Ilia Markos sipas refencës nr. 0051, date 02.04. 2019 dhe sipas refencës nr. 0053 regjistruar në emër të Jorgaq Markos i biri Ilia Markos sipas deshmisë së trashëgimisë testamentare sipas testamentit nr.48, date 13.01.2019 dhe kjo leje legalizimi nuk është regjistruar*** sipas certificatës familjare në zbatim të udhëzimit nr. 4695, date 31.05.2016, në kundërshtim me nenin 41, pika 2 e ligjit nr. 3312, date 21.03.2012 si pasuri e përfituar gjatë martesës.

Regjistrimi i këtij objekti është në kundërshtim me ligjin nr. 9482, date 03.04.2006 me ndryshimet përkatese, VKM nr. 1095, date 28.12.2015, Udhezimin nr. 4695, date 31.05.2016 dhe ***udhëzimine KM nr. 2, datë 12.09.2012, pika 2, 3, 4,..pika 8 për plotësimin e formularit të verifikimit sipas shtojcave 1,2,3 bashkëlidhur udhëzimit.***

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Nga ZVRPP Gjirokastër nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes së aktit të lejes së Legalizimit , në kundershtim me dispozitat ligjore të percaktuara nga *ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizmin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar,*

Duke regjistruar objektin Godinë Shërbimi 1 kat me leje legalizimi, në kundërshtim me ligjin nr. 9482, date 03.04.2006 me ndryshimet perkatese, VKM nr. 1095, date 28.12.2015, Udhezimin nr. 4695, date 31.05.2016 dhe udhëzimin ***në kundershtim me udhëzimine KM nr. 2, datë 12.09.2012, pika 2, 3, 4,..pika 8 për plotësimit e formularit të verifikimit sipas shtojcave 1,2,3 bashkëlidhur udhëzimit*** Nuk ka urdhër nga regjistruesi në lidhje me regjistrimin e lejes së legalizimit dhe relacion nga hartografi dhe juristi.

Nuk është plotesuar shtojca 1, në papajtueshmeri me pikën 2-3, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
Nenin 44-45 pika 5 të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012
Pikën 2-3 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012
Kreun e IV-të të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999
Në ligjin nr. 9482, dat 03.04.2006 me ndryshimet, VKM nr. 1095, date 28.12.2015 dhe udhëzimin nr. 4695, datë 31.05.2016.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
F T Regjistrues
L K Juriste
Th C Hartograf.
2.Me refencën nr. 0041, date 01.06.2019, Aplikim nr. 2449, datë 20.10.2016(Marjeta Hyka)në KPP rezulton e regjistruar p. 71/15, v.4, faqe 38 Godinë Banimi në emër të ***Tase Zaho Çano*** me sipërfaqe ***trualli 240 m2 dhe ndertim 82 m2*** sipas ***lejes legalizimit nr. 16538, datë 29.04.2019*** me certificatë të lëshuar me datë ***20.10.2016,*** nënshkruar kpp nga specialist ***Nertil Nebiaj dhe ish-regjistruesi nga M K.***
Nuk ka inventar të dosjes nga specialisti dhe procesverbal dorëzimi në arkivë.
-Sipas plikimit nr. 2449, datë 20.10.2016 për kodet 14, 15, L1, R2 dhe R6 rezulton të jete kryer pagesa sipas tarifave të shërbimit në vlerën prej 7700 lekë për truallin.
-Me shkresën nr. 812, datë 18.05.2016 nga ALUIZN-i Gjirokaster(Klodian Micka) dërguar dokumentacioni në ZVRPP për regjistrimin sipas lejes së legalizimit ***nr. 16538, datë 29.04.2016,*** Gen-planit të objektit, Planimetrive per çdo kat dhe kopjes së certifikatës familjare në zbatim të VKM nr. 1095, date 28.12.2015 pika 10.
Sipas lejes së legalizimit ***nr. 16538, datë 29.04.2016 per godinë Banimi dy kat dhe objekt ndihmës*** rezulton të jetë perfituar nga ***Tase Zaho Çano parcelë ndertimore 240 m2*** nga e cila ***ndërtim 82 m2***, ndërsa për parcelen është vendosur shënimi se "Do të miratohet me VKM".
-Çertifikata familjare lëshuar me date 31.07.2014 dhe evidentohen ***Tase dhe Aleksandra Zaho,*** ndersa nuk rezulton çertifikata në momentin e aplikimit per legalizim që është data 20.10.2016. Nuk rezulton të ketë aplikim për regjistrimin e ndërtimit informal me sipërfaqe ***82 m2.***
HTR është pa datë dhe nëshkruar nga ish-Regjistruesi ***M K dhe Th C*** per sipërfaqen ndërtimore.
Me shkresën nr. 2004, datë 06.10.2016 është dërguar në ZVRPP dokumentacioni, së bashku me formularët e pagesave, në lidhje me shlyerjen e detyrimeve financiare në lidhje me pagesën e parcelës ndertimore të miratuar per kalim pronësie nga shteti tek poseduesi i ndertimit pa leje sipas ***VKM nr. 649, date 14.09.2016*** dhe shuma e paguar në lekë 34560 dhe me bono 50000 lekë sipas MA Kredins Bank datë 05.10.2016.
Për këtë pasuri ***p. 71/15, v.4, faqe 38*** Godinë Banimi në emër të ***Tase Zaho Çano*** me sipërfaqe trualli 240 m2 dhe ndertim 82 m2 sipas lejes legalizimit nr. 16538, datë 29.04.2019 të regjistruar me refencen nr. 0041, në seksionin E të KPP, ***nuk rezulton të ketë pasur shënime per parcelën ndertimor(hipotekë ligjore) dhe nuk rezulton të jetë hequr hipoteka ligjore sipas urdhrit të regjistruesit bazuar në shkresën nr. 2004, datë 06.10.2016 bazuar në VKM nr. 649, date 14.09.2016 dhe pagesave të kryera.***
Nuk ka relacion nga hartografi dhe Juristi dhe urdhër për regjistrim nga regjistruesi të dokumentacionit dërguar nga ALUIZNI-i Gjirokastër ku të percaktohet se ky objekt gjendet në truall shtet dhe per veprimet që do të kryhen në HTR dhe KPP në lidhje me truallin dhe objektin.
Harta treguese është e nënshkruar nga ***Th C dhe ish- Regjistruesi M K*** per siperfaqen 82 m2 ndërtesë dhe truall 240 m2 në kundershtim me udhëzimine KM nr. 2, datë 12.09.2012, pika 2, 3, 4,..pika 8 për plotësimit e formulaarit të verifikimit sipas shtojcave 1,2,3 bashkëlidhur udhëzimit.

Sikurse evidentohet në dokumentacionin bashkëlidhur praktikës regjistrimit pasuria me leje legalizimi rezulton te jete kryer në emër të ***Tase Zaho Çano sipas refencës nr. 0041,*** date 01.06.2016 dhe jo sipas certificatës familjare në zbatim të udhëzimit nr. 4695, date 31.05.2016, në kundërshtim me nenin 41, pika 2 e ligjit nr. 3312, datë 21.03.2012 si pasuri e perfituar gjatë martesës.
Regjistrimi i këtij objekti është në kundërshtim me ligjin nr. 9482, date 03.04.2006 me ndryshimet perkatese, VKM nr. 1095, date 28.12.2015, Udhëzimin nr. 4695, datë 31.05.2016, udhëzimine KM nr. 2, datë 12.09.2012, pika 2, 3, 4,..pika 8 për plotësimit e formulaarit të verifikimit sipas shtojcave 1,2,3 bashkëlidhur udhëzimit.
Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:
Nga ZVRPP Gjirokastër nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes së aktit të lejes së Legalizimit , në kundërshtim me dispozitat ligjore të përcaktuara nga ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizmin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar,
Duke regjistruar objektin Godinë Shërbimi 1 kat me leje legalizimi, në kundërshtim me ligjin nr. 9482, date 03.04.2006 me ndryshimet perkatese, VKM nr. 1095, date 28.12.2015, Udhezimin nr. 4695, date 31.05.2016 dhe udhëzimine KM nr. 2, datë 12.09.2012, pika 2, 3, 4,..pika 8 për plotësimit e formulaarit të verifikimit sipas shtojcave 1,2,3 bashkëlidhur udhëzimit. Sikurse evidentohet në dokumentacionin bashkëlidhur praktikës regjistrimit pasuria me leje legalizimi rezulton te jete kryer në emër të ***Tase Zaho Çano sipas refencës nr. 0041,*** date 01.06.2016 dhe jo sipas certificatës familjare në zbatim të udhëzimit nr. 4695, date 31.05.2016, në kundërshtim me nenin 41, pika 2 e ligjit nr. 3312, datë 21.03.2012 si pasuri e perfituar gjatë martesës.
Nuk ka urdhër nga regjistruesi në lidhje me regjistrimin e lejes së legalizimit dhe relacion nga hartografi dhe juristi, nuk është plotesuar shtojca 1, në papajtueshmeri me pikën 2-3, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
Nenin 44-45 pika 5 të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012
Pikën 2-3 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012
Kreun e IV-të të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999
Në ligjin nr. 9482, dat 03.04.2006 me ndryshimet, VKM nr. 1095, date 28.12.2015 dhe udhëzimin nr. 4695, datë 31.05.2016.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
Meleq Karabina me detyrë ish-Regjistrues
Nertil Nebiaj me detyrë Jurist
Thanas ÇARKA me detyrë hartograf.
<u>3.Me refencën nr. 0045, datë 24.01.2019,</u> Aplikim nr.405-429, datë 14.02.2017, (Marjeta Hyka)në KPP rezulton e regjistruar ***p. 69/5, v.4, faqe 39 Godinë Banimi dhe truall në emër të Alqi Vasil Xhavara*** me sipërfaqe ***trualli 150 m2 dhe ndertim 55 m2 sipas lejes legalizimit nr. 16536, datë 29.04.2016*** me certificatë të lëshuar me datë ***24.01.2018,*** nënshkruar kpp nga specialist G H dhe nënshkruar e vulosur KPP nga ish-Regjistruesi M K.
Inventar i dosjes date 24.01.2018 nga specialisti G Hdhe Arkiviste A G.
-Sipas aplikimit nr. 405 , datë 14.02.2017për kodet 14, 15, L1, R2 dhe R6 rezulton të jetë kryer pagesa sipas tarifave të shërbimit në vlerën prej 7700 lekë për truallin.
-Me shkresën nr. 954, datë 07.06.2016(Aplikim 1382, date 28.06.2016) nga ALUIZN-i Gjirokaster(Klodian Micka) dërguar dokumentacioni në ZVRPP per regjistrimin sipas lejes së legalizimit nr. 16536, datë 29.04.2019, ***me siperfaqe objekti 55 m2*** dhe ka bashkëlidhur Gen-planin e objektit kopje dhe leja e legalizimit kopje, dhe mungojnë Planimetrit e kateve dhe kopje e certificates familjare në zbatim të VKM nr. 1095, date 28.12.2015 pika 10.
Sipas lejes së legalizimit nr. 1653, datë 29.04.2019 per godinë Banimi dy kat rezulton të jete perfituar nga ***Alqi Vasil Xhavara parcelë ndertimore 150 m2 nga e cila ndertim 55 m2,*** ndersa per parcelen është vendosur shënimi se "Do të miratohet me VKM" sipas refencës nr. 0042.

-Nuk ka çertifikatë familjare lëshuar në momentin e aplikimit per legalizim që është data 29.04.2016. ***(Mungon aplikimi për ndërtimin 55 m2 nr. 1382, datë 28.06.2016).***
HTR është datë 15.09.2016 dhe nëshkruar nga ish-Regjistruesi M K dhe L B për sipërfaqen ndërtimore.
Me shkresën nr. 2130, datë 17.10.2016 është dërguar në ZVRPP dokumentacioni, së bashku me formularët e pagesave, në lidhje me shlyerjen e detyrimeve financiare në lidhje me pagesën e parcelës ndertimore të miratuar per kalim pronësie nga shteti tek poseduesi i ndertimit pa leje sipas ***VKM nr. 649, date 14.09.2016*** dhe shuma e paguar në lekë 21600 dhe me bono 30000 lekë sipas MA Kredins Bank datë 05.10.2016.
Për këtë pasuri ***p. 69/5, v.4, faqe 39 Godinë Banimi dhe truall në emër të Alqi Vasil Xhavara me sipërfaqe trualli 150 m2 dhe ndertim 55 m2*** sipas lejes legalizimit nr. 16536, datë 29.04.2016 të regjistruar me ***refencen nr. 0045,*** me shënim në seksionin E për marrëdhëniet e truallit sipas references 0042 të KPP, ***nuk rezulton të jetë hequr hipoteka ligjore sipas urdhrit të regjistruesit bazuar në shkresën nr. 2130, datë 17.10.2016 bazuar në VKM nr. 649, date 14.10.2016 dhe pagesave të kryera.***
Nuk ka relacion nga hartografi dhe Juristi dhe urdhër për regjistrim nga regjistruesi të dokumentacionit dërguar nga ALUIZNI-i Gjirokastër ku të percaktohet se ky objekt gjendet në truall shtet dhe per veprimet që do të kryhen në HTR dhe KPP në lidhje me truallin dhe objektin.
Harta treguese është e nënshkruar nga ***L B dhe ish- Regjistruesi M K per siperfaqen 55 m2 ndërtesë dhe truall 150 m2*** në kundershtim me udhëzimine KM nr. 2, datë 12.09.2012, pika 2, 3, 4,..pika 8 për plotësimin e formulaarit të verifikimit sipas shtojcave 1,2,3 bashkëlidhur udhëzimit.
Sikurse evidentohet në dokumentacionin bashkëlidhur praktikës regjistrimit pasuria me leje legalizimi rezulton te jete kryer në emër të Alqi Vasil Xhavara sipas refencës nr. 0045, date 24.01.2018 dhe jo sipas certificatës familjare në zbatim të udhëzimit nr. 4695, date 31.05.2016, në kundërshtim me nenin 41, pika 2 e ligjit nr. 3312, datë 21.03.2012 si pasuri e perfituar gjatë martesës.
Regjistrimi i këtij objekti është në kundërshtim me ligjin nr. 9482, date 03.04.2006 me ndryshimet perkatese, VKM nr. 1095, date 28.12.2015, Udhëzimin nr. 4695, datë 31.05.2016, udhëzimine KM nr. 2, datë 12.09.2012, pika 2, 3, 4,..pika 8 për plotësimit e formulaarit të verifikimit sipas shtojcave 1,2,3 bashkëlidhur udhëzimit.
Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:
Nga ZVRPP Gjirokastër nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes së aktit të lejes së Legalizimit, në kundërshtim me dispozitat ligjore të përcaktuara nga ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizmin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar,
Duke regjistruar objektin Godinë Shërbimi 2 kat me leje legalizimi, në kundërshtim me ligjin nr. 9482, date 03.04.2006 me ndryshimet perkatese, VKM nr. 1095, date 28.12.2015, Udhezimin nr. 4695, date 31.05.2016 dhe udhëzimine KM nr. 2, datë 12.09.2012, pika 2, 3, 4,..pika 8 për plotësimit e formulaarit të verifikimit sipas shtojcave 1,2,3 bashkëlidhur udhëzimit.
Sikurse evidentohet në dokumentacionin bashkëlidhur praktikës regjistrimit pasuria me leje legalizimi rezulton te jete kryer në emër të ***Alqi Vasil Xhavara sipas refencës nr. 0045, date 24.01.2018 d***he jo sipas certificatës familjare në zbatim të udhëzimit nr. 4695, date 31.05.2016, në kundërshtim me nenin 41, pika 2 e ligjit nr. 3312, datë 21.03.2012 si pasuri e perfituar gjatë martesës.
Nuk ka urdhër nga regjistruesi në lidhje me regjistrimin e lejes së legalizimit dhe relacion nga hartografi dhe juristi, nuk është plotesuar shtojca 1, në papajtueshmeri me pikën 2-3, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
Nenin 44-45 pika 5 të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012
Pikën 2-3 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012

Kreun e IV-të të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999
Në ligjin nr. 9482, dat 03.04.2006 me ndryshimet, VKM nr. 1095, date 28.12.2015 dhe udhëzimin nr. 4695, datë 31.05.2016.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
Meleq Karabina me detyrë ish-Regjistrues
L B me detyrë Hartograf
4.Me refencën nr. 0049, datë19.07.2018, Aplikim nr. 3200, date 27.08.2018, (Maldin Mema) në KPP rezulton e regjistruar ***p. 69/7-Nd, v.4, faqe 42 Godinë Banimi në emër të Sokrat Vangjel Koçi me sipërfaqe ndërtimi 64.6 m2-Nd*** sipas ***lejes legalizimit nr.121502, datë 27.06.2018 me certificatë të lëshuar me datë 14.09.2018,*** nënshkruar kpp nga specialist ***S Sh*** dhe pa nënshkruar e vulosur KPP nga Regjistruesi ***Florian Toçi.***
Inventar i dosjes datë 18.09.2018 nga specialisti S Sh dhe Arkiviste A G (Maria Jovani).
-Sipas aplikimit ***nr. 3200, datë 27.08.2018 për kodet 14, 15, L1, R8*** rezulton të jetë kryer pagesa sipas tarifave të shërbimit në vlerën prej 8500 lekë (certificate, HTR, KPP dhe leje legalizimi të objektit).
-Me shkresën nr.1987, date 09.07.2018 nga ALUIZN-i Gjirokaster(Nertil Nebiaj) dërguar dokumentacioni në ZVRPP për regjistrimin sipas lejes së legalizimit ***nr. 121502, datë 27.06.2018*** me certificatë të lëshuar me datë 14.09.2018, ***me sipërfaqe ndërtimi 64.7 m2*** dhe ka bashkëlidhur Gen-planin e objektit, Planimetrit e kateve dhe kopje e certificates familjare në zbatim të VKM nr. 1095, date 28.12.2015 pika 10.
Sipas lejes së legalizimit nr.121502,datë 27.06.2018 per godinë Banimi dy kat rezulton të jete perfituar nga ***Sokrat Vangjel Koçi parcelë ndertimore 190 m2 nga e cila ndertim 64.6 m2,*** ndërsa për parcelën është vendosur shënimi se "Do të miratohet me VKM" sipas refencës nr. 0049.
-Nuk ka çertifikatë familjare lëshuar në momentin e aplikimit për legalizim që është data 27.08.2018.
HTR është datë 15.09.2016 është nëshkruar nga ***A C (hartograf)*** por pa nëshkruar nga Regjistruesi ***F T.***
Nuk ka VKM për truallin dhe shkresë nga ALUIZN-I në lidhje me shlyerjen e detyrimeve financiare në lidhje me pagesën e truallit me lekë dhe bono.
Për këtë pasuri ***p. 69/5, v.4, faqe 39 Godinë Banimi dhe truall në emër të Sokrtat Vangjel Koçi me sipërfaqe trualli 190 m2 dhe ndertim 64.6 m2*** sipas lejes së legalizimit nr. 121502,datë 27.06.2018 me certificatë të lëshuar me datë 14.09.2018, me sipërfaqe ndërtimi 64.7 sipas refencës nr. 0049, ka shënim në seksionin E për marrëdhëniet e truallit.
Nuk ka relacion nga hartografi dhe Juristi dhe urdhër për regjistrim nga regjistruesi të dokumentacionit dërguar nga ALUIZNI-i Gjirokastër ku të percaktohet se ky objekt gjendet në truall shtet dhe per veprimet që do të kryhen në HTR dhe KPP në lidhje me truallin dhe objektin.
Harta treguese është e nënshkruar nga ***L B dhe ish- Regjistruesi M K*** per ***siperfaqen 64.6 m2 ndërtesë dhe truall 190 m2***, në kundërshtim me udhëzimine KM nr. 2, datë 12.09.2012, pika 2, 3, 4, pika 8 për plotësimin e formularit të verifikimit sipas shtojcave 1,2,3 bashkëlidhur udhëzimit.
Sikurse evidentohet në dokumentacionin bashkëlidhur praktikës regjistrimit pasuria me leje legalizimi rezulton te jete kryer në emër të ***Sokrtat Vangjel Koçi sipas refencës nr. 0049, date 19.07.2018*** dhe jo sipas certificatës familjare në zbatim të udhëzimit nr. 4695, date 31.05.2016, në kundërshtim me nenin 41, pika 2 e ligjit nr. 3312, datë 21.03.2012 si pasuri e perfituar gjatë martesës.
Regjistrimi i këtij objekti është në kundërshtim me ligjin nr. 9482, date 03.04.2006 me ndryshimet përkatese, VKM nr. 1095, date 28.12.2015, Udhëzimin nr. 4695, datë 31.05.2016, udhëzimine KM nr. 2, datë 12.09.2012, pika 2, 3, 4,..pika 8 për plotësimit e formulaarit të verifikimit sipas shtojcave 1,2,3 bashkëlidhur udhëzimit.
Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Nga ZVRPP Gjirokastër nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes së aktit të lejes së Legalizimit , në kundërshtim me dispozitat ligjore të përcaktuara nga ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizmin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar,
Sqarimi i grupit të auditimit: Observacioni juaj nuk meret në konsideratë pas: Rast pas rasti sa parashtroni në observimet tuaja, i referoheni se cdo veprim që keni kryer është në përputhje me rregulloren 184, ligjit nr.33/2012 "Per Regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme", UKM nr.2/2012 si dhe neni 193 e vijues te Kodit Civil etj, duke bërë interpretimin e tyre, por në asnjë rast nuk paraqesni të dhëna të reja që të provojnë të kundërtën, pasi në materialin e paraqitur nga grupi i auditimit janë përcaktuar qartë veprimet apo mosveprimet e kryera nga ana juaj dhe dispozita ligjore e cila nuk është respektuar neni, paragrafi gërma, rast pas rasti sipas problematikës së dalë, ku janë kryer dhe ballafaqimet përkatëse, për rastet e mbivendosjeve, ligjshmëria dhe vlefshmëri e akteve të fitimit të pronësisë, verifikimi teknik dhe ligjor rast pas rasti kur kalojnë nga siste mi vjetër në sistemin e ri të regjistrimit të cilat duhet të trajtohen si regjistrim i mirfilltë fillestar, problematika me hartat e punës pozicjoni i objekteve hedhja e tyre me konturet e kuqe jo sipas pizicionit faktit, të meta dhe mangësi që kan erdhur edhe si rezultat i dëmtimit të hartave të punës të cilat nuk janë ribërë, dokumentacion i cili duhet të jetë i plotë orgjinal me të gjithë elementët si në formë dhe në përmbajtje. Tjetërsimi i pasurive shtet të cilat i shërbejnë një interesi publik edhe pse për të cilat nuk ka akte nënligjore nga ministritë e linjës për kalimin në administrim dhe ose përdorim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe jo vetëm. Kryerja e këtyre veorimeve kan impakt të drejtpërdrejtë tek pronarët e ligjshëm apo te grupet e interesit.

7. Auditim mbi procedurën e ndjekur për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga vendime gjyqësore të formës së prerë.

Në zbatim të kësaj pike të programit të auditimit nga verifikimi i dokumentacionit përkatës, u konstatuan të meta e parregullsi, të cilat po i trajtojmë më poshtë:

- Referencë nr. 16045

Me aplikim nr. 20, datë 09.01.2017, Zisi Koço Papazisi ka kërkuar regjistrimin e kalimit të pronësisë me vendim gjykate, për pasurinë nr. 13/136, ZK 8541.
Në volum 35, faqe 141, është regjistruar pasuria nr. 13/136, truall me sipërfaqe 365 m^2, mbi të cilin ndodhet ndërtesëa me sipërfaqe 86 m^2, në pronësi të Ziso Papazisit, lëshuar vërteim hipotekor datë 25.01.2017.
Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se regjistrimi i pasurisë rrjedh nga Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Gjirokastër, nr. 764, datë 01.12.2016, palë paditëse është Ziso Papazisi dhe palë e paditur është ZVRPP Gjirokastër, në mungesë.
Objekt i kësaj padie është detyrimin e ZVRPP Gjirokatër për të bërë regjistrimin e pasurisë truall me sipërfaqe 365 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 86 m^2 dhe pajisjen me dokument pronësie në favor të palës paditëse.
Në përfundim të procesit Gjykata është shprehur në favor të paditësit, duke vendosur detyrimi i ZVRPP Gjirokatër për të bërë regjistrimin dhe pajisjen me dokument pronësie në favor të palës paditëse. Ky vendim gjykate ka marrë formë të prerë me datë 28.12.2016

Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor gjendje në dosje, rezulton se nga ZVRPP Gjirokastër, nuk janë verifikuar elemntet e formës dhe të përmbajtjes së Aktit Administrativ të dhe nuk është plotësuar ***shtojca 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Si përfundim, duke ju referuar dokumentacionit të shqyrtuar gjatë auditimit, arrijmë në konkluzionin, ***se gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor, ku ZVRPP Gjirokastër, ka qenë palë e paditur, ka rezultuar në mungesë në seancat përfundimtare të procesit gjyqësor, gjithashtu nuk ka bërë ankimimin brenda afateve të vendimeve të gjaykatëve, të cilat kanë marrë formë të prerë pa u ankimuar, duke ndikuar direkt në përfundimin e procesit për të bërë të mundur ndjekjen e të gjitha shkallëve të gjykimit.***
Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuara ngarkohet me përgjefgjësi z. M K me detyrë ish Regjistrues,

- Referencë nr. 15061
Me aplikim nr. 3292, datë 27.12.2016, Erdet Sherif Mezini ka kërkuar regjistrimin e kalimit të pronësisë me vendim gjykate, për pasurinë nr. 9/28, ZK 8541.
Në volum 35, faqe 149, është regjistruar me datë 02.03.2017, pasuria nr. 9/28, truall me sipërfaqe 420 m^2, mbi të cilin ndodhet ndërtesë banimi 2 kate, me sipërfaqe 99 m^2, në pronësi të Erdet Mezinit, lëshuar vërteim hipotekor datë 09.03.2017.
Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se regjistrimi i pasurisë rrjedh nga Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Gjirokastër, nr. 660, datë 27.10.2016, palë paditëse është Erdet Mezini dhe palë e paditur është ZVRPP Gjirokastër, në mungesë.
Objekt i kësaj padie është detyrimin e ZVRPP Gjirokatër për të bërë regjistrimin e pasurisë truall me sipërfaqe 420 m^2 dhe pajisjen me dokument pronësie në favor të palës paditëse.
Në përfundim të procesit Gjykata është shprehur në favor të paditësit, duke vendosur detyrimi i ZVRPP Gjirokatër për të bërë regjistrimin dhe pajisjen me dokument pronësie në favor të palës paditëse. Ky vendim gjykate ka marrë formë të prerë me datë 27.10.2016
Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor gjendje në dosje, rezulton se nga ZVRPP Gjirokastër, nuk janë verifikuar elemntet e formës dhe të përmbajtjes së Aktit Administrativ të dhe nuk është plotësuar ***shtojca 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Si përfundim, duke ju referuar dokumentacionit të shqyrtuar gjatë auditimit, arrijmë në konkluzionin, ***se gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor, ku ZVRPP Gjirokastër, ka qenë palë e paditur, ka rezultuar në mungesë në seancat përfundimtare të procesit gjyqësor, gjithashtu nuk ka bërë ankimimin brenda afateve të vendimeve të gjaykatëve, të cilat kanë marrë formë të prerë pa u ankimuar, duke ndikuar direkt në përfundimin e procesit për të bërë të mundur ndjekjen e të gjitha shkallëve të gjykimit.***
Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuara ngarkohet me përgjefgjësi z. M K me detyrë ish Regjistrues,

- Referencë nr. 15631
Me aplikim nr. 1241, datë 10.04.2017, Riza SHEHU ka kërkuar regjistrimin e ndarjen e pasurisë bazuar në vendim gjykate..
Në volum 35, faqe 158, është regjistruar dhe regjistër hipotekor nr. 280, datë 17.07.2017, , pasuria nr. 10/149, truall me sipërfaqe 218 m^2, mbi të cilin ndodhet ndërtesë banimi, me sipërfaqe 118 m^2, në pronësi të Riza Shehut, lëshuar vërteim hipotekor datë 17.07.2017.
Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se regjistrimi i pasurisë rrjedh nga Vendimi i Gjykatës të Shkallës së parë Gjirokastër, nr. 00414, datë 30.06.1999, që ka vendosur pjestimin e

pasurisë truall me sipërfaqe 2278 m^2, në 7 pjesë, pjesë e të cilit është edhe pasuria e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 280, datë 17.07.2017.
Origjina e pasurisë së pjestuar ndërmjet palëve rrjedh nga Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjirokastër nr. akti 796 dhe nr. vendimi 682, datë 17.12.1999, për njohje pronësie, në mungesë të aktit të pronësisë, palë paditëse Riza Shehu dhe palë e paditur Bashkia Gjirokastër, i cili ka vendosur njohjen e pronësisë së paditësit, shtëpi 2 katëshe me sipërfaqe ndërtimi 118.7 m^2 dhe truall me sipërfaqe 1277 m^2.
Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor gjendje në dosje, rezulton se nga ZVRPP Gjirokastër, nuk janë verifikuar elemntet e formës dhe të përmbajtjes së Aktit Administrativ të dhe nuk është plotësuar ***shtojca 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit". Veprimet janë kryer nga specialisti jurist O C.
Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se regjistrimi i pasurisë që në origjinën e saj, është kryer me shkelje dhe parregullsi:
- Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjirokastër nr. akti 796 dhe nr. vendimi 682, datë 17.12.1999, është vërtetim fakti, i cili është shprehur për njohjen e pronësisë në favor të paditësit, i cili nuk disponon dokumente dhe akte pronësie, duke paditur si palë Bashkinë Gjirokastër, e cila në fakt nuk është pronare e pasurisë së përfituar nga paditësi, sa vepruar në kundërshtim me nenin 195, të ligjit nr. të kodit Civil.
- Vendimi i Gjykatës të Shkallës së parë Gjirokastër, nr. 00414, datë 30.06.1999, ka vendosur pjestimin e pasurisë truall me sipërfaqe 2278 m^2, por në fakt referuar origjinës së pasurisë, Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjirokastër nr. akti 796 dhe nr. vendimi 682, datë 17.12.1999, i cili ka përcaktuar njohje të pasurisë truall me sipërfaqe 1277 m^2, për rrjedhojë ***është krijuar një diferencë prej 1001 m^2(2278-1277), për të cilën mungon dokumentacioni i fitimit të pronësisë.***
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me shkronjën "a" neni 25, me pikën 2 nenin 45, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", neni 24/b i ligjit nr. 7843, datë 19.07.1994, i shfuqizuar, me pikën 5, UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" dhe Regulloren nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar;
Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër, sipas periudhave që janë kryer veprimet **ngarkohen me përgjegjësi** M K, me detyrë ish Regjistrues, O C me detyrë specialist jurist.

- Referencë nr. 14836; 8791
Me aplikim nr. 696, datë .04.2016, Mihal Kola ka kërkauar ndarjen e pasurisë nr. 26/70, ZK 8541.
Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 35, faqe 13 dhe regjistrin hipotekor nr. 212, datë 23.05.2016, është regjistruar pasuria nr. 26/209, truall me sipërfaqe 390 m^2 dhe volum 35, faqe 14 dhe regjistrin hipotekor nr. 213, datë 23.05.2016, është regjistruar pasuria nr. 26/208, truall me sipërfaqe 1520 m^2 mbi të cilin ndodhet ndërtesa me sipërfaqe 110 m^2, në pronësi të Mihal Kolës dhe duke lëshuar vërtetim pronësie datë 23.05.2016.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se mungon kërkesa e pronarit të pasurisë dhe urdhëri i regjistruesit, për ndarjen e pasuisë, duke mos respektuar kërkesat ligjore përcaktuar në nenin 34, të ligjit nr. 33, datë 21.03.212 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme",
Veprimet e kryera për ndarjen e pasurisë janë kryer nga specilistëti jurist Bexhet Baxhia dhe specialisti hartograf E B.
Dokumentacioni që ka shërbyer për regjistrimin e pasurisë ndodhet në dosjen me me referncë nr. 8791. Origjina e pasurisë rrjedh nga Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjirokastër nr. akti 728 dhe nr. vendimi 599, datë 31.08.1992, për vërtetimin e faktit të pronësisë mbi një shtëpi banimi të ndodhur në lagjen "Varosh", të kufizuar me shtëpitë e qytetarëve: Ksenofon Taçi, Asllan Vrunjo,

Vasil Konomi, Petro Harilla, Garito e Kiço Zisi dhe me truallin e pallatit. Gjithashtu në dosjen me referencë nr. 8791, gjendet vërtetim pronësie me nr. prot. 55, datë 10.10.1992, i cili përshkruan se ka të regjistruar shtëpi banimi 1 kat e me sipërfaqe 110 m^2 dhe ka një kopësht me sipërfaqe 1800 m^2, regjistrim i kryer në bazuar në Vendimin e Gjykatës nr. 599, datë 31.08.1992.
Pjesë e dokumentacionit gjendje në këtë dosje është edhe një vërtetim nr. 23/4, datë 23.04.2002, i lëshuar nga Përgjegjësi i Urbanistikës së Bashkisë Gjirokastër, sipas të cilit vërtetohet se Mihal Kola ka në pronësi në lagjen "Varosh", shtëpi banimi me sipërfaqe 110 m^2 dhe një kopësht me sipërfaqe 1800 m^2. Më shkresën nr. 359/1, datë 04.08.2008, Arkivi Shtetëror Vendor Gjirokaëtr ka dërguar një fletë kopje të Vendimit nr. 83, datë 19.08.1985, të Komitetit Ekzekutiv të K.P. Gjirokastër, sipas të cilit i jepet Lje ndërtimi qytetarit Mihal Kola, për ndërtimin e një shtëpie të re në Lagjen "18 Shtatori", me sipërfaqe të përgjithshme 170 m^2.
Mbi bazën e këtij dokumentacioni dhe të disa plan rilevimeve dhe deklarata të kufitarëve, është kryer regjistrimi fillastar në regjistrat e ZVRPP–së Gjirokastër, në R.H. nr. 248, datë 09.11.2009, pasuria numër 26/70, me sipërfaqe 1910 m^2, mbi të cilin ngihet banesë 1 kat e me sipërfaqe 110 m^2, lëshuar vërtetim pronësie datë 04.11.2009.
Në fakt *duke ju referuar dokumentacionit të origjinës, Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjirokastër nr. akti 728 dhe nr. vendimi 599, datë 31.08.1992, rezulton se nuk ka vendosur për njohje apo kalim pronësie për truallin,* por është shprehur vetëm për njohje të pronësisë mbi ndërtesën, për rrjedhojë regjistrimi i truallit me sipërfaqe 1910 m^2, nuk duhet të regjistrohej.
Veprimet janë kryer nga specialistët përkatës(nuk mund të identifikohen, hartograf K R) dhe Regjistrues Nikolla Dina
Sa trajtuar, rezulton se regjistrimi ***i pasurisë truall me sipërfaqe 1910 m^2***, *është kryer ne shkelje të dispoziatve ligjore,* ***pasi mungon dokumentacioni i që shërben si Titull Pronësie, sa vepruar në kundërshtim*** me germën "a" neni 24, të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe Regulloren nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar;
Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër, sipas periudhave që janë kryer veprimet, për veprimet që i përkasin regjistrimit(në vitin 2009), **ngarkohen me përgjegjësi** Nikolla Dine dhe specialisti hartograf K R, ndërsa për veprimet e kryera që i përkasin ndarjes së pasurisë(viti 2016), **ngarkohen me përgjegjësi** Bexhet Baxhia me detyrë specialist jurist dhe E B, me detyrë specilist hartograf.

- Referencë nr. 0249, ZK 1053;
Me aplikim nr. 2984, datë 13.10.2015 dhe nr. 2725, datë 10.11.2016, Mane Braho Dinaj ka kërkuar kalimin nga hipoteka në sistem regjistrimi për pasurinë nr. 205/248, ZK 1053.
Në volum 5, faqe 99 dhe regjistër hipotekor nr. , datë , është regjistruar, pasuria nr. 205/248, truall me sipërfaqe 306 m^2, mbi të cilin ndodhet ndërtesë banimi, me sipërfaqe 53.8 m^2, në pronësi të Simo Binerit, lëshuar vërteim hipotekor.
Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se regjistrimi i pasurisë rrjedh nga kontrata e shitjes nr. 1438 rep. , 425 kol. , datë 05.06.1998, palë shitëse qytetari Ymer Ymeraj dhe pala blerësë Simo Bineri, regjistruar në RH. Nr. 502, datë 15.06.1998.
Origjina e pasurisë rrjedh nga Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjirokastër nr. akti 150 dhe nr. vendimi 22, datë 14.01.1998, me objekt njohje pronësie, në mungesë të aktit të pronësisë, palë paditëse Imer Imeraj dhe palë e paditur Komuna e Antigonesë, Gjirokastër, ku ka vendosur njohjen e pronësisë së paditësit, shtëpi 1 katëshe me sipërfaqe ndërtimi 53.8 m^2 dhe truall me sipërfaqe 306.2 m^2.
Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor gjendje në dosje, rezulton se nga ZVRPP Gjirokastër, nuk janë verifikuar elemntet e formës dhe të përmbajtjes së Aktit Administrativ të dhe nuk është plotësuar ***shtojca 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të

pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit". Veprimet janë kryer nga specialisti jurist i pa identifikuar..
Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se regjistrimi i pasurisë që në origjinën e saj, është kryer me shkelje dhe parregullsi:
- Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjirokastër nr. akti 150 dhe nr. vendimi 22, datë 14.01.1998,, është vërteim fakti, i cili është shprehur për njohjen e pronësisë në favor të paditësit, i cili nuk disponon dokumente dhe akte pronësie, duke paditur si palë Komunën Antigone, Gjirokastër, e cila në fakt nuk është pronare e pasurisë së përfituar nga paditësi.
Sa trajtuar, rezulton se regjistrimi ***i pasurisë***, *është kryer ne shkelje të dispoziatve ligjore*, ***pasi mungon dokumentacioni i origjinës së pronës, që shërben si Titull Pronësie, sa vepruar në kundërshtim*** me germën "a" neni 24, të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe Regulloren nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar;
Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër, **ngarkohen me përgjegjësi** M K dhe specialisti jurist(i pa identifikuar) që kryer veprimet.
Në asnjë rast, gjatë paraqitjes për regjistrim të vendimeve të gjykatave, nga specialistët e ZVRPP-së Gjirokastër nuk është plotësuar ***shtojca 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Për këtë ngar kohenme përgjegjësi specilistët juristë që kanë kryer veprimet, përkatësisht Bexhet Baxhia dhe O C.

Lidhur sa trajtuar në faqet 183-188 të Projekt Raportit të Auditimit dhe në Akt-Konstatimin nr. 16 datë 09.08.2019, janë paraqitur observacionet në rrugë elktronike dhe derguar me shkresen 3906. Prot, datë 13.09.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 372/5, datë 16.09.2019 dhe me shkresen 3619. Prot, datë 09.09.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 372/6, datë 25.09.2019(përbledhur nga Drejori F. Taçi), nga z. B B, me detyrë ish Zv. Regjistrues dhe specialistët jurist, ku sqarohet:
Lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr. 14973, ZK 8541, ku konstatoni se dokumentacioni urbanistik nuk është origjinal, sqarojmë se dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia Gjirokastër është në përputhje me kreun IV, pika 12, të Rregullores, dhe duhet të merret parasysh që akti administrativ është krijuar nga Njësia e Qeverisjes vendore, si dhe ësjtë kofirmuar po nga institucion që e ka lëshuar. I gjithë dokumentacioni urbanistik i dërguar nga bashkia janë të administruara në dosje dhe përcjellë zyrtarisht nga bashkia..... .
Sqarimi i Grupit të auditimit:
Lidhur me observacionet e paraqitur, të sipërcituar, nuk merren në konsideratë pasi, nuk janë paraqitur argumente dhe prova të reja, Konstatimet tona lidhen me mungesën e dokumentacionit origjinal, kryesisht leja e ndërtimit që shërben si akt administrativ për fitimin e pronësisë, gjithashtu rezulton mungesë e marrëdhënieve me trualli, më hollësisht jemi shprehur në aktin e konstatimit. Në kushtet e mos paraqitjes së dokumenteve argumentuese, konstatimet tona mbeten të pandryshuara.

ZK 8542;

- (Për auditimin e regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituar sipas Vendimeve të Gjykatës")

Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit mbi pranimin dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituar sipas *Vendimeve të Gjykatës*, të ndryshuar, rezultoi se pranimi i

dokumentacionit dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme është bërë me të meta dhe mangësi si më poshtë:

- Referencë nr. 03658/ 02089, ZK 8542;
Me kërkesë nr. 545, datë 19.02.2019, Sabaudin Kodra ka kërkuar për tu pajisur me fragment harte, kopje kartele dhe vërtetim pronësie regjistrim kontrate.
Në KPP volum 5, faqe 42, është regjistruar pasuria nr. 8/213, truall me sipërfaqe 1625 m^2, në pronësi të Sabaudin Kodra.
ZVRPP Gjirokastër ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***Pasuria nr. 8/213 krijon pjesërisht mbivendosje me pasurinë 8/237 sipas hartës treguese të regjistrimit e azhurnuar sipas regjistrimit fillestar datë 02.03.2011. Gjithashtu nga nuk është bërë ankimimi brenda afatit 15 ditor në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, vendimi i gjykatës nr. 1073 datë 06.09.2010 si pal e paditur, me objekt detyrimin e ZVRPP të lëshojë certifikatën e pronësisë për pasurinë e paluajtshme nr. 8/213 ZK 8542, sipërfaqja 1625 m^2, regjistruar sipas referencë nr. 02089 aplikim nr. 949 datë 27.09.2010. Nuk është bërë verifikimi nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër***.
Veprime këto në papajtueshmëri me pikën "ç", "e", neni 20, shkronjën "a" neni 25, pikën 1 nenin 29 dhe 30 të Ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" i ndryshuar, me pikën 10.5 të kreut të I dhe 5.1 të kreut VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të Udhëzim Këshillit Të Ministrave Nr. 2, Datë 12.09.2012 Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit në kundërshtim me pikën II.i. pikën II.iii. të shkresë nr. 1969 prot, datë 23.03.2012 të ZQRPP "Rregullorja mbi monitorimin e regjistrimit fillestar". ne dokumentin nr. 892 prot. datë 07.02.2008 "Procedurat e Kontrollit të Regjistrimit Fillestar", shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5348 prot., date 18/10/2011 "Skema e rishikuar për kontrollin dhe monitorimin e regjistrimit fillestar", dhe shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5985 prot, date 16/11/2009. Udhëzimi nr. 79, datë 09.05.2003 i ZQRPP "Regjistrimi fillestar sporadic të pasurive të pa lujtshme në zonat urbane".
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. R G me detyrë jurist, z. E I me detyrë hartograf, z. Aleksandri Pesha me detyrë ish/regjistrues.

- Referencë nr. 03543, ZK 8542**;**
Me kërkesë nr. 23511, datë 14.09.2017, Mukades Magarelli ka kërkuar për tu pajisur me fragment harte, kopje kartele dhe vërtetim pronësie regjistrim kalim pronësie.
Në KPP volum 8, faqe 41, është regjistruar pasuria nr. 8/361, truall me sipërfaqe 300 m^2, objekt 65në pronësi të Andrea Zota.
ZVRPP Gjirokastër ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***Nuk është bërë ankimimi brenda afatit 15 ditor në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, vendimi i gjykatës nr. 551 datë 27.09.2016 si pal e paditur, i cili ka vendosur anulimin e aktit administrativ nr.510 prot, datë 04.05.2016 të ZVRPP Gjirokastër, fshirjen nga regjistrat hipotekorë pronën e [redacted] e cila krijon mbivendosje me paditësin dhe detyrimin e ZVRPP të regjistrojë në emër të trashëgimtarëve [redacted]. Nuk është bërë verifikimi nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër***. .
Veprime këto në papajtueshmëri me pikën "ç", "e", neni 20, shkronjën "a" "b"neni 25, pikën 1 nenin 29 dhe 30 të Ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" i ndryshuar, me pikën 10.5 të kreut të I dhe 5.1 të kreut VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të Udhëzim Këshillit Të Ministrave Nr. 2, Datë 12.09.2012 Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit në kundërshtim me pikën II.i. pikën II.iii. të

shkresë nr. 1969 prot, datë 23.03.2012 të ZQRPP "Rregullorja mbi monitorimin e regjistrimit fillestar". ne dokumentin nr. 892 prot. datë 07.02.2008 "Procedurat e Kontrollit të Regjistrimit Fillestar", shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5348 prot., date 18/10/2011 "Skema e rishikuar për kontrollin dhe monitorimin e regjistrimit fillestar", dhe shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5985 prot, date 16/11/2009. Udhëzimi nr. 79, datë 09.05.2003 i ZQRPP "Regjistrimi fillestar sporadic të pasurive të pa lujtshme në zonat urbane".
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. F T me detyrë Regjistrues.

Lidhur sa trajtuar në faqet 181-183 të Projekt Raportit të Auditimit dhe në Akt-Konstatimin nr. 5 datë 09.08.2019, janë paraqitur observacionet në rrugë elktronike dhe derguar me shkresen 3906. Prot, datë 13.09.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 372/5, datë 16.09.2019, nga dhe me shkresen 3619. Prot, datë 09.09.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 372/6, datë 25.09.2019(përbledhur nga Drejori F. Taçi), *z. F T me detyrë Regjistrues Z.R G(me detyre specialist jurist)si dhe Z.E I (me detyre specialist hartograf)*
Persa i perket Konstatimit sipas(references nr.03543 zk.8542) :
Lidhur me kerkesen nr.23511 date 14.09.2017, sipas te cilit qytetarja Mukades Magarreli ka kërkuar regjistrimin e vendimit gjyqësor nr. 551 dt. 27.09.2016 të Gjykatës Administrative të shkallës së Parë Gjirokastër lënë në fuqi me vendimin nr. 3177 dt. 05.07.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, vleresojme se konstatimi i grupit te auditimit per mungese te ankimimit brenda afatit 15 ditor në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë si palë e paditur - nuk qendron, pasi veprimet e kryera jane konform ligjit nr.33/2012 si dhe Kodit Civil dhe te Procedures Civile.
Konkretisht, me vendimin nr.551 dt. 27.09.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër me palë paditëse [redacted], i paditur ZVRPP Gjirokastër, persona të tretë [redacted], [redacted], me pjesmarrjen e Zyrës Vendore e Avokaturës së Shtetit Gjirokastër, me objekt :
" -Anullimin e aktit administrativ nr.510 prot. dt. 04.05.2016 të ZVRPP Gjirokastër.
Detyrimi i ZVRPP Gjirokastër të regjistroj në regjistrat hipotekorë pronën një shtëpi banimi e ndodhur në lagjen "teqe" me sipërfaqe prej 500 m^2 me gjithë oborr që ndodhet brenda mureve rrethues të saj prona ka kufizime nga një krah me rrugë kryesore , nga ana tjetër me turizimin, nga ana tjetër em shtëopinë e Shuaip Bendos dhe në një anë me rrugë. Prona ka pronarë trashëgimtarët ligjorë të [redacted]. Detyrimi i ZVRPP Gjiorokastër të bëjë fshirjen ngaregjistri të cdo regjistrimi dhe mbivendosje mbi pronën e trashëgimtarëve ligjor të [redacted] dhe regjistrimin e duhur në respektim të vendimit nr. 1082 dt. 04.12.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.", sipas te cilit është vendosur:-Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. -Shfuqizimin e aktit adminstrativ , Vendimit nr.510 dt. 04.05.2016 të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastër.
-Detyrimin e palës së paditur Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastër të regjistrojë në emër të trashëgimtarëve ligjor të [redacted] pronën e fituar me Aktin Administrativ , vendimin nr. 8 dt. 17.02.2016 të Bashkisë Gjirokastër.
-Kundër këtij vendimi ka bërë ankim pala paditëse [redacted] dhe me vendimin nr. 3177 dt. 05.07.2017 të Gjykatës Adminstrative të Apelit Tiranë është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 551 dt.27.09.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.
-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar në referencën nr. 3543 rezulton se me vendimin nr. 08. Dt. 17.02.2016 "për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj të Bashkisë Gjirokastër (bazuar në VKM nr. 608 dt. 05.09.2012) është vendosur :
-Kalimin në pronësi të objektit banesë e truall funksional prej 300 m^2 nga të cilat 65 m banesë dhe 235 m truall funksional me nr. Pasurie në zonën kadastrale 8542 në lagjen [redacted]

[redacted]

-Ndërsa me vendimin gjyqësor nr. 1082 dt. 04.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër me palë paditëse [redacted] të paditur ATP Tiranë, [redacted] palë e tretë [redacted] me objekt"Anullimin e pjesshëm të vendimit nr. 496 dt. 16.01.1998 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimti të Pronave me të cilin është vendosur: -Miratimin e zgjidhjes me pajtim të cështjes midis paditëses [redacted] dhe të paditur [redacted] për cështjes civile me nr. Regj.Them 688[21233-00976-21-2012, dt. 28.05.2012 si më poshtë:
-palët janë dakort me aktin e ekspertimit të ekspertit [redacted] duke u saktësuar kufiri jugur i pronës së paditëses [redacted] si trashëgimtare e familjes [redacted] dhe të paditurit [redacted] nga muri jugor i shtëpisë së familjes [redacted] dhe të paditurit [redacted], nga muri jugor i shtëpisësë familjes [redacted], shtëpi banimi dy katëshe, distanca me murin rrethues të oborrit të banesës së [redacted] do të jetë 3 m. Për zgjidhjen dhe përcaktimin në terren të pronës refrojur aktit të ekspertimit.
ZVRPP Gjirokastër në përgjigje të aplikimit nr.23511 datë 14.09.2017 të [redacted] ka regjistruar pasurinë nr. 8/361ZK 8542, 14.09.2017 në nr. 50 regj.hipotekor dt. 18.07.2018, truall me sipërfaqe 300 m^2 dhe ndërtesë 65 m^2 . Regjistrimi është bërë në përputhje me nr. 551 dt. 27.09.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër lënë në fuqi me vendimin nr. 3177 dt. 05.07.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, vendimin nr. 08. Dt. 17.02.2016 "Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj të Bashkisë Gjirokastër (bazuar në VKM nr. 608 dt. 05.09.2012) dhe vendimin gjyqësor nr. 1082 dt. 04.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. Lidhur me pretendimin se nga ana ZVRPP Gjirokastër nuk është bërë ankim ndaj vendimit nr. 551 dt. 27.09.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër - sqaroj se vitin 2016 nuk kam ushtruar funksionet e regjistrues pranë ZVRPP Gjirokastër, pasi emërimi im në këtë funksion është bërë në dt. 26.09.2017. Në kohën e regjistrimit të vendimit nr. 551 dt. 27.09.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, ky vendim kishte marrë formë të prere me vendimin nr. 3177 dt. 05.07.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.Një vendim i formës së prerë është i detyrueshëm për regjistrim në bazë të ligjit nr.33/2012, Kodit Civil si dhe Kodit te Porcedures Civile. Persa i perket Konstatimit me(reference nr.03658/02086 zk.8542):
Lidhur me kerkesen nr.545 date 19.02.2019, trajtuar nga une , Z.R G(me detyre specialist jurist)si dhe Z[redacted] (me detyre specialist hartograf) ,sipas te cilit qytetariSabahudin Kodra ka kerkuar regjistrimin e kontrates se shitjes me vertetim hipotekor 14 Regj. date 08/03/2019 per pasurne nr.8/2013 vol.5 faqe 42 zk.8542 (truall me sip.1625 m2),vleresojme se konstatimi i grupit te auditimit se Pasuria nr.8/213 krijon pjeserishte mbivendosje me pasurine 8/237 sipas hartes treguse te regjistrimit e azhonuar sipas regjistrimit fillestar date 02/03/2011 . Gjithashtu nga nuk eshte bere ankimi brenda afatit 15ditor ne Gjykaten e Apelit Gjirokaster , vendimi i Gjykates nr.1073 date 06/09/2010 si pale e paditur , me objekt detyrimin e ZVRPP te leshoj certifikaten e pronesise per pasurine e paluajtshme nr. 8/2013 ZK. 8542 , siperfaqe 1625 m2 , regjistruar sipas references nr.02089 aplikim nr.949 date 27/09/2010 . Nuk eshte bere verifikimi nese prona ne fjale rjedhin nga tituj pronesie te pronarit te fundit te saj , te regjistruar me pare ne regjister - nuk qendron, pasi veprimet e kryera jane konform nenit 36 pika 1, neni 37 e vijues i ligjit nr.33/2012 , neni 193 i Kodit Civil, Rregullore e punes nr.184 date 08.04.1999 si dhe UKM nr.2/2012. -Konkretisht, pasuria menr.8/2013 vol.5 faqe 42 zk.8542 (truall me sip.1625 m2)i eshte nenshtruar procesit te regjistrimit fillestar te zk.8542 dhe bazuar ne dispozitat 25 dhe ne vijim te Ligjit nr.33/2012 ''Per Regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme '' sipas vendimit per njohje dhe kompesim me nr.10/4 date 25/04/1996 ne favor te familjes [redacted] , vendimi i rregjistruar ne regjistrin e transkiptimeve me nr.340 date 24/05/1996 nga Ish nenpunesja e hipotekes [redacted]. Referuar nenit 37/2012 (perparesia per regjistrim) percaktohet ligjeshmeria e veprimit te kryer ne favore te trashegimtareve Kodra ne kushtet kur vendimi me nr.

10/4 date 25/04/1996 ne favor te familjes [redacted] , eshte i regjistruar ne regjitrin e trankriptimeve me nr. 340 date 24/05/1996 nderkohe qe Titulli i pronesise ne favor te trashegimtareve [redacted] eshte regjistruar prane ZVRPP Gjirokaster ne vitin 2009. Fakti qe nuk krijohet mbivendosje konfirmohet edhe nga Akti Per [redacted] Pasurie me nr.2306 rep. Nr.878/2 kol. Date 30.08.2012, sipas te cilit [redacted] pranojne te pajisen me Vertetim Pronesie per pasurite respektive 8/237 me sip.736 m2 dhe 8/238 me sip.398 m2 per nje total 1134 m2. Referuar HTR te leshuara per keto pasuri rezulton se nuk krijohet mbivendosje ne ndonje nga pasurite kufitare. Gjithashtu sqaroje se nga ana jone nuk jane kryrer veprime ne HTR.

Sqarimi i grupit të auditimit, observacionet tuaja nuk meren në konsideratë pas: Rast pas rasti sa parashtroni në observimet tuaja, i referoheni se cdo veprim që keni kryer është në përputhje me rregulloren 184, ligjit nr.33/2012 "Per Regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme", UKM nr.2/2012 si dhe neni 193 e vijues te Kodit Civil etj, duke bërë interpretimin e tyre, por në asnjë rast nuk paraqesni të dhëna të reja që të provojnë të kundërtën, pasi në materialin e paraqitur nga grupi i auditimit janë përcaktuar qartë veprimet apo mosveprimet e kryera nga ana juaj dhe dispozita ligjore e cila nuk është respektuar neni, paragrafi gërma, rast pas rasti sipas problematikës së dalë, ku janë kryer dhe ballafaqimet përkatëse, për rastet e mbivendosjeve, ligjshmëria dhe vlefshmëri e akteve të fitimit të pronësisë, verifikimi teknik dhe ligjor rast pas rasti kur kalojnë nga siste mi vjetër në sistemin e ri të regjistrimit të cilat duhet të trajtohen si regjistrim i mirfilltë fillestar, problematika me hartat e punës pozicjoni i objekteve hedhja e tyre me konturet e kuqe jo sipas pizicionit faktit, të meta dhe mangësi që kan erdhur edhe si rezultat i dëmtimit të hartave të punës të cilat nuk janë ribërë, dokumentacion i cili duhet të jetë i plotë orgjinal me të gjithë elementët si në formë dhe në përmbajtje. Tjetërsimi i pasurive shtet të cilat i shërbejnë një interesi publik edhe pse për të cilat nuk ka akte nënligjore nga ministritë e linjës për kalimin në administrim dhe ose përdorim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe jo vetëm. Kryerja e këtyre veorimeve kan impakt të drejtpërdrejtë tek pronarët e ligjshëm apo te grupet e interesit.

8. Auditim mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme, në bazë të nenit 24/b, të ligjit nr. datë "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe nr. 25/b, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme"

Në zbatim të kësaj pike të programit të auditimit nga verifikimi i dokumentacionit, nga përzgjedhja e referncave, të nxjerrë kryesisht nga regjistrimet në KPP, sipas volumeve përkatëse u konstatua se **në 2 raste,** janë regjistruar në kartelat e pasurisë së paluajtshme me të meta e mangësi, të cilat po i trajtojmë më poshtë:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Nga ana e ZVRPP Gjirokastër nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjin nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe VKM nr. 745, datë 12.10.2012 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen."

- Referencë nr. 11600;

Me kerkesë nr. 111, datë 14.01.2016, Janis Arif Late ka kërkuar regjistrimin e pasurisë nr. 24/17, truall me sipërfaqe 2970 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 140 m^2, ZK 8541.

Në KPP volum , faqe , dhe në regjistrim hipotekor nr. 260, datë 22.06.2017, është regjistruar pasuria nr. 24/17, truall me sipërfaqe 2970 m^2 dhe ndërtesë 3 kat me sipërfaqe 140 m^2 në pronësi të lëshuar vërtetim pronësie datë 22.06.2017.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se origjina e pasurisë rrjedh nga nota e transkriptimit pa numër dhe datë, sipas së cilës është regjistruar kontrata e dhurimit datë 23.01.1961, sipas së cilës vellezërit Refik, myrteza dhe Fuat Latja i dhurojnë vëlezërve të tyre Arif dhe Munir Latja

pjesë të një shtëpie të përbërë nga 4 dhoma , divan e nënë divan, qilar, katoq dhe muslluk, me një kopësht të vogël dhe një oborr dhe një haur në oborr, pronësia e dhuruesëve vërtetohet me notë transriptimi nr. 182,. Datë 13.12.1960. Më pas këtë pronë të dhuruar Arif late dhe Munir Late e kanë ndarë ndërmjet tyre, sipas kontratës së pjestimit nr. 58/35, datë 28.07.1962.
Dokumentacioni gjendje në dosjen me referencë 11600, që ka shërbyer për regjistrimin e pasurisë, rezulton si vijon:
- Nota e transkriptimit pa numër dhe datë, sipas së cilës është regjistruar kontrata e dhurimit datë 23.01.1961;
- Kontrata e pjestimit nr. 58/35, datë 28.07.1962, sipas së cilës Arif late dhe Munir Late, kanë në pronësi një shtëpi banimi të ndodhur në lagjen "Mnalat", të përbërë nga 4 dhoma, 1 divan e nëndivan, qilar, katoq dhe muslluk, një haur dhe 2 kasolle bari, të cilën e kanë ndarë ndërmjet tyre;
- Shkresë e Bahkisë Gjirokastër nr. 2982/1, datë 2.07.2007 "Konfirmim dokumentacioni", plan rilevim i hartuar datë 20.03.2004, ku përcakton sipërfaqe ndërtimi 144 m^2 dhe truall me sipërfaqe 3144 m^2; vërtetim nr 27/1 datë 27.01.2003, lëshuar nga Bashkia Gjirokastër, ku konfirmohet se familja e Arif Late, është banore e Lagjes "Manalat";
- Deklaratë personale e Arif Late, që kofirmon kufitarët me të cilët kufizohet prona e tij, konkretisht: Veriu me pronat e [redacted] dhe N. Sinani dhe rrugë automobilistike; Lindja me pronat e [redacted]"
, Perëndimi me pronëën e [redacted] dhe fotokopje e njehsuar nga noteri deklarate e kufitarëve e nënshkruar nga kufitarët Saim [redacted].
- Skica të palnimetrive të kateve të skicuara nga arkitekti [redacted]
- Shkresë nr. 2281, datë 02.12.2016, "Per plotesim dokumentacioni", dërguar nga ZVRPP Gjirokastër, për Jonis Late;
- Shkresë e Bahkisë Gjirokastër nr. 841/1, datë 17.03.2016 "Konfirmim dokumentacioni", ku konfirmohet prona e tarshëgimlënësit [redacted], me kufizimet: nga veriu "rrugë" dhe nga jugu "Përroi i Manalatit", bashkëlidhur shkresës pjesë fragment harte para vitit 1990, mbi të cilin punuar plan rilevim, nga drejtoria e urbanistikës së bashkisë;
- Deklaratë noterale nr. 339/161, datë 09.03.2017, nga pronarët [redacted];
- Deklaratë noterale nr. 165/67, datë 01.02.2017, nga Janis Late trashëgimtar i [redacted], i cili deklaron se kam një pasuri të paluajtshme shtëpi me sipërfaqe ndërtimi 144 m^2 dhe truall me sipërfaqe 3144 m^2, për të cilën nuk zotëroj dokumente pronësie.
- Skica të palnimetrive të kateve të skicuara nga ing. [redacted], të cilat kanë konfigurim të ndryshëm nga skicat e paraqitura nga arkitekti [redacted].
Sa sipër rezulton se aktet në të cilat është bazuar regjsitrimi i kësaj pasurie nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen, për rrjedhojë procedura e regjistrimit i përket zbatimit të procedurës së përcaktuar në germën" b" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".
Sa sipër rezulton se janë konstatuar të meta e mangësi të dokumentacionit tekniko ligjorë, si më poshtë:
-Mungon dokumentacioni nga arkivi teknik i ndërtimit, që pasqyron hartografisht gjendjen e pasurisë që pretendohet, bazuar në germën c pika 4, të VKM nr. 745, datë 12.10.2012 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen";
- Nuk është ngritur grup pune, të përbërë nga të paktën, 2 punonjës hartografë të zyrës së regjistrimit, për të bërë matjet në terren dhe për të hartuar dokumentet përkatëse, siç përcaktuar në pikën 11, të VKM nr. 745, datë 12.10.2012 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen";

- Regjistrimi i pasurisë është kryer në mungesë të vendimit të Regjistruesit, duke mos respektuar përcaktimet ligjore shprehur në pikën 12 dhe pikën 14 të VKM nr. 745, datë 12.10.2012 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen";
- **Regjistrimi i pronësisë për** truallin me sipërfaqe 2970 m^2, duke lëshuar vërtetim pronësie datë 22.06.2017, është në kundërshtim me dispozitat ligjore, duke miratuar një sipërfaqe shumë më të madhe se trefishi i sipërfaqes së ndërtimit të objektit, duke konsideruar si kufi "Përroin e Manalatit", që në fakt nuk mund të konsiderohet si kufi, pasi ka një largësi shumë të madhe nga banesa, ndërsa referuar notës së transkriptimit(që ka shërbyer si dokument pronësie) përcaktohet një bahçe e vogël dhe një oborr, ndërsa kontrata e pjestimit nr. 58/35, datë 28.07.1962, nuk është shprehur për ndarjen e pasurisë truall(oborr, bahçe, etj), për rrjedhojë për truallin e përfituar me sipërfaqe 2970 m^2, mungon dokumenti i pronësisë në kuptim të germës b nenit 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme",

Si përfundim arrijmë në përfundimin se, regjistrimi i pasurisë së paluajtshme ***truall me sipërfaqe 2970 m^2*** duke lëshuar vërtetim pronësie, *është kryer në shkelje të dispoziatve ligjore*, veprim ***në papajtueshmëri me*** germën" b" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", pikat 4, 11, 12, të VKM nr. 745, datë 12.10.2012 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen."

Në shkronjën "b" neni 25, përcaktohet:

Regjistruesi, ose çdo grup i ngarkuar, kërkojnë që pronësia, si dhe kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen në bazë të kritereve të mëposhtëme:

b) individët, familjet dhe personat juridikë, privatë apo shtetërorë, që zotërojnë dokumente pronësie, sipas shkronjës "a" të këtij neni, por nuk kanë të përcaktuar në to sipërfaqen, duhet t'i paraqesin regjistruesit një kërkesë për regjistrim pronësie, e cila duhet të shoqërohet me:
i) dokumentin e pronësisë;
ii) një plan rilevimi të pasurisë, të përgatitur nga një subjekt i licencuar për punime topografike, sipas kërkesës së të interesuarit apo nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
iii) deklaratën noteriale të pronarëve kufitarë, që vërtetojnë përmbajtjen e kërkesës për kufijtë e pasurisë që pretendohet të regjistrohet.

Në germën "a" pika 4, përcaktohet:

4. Regjistrimi i pasurive të paluajtshme, të përcaktuara në këtë vendim, bëhet me kërkesë të personit të interesuar. Ai duhet ta provojë pronësinë me dokumentet e pronësisë në kuptim të nenit 193 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, duke paraqitur tek regjistruesi këto dokumente:
a) aktin e fitimit të pronësisë, në rastet kur pasuria e paluajtshme regjistrohet për herë të parë, ose dokumentin e regjistrimit, në rastet kur pasuria e paluajtshme figuron e regjistruar në regjistrat hipotekorë;

Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuar më sipër ***ngarkohet me përgjegjësi*** M K me detyrë ish Regjistrues, G K me detyrë ish specialist jurist dhe E B me detyrë specialist hartograf

- Referencë nr. 14791;

Me kerkesë nr. 266, datë 01.02.2016, Gjenci Demir Teleku ka kërkuar regjistrimin e pasurisë nr. 11/34, truall me sipërfaqe 252 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 81 m^2, ZK 8542.

Në KPP volum , faqe , dhe në regjistrim hipotekor nr. 110, datë 29.03.2016, është regjistruar pasuria nr. 11//34, truall me sipërfaqe 252 m^2 dhe ndërtesë 2 kat me sipërfaqe 81 m^2 , në pronësi të Gjenci Telekut dhe lëshuar vërtetim pronësie datë 30.03.2016

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se origjina e pasurisë rrjedh nga dokumentacioni gjendje në dosjen me referencë 14791, që ka shërbyer për regjistrimin e pasurisë, rezulton si vijon:

- Vendim gjykate nr. 164 Akti dhe nr. 138 Vendimi, datë 03.03.1966, sipas të cilit vërtetohet fakti juridik për bashkëpronësinë mbi një shtëpi banimi 2 kat me oborr dhe notë transkriptimi nr. 51, datë 01.04.1967;
- Kontrata e dhurimi nr. 396/396, datë 07.03.1994, sipas së cilës Hanide Teleku, ka në pronësi një shtëpi 2 katëshe e cila sëbashku me truallin ka një sipërfaqe 300 m^2, të cilën ja dhuron djalit të saj Gjençi Telekut;
- Shkresë e Bahkisë Gjirokastër nr. 4126/2, datë 08.01.2016 "Konfirmim dokumentacioni", plan rilevim i hartuar datë 10.10.2015, i konfirmuar nga bashkia, ku përcakton sipërfaqe ndërtimi 81 m^2 dhe truall me sipërfaqe 252 m^2; gjithashtu ndodhen edhe 2 plane rilevime të tjera të hartuara nga i njëjti përson, por që nuk përcaktojnë sipërfaqe të njëjtë takuese të truallit, ku rezulton se duke ju referuar konfigurimit të sipërfaqes së truallit, rezulton se kemi një spostim, duke përfituar sipërfaqe nga rruga që kufizon pronën, gjurmë e cila është e dallueshme edhe në HTR provizore.
- Deklaratë noterale, nga pronari i pasurisë që pretendohet dhe nga 1 pronar kufitarë, përkatësisht: nga veriu dhe pjesërisht nga nga lindja(pasuria 11/38), ***nga jugu dhe perëndimi kufizohet me pasurinë nr. 11/38, në pronësi të Shaho Hysa(i cili nuk rezulton të ketë bërë deklaratë)***, ndërsa nga lindja kufizohet me pasurinë rrugë me nr. 11/30, konfirmuar nga Bashkia Gjirokastër.

Sa sipër rezulton se aktet në të cilat është bazuar regjsitrimi i kësaj pasurie nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen, për rrjedhojë procedura e regjistrimit i përket zbatimit të procedurës së përcaktuar në germën" b" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

Sa sipër rezulton se janë konstatuar të meta e mangësi të dokumentacionit tekniko ligjorë, si më poshtë:

-Mungon deklarata e pronarit të pronës nr. 11/38, me të cilën kufizohet nga jugu dhe nga perëndimi,duke mos plotyësuar kërkesat prcaktuar në VKM nr. 745, datë 12.10.2012 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen".

-Mungon dokumentacioni nga arkivi teknik i ndërtimit, që pasqyron hartografisht gjendjen e pasurisë që pretendohet, bazuar në germën c pika 4, të VKM nr. 745, datë 12.10.2012 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen";

- Nuk është ngritur grup pune, të përbërë nga të paktën, 2 punonjës hartografë të zyrës së regjistrimit, për të bërë matjet në terren dhe për të hartuar dokumentet përkatëse, për rrjedhojë nuk kemi një përcaktim të saktë të sipërfaqes takuese të truallit, duke përfituar pjesë nga pasuria "rrugë"(nr. 11/30 kufiri lindor) duke mos plotyësuar kërkesat prcaktuar në pikën 11, të VKM nr. 745, datë 12.10.2012 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen";
- Regjistrimi i pasurisë është kryer në mungesë të vendimit të Regjistruesit, duke mos respektuar përcaktimet ligjore shprehur në pikën 12 dhe pikën 14 të VKM nr. 745, datë 12.10.2012 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen";

Si përfundim arrijmë në përfundimin se, regjistrimi i pasurisë së paluajtshme ***truall me sipërfaqe 252 m^2*** duke lëshuar vërtetim pronësie, *është kryer me shkelje dhe parregullsi*, veprim ***në papajtueshmëri me*** germën" b" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", pikat 4, 11, 12, të VKM nr. 745, datë 12.10.2012 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen."

Në shkronjën "b" neni 25, përcaktohet:

Regjistruesi, ose çdo grup i ngarkuar, kërkojnë që pronësia, si dhe kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen në bazë të kritereve të mëposhtëme:

- Mungon dokumenti zyrtar që vërteton se objekti është ndërtuar para datës 10.08.1991, si kriter bazë për të mundësuar të drejtën e prfitimit të pronësisë nga poseduesi, duke mos përmbushur kërkesat ligjore, sipas germës a, pika 4, germën ç pika 5, të VKM nr. 608, datë 05.09.2012 "Për Përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtëshme, të ndërtuara deri 10.08.1991, e truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre", të ndryshuar
- Dokumentacioni i ndodhur në dosjen me numër refrence 15645, që përmban Vendimin nr. 44 datë 11.08.2016, sëbashku me dokumentacionin shoqërues, të dërguar nga Bashkia Gjirokastër, mbi bazën e të cili është kryer regjistrimi, rezulton se nuk është origjinal por fotokopje.
- Në dokumentacionin e dërguar nga Bashkia Gjirokastër, mungon dokumenti që vërteton shlyerjen e detyrimit financiar, lidhur me shlyerjen e truallit të perfituar, i cili llogaritet **në vlerën 300,000 lekë,** referuar aneksit bashkëlidhur VKM -së nr. 608, datë 05.09.2012, të ndryshuar, veprim në papajtueshmëri me pikën 8, të VKM -së nr. 608, datë 05.09.2012, të ndryshuar.
Lidhur sa trajtuar, konkludojmë që Bashkia Gjirokastër nuk duhet të merrte vendim për kalimin e pronësisë në favor të poseduesit, ndërsa ish ZVRPP Gjirokastër duhet të shqyrtonte hollësisht dokumentacionin e paraqitur dhe të verifikonte elementët e formës dhe përmbajtjes së Aktit administrativ dhe nuk duhet të kryente regjistrimin e këtij akti, veprim ky **në papajtueshmëri** me germën "ç" neni 25, nenin 45, të ligjit nr. 33/2012 "Për Regjistrimin e pasurive të paluajtëshme", VKM nr. 608, datë 05.09.2012 "Për Përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtëshme, të ndërtuara deri 10.08.1991, e truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre", të ndryshuar dhe UKM nr. 2, datë..
Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** O C me detyrë ish specialist jurist.

- Referencë nr. 15772;
Me aplikim nr. 1719, datë 09.05.2017, [redacted] ka kërkauar regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të përfituar me Vendim nr. 8, datë 13.02.2016, lëshuar nga Bashkia Gjirokastër, dhe pajisja me certifikatë pronësie.
Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP sporadik) volum 35, faqe 230 dhe regjistrin hipotekor nr. 290, datë 25.07.2017, është regjistruar pasuria nr. 33/152, truall me sipërfaqe 127 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 100 m^2, datë 08.11.2017, ka kaluar në pronësi të [redacted], duke lëshuar vërtetim pronësie datë 15.11.2017.
Me shkresën nr. 2338, datë 26.04.2017, nga Bashkia Gjirokastër është dërguar dokumentacioni përkatës për regjistrimin e Vendim nr. 8 datë 13.02.2016, lëshuar nga Bashkia Gjirokastër , për transferimin e pasuisë, në favor të [redacted]
Nga kontrolli i dokumentacionit pjesë e kesaj dosje, rezultojnë të meta e parregullsi si vijon:
- Mungon dokumenti zyrtar që vërteton se objekti është ndërtuar para datës 10.08.1991, si kriter bazë për të mundësuar të drejtën e prfitimit të pronësisë nga poseduesi, duke mos përmbushur kërkesat ligjore, sipas germës a, pika 4, germën ç pika 5, të VKM nr. 608, datë 05.09.2012 "Për

Përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtëshme, të ndërtuara deri 10.08.1991, e truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre", të ndryshuar

- Në dokumentacionin e dërguar nga Bashkia Gjirokastër, mungon dokumenti që vërteton shlyerjen e detyrimit financiar, lidhur me shlyerjen e truallit të perfituar, i cili llogaritet **në vlerën 300,000 lekë,** referuar aneksit bashkëlidhur VKM -së nr. 608, datë 05.09.2012, të ndryshuar, veprim në papajtueshmëri me pikën 8, të VKM -së nr. 608, datë 05.09.2012, të ndryshuar.

Regjistrimi është bërë vetën në emët të kryefamiljarit dhe jo të gjithë anëtarët e familjes, sipas certefikatës 01.08.1991, sipas pikës 10, të VKM 608.

Lidhur sa trajtuar, konkludojmë që Bashkia Gjirokastër nuk duhet të merrte vendim për kalimin e pronësisë në favor të poseduesit, ndërsa ish ZVRPP Gjirokastër duhet të shqyrtonte hollësisht dokumentacionin e paraqitur dhe të verifikonte elementët e formës dhe përmbajtjes së Aktit administrativ dhe nuk duhet të kryente regjistrimin e këtij akti, veprim ky **në papajtueshmëri** me germën "ç" neni 25, nenin 45, të ligjit nr. 33/2012 "Për Regjistrimin e pasurive të paluajtëshme", VKM nr. 608, datë 05.09.2012 "Për Përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtëshme, të ndërtuara deri 10.08.1991, e truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre", të ndryshuar dhe UKM nr. 2, datë..

Lidhur sa sipër trajtuar është mbajtur Akt-Konstatimi nr. 20, datë 09.08.2019, si dhe për projekt raportin e auditimit, nuk janë paraqitur observacione nga personat e atakuar të cilësuar si përgjegjës.

ZK 8542

- (Për auditimin e regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituar sipas Vendimit nr. 608, datë 5.9.2012 "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie", etj)

Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit mbi pranimin dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituar sipas *Vendimit nr. 608, datë 5.9.2012 "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie", etj*, rezultoi se pranimi i dokumentacionit dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme është bërë me të meta dhe mangësi si më poshtë:

- Referencë nr. 03377, ZK 8542**;**

Me kërkesë nr. 57, datë 25.01.2017, [redacted] ka kërkuar për tu pajisur me fragment harte, kopje kartele dhe vërtetim pronësie regjistrim kalim pronësie.

Në KPP volum 8, faqe 92, është regjistruar pasuria nr. 24/96, truall me sipërfaqe 200 m^2 objkekt 97.5 m^2, në pronësi të [redacted] miratuar me vendimin nr. 62, datë 10.10.2016.

ZVRPP Gjirokastër ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***Brenda truallit të miratuar e banesës funksionale ndodhet një objekt për të cilin organet përgjegjëse nuk shprehen nëse është objekt i vjetër apo i ndërtuar pa leje***.

Veprime këto në papajtueshmëri me pikën "ç", "e", neni 20, shkronjën "a" neni 25, pikën 1 nenin 29 dhe 30 të Ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" i ndryshuar, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të Udhëzim Këshillit Të Ministrave Nr. 2, Datë 12.09.2012 Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit në kundërshtim me pikën II.i. pikën II.iii. të shkresë nr. 1969 prot, datë 23.03.2012 të ZQRPP "Rregullorja mbi monitorimin e regjistrimit fillestar". ne dokumentin nr. 892 prot. datë 07.02.2008 "Procedurat e Kontrollit të Regjistrimit Fillestar", shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5348 prot., date 18/10/2011 "Skema e rishikuar për kontrollin dhe monitorimin e regjistrimit fillestar", dhe shkresën e

Kryeregjistruesit nr. 5985 prot, date 16/11/2009. Udhëzimi nr. 79, datë 09.05.2003 i ZQRPP "Regjistrimi fillestar sporadic të pasurive të pa lujtshme në zonat urbane". Vendimin nr. 608, datë 5.9.2012 "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre".
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. M K me detyrë ish/Regjistrues dhe z. L B me detyrë ish/hartograf.

- Referencë nr. 03351, ZK 8542**;**
Me kërkesë nr. 1624, datë 02.05.2017, [redacted] ka kërkuar regjistrim kalim pronësie.
Në KPP volum 8, faqe 83, është regjistruar pasuria nr. 7/190, truall me sipërfaqe 300 m^2, volum 8 faqe 84 pasuria nr. 7/117 me sipërfaqe 148 m^2 truall dhe 148 m^2 objekt, në pronësi të [redacted] miratuar me vendimin nr. 79, datë 12.12.2016.
ZVRPP Gjirokastër ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***Është përfituar truall me tepër jashtë objektit funksional, pasi trualli ndahet nga rruaga dhe sipërfaqja e përfituar tepër prej 300 m2 është përtej rrugës dhe nuk lidhët me objektin që të përcaktohet si sipërfaqe funksionale e tij*.**
Veprime këto në papajtueshmëri me pikën "ç", "e", neni 20, shkronjën "a" neni 25, pikën 1 nenin 29 dhe 30 të Ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" i ndryshuar, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të Udhëzim Këshillit Të Ministrave Nr. 2, Datë 12.09.2012 Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit në kundërshtim me pikën II.i. pikën II.iii. të shkresë nr. 1969 prot, datë 23.03.2012 të ZQRPP "Rregullorja mbi monitorimin e regjistrimit fillestar". ne dokumentin nr. 892 prot. datë 07.02.2008 "Procedurat e Kontrollit të Regjistrimit Fillestar", shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5348 prot., date 18/10/2011 "Skema e rishikuar për kontrollin dhe monitorimin e regjistrimit fillestar", dhe shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5985 prot, date 16/11/2009. Udhëzimi nr. 79, datë 09.05.2003 i ZQRPP "Regjistrimi fillestar sporadic të pasurive të pa lujtshme në zonat urbane". Vendimin nr. 608, datë 5.9.2012 "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre".
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. M K me detyrë ish/Regjistrues dhe z. Th C me detyrë hartograf.

- Referencë nr. 03301, ZK 8542**;**
Me kërkesë nr. 2961, datë 30.11.2016, [redacted] ka kërkuar regjistrim kalim pronësie, kopje kartele fragment harte.
Në regjistrin hipotekor numër 103, datë 13.12.2016 është regjistruar pasuria nr. 9/71, me sipërfaqe trualli 500 m^2, objekt 90 m^2, si dhe volum 8 faqe 65 pasuria nr. 9/71 në pronësi të [redacted], miratuar me vendimin nr. 71, datë 09.11.2016.
ZVRPP Gjirokastër ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***Nuk përputhen konfigurimi i gjurmës së truallit dhe objektit sipërfeqes totale të objektit dhe e truallit mes planrilevimit të konfirmuar nga bashkia dhe hartës treguese të regjistrimit***.
Veprime këto në papajtueshmëri me pikën "ç", "e", neni 20, shkronjën "a" neni 25, pikën 1 nenin 29 dhe 30 të Ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" i ndryshuar, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të Udhëzim Këshillit Të Ministrave Nr. 2, Datë 12.09.2012 Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit në kundërshtim me pikën II.i. pikën II.iii. të shkresë nr. 1969 prot, datë 23.03.2012 të ZQRPP "Rregullorja mbi

monitorimin e regjistrimit fillestar". ne dokumentin nr. 892 prot. datë 07.02.2008 "Procedurat e Kontrollit të Regjistrimit Fillestar", shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5348 prot., date 18/10/2011 "Skema e rishikuar për kontrollin dhe monitorimin e regjistrimit fillestar", dhe shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5985 prot, date 16/11/2009. Udhëzimi nr. 79, datë 09.05.2003 i ZQRPP "Regjistrimi fillestar sporadic të pasurive të pa lujtshme në zonat urbane". Vendimin nr. 608, datë 5.9.2012 "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre".
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. M K me detyrë ish/Regjistrues dhe z. Th Cme detyrë hartograf.

- Referencë nr. 03351, ZK 8542**;**
Me kërkesë nr. 2969, datë 01.12.2016, [redacted] ka kërkuar regjistrim kalim pronësie, kopje kartele fragment harte.
Në regjistrin hipotekor numër 100, datë 01.12.2016 është regjistruar pasuria nr. 1/17, me sipërfaqe trualli 454 m^2, objekt 135 m^2, në pronësi të [redacted], miratuar me vendimin nr. 63, datë 11.10.2016.
ZVRPP Gjirokastër ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***Nuk përputhen konfigurimi i gjurmës së truallit dhe objektit sipërfeqes totale të objektit mes planrilevimit të konfirmuar nga bashkia dhe hartës treguese të regjistrimit me një diferencë prej 28 m^2***.
Veprime këto në papajtueshmëri me pikën "ç", "e", neni 20, shkronjën "a" neni 25, pikën 1 nenin 29 dhe 30 të Ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" i ndryshuar, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të Udhëzim Këshillit Të Ministrave Nr. 2, Datë 12.09.2012 Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit në kundërshtim me pikën II.i. pikën II.iii. të shkresë nr. 1969 prot, datë 23.03.2012 të ZQRPP "Rregullorja mbi monitorimin e regjistrimit fillestar". ne dokumentin nr. 892 prot. datë 07.02.2008 "Procedurat e Kontrollit të Regjistrimit Fillestar", shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5348 prot., date 18/10/2011 "Skema e rishikuar për kontrollin dhe monitorimin e regjistrimit fillestar", dhe shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5985 prot, date 16/11/2009. Udhëzimi nr. 79, datë 09.05.2003 i ZQRPP "Regjistrimi fillestar sporadic të pasurive të pa lujtshme në zonat urbane". Vendimin nr. 608, datë 5.9.2012 "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre".
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. M K me detyrë ish/Regjistrues dhe z. Th Cme detyrë hartograf.
- Referencë nr. 03417, ZK 8542**;**
Me kërkesë nr. 2014, datë 23.05.2017, [redacted] ka kërkuar për tu pajisur me fragment harte, kopje kartele dhe vërtetim pronësie, regjistrim kalim pronësie.
Në KPP volum 8, faqe 121, është regjistruar pasuria nr. 23/26, truall me sipërfaqe 500 m2, objekt 100 m2 , në pronësi të [redacted].
ZVRPP Gjirokastër ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***Nuk përputhen gjurma e truallit në planrilevimin e konfirmuar nga bashkia me hartën treguese të regjistrimit.*** Veprime këto në papajtueshmëri me pikën "ç", "e", neni 20, shkronjën "a" neni 25, pikën 1 nenin 29 dhe 30 të Ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" i ndryshuar, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të Udhëzim Këshillit Të Ministrave Nr. 2, Datë 12.09.2012 Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit në kundërshtim me pikën II.i. pikën II.iii. të shkresë nr. 1969 prot, datë 23.03.2012 të ZQRPP "Rregullorja mbi

monitorimin e regjistrimit fillestar". ne dokumentin nr. 892 prot. datë 07.02.2008 "Procedurat e Kontrollit të Regjistrimit Fillestar", shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5348 prot., date 18/10/2011 "Skema e rishikuar për kontrollin dhe monitorimin e regjistrimit fillestar", dhe shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5985 prot, date 16/11/2009. Udhëzimi nr. 79, datë 09.05.2003 i ZQRPP "Regjistrimi fillestar sporadic të pasurive të pa lujtshme në zonat urbane". Vendimin nr. 608, datë 5.9.2012 "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre".
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. F T me detyrë Regjistrues, z. L B me detyrë ish/hartograf.

Lidhur sa trajtuar në faqet 198-201 të Projekt Raportit të Auditimit dhe në Akt-Konstatimin nr. 3, datë 09.08.2019, janë paraqitur observacionet në rrugë elktronike dhe derguar me shkresen 3906. Prot, datë 13.09.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 372/5, datë 16.09.2019, dhe me shkresen 3619. Prot, datë 09.09.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 372/6, datë 25.09.2019(përbledhur nga Drejori F. Taçi), nga *z. F T me detyrë Regjistrues.*
Persa i perket Konstatimit sipas(references nr.03417 zk.8542) :
Lidhur me kerkesen nr.2014 date 23.05.2017, trajtuar nga specialisti jurist G C dhe hartograf L B, sipas te ciles qytetari Ali Duzgo ka kerkuar regjistrimin e Vendimit nr.15 date 23.02.2017 te Bashkise Gjirokaster (perkalimin e pronesiseper pas.23/26 zk.8542 me sip.500 m2 truall dhe ndertese me sip.100 m2 -sipas VKM nr.608/2012) dhe pajisjen me vertetim pronesie ne favor te tij, vleresoj se konstatimi i grupit te auditimit per mosperputhje te gjurmes se truallit te pasqyruar ne harten treguese me plan-rilevimin e konfirmua nga bashkia - nuk qendron, pasi veprimet e kryera jane konform ligjit nr.33/2012, UKM nr.2/2012 si dhe nenit 193 te Kodit Civil. Konkretisht, konfiguracioni hartografik ipasurisenr.23/26 zk.8542 evidentohet sipas plan-rilevimit te konfirmuar nga bashkia ne funksion te procedures se ndjekur sipas VKM nr.608/2012 dhe nga verifikimi rezulton se kjo pasuri eshte pasqyruar ne 2 pjese: 500 m2 truall (brenda te cilit perfshihet ndertesa prej 100 m2) dhe per te cilin eshte bere kalimi i pronesise dhe sip.prej 210 m2 qe eshte ne posedim te qytetaritpor per te cilen qytetari nuk e perfiton. Ne keto kushte, nga ana e specialistit hartograf eshtebere hedhja e gjurmes ne perputhje te plote me konfiguracionin hartografik sipas plan-rilevimit, cka evidentohet lehtesisht sipas planshetes GJ-L-7 (hartes se punes). Sa me lart, vleresoj se trajtimi, regjistrimi i aktit perkates per kalimin e pronesise dhe pasqyrimi i gjurmes ne perputhje te plote me konfiguracionin hartografik sipas plan-rilevimit te konfirmuar nga pushteti vendor- eshte bere konform procedurave te parashikuara nga neni 13 e vijues i ligjit nr.33/2012 "Per Regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme",Rregullore e punes per ZRPP nr.184/1999,UKM nr.2/2012 si dhe neni 193 e vijues te Kodit Civil. Sa me lart, kopje te dokumentacionit perkates e gjeni bashkengjitur.
Sqarimi i grupit të auditimit, observacioni juaj nuk meret në konsideratë pasi: Rast pas rasti sa parashtroni në observimet tuaja, i referoheni se cdo veprim që keni kryer është në përputhje me rregulloren 184, ligjit nr.33/2012 "Per Regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme", UKM nr.2/2012 si dhe neni 193 e vijues te Kodit Civil etj, duke bërë interpretimin e tyre, por në asnjë rast nuk paraqesni të dhëna të reja që të provojnë të kundërtën, pasi në materialin e paraqitur nga grupi i auditimit janë përcaktuar qartë veprimet apo mosveprimet e kryera nga ana juaj dhe dispozita ligjore e cila nuk është respektuar neni, paragrafi gërma, rast pas rasti sipas problematikës së dalë, ku janë kryer dhe ballafaqimet përkatëse, për rastet e mbivendosjeve, ligjshmëria dhe vlefshmëri e akteve të fitimit të pronësisë, verifikimi teknik dhe ligjor rast pas rasti kur kalojnë nga siste mi vjetër në sistemin e ri të regjistrimit të cilat duhet të trajtohen si regjistrim i mirfilltë fillestar, problematika me hartat e punës pozicjoni i objekteve hedhja e tyre me konturet e kuqe jo sipas pizicionit faktit, të meta dhe mangësi që kan erdhur edhe si rezultat i dëmtimit të hartave të punës të cilat nuk janë ribërë, dokumentacion i cili duhet të jetë i plotë orgjinal me të gjithë elementët si në formë dhe në përmbajtje. Tjetërsimi i pasurive shtet të cilat i shërbejnë një interesi publik edhe

pse për të cilat nuk ka akte nënligjore nga ministritë e linjës për kalimin në administrim dhe ose përdorim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe jo vetëm. Kryerja e këtyre veorimeve kan impakt të drejtpërdrejtë tek pronarët e ligjshëm apo te grupet e interesit.

9. Auditim mbi regjistrimin e pasurive me mbivendosje me prona të regjistruara më parë, evidentimi i tyre nga ZVRPP.

Nga auditimi rezultoi që:

- Në lidhje me zbatimin e pikës 9 "Për auditimin mbi regjistrimin e pasurive me mbivendosje me prona të regjistruara më parë, evidentimi i tyre" Grupi i Auditimit ka kërkuar dokumentacionin dhe evidencat përkatëse, por nga ish ZVRPP Gjirokastër nuk ka një evidencë dhe nuk njihet e raportohet gjendja e pasurive të regjistruara me mbivendosje, as nuk raportohet ndjekja e procedurave ligjore për trajtimin e pasurive me mbivendosje si dhe nuk raportohet ecuria e zgjidhjes dhe pjesëmarrja e kësaj zyre në seancat gjyqësore për këto çështje.
Kjo gjendje vazhdon të jetë për periudhën objekt auditimi 01.01.2016 deri 31.05.2019**,** çka nënkupton se mosevindetimi i pasurive me mbivendosje vazhdon që prej oeriuudhave të mëparshme, referuar rekomandimeve të lëna nga KLSH sipas Raportit Përfundimtar të vitit 2016, pra dhe mos marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH sipas të cilave është rekomanduar krijimi i data-base për evidentimin e pasurive me mbivendosje dhe ecurinë e zbatimit të procedurave ligjore në përputhje me kërkesat e Ligjit 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme", Nenit 59 dhe 74
Përcaktimi i pasurive me mbivendosje dhe vendosja e kufizimit në seksionin "E" për të mos kryer veprime deri në zgjidhjen e përfundimtare, vjen në zbatim të pikës 2, 3, neni 37, të ligjit nr. 33, datë 210.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ku përcaktohet "Në rastet kur dokumentet e paraqitura për regjistrim **krijojnë mbivendosje,** me një pasuri të regjistruar më parë, regjistruesi, me urdhër të arsyetuar, refuzon regjistrimin e pasurisë për atë pjesë që krijon mbivendosje, deri në zgjidhjen gjyqësore dhe orienton kërkuesin për zgjidhjen e çështjes në rrugë administrative a gjyqësore".
Ky akt verifikimi mbahet me:
Z Z. F T, me detyrë, Drejtor në Drejtorinë Vendore të ASHK Gjirokastër,
Z. Meleq Krabina, me detyrë, ish Regjistrues i ZVRPP Gjirokastër
Z. F H, me detyrë, ish Regjistrues i ZVRPP Gjirokastër,
Lidhur sa trajtuar në Akt-verifikimi nr. 2, datë 09.08.2019, dhe në Projektraportin e Auditimit, nuk janë paraqitur observacione.

10. Regjistrimi i pasurive Publike të transferuara dhe Administrimi i tyre.

Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit mbi regjistrimin e **pasurive e transferuara, administrimi i tyre, kontratat e qerave dhe/ose shitjeve**, të ndryshuar, u konstatua se pasuritë e paluajtshme, janë ndarë dhe janë regjistruar në kartelat e pasurisë së paluajtshme duke lëshuar certifikata pronësi me të meta e mangësi sipas pasqyrës më poshtë:

Pran ZVRPP Gjirokastër janë aplikuar shtatë kontrata qera për regjistrim, të lidhura ndërmjet: Ish/Komuna Lunxheri (2), Bashkia Gjirokastër (3), Bashkia Libohovë (2). Pasqyra nr. 1 bashkëlidhur projektraportit të auditimit.
Në të gjitha rastet është mbajtur Aktverifikim, ku parashtrohet fakti që qiradhënësit të paraqesin dhe regjistrojnë fillimisht aktet e fitimit të pronësisë (VKM) më pas të vijohet me regjistrimin e këtyre kontratave.
Pavarësisht faktit se pronat objekt qeraje nuk janë të regjistruara në regjistrat e pasurive të pa luajtshme, palët kanë shprehur vullnetin e tyre për lidhjen e mardhënieve kontraktuale.

Observacione të paraqitura në lidhje me aktkonstatimet, projektraportin nr. 3926 prot, datë 13.08.2019 dhe nr. 3201/1 prot, datë 13.09.2019 F T

Konstatimit mbi regjistrimin e kontratave te qerave:
Lidhur me kontratat e qerave ndermjet organeve te pushtetit vendor dhe individeve te ndryshem, theksoj se nga ana e ZVRPP Gjirokaster nuk eshte proceduar me regjistrimin e tyre deri ne plotesimin e dokumentacionit perkates nga ana e pales qiradhenese (VKM, etj), qendrim i cili eshte ne perputhje me kerkesat e nenit 193, 195 e vijues te Kodit Civil si dhe percaktimet ligjore sipas nenit 25 pika"a" e ligjit nr.33/2012.
Sqarimi i grupit të auditimit, observacioni jua argumentohet ligjerish, por ka vend për interpretim nisur nga precedentët e gjykatës së lartë për raste të ngjashme.

ZK 1779;

Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit mbi regjistrimin e **pasurive e transferuara, administrimi i tyre, kontratat e qerave dhe/ose shitjeve**, të ndryshuar, u konstatua se pasuritë e paluajtshme, janë ndarë dhe janë regjistruar në kartelat e pasurisë së paluajtshme duke lëshuar certifikata pronësi me të meta e mangësi sipas pasqyrës më poshtë:

- Referencë nr. 00148/0149/0507ZK 1779;
Me aplikim nr. 384, datë 05.02.2019, subjekti "[redacted]" sha ka kërkuar regjistrimit kontratës së shitjes nr. 490 rep dhe nr. 200/1 kol datë 04.02.2019 pala shitëse MF Drejtoria Drejtimit të Pronës Publike, blerësi shoqëria "[redacted]" sha, me objekt : shitje trualli me sipërfaqe 4933 m^2.
Me shkresën nr. 243 prot, datë 05.02.2019 Bashkia Dropull ka dërguar planrilevimin A pa numër pasurie me sipërfaqe 4933 m^2.
Me shkresën nr. 242 prot, datë 05.02.2019 Bashkia Dropull ka dërguar planrilevimin me numër pasurie 424/1 me sipërfaqe totale 7903 m^2.
Me urdhër të Regjistruesit nr. 14 prot, datë 06.02.2019 është kryer ndarja e pasurisë shtet dhe hapja e kartelës së pasurisë për pasurinë nr. 421/1 volum 6 faqe 8 dhe hapja e dy pasurive nr. 424/2 volum 6 faqe 9 dhe nr. 424/3 volum 6 faqe 10.
Me aplikim nr. 385, datë 05.02.2019, subjekti "[redacted]" sha ka kërkuar regjistrimit kontratës së shitjes nr. 489 rep dhe nr. 199/1 kol datë 04.02.2019 pala shitëse MF Drejtoria Drejtimit të Pronës Publike, blerësi shoqëria "[redacted]" sha, me objekt : shitje trualli me sipërfaqe 4809 m^2.
Me shkresën nr. 243 prot, datë 05.02.2019 Bashkia Dropull ka dërguar planrilevimin B pa numër pasurie me sipërfaqe 4809 m^2.
Me urdhër të Regjistruesit nr. 1 datë 07.01.2019 është korrigjuar harta kadastrale dhe kartelat e pasurisë si më poshtë:
Korrigjimi hartës (26A) ZK 1779, konfiguracioni hartografik i pasurisë nr.424 volum 5 faqe 107 e llojit Përrua në pronësi Shtet, duke pasqyruar pozicionin e ri hartografik në bazë të azhurnimit të bërë nga Bashkia Dropull sipas planit të rilevimit përcjellë me shkresën nr.2373 prot datë 31.12.2018.
Korrigjimi i kartelës për pasurinë nr. 44/11 volum 1 faqe 152 ZK 1779, Rrugë me sipërfaqe 600 m^2 në seksionin B të kartelës duke korrigjuar sipërfaqen e pasurisë nga 600 m^2 në 505 m^2 sipas shkresës së DAMT Gjirokastër dhe planit të rilevimit të përcjellë nga Bashkia Dropull me shkresën nr. 2373 prot, datë 31.12.2018.
Mbyllet kartela e pasurisë nr. 44/11 volum 1 faqe 152 rrugë me sipërfaqe 505 m^2 në pronësi shtet dhe hapjen e dy kartelave të reja sipas shkresës së DAMT Gjirokastër nr. 858/1 prot, datë 02.10.2018 dhe shkresës përcjellë nga Bashkia Dropull nr. 1794 prot, datë 03.10.2018.
Korrigjohet kartela e pasurisë nr. 39/30 volum 1 faqe 132 ZK pronësi Shtet e llojit Rrugë nga 840 m^2 në 410 m^2 sipas gjendjes faktike dhe konfirmuar planrilevimi përcjellë nga Bashkia Dropull me shkresën nr. 1794 prot, datë 03.10.2018.

Hapja e kartelës për pasurinë me nr. 39/58 volum 6 faqe 2 e llojit pa fryt me sipërfaqe 294 m2 sipas DAMT Gjirokastër nr. 1087/1 prot, datë 24.12.2018.
Hapet kartelë e re për pasurinë e re që krijohet nga zhvendosja e shtratit të përroit pasuria nr. 424 sipas planit të rilevimit nga Bashkia Dropull me shkresën nr. 1794 prot, datë...., duke krijuar pasuria nr. 424/1 volum 6 faqe 8 ZK1779, truall 7903 m2 në pronësi Shtet.
Korrigjohet kartela e pasurisë nr. 424 volum 5 faqe 107 ZK1779, përrua me sipërfaqe 32700 m2duke zbritur sipërfaqen e pasurisë nr. 424/1 etj.
- Në kartelat e pasurive të paluajtshme (KPP) volum 6, faqe 16, është regjistruar pasuria nr. 44/26 arë+truall me sipërfaqe 4254 m^2 sipërfaqe total dhe 171 m^2 truall në pronësi "[redacted]" sha pajisur me certifikatë pronësie datë 26.02.2019, pasuri e cila vjen nga volum 5 faqe 249, volum 5 faqe 246, volum 1 faqe 152 e llojit rrugë. Në kartelat e pasurive të pa luajtshme volum 5 faqe 107, është regjistruar pasuria nr. 424 e llojit përrua me sipërfaqe 32700 m^2, sipas referencë 0146 bërë 26272 m^2, seksioni përshkrimi i veçantë urdhri i regjistruesit shkresat përcjellëse DAMT Gjirokastër, Bashkia Gjirokastër, kartela mbyllet shkon volum 5 faqe 246 truall, volum 5 faqe 248- 249 nga shteti tek "[redacted]" sha pajisur me certifikatë pronësie datë 06.02.2019 dhe në vijim volum 6 faqe 16-17.
- ZVRPP Gjirokastër ka ofruar shërbimin e kërkuar duke kryer veprime në regjistrat e pasurive të paluajtshme në kushtet kur: ***Subjektet e interesuara (Bashkia Dropull/ DAMT Gjirokastër) për ndryshimin e kategorisë së resurseve nuk kanë në administrim/përdorim apo pronësi tokën në fjalë. Janë nënshtruar ndryshimi i zërit kadastral nga përrua në truall dhe nga rrugë në truall si dhe zhvendosje e shtratit të përroit në kartela dhe hartën e punës, prona të cilat i shërbejnë interesit publik dhe nuk janë objekt i akteve nënligjore për ndryshimin e kategorive të resurseve të tokës. Nuk ka procedurë ligjore nga Ministria dhe autoritetet e planifikimit përkatës që mbulon veprimtarinë që lidhet me këto kalime apo ndryshime të kategorisë së resursit, ku DAMT bën koordinimin e veprimeve deri në daljen e akteve nënligjore, e cila njofton ZVRPP ku të pasqyrojë ndryshimet në llojin e pasurive, sipas pronarëve ose poseduesve të ligjshëm të tyre***.
Veprime këto në papajtueshmëri me "ç", "e", neni 20, shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar, me pikat I 1, 2, 3, 4 dhe V III të Vendimit nr. 410, datë 27.06.2012 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës" pikat 5.1, kreu VI të Rregullores Nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 "Për punën e zyrës se regjistrimit te pasurive te paluajtshme", (Ndryshimi i gjendjes së përshkrimit të pasurisë)
Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. F T me detyrë Regjistruese, z. S Sh me detyrë jurist dhe z. E I me detyrë hartograf.

Lidhur sa trajtuar në faqet 202-204 të Projekt Raportit të Auditimit dhe në Akt-Konstatimin nr. 24, datë 09.08.2019, janë paraqitur observacionet në rrugë elktronike dhe derguar me shkresen 3906. Prot, datë 13.09.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 372/5, datë 16.09.2019, dhe me shkresen 3619. Prot, datë 09.09.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 372/6, datë 25.09.2019(përbledhur nga Drejori F. Taçi), nga *z. F T me detyrë Regjistruese, z. S Sh me detyrë jurist dhe z. E I*
Persa i perket Konstatimit sipas(references nr.0146, 0148 dhe nr.0149, zk.1779) :
Lidhur me kerkesen nr.5191 date 24.12.2018 dhe nr.5228 date 31.12.2018, trajtuar nga specialisti jurist S Sh dhe hartograf E I, sipas te ciles perfaqesuesi i Bashksie Dropull z.[redacted] ka kerkuar korrigjim te gabimeve ne kartele dhe htr referuar disa pasurive ne pronesi dhe administrim te Bashkise Dropull, vleresoj se konstatimi i grupit te auditimit per mosrespektim te procedures se duhur ligjore si dhe per mungese te tagrave perkatese ligjore ne favor te Bashkise Dropull si dhe DAMT prane Keshillit te Qarlut Gjirokaster- nuk qendron, pasi veprimet e kryera jane konform nenit 20 pika "ç, e", nenit 30, 63 e vijues te ligjit nr.33/2012,Pika 5.1 Kreu VI i Rregullores se punes nr.184/1999, neni 193 i Kodit Civil, VKM nr.121 date 17.02.2011 "Per

menyrat e ushtrimit te funksioneve nga DAMT ne Qarqe dhe ZMMT ne Komuna dhe Bashki" , VKM nr.256 date 02.08.1991 si dhe UKM nr.2/2012per arsyet si me poshte:Referuar dokumentacionit ne arkiv me reference 0146 konstatohet se ne praktiken e regjistrimit jane depozituar:shkresa nr.1794 prot. Date 03.10.2018 e nenshkruar nga Kryetari i Bashkise Dropull sipas se ciles kerkohet korrigjim i te dhenave te pasurive (objekt i kerkeses) ne KPP dhe Htr shoqeruar me plan rilevime te konfirmuara;shkresa nr.858/1 prot. Date 02.10.2018 e nenshkruar nga Drejtori DAMT prane Keshillit te Qarkut Gjirokaster – per konfirmim te zones urbane fshati Gline (ze kadastral truall) dhe miratim zone ku mund te nderhyet ne funksion te zhvillimit urban;
shkresa nr.1794/1 prot. Date 03.10.2018 e nenshkruar nga Kryetari i Bashkise Dropull sipas se ciles vihet ne dispozicion VKM nr.249 date 06.03.2009"Per miratimin e listes perfundimtare te pronave te paluajtshme publike, shteterore qe transferohen ne pronesi ose perdorim te Komunes Dropull i Poshtem";Vendim i Keshillit Kombetar te territorit nr.5 date 29.12.2014;shkreseper plotesim te dhenash nr.2069/1 prot. date 18.12.2018 e nenshkruar nga Kryetari i Bashkise Dropull;Deklarate noteriale nr.1463 rep.640 kol. Date 17.12.2018 noter [redacted] me deklarues subjektin "[redacted]" sh.a.
shkresa nr.2332/1 prot. Date 24.12.2018 e nenshkruar nga Kryetari i Bashkise Dropull sipas se ciles kthehet pergjigje dhe vihen ne dipozicion plan rilevime te konfirmuara;
shkresa nr.2373 prot. Date 31.12.2018 e nenshkruar nga Kryetari i Bashkise Dropull sipas se ciles kthehet pergjigje dhe vihen ne dipozicion plan rilevime te konfirmuara;
Urdher Regjistruesi nr.1 date 07.1.2019 "Per korrigjim te hartes kadastrale dhe karteles se pasurise";
Kopje kartelash pasurie dhe fragmente harte, etj;
Autorizim nr.1861 prot. Date 10.10.2018 nga Bashkia dropull per z.[redacted].
Sa me lart, rezulton se eshte depozituar dokumentacioni i nevojshem dhe mjaftueshem tekniko-ligjor ne funksion te korrigjimit te hartes dhe kartelave te pasurive ne perputhje me percaktimet qe vijne nga neni 25, 30, 63 e vijues i ligjit nr.33/2012: Neni 30 Korrigjimi i hartës kadastrale dhe shtesat e reja Regjistruesi, në çdo kohë me ose pa kërkesën e personave të interesuar, mund:a) të kërkojë që të bëhet një studim/rilevim për çdo pasuri të paluajtshme, për qëllime të këtij ligji, dhe, pasi të ketë njoftuar personat e interesuar, mund të korrigjojë hartën kadastrale si rezultat i studimit/rilevimit të lartpërmendur;të korrigjojë çdo gabim teknik apo material në hartën kadastrale, nëse nuk cenohen interesat e ndonjë personi, duke vënë në dijeni personat e interesuar apo personat që kanë të drejta reale mbi sendin;të udhëzojë përgatitjen e një harte të re kadastrale ose të një pjese të saj, në rast dëmtimi apo humbjeje.ç) të korrigjojë me qëllim përmirësimin e hartës kadastrale.Neni 63 Korrigjimi nga regjistruesi1.Regjistruesi korrigjon gabimet materiale në certifikatë dhe/ose kartelën e pasurisë së paluajtshme, me kërkesë të pronarit, në rastet e mëposhtme:në rastin e gabimeve ose mungesave që nuk prekin interesat e një pronari tjetër;
Gjithashtu, procedura e ndjekur eshte ne zbatim te plote dhe me percaktimet tekniko-ligjore qe vijne nga pika 5.1 Kreu VI i Rregullores se punes nr.184 date 08.04.1999, sipas te cilit parashikohet:"Trasaksione ndryshim kufiri:.....Ne rastin e ndryshimit te kufirit midis pasurive publike dhe private , per shkaqe madhore (shembull:ndryshimi i shtratit te lumit apo perroit), ky ndryshim duhet te kerkohet nga subjekti i interesuar i cili duhet te paraqese:Kerkese per ndryshimin e kufirit;Plan rilevimi;Vertetim i ndrsyhimit te kufirit, ileshuar nga autoritetet e pushtetit lokal ose nga subjekti shteteror ne administrim.
Ne regjistrimin e ketij trasanksioni do te kete ndryshime ne seksionin B, ne fushat per siperfaqen dhe referenca per dokumentat perkatese."Ndryshim i gjendjes se pershkrimit te pasurise:
Ndiqen rregullat....dhe Vendimit nr.256 date 02.08.1991 "Per rregulloren per regjistrimin, ndryshimin dhe kalimin e gjendjes se tokave dhe kadastres".
Ne zbatim te referencave ligjore cituar si me siper, eshteleshuar Urdher Regjistruesi nr.1 date 07.1.2019 "Per korrigjim te hartes kadastrale dhe karteles se pasurise", duke proceduar specialistet me korrigjmet perkatese ne harte dhe kartele pasurie.Me aplikimet nr.384 dhe nr.385 date 05.02.2019 eshte kerkuar regjistrimi i kontrates se shitjes nr.489 rep.199/1 kol. date

04.02.2019 dhe kontrates se shitjes nr.490 rep.200/1 kol. date 04.02.2019 notere Ridvana Ruci, me pale shitese Ministrine e Financave (Dr.Drejtimit Prones Publike)dhe pale blerese shoqerine "[redacted]" sha per siperfaqet prej 4809 m2 dhe 4933 m2, nga verifikimi i elementeve te te cilave (bazuar ne UKM nr.2/2012) rezultoi se ato plotesonin kerkesat ligjore, duke passjelle per rrjedhoje procedimin me regjistrim ne regjistrat kadastrale. Ne keto kushte, proceduar e ndjekur, trajtimi dhe pajisja me dokument pronesie per shoqerine "[redacted]" sha eshte bere konform percaktimeve ligjore sipasnenit 20 pika "ç, e", nenit 30, 63 e vijues te ligjit nr.33/2012, Pika 5.1 Kreu VI i Rregullores se punes nr.184/1999, neni 193 i Kodit Civil, VKM nr.121 date 17.02.2011 "Per menyrat e ushtrimit te funksioneve nga DAMT ne Qarqe dhe ZMMT ne Komuna dhe Bashki" VKM nr.256 date 02.08.1991 si dhe UKM nr.2/2012. Sa me lart, kopje te dokumentacionit e gjeni bashkengjitur.

Ne perfundim te shpjegimeve dhe komenteve te dhena referuar projekt raportitte auditimit te kryer prane ish Zvrpp-Gjirokaster, kerkojqe ato te merren ne konsiderate nga ana juaj, me shpresen se do te vlerësohen si komente të pranueshme dhe të mbështetura me evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme.

Sqarimi i grupit të auditimit, observacioni juaj..... Rast pas rasti sa parashtroni në observimet tuaja, i referoheni se cdo veprim që keni kryer është në përputhje me rregulloren 184, ligjit nr.33/2012 "Per Regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme", UKM nr.2/2012 si dhe neni 193 e vijues te Kodit Civil etj, duke bërë interpretimin e tyre, por në asnjë rast nuk paraqesni të dhëna të reja që të provojnë të kundërtën, pasi në materialin e paraqitur nga grupi i auditimit janë përcaktuar qartë veprimet apo mosveprimet e kryera nga ana juaj dhe dispozita ligjore e cila nuk është respektuar neni, paragrafi gërma, rast pas rasti sipas problematikës së dalë, ku janë kryer dhe ballafaqimet përkatëse, për rastet e mbivendosjeve, ligjshmëria dhe vlefshmëri e akteve të fitimit të pronësisë, verifikimi teknik dhe ligjor rast pas rasti kur kalojnë nga siste mi vjetër në sistemin e ri të regjistrimit të cilat duhet të trajtohen si regjistrim i mirfilltë fillestar, problematika me hartat e punës pozicjoni i objekteve hedhja e tyre me konturet e kuqe jo sipas pizicionit faktit, të meta dhe mangësi që kan erdhur edhe si rezultat i dëmtimit të hartave të punës të cilat nuk janë ribërë, dokumentacion i cili duhet të jetë i plotë orgjinal me të gjithë elementët si në formë dhe në përmbajtje. Tjetërsimi i pasurive shtet të cilat i shërbejnë një interesi publik edhe pse për të cilat nuk ka akte nënligjore nga ministritë e linjës për kalimin në administrim dhe ose përdorim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe jo vetëm. Kryerja e këtyre veorimeve kan impakt të drejtpërdrejtë tek pronarët e ligjshëm apo te grupet e interesit.

<u>11. Auditimi i praktikave në proces dhe shërbimi i ZVRPP ndaj Kërkesave të qytetarëve. Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit dhe indicet e ankesat e administruara në KLSH.</u>

11.I- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kërkuar dhe të ofruar, gjatë kryerjes së auditmit, dokumentacioni i administruar në arkivë, praktikat, referencat dhe Av, rezultoi se nga ana e ZVRPP Lushnje nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 20 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", me kreun V , të ligjit nr. 9154, datë 6.1.1993 "Për Arkivat", ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", pika 7 e Rregullores nr. 184, datë 8.4.1999 "Për Punën në ZVRPP", të ndryshuar, dhe Rregulloren nr. 2079, datë 11.6.2007 "Për arkivimin e dokumenteve tekniko ligjore në ZRPP", në të cilat ndër të tjera përcaktohet:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit si praktikat në proces, në bazë të informacionit dhe dokumentacionit përkatës, nga specialistët dhe nga përgjegjësit e sektorëve përkatës, për praktikat në proces dhe të ardhurat e realizuara, dokumentacioni i administruar në arkivë, praktikat, referencat dhe Av, rezultoi se nga ana e ZVRPP Gjirokastër nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 20 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", ligjin nr. 9154, datë 6.1.1993 "Për Arkivat", ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", pika 7 e Rregullores nr. 184, datë 8.4.1999 "Për Punën në ZVRPP", të

ndryshuar, dhe Rregulloren nr. 2079, datë 11.6.2007 "Për arkivimin e dokumenteve tekniko ligjore në ZRPP", në të cilat ndër të tjera përcaktohet:

Nenin 20 i ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", *Regjistruesi ka këto kompetenca:*
a) drejton dhe organizon veprimtarinë e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për realizimin e funksioneve dhe përmbushjen e detyrave të saj, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi;
ç) të kërkojë me shkrim ose me shkresë zyrtare nga personi i interesuar që, brenda një afati jo më të gjatë se 30 ditë, të paraqesë dokumentet e pronësisë, certifikatat, çdo dokument tjetër apo plan rilevimi, të lidhur me pasurinë e paluajtshme, kontratën e qirasë ose hipotekën në fjalë. Në rast të mosparaqitjes së dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të sipërcituar kërkesa për regjistrim refuzohet;
d) të thërrasë çdo person të interesuar që të paraqitet tek ai ose te ndonjë person tjetër i autorizuar prej tij, për të dhënë informacion ose shpjegim për pasurinë e paluajtshme, kontratën e qirasë ose hipotekën;
dh) t'i propozojë Kryeregjistruesit refuzimin e regjistrimit kur nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në këtë ligj;
e) të administrojë dhe të verifikojë të dhënat e përcaktuara në shkronjat "c", "ç", "d" dhe "dh" të këtij neni;
ë) t'i kërkojë personit, që paraqet një informacion jo të rregullt, që t'ia paguajë zyrës së regjistrimit shpenzimet që ajo ka kryer në procesin e verifikimit të këtij informacioni jo të rregullt.
Pika 7 –Arkiva, e Rregullores nr. 184, datë 8.4.1999 "Për Punën në ZVRPP", të ndryshuar,
7.1. Arshivon dokumentat e pershkruara ne piken 4: (4/2, 4/3, 4/4, 4/6, 4/7, 4/9,4/11),
7.3. Pas perfundimit te te gjitha procedurave te regjistrimit dhe nenshkrimit te Aplikimit nga Regjistruesi, dokumentin dhe dy kopjet e Aplikimit i pranon per arkivim. Ploteson kuadratin "Arkivimi Manual" te Aplikimit dhe vendos ne zarfin perkates dokumentin bashke me kopjen e pare te Aplikimit. Kopja e dyte i jepet Aplikantit.
7.4. I pergjigjet me dokumentacionin e nevojshem punonjesve te ZRPP sipas kerkesave paraprake te bera prej tyre. Cdo levizje ditore e dokumentave apo hartave jashte arshives regjistrohet ne "Regjistrin e veprimeve ditore te dokumentave te arkivit", etj…..

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me auditimin e gjendjes, evidentimit nga ZVRPP dhe ecurinë e regjistrimit të pasurive që lidhen me aplikimet e qytetarëve por që nuk kanë marrë zgjidhje dhe të mbetura në proces, për vitet para 2016, 2017, 2018 deri në datë 31.05.2019, sipas pikës nr. 11, të programit të auditimit.
1. Nuk ka një rregullore të brendshme të Funksionimit të Administratës së ZVRPP Gjirokastër, të miratuar nga Kryeregjistruesi për periudhën e mëparshme dhe atë objekt auditimi të bazuar në organikat dhe organigramat dërguar nga Kryemisistri me urdhrat përkatës dhe Urdhrave nr. 58, datë 23.04.2009, nr. 33, datë 02.04.2014 "Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Sistemit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme". (megjithëse ish ZVRPP Gjirokastër, ka hartuar një rregullore të brendëshme, të cilën e ka dërguar për miratim në ish ZQRPP Tiranë, me shkresën nr. por që nuk ka marrë përgjigje për miratimin e saj.
Rregullorja aktuale nr. 184, datë 8.4.1999 "Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", përveç se është një rregullore tekniko ligjore e cila është ende ajo e viteve 1999, e shoqëruar me ndryshime të pjesshme, nuk ka si objekt funksionimin e Administratës së ish ZVRPP, si njësi e vetme në territorin vendor dhe në kushtet e reja të përditësimit dhe zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".
Për pasojë nuk ka një përcaktim të kryerjes së detyrave, lidhur me ushtrimin e kompetencave dhe mbajtjes së përgjegjësive të secilit specialist sipas sektoreve, Drejtor(ish Regjistrues), zv.

Regjistruesit, lidhur me përgatitjen e evidencave, informacionit në tërësi si dhe sidomos lidhur administrimin e dokumentacionit me trajtimin dhe ndjekjen e ankesave kërkesave të qytetarëve për mënyrën e marrjes së shërbimit të ofruar qytetarëve nga kjo zyrë, lidhur me vjeljen e opinionit të tyre për cilësinë afatin e shërbimit dhe sidomos lidhur me evidentimin, raportimin e praktikave në proces, evidentimin e afateve të zgjidhjes së tyre, nxjerrjen e përgjegjësisë së zgjatjes dhe shkeljes së afateve, evidentimin dhe ndjekjen periodike të zgjidhjes së pronave të regjistruara me mbivendosje, trajtimin dhe përgjigjen e ankesave etj. , pra mungon **Sistemi i Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm** (SMKB), në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", gjendje kjo e pandryshuar, pasi është evidentuar edhe në auditimin e mëparshëm.

1. *Mbi administrimin e administrimin* dhe qarkullimin e *dokumentacionit.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kërkuar dhe të ofruar, gjatë kryerjes së auditmit, dokumentacioni i administruar në arkivë, praktikat, referencat dhe Av, rezultoi se nga ana e ZVRPP Gjirokastër, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 20 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", me kreun V , të ligjit nr. 9154, datë 6.1.1993 "Për Arkivat", ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", pika 7 e Rregullores nr. 184, datë 8.4.1999 "Për Punën në ZVRPP", të ndryshuar, dhe Rregulloren nr. 2079, datë 11.6.2007 "Për arkivimin e dokumenteve tekniko ligjore në ZRPP".

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se:

Adninistrimi i dokumetacionit në ZVRPP Gjirokastër, ndërvite, nuk ka plotësuar kërkesat dhe standardet e pracaktuara, pasi nga lëvizjet e shpeshta të punonjësve nga njëri sektor në tjetrin, si dhe largimet nga puna, nuk shoqërohet me dorëzimin e praktikave që ka në përpunim dhe librit Model 4, për të cilat duhet mbahet procesverbali i dorëzimit ku të pasqyrohen të gjithë dokumentet që ka dorëzuar personi që largohet nga vendi i punës, sipas përcaktimeve në Rregulloren nr. 2079, datë 11.06.2007 "Qarkullimi dhe shfrytëzimi i dokumenteve tekniko ligjor në ZRPP".

Gjendja e krijuar, për shkakt të administrimit jo në përputhje me rregullat dhe standardet e përcaktuara, rezulton se gjatë kruerjes së auditimit, u konstatua se mungonin një numër i konsiderueshëm referncash, pasi rezultonin të parkivuara dhe nuk gjendeshin as në ambjentet e punës, në sektorët përkatës. Referencat e munguara paraqiten sipas tabelës së më poshtëme:

Tabela e referencave që mungojnë.

Z K	Referencat që mungojnë në arkivën e ZVRPP Tiranë	Sasia (Copë)
ZK nr. 8541	Në total mungojnë 1318 refernca , ku 780 referenca janë marrë nga Kompania [redacted], të përdorura për urdhëra kufizimi, ndërsa 610 referenca në mungesë.	1318
ZK nr. 8542	Në total mungojnë 561 refernca , ku 380 referenca janë marrë nga Kompania "[redacted], të përdorura për urdhëra kufizimi, ndërsa 181 referenca në mungesë.	561
ZK nr. 8543	Në total mungojnë 651 refernca , ku 458 referenca janë marrë nga Kompania "[redacted], të përdorura për urdhëra kufizimi, ndërsa 193 referenca në mungesë.	651
TOTALI I REFERENCAVE TË MUNGUARA		**2530**

Shënim: Ky informacion është marrë nga procesverbalet e mbajtura me datë 01.12.2017. nga specialistja e arkivës** A G**, gjatë procesit të skanimit, me grupin e skanuesëve të autorizuar nga Kryeregjistruesi.

Numëri i ivedencave të munguara ndër vite, duhet të jetë akoma më i madh, pasi nga ish ZVRPP Gjirokastër nuk ka një evidencë të saktë lidhur me referencat e munguara.

Gjithashtu konstatohet se nuk janë mbajtuar apo përditësuar aktet ligjore të detyrueshme për veprimtarinë e ZVRPP, konkretisht:
-Libri i Inventarit të Regjistrave të Hipotekës
-Regjistri Inventar i Fondeve (Model 14)
-Regjistri i Shfrytezimit (Model 15)
-Formularet "A", të Inventarit të Dokumentave të Transkriptimeve
-Formularet "B",të Inventarit të Dokumentave të Inskriptimeve, Notimeve, Bashkengjitjeve
-Formulari i Referencave të Sistemit
-Formulari "Elementet e Kapakut të Dosjes" (Model 6)
-Formulari "Inventari i Brendshëm i Dosjes" (Model 8)
-Inventari i Librit të Hipotekës.
Lidhur me refeërencat e munguara, ato i përkasin kryesisht periudhës para dhe deri në vitin 2017.
Konstatojmë se gjatë viti 2018 e më pas, ka një reflektim ndryshe lidhur me administrimin dhe trajtimin e dokumentacionit, dhe arkivimin e tij, por mbetet akoma për të bërë, lidhur me trajtimin dhe administrimin e dokumentacionit, në përputhje kërkesat ligjore.

Për veprimet dhe mosveprimet si më sipër që vijnë në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, datë 21.03.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat", Rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 "Për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme" me ndryshime dhe Rregulloren e ZQRPP nr. 2079, datë 11.06.2007 "Për arkivimin e dokumenteve tekniko–ligjore në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme" mbajnë përgjegjësi Ish regjistruesit, ***sipas periudhave që kanë ushtruar funksionin e regjistruesit dhe administratorët e Kompanisë [redacted], konkretisht:***
Z. Dhimitër Kristidhi, me detyrë, ish Regjistrues i ZVRPP Gjirokastër, deri prill 2013;
Z. Klodian Micka, me detyrë, ish Regjistrues i ZVRPP Gjirokastër, periudha 29.09.2016 deri 15.09..2017;
Z. M K, me detyrë, ish Regjistrues i ZVRPP Gjirokastër, periudha 29.09.2016 deri 15.09..2017;
Z. F H, me detyrë, ish Regjistrues i ZVRPP Gjirokastër, periudha viti 10.11.2014 deri 14.07.2016;
- Përfaqësuesit e kompanisë [redacted]

2- Nga Regjistruesit marrës në dorëzim dhe dorëzues të detyrës nuk rezulton të ketë dhe nuk u paraqitën akt-dorëzimet apo procesverbalet e marrjes në dorëzim dhe dorëzimin e detyrës nga secili Regjistrues-dorëzues dhe regjistrues-marrës detyre, përgjegjës zonash-sektorësh e specialist, nuk evidentohen.
Theksojmë se mos dorëzimi dhe mosmarrja e detyrës me procesverbal si dhe lëvizjet mjaft të shpeshta të punonjësve, evidente kjo për ZVRPP Gjirokastër ka sjellë mjaft probleme si vonesa në kthimin e përgjigjeve, humbjen e dokumentacionit dhe mosarkivimin e tyre, aq më tepër kur kemi të bëjmë dokumentacion pronësie, gjendje kjo ***në kundërshtim me legjislacionin për periudhën e mëparshme dhe me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe me udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011"Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik***".
Përgatitja, ndjekja, dhe raportimi i evidencave përmendur më sipër, në një masë të konsiderueshme shprehin performancën e punës së secilit punonjësi por mbi të gjitha performancën e shërbimit të kësaj zyre ndaj qytetarëve duke rritur dhe transparencën e kësaj zyre shtetërore për cilësinë e shërbimit dhënë ndaj publikut.

2. ***Mbi administrimin e kërkesave dhe aplikimeve të qytetarëve për të cilat është paguar shërbimi por që nuk është marrë***.

Ka munguar, nuk është vendosur e nuk funksionon i shprehur në rregullore detyrimi ndaj zonave-sektorëve dhe ndaj punonjësve përkatës të IT, detyrimi i shërbimit të krijimit të Data-base, për evidentimin e referencave të regjistrimit, aplikimet dhe paraqitjen e dokumentimin e kërkesave të qytetarëve, aplikimeve dhe administrimin e praktikave me aktverifikim..

Nga auditimi rezultoi se, nuk disponohej ndonjë procesverbal, për dorëzimin e marrjen në dorëzim të dokumentacionit dhe praktikave në proces me inventarin përkatës, prej sejcilit specialist të larguar, veprim ky ***në kundërshtim*** *me ligjin nr. 9154, datë 6.1.1993 "Për Arkivat", dhe për shkeljen e afatit 1 mujor të KPA, me Urdhrat e regjistruesit, dhe me rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 "Për Punën në ZVRPP", të ndryshuar, dhe me Rregulloren nr. 2079, datë 11.6.2007 "Për arkivimin e dokumenteve tekniko ligjore ne ZRPP"*, dhe që ngarkon me përgjegjësi **Regjistruesit sipas viteve, si dhe përgjegjësit e specialistët,** të cilët nuk kanë disponuar dhe hartuar në kohë procesverbalet e marrjes në dorëzim të praktikave në proces.

Sipas informacionit të kërkuar nga grupi i auditimit të KLSH-së dhe sipas raportimeve të sektorëve dhe arkivës së ZVRPP-së Gjirokastër, gjendja e praktikave në proces për vitet para dhe 2015, 2016, 2017 deri 012.07.2018 paraqitet sipas tabelës së mëposhtëme:

Muaji	Para/deri viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Deri 31.05.2019	Totali
Janar		20	15	23+18	15	91
Shkurt		14	16	20+25	20	95
Mars		18	26	28+28	18	118
Prill		23	28	24+23	77	175
Maj		17	38	12+17+24	34	142
Qershor		27	58	18		103
Korrik		18	35	29		82
Gusht		21	16+38	25		100
Shtator		29	14	33		76
Tetor		28	18	33		79
Nentor		25	33	16		74
Dhjetor	3200	31	40	30		101
Totali	3200	271	375	**416**	**164**	**1236**

Në total gjendja e praktikave të prapambetura të pa trajtuara ndër vite, deri në vitin 2016 ka rezultuar rreth 3200 copë, ndërsa ZVRPP Gjirokastër i ka kushtuar një rëndësi të veçantë riaktivizimit të trajtimit të praktikave të prapambetura dhe deri në fund të vitit 2018, janë trajtuar përfundimisht rreth 2750 prtaktika, ndërsa mbeten për trajtim edhe 350, deri në përfundimin e plotë.

Të ardhurat e vjela nga aplikimet e qytetarëve dhe duke mbetur praktikat pa zgjidhur dhe në proces, janë të ardhura të arkëtuara të pamerituara sa kohë që shërbimi-produkt nuk është kryer nga kjo zyrë ndërsa qytetari ka paguar duke mos marrë produktin- shërbimin e kërkuar.

Nuk është rregulluar me urdhër të titullarit apo rregullore çelja e llogarisë "Kreditorë për shërbime të pa kryera dhe në proces", ku të evidentoheshin këto të ardhura të marra nga qytetarët për shërbime të pa kryera, si dhe nuk janë arkivuar praktikat në arkiv, e duke mos i lënë në duar të punonjësve me afate nga 1 e më shumë vite, **në kundërshtim me** afatin e Kodit të Procedurave Administrative (KPA).

Dorëzimi dhe arkivimi në arkiv i praktikave në proces menjëherë pas kryerjes së aktverifikimit nga punonjësi përpunues dhe dërgimit apo njoftimit të qytetarit, rast pas rasti, bashkë me njoftimin ti bëhet e ditur qytetarit se kjo zyrë është kreditore ndaj tij për shumën e paguar dhe shërbimin e pakryer e lënë në proces si dhe dokumentacioni i tij ndodhet i arkivuar pranë ZVRPP.

Mangësitë e mësipërme në disa raste kanë ardhur edhe për shkak të mosdorëzimit dhe marrjes së detyrës me procesverbal në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27/12/2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 13 ku citohet se *"Punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast se largohen ose transferohen nga puna, bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit të përcaktuar nga Nëpunësi Autorizues i njësisë respektive sipas specifikave të aktiveve"*.

Për veprimet dhe mos veprimet lidhur me mosdorëzimin dhe administrimin në arkivë të dokumentacionit të praktikave në proces të papërfunduara, që vjen në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 6.1.1993 "Për Arkivat", me rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 "Për Punën në ZVRPP", të ndryshuar, ***me Rregulloren nr. 2079, datë 11.6.2007 "Për arkivimin e dokumenteve tekniko ligjore ne ZRPP"***, dhe për shkeljen e afatit 1 mujor të KPA, të trajtimit të kërkesave të qytetarëve dhe enteve publike, trajtimin me vonese dhe mostrajtimin për periudhën objekt auditimi të mbi ***1236 aplikimeve*** të paguara, duke mos e marr shërbimin e parapaguar, që ka sjellë si pasojë uljen e transparencës së punës së Zvrpp Gjirokastër.

Mbajnë përgjegjësi Ish regjistruesit, ***sipas periudhave që kanë ushtruar funksionin e regjistruesit , konkretisht:***

Z. M K, me detyrë, ish Regjistrues i ZVRPP Gjirokastër, periudha 29.09.2016 deri 15.09..2017;

Z. F H, me detyrë, ish Regjistrues i ZVRPP Gjirokastër, periudha viti 10.11.2014 deri 14.07.2016;

Z. B B, me detyrë, specialist jurist, periudha ...

Z. F T, me detyrë, Drejtor i Drejtorisë Vendore të ASHK Gjirokastër, periudha nga 18.01.2018 e në vazhdim

Lidhur sa trajtuar në Akt-Konstatimi nr. 23, datë 09.08.2019, nuk janë paraqitur observacione në fazën e hartimit të projekt raportit të auditimit.

Lidhur sa trajtuar në faqet 204-209 të Projekt Raportit të Auditimit dhe në Akt-Konstatimin nr. 23, datë 09.08.2019, janë paraqitur observacionet në rrugë elktronike dhe derguar me shkresen 3202/1. Prot, datë 13.09.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 372/5, datë 16.09.2019, dhe me shkresen 3619. Prot, datë 09.09.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 372/6, datë 25.09.2019(përbledhur nga Drejori F. T), nga z. F T, me detyrë drejtor, ku sqarohet:

Lidhur me konstatimet që i përkasin pikës 1 (me objekt mbi administrimin dhe qarkullimin e dokumentacionit) sqaroj se ne momentin qe jane bere largim nga detyra te specialisteve te ndryshem, ***specialistet perkates jane larguar ne menyre arbitrare, pa pranuar te pergatisin dhe te dorezojne procesverbalin mbi dorezimin e detyres dhe dokumentacionin.*** *Ne keto kushte nga ana e Zyres nuk eshte leshuar fleteshkeputja respektive apo reference ne rastet e kerkuara.*

*Gjithashtu prej periudhes Tetor 2017 e ne vazhdim(akoma ne proces****), arkiva i eshte nenshtruar procesit te inventarizimit te dokumentacionit.*** *Qe prej kesaj periudhe eshte zbatuar procedura ligjore përkatëse..... .*

Per sa i perket lenies dhe marjes ne dorezim te detyres nga Regjistrues apo Pergjegjes Zonash-Sektoresh te meparshem nuk eshte lene procesverbal dorezimi i detyres.Ne keto kushte, pergjegjesia eshte individuale e atyre personave.

Lidhur me piken 2 (mbi administrimin e kerkesave dhe aplikimeve te qytetareve per te cilet eshte paguar sherbimi por qe nuk eshte marre) theksojse ***praktikat qe ju keni pasqyruar ne akt-konstatimin Nr.23 sipas te dhenave ne tabele per vitet 2016-2019 jane praktika te trajtuara me Akt Verifikimi*** *(me problematika te evidentuara ose per plotesim dokumentacioni)****nga specialistetdhe jo praktika me prapambetje ne shqyrtim.***

Ne total, 3200 praktika te prapambetura te konstatuara sipas Raportit te KLSH ne vitin 2016, jane ezauruar ne masen prej 2750 praktika gjate periudhes 26.09.2017 deri me sot, duke theksuar

*se mbeten ne proces trajtimi **350 praktika,** cka deshmon seriozitet dhe perkushtim ne punen e ZVRPP-se gjate kesaj kohe.*

Sqarimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me observacionet e paraqitur, të sipërcituar, merret në konsideratë përsa i përket trajtimit të praktikave të prambetura ndër vite, duke e reduktuar në 350 praktika, por gjithsesi të gjithë konstatimet tona qëndrojnë, përgjegjësia e preoblemeve të konstatuar është individuale për çdo person sipas periushës së ushtrimit të detyrës, gjë të cilën ne ekmi shprehur edhe në akt konstatimin përkatës.

12. Të ndryshme dhe trajtimi i indiceve të ardhura nga qytetarë në KLSH

Në zbatim të kësaj pike të programit të auditimit, gjatë periudhës së auditimit në subjekt, nuk na është vënë në dispozicion asnjë rast lidhur me ankesa të bëra nga qytetarë të ndryshëm, për rrjedhojë nuk është mbajtur asnjë akt nga grupi i auditimit.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1-Gjetje: ZVRPP Gjirokastër, nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e dërguara nga KLSH në auditimin e mëparshëm, pa dhënë argumente ligjorë apo paraqitur prova e dokumente që justifikojnë mosveprimin. Zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së, do të ndikonte direkt në rritjen e mirëmenaxhimit të njësisë publike dhe mangësitë e evidentuara do të ishin minimizuar nga punonjësit e administratës së këtij institucioni. Gjithashtu në disa raste janë hequr kufizimet e vendosura më parë, sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH, me argumentimin se janë plotësuar kushtet për të cilat janë kufizuar, rezulton se nuk është njoftuar KLSH-ja, për heqjen e këtyre kufizimeve *(Trajtuar në faqet 13-29, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 1: DVASHK(ish ZVRPP) Gjirokastër, të marrë masa për rivlerësimin e rekomandimeve të pazbatuara dhe në proces, të dërguara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën nr. 1102/11, dt. 13.05.2016, përkatësisht rekomandimet: nr. 1, nr. 2, nr. 6, nr. 7, nr. 9, nr. 11, nr. 13, nr. 14, nr. 15, nr. 17, nr. 18, nr. 19, nr. 20, nr. 21, nr. 22, nr. 23, nr. 24, nr. 25, nr. 26, nr. 27, nr. 28, nr. 30, nr. 31,nr. 32, nr. 33, nr. 35, nr. 39, nr 41, nr. 43, nr. 46, nr. 47, nr. 49, nr. 52, nr. 54, nr. 61, nr. 62, nr. 66, nr. 67, si dhe "tek masa për shpërblim dëmi", përkatësisht rekomandimet: nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 7, nr. 8, nr. 9, nr. 10, nr. 11, nr. 12 dhe nr. 13, të hartojë program masash për zbatimin e plotë të rekomandimeve të evidentuara si të pazbatuara e më proces **dhe të njoftojë KLSH-në për çdo rast të plotësimit të dokumentacionit të munguar, apo parregullsive të konstatuara, sipas rekomandimeve të lëna.**

Menjëherë

2-Gjetje: DVASHK**(**Ish ZVRPP) Gjirokastër në **1 rast**, me referencë nr. 15141, ZK 8541, ka kryer veprime dhe ka ofruar shërbimin e kërkuar, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi* dokumentacioni i origjinës së fitimit të pronësisë(Vendimi i KKKP Gjirokastër nr. 151, datë 22.09.2000), ***nuk është origjinal, por fotokopje i panoterizuar*** dhe i pa konfirmuar nga institucioni që e ka lëshuar aktin administrativ (ATP) sa vepruar në ***papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" dhe dhe Regulloren nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar *(Trajtuar në faqet 29-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 2: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 65/1, volum 29, faqe 67, ZK 8541, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Brenda muajit Dhjetor 2019

3-Gjetje: DVASHK**(**Ish ZVRPP) Gjirokastër në **1 rast**, me referencë nr. 11569 dhe 15790, ZK 8541, ka kryer veprime dhe ka ofruar shërbimin e kërkuar, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore,* ***pasi dokumentacioni i fitimit të pronësisë, Vendimi i KKKP-së nuk ka përcaktuar njohje dhe kthim të truallit, por është shprehur vetëm për objektin shtëpi, ndërsa nga punonjësit e ZVRPP janë kryer veprime të lëshuar vërtetim pronësie, sa*** vepruar në ***papajtueshmëri me*** shkronjën "a", neni 25 të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", UKM nr.2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit", Regulloren nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar *(Trajtuar në faqet 39-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandim 3: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 13/137, volum 35, faqe 136, ZK 8541, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Brenda muajit Dhjetor 2019

4-Gjetje: Ish ZVRPP Gjirokastër në 7 **raste** sipas referencave: nr. 085, nr. 089 e nr. 090, nr. 091, ZK 1640; nr. 0218, ZK 2030; nr. 0218, nr. 0155, nr. 0169, nr. 0178 dhe nr. 0161, ZK 3580, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme truall+ndërtesë në zonat urbane të fshatrave, nga të cilat ***në 2 raste,*** *janë regjistruar për të njëjtën familje 2 e më shumë pasuri truall dhe ndërtesë, duke mos zbatuar kërkesat ligjore,* pasi ***dokumenti ligjor "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", nuk plotëson kushtet për të shërbyer si Titull Pronësie, ndërsa është regjistruar në total*** trualli me sipërfaqe ***2400 m²*** dhe ndërtesa me sipërfaqe totale ***1017m²,*** sa vepruar **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25 të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", VKM nr. 432, datë 14.08.1995"Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", i shfuqizuar dhe Urdhrin e Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2013 *(Trajtuar në faqet 31-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandim 4: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për në **7 rastet e sipërcituara dhe në të gjitha rastet e ngjashme**, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Dhjetor 2019

5-Gjetje: Ish ZVRPP Gjirokastër sipas referencës nr. 167, ZK 3580, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme për poseduesit e AMTP-së nr. 825, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore,* pasi është regjistruar një sipërfaqe toke në total prej ***1730 m²,*** më tepër se sipërfaqja takuese sipas AMTP-së përkatëse, sa vepruar **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25 dhe pikën 2 neni 45, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP) *(Trajtuar në faqet 31-77, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandim 5: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën"**, bazuar në**

shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara sipas AMTP-së nr.825, referencë nr/ 0167, ZK 3580, deri në veçimin e regjistrimin në pronësi "shtet", të sipërfaqes së përfituar padrejtësisht, në zbatim të procedurave të përcaktuara në VKM nr. 994, datë 9.12.2015 i ndryshuar.

Brenda muajit Dhjetor 2019

6-Gjetje: Ish ZVRPP Gjirokastër në **3 raste**, sipas referencave: nr.085, nr.089, 09, ZK 1640 dhe nr. 0155, ZK 3580, ka regjistruar pasuri të paluajtshme dhe ka kryer transaksione, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore,* pasi për një trung familjar janë lëshuar 2 e më shumë AMTP, duke shkelur kriterin e ndarjes së tokës sipas normës për frymë të çdo fshati, dhe ndarë tokë në mënyrë të pa barabartë, për rrjedhojë nga regjistrimi i tyre ***kanë përfituar më tepër në total tokë me sipërfaqe 27700 m²,*** se sipërfaqja takuese sipas normës për frymë, bazuar në përbërjen familjare me datë 01.08.1991, sa vepruar **në papajtueshmëri** me pikën 2 neni 3, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" dhe në pikën 2, të VKM-së nr. 255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës", e ndryshuar, përsa i përket regjistrimit të pasurive tokë bujqësore të ndara me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar *(Trajtuar në faqet 31-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 6: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë në **3 rastet e sipërcituara** deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM nr.994, datë 9.12.2015, si dhe të dërgojë AMTP-të përkatëse, për vlerësim dhe shqyrtim ligjor nga institucionet përkatëse kompetente.

Brenda muajit Dhjetor 2019

7-Gjetje: Ish ZVRPP Gjirokastër në **1 rast**, ka regjistruar pasuri të paluajtshme dhe ka kryer transaksione, *në favor* të poseduesit të AMTP-së me referencë nr. 11577, zk 8541, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi rezulton se* AMTP-së nr. 7482, datë 24.05.1996, me posedues [redacted], ***i mungon njëra nga vulat, që është një ndër elementët bazë që duhet të plotësojë ky akt,*** ndërsa ZVRPP Gjirokastër, nuk duhet të procedonte me kryerjen e veprimeve duke lëshuar dokument pronësie, por duhet ti drejtohej KVVTP pranë Prefekturës së Qarkut Gjirokastër, për të konfirmuar vlefshmërinë ligjore të AMT-së, veprim **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", UKM Nr.2, datë 13.06.2013 "Për Mënyrën e Procedimit të organeve të administratës publike për pasuritë e paluajtshme, të fituara me aktin e marrjes së tokës në pronësi (amtp)", pikën 2.2, germa ç, të UKM Nr. 994, datë 9.12.2015 *(Trajtuar në faqet 31-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 7: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë e përfituara me AMTP nr.7482, datë 24.05.1996, me posedues [redacted], ZK 8541, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe zbatimin e procedurave sipas VKM nr.994, datë 9.12.2015.

Brenda muajit Dhjetor 2019

8-Gjetje: Ish ZVRPP Gjirokastër nuk ka krijuar një bashkëpunim të plotë dhe komunikim të vazhdueshëm ndërmjet ZVRPP dhe Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Prefekti Qarkut Gjirokastër, për rrjedhojë nuk ka informacion të plotë, lidhur me procedurën e ndjekur për shqyrtimin e vlerësimin e ligjshmërisë së AMTP-ve, deri në përfundim të procesit. Gjithashtu *nuk është vendosur masë kufizimi në asnjë rast, për pasuritë e regjistruara me amtp, për të cilat vendimet shprehen për gjendjen në proces shqyrtimi, deri në marrjen e formës së prerë të vendimeve gjyqësore dhe për ato që* KVVTP Prefekti Qarkut ka dërguar në

ZVRPP Gjirokastër, *pra nuk është vendosur kufizim në KPP, apo shënim i veçantë(seksionin seksionin përkatës)**,** gjatë fillimit dhe zbatimit të procedurave të shqyrtimit të verifikimit, veprime këto **në kundërshtim me** ligjin nr.* ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", neni 74 dhe nenet 45, 59 neni 60, me vetë Vendimet e Gjykatave dhe në kundërshtim me Ligjin nr.9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore", të ndryshuar *(Trajtuar në faqet 31-77, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 8: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër të rrisë bashkëpunimin dhe të kërkojë informacion të vazhdueshëm, nga institucionet përkatëse që kanë në kompetencë shqyrtimin e vlerësimin e ligjshmërisë së AMTP-ve, si dhe të kufizohen veprimet për pasuritë e përfituara me AMTP, *të cilat janë në proces shqyrtimi, deri në përfundimin e këtij procesi.*

Brenda muajit Dhjetor 2019

9-Gjetje: ***ASHK (ish-ZVRPP) Gjirokastër*** ka regjistruar sipas ***referencës 0048,***pasurin ***113/7, v. 4, faqe 40, që vjen nga v. 3, faqe 174*** për sipërfaqen 1000 m2, me dëshmi trashëgimie testamentare, ***sipas AMTP 4713, 2715 dhe referencës nr. 0528*** pasuritë 77/9, v. 8, faqe 13 dhe 77/ 10 v. 8, faqe 14 pa u kryer veprimet për saktësimin e pasurive sipas AMTP në kundërshtim me pikën 2 të VKM nr. 994, datë 09.12.2015, dhe nuk ka njoftime për subjektin përfitues, dhe nuk ka deklaratë për saktësimin e pasurive nga subjekti që është dakord me saktësimin, Në kundërshtim me rregulloren nr.184, datë 08.04.1999, Kreu IV-të pika 5 ": Në kundërshtim me rregulloren 184, datë 08.04,1999 "Ndryshim saktësim emri" bërë ndërim emri pa u saktësuar emri i subjektit përfitues, dhe ndërrimi i përfaqësuesit të familjes bujqësore sipas certifikatës familjare dhe deklaratën e anëtarëve të tjerë të familjes për zgjedhjen e një përfaqësuesi të ri të familjes *(Trajtuar në faqet 31-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 9: ***Agjencia Shtetërore e Kadastrës(ish-ZVRPP) –Gjirokastër, Drejtori i ASHK të marrë masa*** për regjistrimin e pasurive përfituar me dëshmi trashëgimie dhe sipas AMTP bazuar në shkeljet e konstatuara, per regjistrimin e tyre në vijimësi në zbatim të pikës 2 të VKM nr.994, datë 09.12.2015, si dhe për korrigjimin, ndërrimin e emrit në zbatim të rregullores nr.184, datë 08,04.1999 "Ndryshim saktësim emri".

Brenda datës 31.12.2019

10-Gjetje: ***Nga Agjencia Shtetërore Kadastrës(ish-ZVRPP) Gjirokastër janë regjistruar pasuri të përfituara në zbatim të VKM 432, datë 14.08.1995, i ç'fuqizuar dhe VKM nr. 159, datë 21.03.2006, sipas referencave 0050, 0032,0051,0053,0041, 0045, 0042, 0049, 0047, 0043, sipas referencave 0535, 0076, 0525, sipas referencave 0653, 0675, 0637, 0609, 0629, 0617 në kundërshtim me urdhrin e kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2012, administruar në ZQRPP me shkresën nr. 3191 dhe 3191/1, datë 14.11.2012 pikat 5,6 dhe 7.*** Në listat e pasurive përfituar sipas listave të 0001 nuk evidentohet data kur janë hedhur nga projekti dhe se listat nuk kanë datë të miratimit nga K/Komunës dhe K/Plakut dhe në disa raste pa nënshkrimet e K/Plakut, nuk dokumentohet se kur këto lista kanë ardhur dhe administruar në ZVRPP pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 159, datë 21.03.2006 apo para hyrjes në fuqi të këtij vendimi,

Në KPP rezulton të jetë bërë ndryshimi i KPP me lëshimin e certifikatës ***nga familjare në Individuale,*** pa urdhër nga regjistruesi apo vendim Gjykate, ***në kundërshtim me pikën 3, 3.3. dhe 3.3.3, "Pranimi dokumenteve për regjistrim", në zbatim të rregullores nr. 184, datë 08.04.1999.***

Nuk rezulton të jete zbatuar UKM nr. 2, datë 12.09.2012"Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" pika 2-3, nuk është plotësuar shtojca 1 *(Trajtuar në faqet 41-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 10: Agjencia Shtetërore e Kadastrës(ish ZVRPP) Gjirokastër, Drejtori i ASHK të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2014 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara, të evidentuara sipas referencave **0050, 0032,0051,0053,0041,0045,0042,0049,0047, 0043,** sipas referencave ***0535, 0076, 0525 dhe sipas referencave 0653, 0675, 0637, 0609, 0629, 0617,*** si pasuri të përfituara në kushtet e mungesave në dokumentacion, nënshkrimin e listave dhe ndryshimin e statusit në KPP pa ndonjë akt dhe pa urdhër të Regjistruesit.

Brenda datës 31.12.2019

11-Gjetje*:* Agjencia Shtetërore e Kadastrës(ish-ZVRPP) Gjirokastër sipas vendimit të gjykatës nr. nr. 464, date 17.09.2015 ka regjistruar pasuri bazuar AMTP të plotësuara nga KQ në kundërshtim me **VKM nr.994, date 09.12.2015 pika 3, 3, 4 dhe ligjin nr.171/2014 "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore në pronësi të përfituesve e në përdorim të tokës bujqësore** sipas referencave **0471, 0525, 0520, 0519, 0508, 0516, 0553, 0596, 0594, 0593** përfituar sipas VKM nr.452, date 17.10.1992 dhe evidentohen të paregjistruara **22 AMTP dërguar nga KQ plotësuar në tejkalim të kompetencave** të pa regjistruara nga ana e ASHK(ish ZVRPP) Gjirokastër. Për këto pasuri te regjistruara dhe të pa regjistruara, nga **Prefekti Astrit Aliaj dhe Drejtori i KVTP Prefektura Gjirokastër M K** i është dërguar informacion ASHK(ish-ZVRPP) Gjirokastër **me shkresën nr, 993, datë 30.03.2018 ku bën me dije ASHK(Ish-ZVRPP)** 32 AMTP të plotësuara nga KQ që janë në proces verifikimi *(Trajtuar në faqet 31-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 11: Agjencia Shtetërore Kadastrës(ish-ZVRPP) Gjirokastër, Drejtori të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2014 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara, të evidentuara sipas referencave **0471, 0525, 0520, 0519, 0508, 0516, 0553, 0596, 0594, 0593, deri në shqyrtimin përfundimtar nga KVTP zona Kadastrale 3701-VALARE** si pasuri të regjistruara në kundërshtim në zbatim të pikës 2 të VKM nr.994, datë 09.12.2012 dhe 171/2014 sipas AMTP të plotësuara nga KQ edhe në tejkalim të kompetencave të tij sikurse përcaktohet në dispozitat ligjore që i jep ligji 171/2014, VKM nr.452, datë 17.010.2014 dhe VKM nr. 994, datë 09.12.2015 dhe të kërkohet edhe njëherë verifikimi i titujve të pronësisë per 32 AMTP të kërkohet edhe një here verifikimi i titujve të pronësisë në zbatim të pikës 2 të VKM nr. 994, datë 09.12.2012.

Brenda datës 31.12.2019

12-Gjetje: ZVRPP Gjirokastër ka regjistruar dhe kryer veprime për pasurinë nr. 186/3, volum 5, faqe 121, ZK 1053, sipas referencës nr. 0267, të përfituar me kontratë shitje nga Seksioni i Financës së Këshillit të Rrethit Gjirokastër, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi shitja e truallit është kryer në mungesë të miratimit për shesh ndërtimi nga Këshilli Bashkisë Gjirokastër dhe të pa përcaktuar asnjë lloj destinacioni, për rrjedhojë* regjistrimi i truallit me ***sipërfaqe sipërfaqe 1080 m^2***, është kryer ***bazuar në dokumentacionin ligjor, i cili nuk mund të shërbejë si Titull Pronësie,*** ndërsa nga punonjësit e ish ZVRPP- nuk janë verifikuar elementet e formës dhe përmbajtjes së aktit, sa vepruar ***në papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 3 të ligjit nr.7980, datë 27.07.1995 "Për Shitblerjen e trojeve", i ndryshuar dhe UKM nr.2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" *(Trajtuar në faqet 77-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 12: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës "1" neni 5 dhe pikës 1 neni 59, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme**", bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të**

nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë 186/3, volum 5, faqe 121, ZK 1053, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor, që shërben për fitimin e pronësisë.

Brenda muajit Dhjetor 2019

13-Gjetje: ZVRPP Gjirokastër sipas referencës nr. 16965, ka regjistruar dhe kryer veprime për pasurinë nr. 15/24, volum 36, faqe 213, ZK 8541 dhe RH nr. 102, datë 28.05.2019, të përfituar me kontratë shitje nga Seksioni i Financës së Rrethit Gjirokastër, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi shitja e truallit është kryer me destinacion si truall nën objektin e privatizuar, për të cilin nuk asnjë tagër ligjor, për rrjedhojë* regjistrimi i truallit me ***sipërfaqe sipërfaqe 58 m²***, është kryer ***bazuar në dokumentacionin ligjor, i cili nuk mund të shërbejë si Titull Pronësie,*** ndërsa nga punonjësit e ish ZVRPP- nuk janë verifikuar elementet e formës dhe përmbajtjes së aktit, sa vepruar ***në papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 3 të ligjit nr. 7980, datë 27.07.1995 "Për Shitblerjen e trojeve", i ndryshuar dhe UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" *(Trajtuar në faqet 77-91, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 14: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës "1" neni 5 dhe pikës 1 neni 59, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme**", bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 15/24, volum 36, faqe 213, ZK 8541 dhe RH nr. 102, datë 28.05.2019, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Brenda muajit Dhjetor 2019

14-Gjetje: ZVRPP Gjirokastër në **1 rast**, sipas referencës nr. 16482, ka regjistruar pasurinë nr. 38/58+1-4, apartament me sipërfaqe 51.6 m², volum 36, faqe 166, ZK 8541, të përfituar nga privatizimi si palë shitëse Bashkia Gjirokastër, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi apartamenti i tjetërsuar nuk bën pjesë në fondin e banesave sociale dhe bashkia nuk asnjë tagër ligjor për shitjen e kësaj pasurie, për rrjedhojë* regjistrimi i pasurisë, është kryer ***bazuar në dokumentacionin ligjor, i cili nuk mund të shërbejë si Titull Pronësie,*** sa vepruar ***në papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" ligjin nr.9321, datë 05.11.2004 "Për privatizimin e objekteve shtetërore e banesave", UKM nr.2, datë 12.09.2012, VKM nr.97, datë 03.02.2008 "Për procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992" *(Trajtuar në faqet 77-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 15: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 38/58+1-4, volum 36, faqe 166, ZK 8541, **deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor që shërben për fitimin e pronësisë.**

Brenda muajit Dhjetor 2019

15-Gjetje: ZVRPP Gjirokastër në **1 rast**, sipas referencës nr. 15799, ka regjistruar pasurinë nr. 14/48+1-1, apartament me sipërfaqe 81 m², RH nr. 424, datë 14.12.2017, ZK 8541, të përfituar nga privatizimi si palë shitëse EKB, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi kontrata e privatizimit nuk është lidhur para noterit dhe dokumentacioni tjetër shoqërues nuk është origjinal, për rrjedhojë* regjistrimi i pasurisë, është kryer ***bazuar në dokumentacion të pa rregullt dhe jo origjinal, i cili nuk mund të shërbejë si Titull Pronësie,*** sa vepruar ***në papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjin 7652, datë 23.12.1992", "Për privatizimin e banesave shtetërore", i ndryshuar, UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen

nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" *(Trajtuar në faqet 77-91, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 16: Drejtori i Drejtorisë Vendore ASHK Gjirokastër të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 14/48+1-1, regjistruar në RH nr. 424, datë 14.12.2017, ZK 8541, **deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor që shërben për fitimin e pronësisë.**

Brenda muajit Dhjetor 2019

16-Gjetje: Ish/ZVRPP Gjirokastër **në 1 rast** ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***Origjina e pronës kontrata e privatizimit të banesës është e pa nënshkruar nga blerësi, gjithashtu nuk është bërë verifikimi nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër***. Veprime këto në papajtueshmëri me pikat 8.1, kreu IV të Rregullores Nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të UKM Nr. 2, Datë 12.09.2012 me pikën II.i. pikën II.iii. të shkresë nr. 1969 prot, datë 23.03.2012 të ZQRPP "Rregullorja mbi monitorimin e regjistrimit fillestar". ne dokumentin nr. 892 prot. datë 07.02.2008 "Procedurat e Kontrollit të Regjistrimit Fillestar", shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5348 prot., date 18/10/2011, dhe shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5985 prot, date 16/11/2009. Udhëzimi nr. 79, datë 09.05.2003 i ZQRPP "Regjistrimi fillestar sporadic të pasurive të pa lujtshme në zonat urbane" *(Trajtuar në faqet 77-91, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 17: Drejtori i Drejtorisë ASHK Gjirokastër të marrë masa, që në bazë të pikës pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të marrë masa për të mos kryer veprime** për pasurinë volum 1, faqe 59, nr. 16/90+1-8, ZK 8542, **deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Brenda muajit Dhjetor 2019

17-Gjetje: Ish/ZVRPP Gjirokastër **në 1 rast** ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***Origjina e pronës kontrata e privatizimit të banesës nuk përputhet emër mbiemër pasi në të citohet [redacted] ndërsa në vendimin nr. 60, datë 28.06.2018 për përfundimi e procedurave të privatizimit citohet [redacted], gjithashtu nuk është bërë verifikimi nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër***. Veprime këto në papajtueshmëri me pikat 8.1, kreu IV të Rregullores Nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 "Për punën e zyrës se regjistrimit te pasurive te paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të UKM nr. 2, Datë 12.09.2012 me pikën II.i. pikën II.iii. të shkresë nr. 1969 prot, datë 23.03.2012 të ZQRPP. ne dokumentin nr. 892 prot. datë 07.02.2008 "Procedurat e Kontrollit të Regjistrimit Fillestar", shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5348 prot., date 18/10/2011, dhe shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5985 prot, date 16/11/2009. Udhëzimi nr. 79, datë 09.05.2003 i ZQRPP "Regjistrimi fillestar sporadic të pasurive të pa lujtshme në zonat urbane". *(Trajtuar në faqet 77-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 18: Drejtori i Drejtorisë ASHK Gjirokastër të marrë masa, që në bazë të pikës pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të marrë masa për të mos kryer veprime** për pasurinë volum 1, faqe 58, nr. 16/90+1-7 ZK 8542, **deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Brenda muajit Dhjetor 2019

18-Gjetje: Ish/ZVRPP Gjirokastër **në 1 rast** ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: Origjina e pronës është kontrata e shitblerje Seksioni i financës Rrethi Gjirokastër datë

31.05.1995 ***organ i cili nuk ka patur tagër ligjor për kryerjen e shitjes së trojeve. Vendimi i Gjykatës nuk shprehet për ZVRPP Gjirokastër në cilësinë e të padituri në mungesë, vendim i cili nuk është ankimuar brenda afatit 15 ditor në Gjykatën e Apelit Gjirokastër. Nuk është bërë verifikimi nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër***. Veprime këto në papajtueshmëri me pikat 8.1, kreu IV të Rregullores Nr.184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr.7, datë 07.01.2000 paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të UKM nr.2, Datë 12.09.2012 me pikën II.i. pikën II.iii. të shkresë nr.1969 prot, datë 23.03.2012 të ZQRPP në dokumentin nr.892 prot. datë 07.02.2008, shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5348 prot., date 18/10/2011, dhe shkresën e Kryeregjistruesit nr.5985 prot, datë 16/11/2009. Udhëzimi nr.79, datë 09.05.2003 i ZQRPP "Regjistrimi fillestar sporadik të pasurive të paluajtshme në zonat urbane" *(Trajtuar në faqet 77-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 19: Drejtori i Drejtorisë ASHK Gjirokastër të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë** volum 8, faqe 41, nr.8/132 **ZK 8542, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Brenda muajit Dhjetor 2019

19-Gjetje: Ish/ZVRPP Gjirokastër **në 1 rast** ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: Origjina e pronës është kontrata e shitblerje Seksioni i financës rrethi Gjirokastër datë 01.11.1992 ***organ i cili nuk ka patur tagër ligjor për kryerjen e shitjes së trojeve, dy kontratat janë kopje. Nuk është bërë verifikimi nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër***. Veprime këto në papajtueshmëri me pikat 8.1, kreu IV të Rregullores Nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 me pikën II.i. pikën II.iii. të shkresë nr. 1969 prot, datë 23.03.2012 të ZQRPP. ne dokumentin nr. 892 prot. datë 07.02.2008, shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5348 prot., date 18/10/2011, dhe shkresën e Kryeregjistruesit nr.5985 prot, date 16/11/2009. Udhëzimi nr. 79, datë 09.05.2003 i ZQRPP "Regjistrimi fillestar sporadik të pasurive të paluajtshme në zonat urbane" *(Trajtuar në faqet 77-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 20: Drejtori i Drejtorisë ASHK Gjirokastër të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë** volum 8, faqe 129, nr. 13/113 **ZK 8542, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Brenda muajit Dhjetor 2019

20-Gjetje: Ish/ZVRPP Gjirokastër **në 1 rast** ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***Mungon origjina e pronës, gjithashtu nuk është bërë verifikimi nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër***.
Veprime këto në papajtueshmëri me pikat 8.1, kreu IV të Rregullores Nr.184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 "Për punën e zyrës se regjistrimit te pasurive te paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr.2 të UKM nr.2, datë 12.09.2012 me pikën II.i. pikën II.iii. të shkresë nr.1969 prot, datë 23.03.2012 të ZQRPP. ne dokumentin nr.892 prot. datë 07.02.2008, shkresën e Kryeregjistruesit nr. 5348 prot., date 18/10/2011, dhe shkresën e Kryeregjistruesit nr.5985 prot, date 16/11/2009. Udhëzimi nr.79, datë 09.05.2003 i ZQRPP "Regjistrimi fillestar sporadik të pasurive të paluajtshme në zonat urbane" *(Trajtuar në faqet 77-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 21: Drejtori i Drejtorisë ASHK Gjirokastër të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të

paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë** volum 8, faqe 125, nr.2/261 **ZK 8542, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Brenda muajit Dhjetor 2019

21-Gjetje: ZVRPP Gjirokastër në **3 raste** që ju përkasin referencat : nr. 16621, nr. 15664 dhe nr. 15021, ZK 8541, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme përfituar me leje legalizimi, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi lejet e legalizimit kanë miratuar parcela ndërtimore,* me sipërfaqe më tepër se sipërfaqja takuese sa trefishi i sipërfaqes së bazës së objektit, ndërsa *nga ZVRPP Gjirokastër, nuk janë verifikuar elementët e formës e përmbajtjes së Aktit Administrativ të Lejes së Legalizimit në lidhje me sipërfaqen e parcelës ndërtimore,* për rrjedhojë është miratuar në favor të poseduesve të lejeve të legalizimit, më tepër ***trualli me sipërfaqe totale prej 263.6 m²,*** sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën"a" neni 25, nenin 49, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 17 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar dhe me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" *(Trajtuar në faqet 91-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

